



GJOKË DABAJ

Autori i librit : Gjokë Dabaj
Titulli i librit: Strategjia e Shqiptarvet
Korekturë teknike: Liliana Mero
Arti Grafik: Erol Koçi
Kopertina: IRISOFT

© Të gjitha të drejtat e ribotimit apo botimeve në gjuhë të huaja janë të rezervuara.

Të gjithë përfitimet, qofshin honorifikues apo materialë, u takojnë pasardhësve, por me kusht që ata t'i kenë ruajtur gjuhën shqipe dhe vlerat e tjera thelbësore të krahinës nga rrjedhin e të Kombit.

IA KUSHTOJ

SAMI FRASHËRIT,

KRYESTRATEGUT,

NË MUGULLIN E TË RILINDURIT TONË KOMBËTAR.

NË KËRKIM TË SYVET...

Në këta çaste po më vijnë në mendje **kuajt e verbër të Ismail Kadaresë**. Përballë të gjitha përpjekjeve për të gjetur një rrugë sa më të sigurtë drejt së ardhshmes, ne iliro-arbro-shqiptarët, në të gjitha kohët, filluar qysh prej mbretëritvet të Ilirisë (e mbase edhe më parë), duket se na ka shoqëruar dhe mbisunduar **sindroma fatale e kuajvet të verbër**. A do të arrijmë më në fund që **t'i vëmë sy, t'ia transplantojmë një palë sy**, këtij lloj “*kali*”, i cili është më i fismi midis të gjithë “*kuajve*” të tjerë?!

... NË KËRKIM TË GJENERALËVET

Sipas Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, botim 1980, STRATEGJI është *arti dhe shkenca e përgatitjes dhe e drejtimit të veprimevet të gjërë me njësi të mëdha ushtarake ose të luftës në tërësi*. Fjala **STRATEGJI**, thonë, vjen nga greqishtja στρατηγία (strategia). Ndërkaq, **STRATEG** do të thotë: *komandant që drejton veprime të gjërë luftarakë, njohës i zotësisë për të luftuar*.

Por ne, shprehjen **STRATEGJI E SHQIPTARËVET**, do ta marrim me kuptimin e një tërësie parimesh e rregullash konkretë, hartuar me qëllimin që t'u tregojë shqiptarëve **çfarë duhet të bëjnë e çfarë nuk duhet të bëjnë sot, në mënyrë që e ardhshmja t'u dalë më e mirë se e tashmja**. Thënë më shkurt, strategji për ne do të thotë **të dimë ç'na del nesër nga kjo që po bëjmë sot**. Ose: **të dimë ç'të bëjmë sot, në mënyrë që nesër të mos na dalë keq**.

Kuptohet, fjalët *sot* dhe *nesër* po i përdorim, sipas natyrës së gjuhës shqipe, me domethënie *kohë e tashme* dhe *kohë e ardhshme*. Pra, shqiptarët, si edhe popujt e tjerë, duhet të ecin me një synim sa të jetë e mundur më të qartë për të ardhshmen e vet, por edhe të pasardhësve të vet. Kjo ka rëndësi:

Edhe të pasardhësve!

Për ta arritur këtë qëllim tonin të madh, del e domosdoshme të plotësohen së paku 3 kërkesa: Kombi duhet të ketë një palë “*gjeneralë*” të aftë për t’i shkruar strategjitë dhe një palë tjetër “*gjeneralësh*” për t’i vënë në jetë ato strategji. “*Gjeneralët*” që shkruajnë janë shkencëtarët, “*gjeneralët*” që e vënë në jetë strategjinë janë politikanët dhe shtetarët në përgjithësi. Por ka në praktikën e popujve edhe një lloj tjetër “*gjeneralësh*”. Këta janë **udhëheqësit shpirtërorë të kombit**, propaganduesit e përditshëm të strategjive tashmë të shkruara, madje imponuesit (me fuqinë e popullit, në rastet kur është e domosdoshme) si dhe modifikuesit e përmirësuesit e herëpas’herëshëm të tyre. **Asnjë strategji nuk mund të ketë kontinuitet, nëse mbështetet vetëm te ata që kanë pushtetin.** Duhet doemos të ketë ndërthurje, kombinim, midis udhëheqjes shpirtërore të një kombi, e cila qëndron mbi të gjithë dhe është konstante, dhe strukturave shtetërore, të cilat mund t’i përkasin, por edhe mund të mos i përkasin tërësisht të njëjtit komb.

Cilësi thelbësore e një strategjie është: **T’i marrë parasysh rrethanat, por të mos u dorëzohet rrethanave.** Ajo mbështetet në veprimet shumë të mençur dhe thellësisht të vetëdijshëm të subjekteve. Pëndryshe, nuk meriton të quhet strategji.

Cilësi tjetër thelbësore: **Të gjithë llojet e “gjeneralëve”, po deshën që t’u shkojë populli prapa, duhet të jenë atdhedashës të përkushtuar.** S’qenë të tillë, “*ushtria*” së cilës ata i prijnë, mbetet sërish llahtarisht e verbër dhe rroposet, shembet lemerishëm turma-turma në gremina e në rrëpira.

Mirëpo, “*gjenralët*” dalin nga vetë “*ushtria*”.

Rrjedhimisht, përgjegjësia është prapë e vetë “*ushtrisë*”, madje e secilit ushtar një për një, nëse lejon të komandohet prej kopukëvet dhe prej askushëvet.

Ky do të jetë edhe qëllimi kryesor i këtij libri: Të mësojmë si ta bëjmë dhe si ta vëmë në jetë një strategji sa më të mirë për Kombin, të cilit i përkasim.

MAJA LAPSASH... JETË ROZAFASH

Çdo komb ka nevojë për strategji, por Kombi ynë më shumë se cilido tjetër. Thënë ndryshe: Të gjithë njerëzit kanë nevojë për kujdes mjekësor, por i sëmuri më ngutshëm se kushdo. Është një e vërtetë e hidhur kur shohim që ne shqiptarët më një anë i kemi pasë karakteristikat, predispozitat, për të qenë shumë më mirë, më anë tjetër, jemi aq keq, sa jemi cilësuar dhe vazhdojmë të cilësohemi si kombi më i prapambetur në Evropë.

Nuk duhet të lejojmë të mbetemi në këtë gjendje. Nuk duhet të mbetemi në pozitën e bredhjevet qorrazi nëpër mjegull, pa e ditur ku duam të mbërrijmë. Ku duam të mbërrijmë, por edhe ku mund të mbërrijmë.

Nuk pretendojmë që kemi hartuar strategjinë më të mirë të mundshme, por jemi të bindur se kjo rrugë, nisur e mos bitisur prej shumë së tjerësh, shekuj pas shekujsh, apo bitisur përgjysmë e copa-copa, duhet të marrë fund njëherë e mirë. (Natyrisht, nëse rrjedhat e historisë nuk na zhgënjejnë, siç na kanë zhgënjyer thuajse në të gjitha kohët.)

Sa për të hyrë në thelbin e thelbit të çështjes, po e krahasojmë veten psh me **izraelitët** apo me **grekët**. Edhe ata kanë në histori një jetë shumë të gjatë, por duhet vërejtur midis nesh dhe atyre një dallim thelbësor dhe tepër domethënës. Ata, ndonëse kanë qenë etnose numerikisht të vegjël, nuk janë zhdukur, por përkundrazi, kanë krijuar nga një histori të madhe. Secili në mënyrën e vet. Kurse ne kemi qenë një etnos i madh, madje shumë i madh (përfytyro Ilirinë), por kemi ardhur duke u ngushtuar, duke u copëtuat dhe duke u zvogëluar. Cili është shkaku?!

Shkaku kryesor, sipas nesh, është se **ata kanë arritur të vënë shkrimin në përdorim**, gjë që ne nuk e kemi bërë dot.

Nuk besojmë të mos kemi pasur përpjekje individësh apo grupesh për t'i dhënë **shkrimit** vendin që i takon në jetën e një etnosi, por nuk kemi arritur, nuk ia kemi dalë dot që **shkrimin, në gjuhën tonë**, ta përdorim gjithanësisht në jetën e përditshme.

Ata, **hebrenjtë dhe grekët**, kanë qenë popuj shumë të vegjël dhe me siguri do t'ishin zhdukur prej kohësh, po të mos u kishin kushtuar rëndësinë e duhur atyre milingonavet të vockla që quhen **shkronja**, për t'i përdorur **në gjuhën e vet**. Po ta kishim "**ulur**" edhe ne veten aq "**poshtë**" sa të merreshim me punë të tilla "**të vogla**", me siguri do t'ishim sot një komb shumë madh. Nuk e dimë si ka ndodhur në të kaluarën, por në 2 a 3 shekujt e fundit kanë qenë pikërisht **shkrimi dhe shkollimi në gjuhën tonë**, që armiqtë tanë kanë dashur të na i vrasin. Kanë dashur të na i vrasin dhe na i kanë vrarë, më shumë për fajin tonë se për fajin e tyre.

Nuk duam të themi me këtë që shkrimi në gjuhën vetjake është çdo gjë. Por themi me bindje që ai është **themeli**. Për të ngritur një kështjellë apo urë, duhen, përveç themelevet, edhe shumë gurë, llaç, drurë e tjegulla, por pa bëje kështjellën, qoftë edhe kasollen, pa ia bërë më parë **themelin!** Përvoja jonë në këtë punë është më tepër se monstrooze. Që të na qëndrojnë themelet e kështjellavet, ne nuk kemi bërë kalkulime me lapsa, por kemi murosur atje nuse të reja, **Rozafa**. Dhe mburremi që i kemi detyruar muret e kështjellavet të mos na rrënohen!

Një vërë në ujë kemi bërë! S'e kemi, të saktë dhe të ruajtur, as edhe një prej tyre! Të gjitha na janë rrënuar! Shko në Greqi, në Itali apo në Francën, krahasimisht shumë më të vonë se ne, dhe shih sa kështjellat, sa skulpturat, sa monumentet, i kanë në këmbë dhe sa mirë e kanë të siguruar jetën e përditshme: Punë, ushqim, veshmbathje, banesa, ambiente të këndshëm!

Ne, ndërkaq, vazhdojmë ta mbulojmë me baltë vetëveten.

CILI ËSHTË ATDHEU I SHQIPTARËVET?

Të pyesësh një shqiptar në sh XXI se cili është Atdheu i shqiptarëve dhe të mos dijë të të përgjigjet ekzakt, është sa çudi aq edhe turp i pakapërdishëm. Na ngushëllon vetëm fakti që nuk jemi të vetmit, sepse së paku këtu në Ballkan një pjesë e mirë e popujvet, psh sërëbet, grekët etj, nuk e dinë me saktësi cili është atdheu i tyre.

Atdheu i shqiptarëve është SHQIPËRIA. Me emërtimin **SHQIPËRI** ne nënkuptojmë atë hapësirë gjeografike e cila përfshihej nën këtë emër para se të fillonte të copëtuarit e saj: **Prej Tivarit në Spuzh, Prijepole, Rrasë (të quajtur Rashkë), Bllacë, Prokuple, Leskovc, Vranjë, Kumanovë, Veles, Musinë, Arnisë, Grebenë, Meçovë, Artë, Prevezë dhe prapë në Tivar...** (Duke i përfshirë brenda kufijvet tanë të gjithë këta vende që i përmendëm.) Pra, me makrotoponimin **SHQIPËRI** ne kuptojmë atë hapësirë **gjeografike** që kanë kuptuar edhe rilindësit tanë në sh XIX, pavarësisht nga parcelimet politiko-shtetërorë që i janë bërë këtij vendi në ndërkohën prej sh XIX e këndeje. Dokumente që e përcaktojnë këtë hapësirë që quhet **SHQIPËRI**, ka me qindra. Ne nuk kemi asnjë të drejtë dhe asnjë arsye as ta **zmadhojmë**, as ta **ndryshojmë** dhe as ta **zvogëlojmë** Atdheun e të parëve tanë.

Arsyetim: 1. Ne vërtet jemi pasardhës të ilirëve, por nuk jemi trashëgues të **krejt** atdheut të ilirëve. Kjo do të thotë që ne nuk kemi të drejtë ta **zmadhojmë** nocionin gjeografik **SHQIPËRI**. 2. Ne vërtet jemi pasardhës të arbërve, etnitet që u krijua në Mesjetë në një pjesë të trojeve të ish-ilirëve, prej ish-ilirëve,

por nuk jemi trashëgues **pikë për pikë** të tokavet të arbërvet. Kjo do të thotë që ne nuk kemi të drejtë ta **ndryshojmë** nocionin gjeografik **SHQIPËRI** as sipas kufinjvet ku shtriheshin viset e arbërvet. 3.**SHQIPËRINË** vërtet e kanë copëzuar **shtetërisht** disa herë, që nga gjysma e dytë e sh XIX e këndeje, por ne prapë nuk na lejohet as ta **copëzojmë** atë, as ta **zvogëlojmë** atë **edhe gjeografikisht**. Çështja e kufijvet të shtetevet është temë tjetër, çështja e shtrirjes gjeografike të një vendi është temë tjetër.

Të tjerët mund të duan, dhe duan, dhe kanë dashur, dhe kanë bërë ashtu si kanë dashur, në një shumicë rastesh, por ne nuk na lejohet të pranojmë, të paktën me fjalë, të folur apo të shkruar, atë çfarë mund të duan të tjerët. Ne nuk mund të pranojmë atë çfarë duan sërëbët, ne nuk mund të pranojmë atë çfarë duan grekët ose çfarë bëjnë në praktikë a thonë 2 fqinjët tanë më të vegjël, sllavomaqedonët e malazezët. Këtu nuk është fjala për miq apo për armiq. Këtu është fjala për një qëndim shkencor ndaj problemit, i cili, po të mos trajtohet si duhet, shkakton dëme të papërfytyrueshëm.

Po marr si shembull, jo prerësit, copëtuesit e Atdheut tonë, por njërin prej miqvet tanë më të dëshmuar, z.Noen Malkolm. Ai thotë që Anamoravën nuk duhet ta quajmë **Kosovë Lindore**. Mirëpo ne nuk mund të jemi të një mendimi me z.N.Malkolm, me gjithë respektin që kemi për të. Anamorava, përfshirë këtu edhe Vranjën, është pjesë e Kosovës, **Kosovë Lindore**, dhe, në kuadrin e ktrejt Atdheut tonë, është pjesë e **Shqipërisë Verilindore**.

Që të mund të ndryshohen emrat e vendeve, duhet së paku të ndryshojë emri i popullit që ua ka dhënë emrin atyre vendeve. Duhet, pra, të zhbëhet ai popull ose të kalojë në një cilësi të re. Madje edhe në të tillë raste, emri i vendit shpeshherë ruhet, duke e trashëguar popuj të tjerë. Kështu, për të ndryshuar emrin e Shqipërisë, të cilësdo pjesë të saj, do të duhej të shuhej

krejt Kombi ynë dhe prapë ai emër mund të mos ndryshohej. Por, përderisa kjo ende nuk ka ndodhur, përderisa ne ende nuk jemi zhdukur, as **ATDHEU I SHQIPTARËVET** nuk ka pse të shfityrohet. Ai mbetet ai që ka qenë dhe emri i tij mbetet **SHQIPËRI**.

Me qenë se jemi te emërtimi, të ndalemi pak edhe te e shumëpërfolura “*Shqipëri e Madhe*”. Thamë pak parë që ne nuk mund të nënkuptojmë me *Shqipëri* krejt vendet që përfshiheshin nën emërtimin *Iliri*. Nëse me *Shqipëri* do të nënkuptonim tokat ku dikur shtrihej Iliria, me të gjithë nënemërtimet e saj, pikërisht kjo do të vërtetonte që ne pretendojmë një “*Shqipëri të Madhe*”. Do t’ish vërtet një marrëzi, sepse një e tillë “*Shqipëri*” do të fillonte në Trieste, do të shkonte në Singidunin e dikurshëm, Beogradin e sotëm, do të zbriste drejt Selanikut, do të kthehej te gjiri i Ambrakisë e prej andej, përmidis të 2 detrave, do të mbyllej sërish me Triesten. Do t’ish vërtet një halucinacion.

Por, në anë tjetër, kur ne të kërkojmë emërtim shkencor të Atdheut tonë të kohës në të cilën jetojmë, askush nuk mund të na akuzojë se po kërkokemi “*Shqipërinë e Madhe*”. Kjo Shqipëri, të cilën ne po kërkojmë ta **quajmë** të tillë, qoftë edhe të ndarë siç është në disa shtete, është fare e **vogël** në krahasim me sa duhej të ishte, nëse të parët tanë, ilirët, do ta kishin pasur një strategji për vete, e pakta një të atillë strategji siç e kishin bashkëkohësit e tyre, latinët.

Do përmendur edhe fakti që disa pjesë të kësaj **SHQIPËRIE**, kaq **të vogël**, prapëseprapë janë tjetërsuar etnikisht në këtë ndërkohë prej sh XIX e këndej. Psh trevat e Toplicës, Kosanicës, Kurshumlisë, Leskovcit, Vranjës, Podgoricës, Follorinës etj tashmë banohen fare pak ose aspak me shqiptarë. Ne nuk mund të pretendojmë që krejt këto treva të përfshihen në një shtet tonin që ndoshta do të mund ta krijojmë në të ardhshmen. Por kjo nuk duhet të na lajthitë a të na pengojë kurrsesi që ato toka të vazhdojmë t’i quajmë toka shqiptare. Ato do të vazhdojnë

të quhen pjesë gjeografike të **Shqipërisë** deri sa të ekzistojë këtu në Ballkan një komb që quhet **Komb Shqiptar**. Banorët e atyre vendeve, që tashmë nuk janë shqiptarë, do të quhen kolonistë, siç quhen të tillët në çdo vend tjetër të Botës. Në Belfast mund të rrojnë me mijëra anglezë a skocezë, Belfasti mund të mbetet edhe 1000 vjet të tjerë në të njëjtin shtet me anglezët dhe skocezët, por Belfasti prapë do të quhet **qytet i Irlandës**.

Përse të ndodhë ndryshe me Shqipërinë? Se e panë të arsyeshme malazezët dhe sllavomaqedonët që **Podgoricën** dhe **Shkupin** t'i bëjnë kryeqytete të shteteve të vet, kjo nuk do të thotë që Podgorica dhe Shkupi kanë dalë jashtë Shqipërisë. Fakti që Shkupi dhe Podgorica janë caktuar, janë zgjedhur, si kryeqytete të 2 shteteve nominalisht joshqiptarë, përbën vërtet një problem shumë të madh. Por kjo nuk do të thotë që shqiptarët me një të këtillë "**fakt të kryer**", "**fait accompli**", duhet të pajtohen, të thonë: "**Epo mirë. Meqë u bë kështu, le të mbertet kështu.**" Natyrisht, kjo nuk do të thotë as të kundërtën: Të merren sëpata e hanxharë dhe të zhbëhen të këtilla punë të pamenduara pjekurisht në kohën e duhur. Për të nxjerrë një qytet, madje jo një qytet, por qoftë edhe një fshat, qoftë edhe një shtëpi të vetme, jashtë një atdheu, ka procedura të gjata, të ndërlikuara dhe shumë të vështira, sepse me përgjegjësi të mëdha para historisë. Ka përplasje diplomatike, ka negociata, ka padi, ka gjyqe ndërkombëtarë, ka referendume dhe prapë, pa vendime të posaçëm parlamentesh, jo një qytet, por edhe një shtëpi nuk mund ta nxjerrësh jashtë atdheut. Të gjithë shqiptarët, por veçanërisht ata që emërtohen si "**truri i kombit**", duhet da kuptojnë mirë: **Nëse do të pajtohemi që Podgoricën dhe Shkupin t'i konsiderojmë si qytete që gjeografikisht ndodhen jashtë Shqipërisë, në të ardhshmen jo të largët shqiptarët do të detyrohen të thonë që edhe Himara, Mitrovica, Korça, Shkodra, ndodhen jashtë Shqipërisë. Shenjat janë pakundërshtueshmërisht të dukshëm, për këdo që ka sy, sidomos prej viteve '90 të shek. XX e këndej.**

Në asnjë dokument ndërkombëtar nuk thuhet shprehimisht që kjo ose ajo pjesë e shkëputur **shtetërisht** prej Shqipërisë nuk do të quhet më **SHQIPËRI**. Ka vetëm vendime kongresesh e konferencash për kufij **shtetërorë**. Janë emërtuar shtetet, Sërbi, Greqi, Mali i Zi, Shqipëri, Maqedoni, më vonë këtyre emërtimeve politikë u janë përshtatur pa kurrfarë logjike edhe emëtimet **gjeografikë**. Emërtime të cilët në radhë të parë janë shprehje e dobësive skandaloze të vetë shqiptarëve.

Po krahasojmë vetëm 2 dëshmi, nga të cilat njëra është e mbëstetur në realitetin gjeografiko-historik, ashtu si duhet, tjetra në realitetin politik-shtetëror, të 2-ja hartuar prej shqiptarësh.

I.10 personalitete të kulturës e politikës shqiptare, midis të cilëve Sami Frashëri nga Përmeti dhe Pashko Vasa nga Shkodra, në një letër që i dorëzojnë ambasadorit francez në Stamboll, z. Furnië, **SHQIPËRINË, në vija të trasha**, duke mos dashur ta ngarkojnë letrën me hollësira, e kanë përcaktuar kështu:

“kufijtë e saj... fillojnë nga Tivari, Shkodra e gjithë malet e banuar me katolikë, Peja, Kurshumlija, Prishtina, Leskofci, Vranja, Shkupi, Përlepi, Manastiri, Follorina, Kosturi, Grebeneja, Pindi, Kolariti, Arta, dhe kalojnë në Gjirin e Ambrakisë” (Krs.Sh.2,f.473)

Koordinatat e **SHQIPËRISË**, sipas këtij dokumenti, janë këto: Në gjërësinë veriore midis gradës 39 dhe gradës 43 e gjysmë (39°-43°,30'), në gjatësinë lindore midis gradës 19 dhe gradës 22 (19°-22°), duke e kaluar pak 22-shin në relacionin Alakin-Bredejë.

Në *Fjalorin enciklopedik shqiptar*, Tiranë 1985, te zëri **SHQIPËRIA**, thuhet kështu:

“Vend në Evropën juglindore, në P(erendim) të Gadishullit Ballkanik, midis koordinatave gjeografike 39°38' dhe 42°39' të gjërësisë V(eriore) dhe 19°16' dhe 21°4' të gjatësisë L(indore).”

Në këtë mënyrë, **vetë shqiptarët** e sh XX kanë lënë jashtë

nocionit gjeografik **SHQIPËRI** dy të tretat e asaj **SHQIPËRIE** që shqiptarët e sh XIX e kishin cilësuar si të tillë. Do të flasim për këto gjëra, më se skandaloze e njëkohësisht **tejet vetëposhtëruese**, në kapitujt që pasojnë.

KOMBI SHQIPTAR

Dallimi midis kombit dhe atdheut qëndron, mes tjerash, edhe në shtrirjen e tyre.

Kombi ka shtrirje më të madhe se atdheu, sepse ai përhapet, derdhet, edhe jashtë atdheut. Kjo ka ekzistuar thuajse në të gjitha kohët, por në shekujt e fundit, sidomos në sh XX e XXI, kjo e vërtetë ka ardhur duke u pranishmuar përherë e më shumë në të gjithë kombet. E kanë këtë dukuri anglezët, francezët, kinezët, indusët, kombet sllavë, kombet zezakë, kombet arabë, grekët. Rasti më për t'u vënë në dukje i dallimit midis vendndodhjes së atdheut dhe vendshtirjes së kombit, është ai i izraelitëvet. Atdheu i tyre i tejlashtë ndodhej aty ku e kanë sot shtetin, ndërsa si komb ata kanë qenë shtrirë prej shumë shekujsh anembanë Globit. Ne kemi ngjashmëri me izraelitët, por kemi edhe dallime.

Me *Komb Shqiptar* kuptojmë atë popull, i cili në kohën tonë, flet dhe shkruan shqip pavarësisht se ku ndodhet, si dhe ata fragmente të këtij populli, të cilët aktualisht nuk e përdorin gjuhën shqipe, apo e përdorin vetëm në të folur, por e dinë se janë shqiptarë ose së paku e dinë të tjerët.

Një pjesë Kombit Shqiptar jeton në Atdheun e vet, në SHQIPËRI, e cila, mbështetur në ç'thamë në kapitullin para këtij, nga perendimi laget prej detratvet Adriatik dhe Jon, nga lindja shkon deri në Moravë, në bërrylin më lindor të saj, si dhe deri në Vardar, në juglindje të Velesit, nga veriu ka për kufinj skajorë Prijepolen, Rrasën, Bllacën e Prokuplen, në jug prek Pindin dhe del në Gjirin e Ambrakisë.

Shqiptarët që jetojnë në Prevezë, në Pargë, në Paramithi, në Janinë, në Filat, në Konicë, në Kostur, në Follorinë, gjeografikisht nuk ndodhen në Greqi, por në Shqipëri. Po kështu edhe grekët që jetojnë në po këta vende, nuk ndodhen në Greqi, por në Shqipëri. Pra, ata grekë jetojnë në shtetin e vet, por jashtë atdheut të vet. Shqiptarët që jetojnë në Manastir, në Prespë, në Resnjë, në Ohër, në Strugë, në Kërçovë, në Dibër, në Gostivar, në Tetovë, në Shkup, në Përlep, në Kumanovë etj, gjeografikisht ndodhen në Shqipëri. Sllavomaqedonët që jetojnë në po këta vende, janë popull i ardhur ose vendës të sllavizuar. Ata nuk kanë tjetër atdhe. Janë, pra, popull imigrant i cili e ka humbur atdheun e vet dhe jeton në Shqipëri. Shqiptarët që jetojnë në Preshevë, në Bujanovc, në Vranjë, në Medvegjë, në Leskovc etj, gjeografikisht nuk ndodhen në Sërbë, por në Shqipëri. Sërbët apo vllëhtë që jetojnë në po këta vende, si dhe në Toplicë, Kosanicë, Kurshumli etj, ndodhen shtetërisht në Sërbë, por gjeografikisht ata janë në Shqipëri. Sërbët, në këtë rast, janë jashtë atdheut të vet, imigrantë, ndërsa vllëhtë janë një etnitet i veçantë, i krijuar në mënyrë specifike në krejt gadishullin tonë dhe ata, kudo që të jetojnë, janë në atdheun e vet. Shqiptarët që jetojnë në Plavë, në Rozhajë, në Podgoricë, në Gusi, në Tuz, në Tivar, në Ulqin, gjeografikisht ndodhen në Shqipëri. Malazezët, që jetojnë në këta vende, gjeografikisht ndodhen në Shqipëri, ndërsa shtetërisht ata janë në shtetin e vet. Në po këta vende, sidomos në Tivar e Podgoricë, ka edhe një numër sërbesh. Ata, as gjeografikisht, as shtetërisht, nuk ndodhen në atdheun e tyre. Ata janë imigrantë të dhjetëvjetëshave të fundit.

Asnjëri prej banorëvev joshqiptarë, me përjashtim të vllëhëvev, sado heret të kenë ardhur këtu të parët e tij, qoftë edhe 13 apo 14 shekuj më parë, kur merret në krahasim me ne shqiptarët, nuk mund të konsiderohet se jeton në atdheun e vet. Pikërisht ky është edhe shkaku kryesor që udhëheqësit

shpirtërorë, strategët, politikanët dhe komandantët e atyre popujve, si të vetmen rrugë për të siguruar një atdhe për vete dhe për pasardhësit e vet, kanë gjetur rrugën e shfarosjes, dëbimit ose tjetërsimit të etnitetit tonë.

SHQIPËRIA është vendrrënja e krejt Kombit Shqiptar. Pra, është Atdheu i të gjithë **shqiptarëvet**, kudo që ndodhen nëpër Botë. Veç shqiptarëvet, **SHQIPËRIA** është vendrrënja edhe e **arbëreshëvet të Italisë**, e **arvanitëvet të Greqisë**, si dhe e **arbëneshëvet të Zarës dhe** e disa të tjerave koloni. Nga mbarëvajtja e pjesës së Kombit tonë brenda Atdheut, (ose nga keqvajtja), varet shumë edhe mbarëvajtja ose mosmbarëvajtja e të gjitha pjesëvet të tjera të këtij Kombi, që aktualisht ndodhen jashtë Atdheut.

Ato pjesë të Kombit tonë që ndodhen jashtë Atdheut tonë, quhen **diasporë shqiptare**. Fjala **diasporë** (διασπορά) është fjalë greke dhe ka domethënie: **shpërndarje**. Me shprehjen **diasporë shqiptare** nënkuptojmë, pra, të gjithë shqiptarët, përfshirë këtu edhe arbëreshët, arvanitët etj, që ndodhen **të shpërndarë** nëpër vende të ndryshëm të Botës.

Diaspora më e madhe shqiptare ndodhet në shtetin **turk**. Pas kësaj, për nga numri, renditet diaspora shqiptare në shtetin **grek**, por pa përfshirë aty shqiptarët që jetojnë në veri të vijës Pind–Gjiri i Ambrakisë. Shqiptarët që jetojnë në veri të vijës Pind–Gjiri i Ambrakisë nuk janë diasporë. Ata, siç e thamë, jetojnë në Atdheun e vet.

Diaspora të tjera shqiptare janë:

1. Shqiptarët që jetojnë në shtetet e Evropës Perendimore (Itali, Zvicër, Austri, Gjermani, Francë, Belgjikë, Hollandë, Luksemburg, Spanjë, Portugali, Angli, Irlandë, Islandë, Danimarkë, Norvegji, Suedi, Finlandë). Në këtë diasporë shqiptare, shumë të shpërndarë, përfshihen, si shqiptarët që janë lagruar së voni prej Atdheut të vet, dmth. prej shtetit që quhet

Republika e Shqipërisë, prej shtetit që quhet Republika e Kosovës, prej shtetit që quhet Republika e Maqedonisë, prej shtetit që quhet Republika Greke, prej shtetit që quhet Mali i Zi dhe prej shtetit që quhet Sërbi, si dhe arbëreshët që kanë shkuar atje nga Italia Jugore, arvanitët që kanë shkuar atje nga Greqia dhe arbëneshët që kanë shkuar atje nga Zara e Dalmacisë. Aty përfshihen edhe shqiptarët që kanë shkuar atje nga Turqia.

2. Shqiptarët që jetojnë në shtete të tjerë të Evropës: Në Rumani, në Kroaci, në Slloveni, në Bullgari, në Ukrainë, në Poloni, në Rusi e ndonjë tjetër.

3. Shqiptarët që jetojnë në Amerikën Veriore, SHBA dhe Kanada. Edhe në këtë diasporë bëjnë pjesë, si shqiptarët të larguar në 2 shekujt e fundit prej Atdheut tonë, ashtu edhe arbëreshët e Italisë, arvanitët e Greqisë, arbëneshët e Dalmacisë dhe shqiptarët e Turqisë.

4. Shqiptarët që jetojnë në Australi dhe në Zelandë të Re, në Indonezi, në Kinë, në Indokinë, në Kore, në Japoni. Edhe për këta vlen i njëjti përcaktim: Aty përmbliidhen si emigrantët nga Shqipëria, prej Pindit deri në Kopaonik e Jabllanicë, ashtu edhe arbëreshët, arvanitët, arbëneshët e Zarës dhe shqiptarët e Turqisë.

5. Shqiptarët që jetojnë në vendet e Lindjes së Afërt dhe në Afrikë: Egjipt, Siri, Liban, Emirate të Bashkuar, Libi, Tunizi, Algjeri, Marok etj, qofshin ata të hershëm apo të vonë.

6. Shqiptarët, arbëreshët, arvanitët, arbëneshët, që jetojnë në shtetet e Amerikës Jugore.

7. Shqiptarë, arbëreshë, arvanitas e arbëneshë, që mund të gjenden nëpër vendet që ne nuk i shënuam këtu.

Numerikisht, diaspora shqiptare është shumë më e madhe se numri i shqiptarëve që jeton në vetë Atdheun e tyre. Rëndësia e kësaj diaspore, për vetë faktin se ajo është shumë e përhapur, e kudogjendur në krejt Globin, është shumë e madhe, deri në shkallën të thuash të pazëvendësueshmërisë përse i përket

së ardhshmes dhe progresit të Kombit tonë. Ajo rëndësi konkretizohet kryesisht në 3 fusha:

1. në fushën politiko-diplomatike,
2. në fushën ekonomike ,
3. në fushën e afirmimit, të ruajtjes dhe të konsolidimit të identitetit tonë kulturor kombëtar.

Mjafton të sjellim këtu vetëm 1 shembull: Një shqiptar nga Tivari, shestanas me prejardhje, në vitet e rinisë së tij as që donte të dëgjonte për emrin *shqiptar*. Me gjithë sqarimet këmbëngulës që i ishin bërë prej një të afërmi të familjes, ai prapë nuk kish pranuar as të mësojë për të folur shqip, as ta quajë veten shqiptar. Më vonë, puna ia pat sjellë që të shkonte për të jetuar në SHBA. Pas disa vjetësh, autori i këtij libri e takon këtë bashkëkrahinas të vetin rastësisht në një familje. Po fliste me pëzemërsi, madje në pjesën më të madhe po fliste shqip. Herë të tjera s’kish ndodhur kështu. “*A e dini si ka thënë ky?*”, sqaroi njëri prej të pranishmëve, “*Ka thënë: M’është dashë me shkuo n’Amerikë për me marrë vesht se jam shqyptar.*”

Ky është Kombi Shqiptar!

Por problemet që kanë, si pjesa e Kombit tonë brenda Atdheut, i ndarë e i stërndarë në një varg shtetesh, si diaspora e këtij Kombi, e përhapur në krejt planetin tonë, janë aq të shumtë, sa ata as që mund të vihen në rrugën e zgjidhjes, pa **hartuar** një **strategji** sa më të saktë e sa më të arsyeshme dhe pa e **zbatuar** atë **strategji** me serozitetin dhe preokupimin më të madh.

**TANI PO HUAZOJMË PREJ SAMIUT
3 TITUJT E 3 KAPITUJVET**

“SHQIPËRIA, Ç’KA QENË?”

SHQIPTARËT DUHET TË DINË KUSH KANË QENË

Që të mund të pohosh se je dikushi, në radhë të parë duhet ti vetë të dish kush je. Për ne shqiptarët është një fatkeqësi e madhe që, jo vetëm një shumicë e jona, por edhe në shkallë dijetarësh, vërtitemi rreth disa njohurive që as përafërsisht nuk janë të plota. Në masën e gjërë të Kombit vihet re një huti e vërtetë. Njerëzit e dinë që janë shqiptarë, por më tutje nuk dinë të ta thonë as edhe një fjalë, në mos për të sharë dikënd: Jugun, Veriun, kosovarët, çamët, malokët, myzeqarët, krahinën fqinje, kushëririn, vëllanë, kumatën. Në një shumicë familjesh, fisesh, fshatrash apo krahinash, tash edhe qytetesh që janë rritur me banorë ti rinj, njohuritë sillen si kali i lidhur pas hurit të lëmit, rreth disa gojëdhënash dhe me kaq duket sikur i quajnë të mjaftueshme njohuritë që kanë për vete.

Si mund të jetë patriot një popull i tillë?!

Është e domosdoshme, pra, që njohuritë jo të plota, konkluzionet e pastabilizuar, tezat ende të pavërtetuara apo tezat që janë hedhur poshtë pa u thelluar sa duhet, të kalohen më me kujdes, më me vëmendje, më seriozisht dhe më me përkushtim, nëpër sitën rigoroze të shkencës. **Albanologjia, ilirologjia** dhe në përgjithësi **ballkanologjia**, në sh XXI do të kenë shumë punë. Duhet jo vetëm të dihet, por edhe të kuptohet shqetësueshëm që në shkencat ballkanologjike ka shumë teori e teza me tendenca thjeshtë etnocide e në drejtim të shqiptarëvet revoltueshëm shqiptarocide. Por ne nuk duhet të merremi fort me revanshe. **Ne duhet të njohim vetëveten!**

Koha parailire.

Duhet t'ia nisim nga fillimi, se në të vërtetë, ashtu nisen të gjitha punët, kur duam të nxjerrim diçka në krye. Ta rishqyrtojmë e ta ritrajtojmë së pari njërin nga problemet tanë më madhorë: **A kemi qenë këtu para se të vijmë helenët në këtë gadishull, apo nuk kemi qenë këtu?** Kjo nuk duhet vetëm të thuhet, por duhet të vërtetohet në mënyrë të atillë që, në të ardhshmen, asnjë helenist apo ballkanolog të mos mund të thotë ndryshe.

S'është fjala për gjithfarë pedantësh të painformuar, që i lexojnë a s'i lexojnë gjithë jetën 7 libra, edhe ata tmerrësisht të njëanshëm, që japin ligjëratat nëpër universitete dhe që botojnë në formë librash konspektet e ligjëratave të veta, si fjalë e fundit e kompetentit, i cili me doemos duhet besuar. Duhet besuar, sepse para emrit të një të tillë "**kompetent**" shkurtesat Ak.Prof.Dr. ta imponojnë detyrueshëm besimin. Fjala është për shkencën e mirëfilltë. Shkencat e mirëfillta, albanologjia, helenistika, sllavistika, krejt ballkanologjia, duhet ta gjejnë me doemos stabilitetin e nevojshëm. Përndryshe, as që mund të ecet më këndeje, pa hasur në probleme deri edhe tragjikë. **Mosnjohjet ose shtrembërimet në filologji sjellin luftëra, sjellin gjakderdhje popujsh.**

Nëse nuk kemi qenë këtu para helenëve, është vetëvetiu e kuptueshme që gjuha dhe kultura helene (greke) në pikëpamje kohe, janë primare në këtë vend dhe pastaj vijmë gjuhët dhe kulturat e popujvet të tjerë, midis të cilëve do të duhej ta gjenin vendin e vet edhe gjuha dhe kultura e shqiptarëve. Por kjo nuk mjafton thjeshtë të thuhet. Kjo kërkon të vërtetohet.

Nëse kemi qenë këtu, kur kanë ardhur helenët (E dihet që ata nuk kanë zbarkuar këtu me kartë e laps në xhep.) atëherë si shpjegohet që të mos hasen albanizma në gjuhën greke? Thënë ndryshe, si shpjegohet që të mos hasen në gjuhën greke

pellazgo-ilirizma, të cilët të mund të krahasohen e zërthehen me ndihmën e shqipes së sotme?

Teza jonë është: O duhet të ketë një numër të madh pellazgo-iliro-albanizmash, jo vetëm në gjuhën e vjetër greke, por në të gjitha sferat e kulturës së tyre, o ne nuk kemi qenë këtu, kur ata kanë ardhur në këtë gadishull.

Po marrim nja 2 a 3 fjalë, për të cilat është thënë që janë **greqizma** të lashtë në gjuhën shqipe: **MAKHANON**, **LAKHANON**, **PRASANON**. Ne na duket se është e kundërta. Janë **pellazgo-ilirizma** që shpjegohen me gjuhën e sotme shqipe. E para mund të zërthehet në **MA-**, e krahasueshme me një parashtesë ***ĒMĒ-**, në **-KHA-**, e krahasueshme me foljen shqipe **ME IK(Ē)**, me lëvizë, dhe në **-NON**, e krahasueshme me një prapashtesë të shqipes - ***ĒNĒ**. Pra: ***ĒMĒIKĒNĒ**, diçka që **IKĒN**, që lëviz, që rrotullohet. E kjo është **MOKĒN** apo si i themi në gjuhën standarde: **MOKĒR**. E dihet që **MOKRA** rrotullohet, lëviz, **IKĒN**.

Fjala **LAKHANON** mendojmë se është e zërthyeshme në **LAKH-** dhe **-ANON**, kurse **PRASANON**, në **PRAS-** dhe **-ANON**. Formanti **-ANON** është, siç thamë më sipër: ***ĒNĒ**, kurse **LAKH-** dhe **PRAS-** janë rrënjët. Mbetet të diskutohet më vete nëse formanti **-ANON**, që ne e krahasojmë me **-*ĒNĒ(N)**, është edhe ai një pellazgo-ilirizëm, pra një albanizëm në greqishten e vjetër, apo ka ndonjë shpjegim tjetër.

Kemi edhe fjalën **AULONA** e, lidhur me këtë, edhe disa toponime **AULONA**, fjalë që është quajtur si greke me kuptimin **lugina**. Mirëpo, ne na duket që edhe kjo e ka shpjegimin në gjuhën shqipe me formën ***E ULĒNA**, gjë që gjithkështu duhet të ketë pasur kuptimin **luginë**, vend **I ULUN**, i ulur.

Po të jetë se fjala **MAKHANON** shpjegohet vërtet me foljen shqipe **IKI**, atëherë edhe vargu i gjatë i fjalëvet, sot ndërkombëtare, **MEKANIKĒ**, **MEKANIZĒM**, **MEKANIZIM**,

MAKINACION etj.etj. duhet të konsiderohen si albanizma në të gjitha gjuhët e Botës.

Po kështu edhe fjala e greqishtes së vjetër **MINA**, me kuptimin **xehe**, mund të ketë shkuar në atë gjuhë nga fjala * **ME MIH(Ë)**, **me gërmue**, e pellazgo-ilirishtes. Fjalën **MIN(Ë)** ne e rindërtojmë ***MIHNË**, **ajo që del nga e MIHUNA**, e **mihura**. Dihet që xehja, minerali, sigurisht nga e **MIHUNA** del. Dilte sidomos në ato kohëra. Por, së këndejmi do të konkludohej që grekët e vjetër edhe zanatin e nxjerrjes së xehevet e kanë mësuar po prej nesh. Dhe kjo nuk do t'ishte më pak e rëndësishme se ajo që ne, psh, kemi marrë prej botës moderne, sot më të përparuar se ne, nxjerrjen e naftës.

Një kapitull shumë i rëndësishëm i të përgjigjurit në këtë pyetje: A na kanë gjetur këtu helenët apo jo, është ai i **mitologjisë**. E kujt është mitologjia? A është e grekëve apo nuk është e grekëve? Si pasojë, a do të jetë e drejtë të përdoret më nëpër Botë shprehja “**mitologjia greke**”, nëse do të rezultojë që ajo nuk është greke?

Duke përqsuar vetitë apo “**funksionet**” e disa perendive të kësaj mitologjie me emrat që ato mbajnë, ne na rezulton shpeshherë një përafri e çuditshme. **ATHINA (ATENA)** na del e përafërt me shqipen **E THËNA**, me kuptimin e mundshëm **mençuria**. E me të vërtetë, miti thotë që Athina ishte perendesha e dijes dhe e shkencës dhe thotë gjithashtu që atë Zeusi e kishte nxjerrë nga koka e vet. S'ka mëdyshje, pra, që ajo personifikon **të thënën**, mençurinë e vetë Zeusit, sepse mençuria del nga koka pikërisht me anë të **së thënës**, me anë të **fjalës**. Këtu është gjithkështu e pasqyruar edhe mençuria e popullit që e ka krijuar këtë perendi dhe që ia ka vënë edhe emrin.

Perendesha **HERA** e ruan emrin e vet në një fjalë të shqipes, **MUSHTJERRË**. I hiqen 2 parashtesat **MU(MË)**- dhe **SHT**- dhe mbetet emri **-(J)ERRË**, tingëllisht krejt e afërt me **HERË**.

Në Shestan formën **JERR** e shqiptojnë pa ndajshesa, si pasthirmë që përdoret për të ndjellë lopën. Miti, në anë tjetër, thotë që **HERA** identifikohet pikërisht me *mushjtjerrën*.

AFËRDITA ka sinonim Yllin e Mëngjesit ose planetin Venera, i cili njihet si ylli që lajmëron **DITËN** e re. Miti thotë që perëndesha **AFËRDITË** ka dalë prej detit, e ka krijuar shkuma e detit në ishullin Qipro. Nëse shikojmë pozicionin gjeografik të Qipros, gjithkush do ta kuptojë që **DITA** atje s'ka nga "*del*" tjetër, veçse prej detit. Në fillim ai krahu nga vjen **DITA**, skuqet, pastaj së shpejti vjen edhe zbardhja, në kohën kur planeti, lajmëtari i **DITËS**, e cila tashmë është **AFËR**, ndodhet diku sipër detit. Edhe në shumë pjesë të tjera të Greqisë së sotme **DITA** "*del nga deti*", sepse deti ndodhet në lindje. E vetmja gjë që e çudit njeriun, i cili e bën këtë analizë logjike duke lidhur mitin me emrin, është: A është e mundur që fjalët **AFËR** dhe **DITË** të mos kenë pësuar kurrfarë ndryshimi kuptimor apo tingullor në më se 30 shekuj? Prandaj dhe kërkohet që mendimet të argumentohen gjithanshëm e jo thjeshtë të thuhet.

Perëndia **APOLLON** konsiderohet, midis tjerash, edhe si mbrojtësi i **pjellorisë**. Mendja na shkon te folja **ME PJELLË** në të kryerën e thjeshtë, në aorist, **POLLI**. Kjo formë e foljes **ME PJELLË**, me një prapashtesë **-(Ë)NI**, do të jepte: ***POLLËNI**. A mund të krijohen emra me aoristin e një foljeje? Veç kësaj, aoristi, e kryera e thjeshtë, a është kaq i lashtë në gjuhën tonë?

Një gjuhëtar i yni thoshte: "*Përqsasje mekanike tingujsh mund të bëhen me cilëndo gjuhë të Botës. Me përqsasje mekanike, pa një mbështetje mbi evolucionin e fjalëve, mbi ligjet e ndryshimit të tingujvet, ne mund ta lidhim gjuhën tonë edhe me gjuhën kineze.*" Edhe ne e dimë që kështu është. Megjithatë, lidhur me mitologjinë, të quajtur "*greke*", jemi të detyruar të ndalemi. Jemi të detyruar të ndalemi edhe se në këtë drejtim, në drejtimin e përafrimit të kësaj mitologjie me

elementë të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare, janë marrë shumë dijetarë, duke filluar që nga Rilindja e këndej. Praktika e të hedhurit poshtë me procedurë të shkurtër, ka bërë që dijet tona nuk i kanë dhënë zgjidhje këtij problemi. Dhe kjo ka ndodhur kur psh emrat e Dardanisë (prej *dardhë*) dhe të Dalmacisë (prej *delme*), shpjeguar kështu prej gjuhëtarësh të huaj, i kemi marrë si të saktë pa kurrfarë kundërshtimi.

Në lidhje me *APOLLONIN* na ka rënë në sy edhe një pjesë e mitit mjaft interesant. Në një ishull të Egjeut qenkëshin përhapur *MINJTË* dhe e paskëshin asgjësuar të gjithë prodhimin. Banorët nuk ditën të gjejnë mënyrë tjetër, veçse t'i bënëin fli e t'i luteshin *APOLLONIT*, perëndisë së pjellorisë. Ata i bënë fli *APOLLONIT* në majën më të lartë të ishullit dhe "*mrekullia*" ndodhi: *MINJTË* u shfarosën dhe jeta në ishull u normalizua. Që atëherë banorët e ishullit nuk thanë më "*perëdia APOLLON*", por thanë "*perëdia SMINTE*", me kuptimin *perëdia që na i zhduku MINJTË*. Edhe vetë ishullit ia vunë emrin: *Ishulli SMINTE*. Në gjuhën e sotme shqipe ky emër *SMINTE* mund të zërthehet në një parashtesë me kuptim mohues *S-* dhe në shumësin e shquar të emrit *MI*, që bën edhe sot: *MINJTË*. A mund të konsiderohet i mundshëm një fjalëformim i këtillë, parashtesë plus shumësi i shquar i një emri? Në anë tjetër, emri *MI* a s'është huazim në shqipet? Kuptimisht emri *SMINTE* përputhet plotësisht me mitin. Po gjuhësisht a mund të përlijet një formim i tillë? Dihet që *APOLLONI* është nderuar edhe në viset e Ilirisë njëlloj si në Greqi. Aq sa ai i ka dhënë edhe emrin njërit prej qyteteve tanë më të njohur: *APOLLONISË*. Ky adhurim, i konkretizuar edhe në një emër qyteti, ashtu siç ka qenë konkretizuar emri i perëndeshës *ATHINA* në emrin e një qyteti grek, a është ndikim i kulturës greke te ilirët, apo në rastin e emrit të *ATHINËS*, është ndikim i kulturës pellazgo-ilire te helenët e hershëm?

Janë 2 perënditë e mjekësisë **MAKAONI** dhe **PODALIRI**, me emrat e të cilëve mund të bëjmë një përjasje me gjuhën e sotme shqipe: *Me MËKUE* do të thotë *me ushqye nëpërmjet gojës. Me MËKUE foshnjën, me MËKUE të sëmurin. MAKAONI*, në mos gabohe mi, është *perëndia që shëron sëmundjet e brendshme*, për të cilat dihet se shërohen me anë të të **MËKUARIT**. Ndërkaq, *me DËLIRË* në shqipen e sotme do të thotë: *me pasture. PODALIRI*, në mos gabohe mi, është *perëndia e shërimit të plagëve*. Ç'bën mjeku kur mjekon plagët? Ai i **DËLIR** ato, i pastron prej infeksioneve, që shfaqen me mahisje e me qelb. Te emri i **MAKAONIT** mund të vërejmë një parashtesë tashmë të përsëritur në shumë raste: ***ËMË-**, **MË-** ose **MA-**. Te emri i **PODALIRIT** vëmë re pjesëzën pohuese **PO-** në rolin e parashtesës.

ILITIA (ELITIA) është hyjnesha e lindjes së fëmijëve. **ILITINË** e dërgonte e ëma Hera për të ndihmuar gratë që **LINDNIN**. A është e mundur që ky emër të lidhet me foljen e sotme të shqipes *me LINDË* dhe me emrin e dalë prej kësaj foljeje: **LINDJE**? A mund të kenë ekzistuar edhe në atë kohë të largëta po kjo formë e foljes *me LINDË* dhe po kjo prapashtesë **-JE**? Dmth a ka vepruar edhe atëherë po ky fjalëformim si në kohën e sotme? Duhet thirrur në ndihmë gramatika historike dhe fonetika historike. Shembuj të këtyllë nga mitologjia ka disafish më shumë se ç' i sollëm këtu, vetëm sa për ilustrim të ideve tona.

Problem tjetër që duhet të trajtohet në raportet tanë me helenët, është ai i **poemave homerike**. Ç'gjuhë kanë folur trojanët? Kush ishin trojanët? Është lehtë të thuhet: *Trojanët kanë qenë njëri nga fiset greke të Azisë së Vogël dhe Lufta e Trojës ishte një luftë për mbisundim midis fiseve të ndryshëm greke*. Është lehtë të themi: *Përderisa poemat homerike janë shkruar në gjuhën greke, vetëkuptohet që ato janë një krijim i grekëve dhe janë madje një nga themelet e madhësisë*

së grekëvet të Antikitetit. Por studiuesit kanë për detyrë të ndalen dhe ta shqyrtojnë gjithanësisht objektin e studimit, jo të mjaftohen me disa pohime të gjetur të gatshëm dhe, aq më keq, t'i shndërrojnë ata në pohime tabu.

Pra, **kush kanë qenë trojanët?** Ç'gjuhë kanë folur ata? Emri **DARDAN**, me të cilin cilësohen trojanët, nuk është për t'u anashkaluar pa vëmendje. Mbreti i Trojës quhet **Priam Dardani**. Vetë Troja ka mitin përkatës të krijimit që nuk lidhet asgjekundi me helenët. A është e mundur që emërtimi **PRIAM** të ketë kuptimin e emrit të përgjithshëm *prijës*? Folja **me PRI**, që për mendimin tonë vjen nga numërori rreshtor **I PARË**, a është e hershme në gjuhën tonë?

Ose le të kthehemi te një personazh tjetër mitologjik, te njëri nga paraardhësit e Priamit, **Laomedonti**. Miti i Laomedontit është **miti i shkeljes së besës**. Te shkelja e besës prej Laomedontit, si te një spirancë e hedhur keq prej vetë atij, janë lidhur të gjitha fatkeqësitë e pasardhësve të tij. Le të jetë i mirë Priami! Le të jetë Hektori një hero! Çdo gjë është e kotë, derisa një nga gjyshërit e tyre ka bërë deliktin më të madh ndaj njerëzvet dhe ndaj perëndivët: **Ka shkelur besën**.

Në të njëjtën kohë dihet që **institucioni i besës**, në të gjithë historinë e derisotme të shqiptarëve, është njëri nga institucionet tanë më problemorë. Mbajtja e **besës** dhe shkelja e **besës** janë 2 konstruktet kryesorë në godinën e moralit të shqiptarëve: njëri shtyllë, tjetri antishtyllë. I kemi në jetën e përditshme: **Për këtë besë! Paska qenë burrë i pabesë!** I kemi në kodet tanë kanunorë: **Kur i ke dhënë besën tjetrit, nuk ke të drejtë ta vrasësh, edhe nëse të ka vrarë njeriun më të afërt.** I kemi në folklorin tonë, pasqyrë e të gjithë kompleksitetit të një etnie: Te balada e Rozafës, njëri vëlla e mban **besën**, 2 të tjerët e shkelin. Te cikli i kreshnikëve, nëna dhe motra e tradhtojnë Mujin, me të shkelur të **besës**. Po kështu edhe Ibrahim Ketën e Ri. Te balada

e Ymeragë Ulqinit, nusja e tij e mban **besën** deri në afatin e paravendosur. Konstantini nuk e harron **besën**, që i ka dhënë së motrës, as në varr. Kjo është linja e pashkëputur e institucionit të **besës** te pellazgo-iliro-shqiptarët që nga Laomedonti e deri në kohët moderne. Ndoshta e kanë edhe grekët këtë linjë. Ne nuk e dimë. Por nëse ata nuk e kanë të kësaj forme siç e kemi ne, atëherë ka një bazë që Laomedonti të jetë krijesë e mentalitetit tonë.

KASANDRA është e bija e Prijamit, e cila ka cilësinë për të **THËNË ËNDRRA**. Tingulli **S** paraqitet shpeshherë si një **TH** e transformuar. Kështu fjala **SIKA** njihet edhe në latinisht, edhe në shqiptimin sllavisht për **THIKË**. A mund të përfytyrohet emri **KASANDRA** si një ***KA THANË ANDRRA**? Do t'ishte një fjalëformim gati i pakconceptueshëm për shqipen e sotme: Një folje në kohën e kryer dhe një emër në shumës. Veç kësaj, fjala **ANDËRR (ËNDEËRR)** a është aq e vjetër në shqip? Është edhe lumi **KSANT**, i cili kalon pranë Trojës, por është më shumë **i thatë** se me ujë. Pra, lumi i **KTHANËT**, lumi që **thahet**. Hidronimia shqiptare e sotmja është plot me: **Lumi i Thatë, Përroi i Thatë**. Një të tillë hidronim tonin sllavët e vonë bëjnë sikur e kanë **“përkthyer”** duke e quajtur **Suva Reka**, por në të vërtetë ai emër dokumentohet aty shumë kohë para ardhjes së sllavëve. Do të shohim pak më vonë që sllavët edhe fjalën **SUV**, edhe **REKA** i kanë imarrë prej iliro-arbërishtes.

Njeri prej kapitujve shumë të rëndësishëm të **homerologjisë** do të duhej të ishte raporti etnik midis **Atridëve** nga njëra anë, dhe **Akilit** e **Uliksit** nga ana tjetër, kapitull, të cilin, si duket, **homerologëvet** as që u ka shkuar ndërmend për ta trajtuar. **Atridët** (Agamemnoni e Menelau) janë teukër (helenë). **Akili** dhe **Uliksi** nuk janë helenë. **Akili** është mirmidonas, **Uliksi** është thjeshtë itakas, zot i një ishulli. Mënyrat se si shkuan këta në luftë kundër Trojës, ose si u çuan në atë luftë, janë fabula tepër interesante dhe ato mund të shërbejnë për të nxjerrë

konkluzione të rëndësishëm. Një nga konkluzionet mund t'ish se ata ishin të së njëjtës etni me trojanët. Mu për këtë arsye duket se në poema ata trajtohen si shkaktarët kryesorë të tragjedisë dhe secili prej tyre merr edhe dënimin që “*i kanë caktuar zotat*”, sipas meritës. Natyrisht, ne nuk mund të ndalemi këtu për t'i zbrëthyer këto pjesë substanciale të poemave, sepse, siç thamë, ato do të përbënin kapituj më vete të **homerologjisë**. Do të sjellim vetëm 2 a 3 hamendje lidhur me emrat e këtyre 2 kryeprotagonistëve. Akili ka 2 emra: **ASPETI**, që gjuhëtarët e kanë shpjeguar me fjalën shqipe ***ISHPEJTI**, dhe **AKIL**, që ne e gjejmë të afrueshme me formën e mundshme shqip: ***IKËLI**. Si ***I Shpejti**, si ***Ikëli**, kanë të njëjtin kuptim, janë sinonime: **Njeri që vrapon shpejt, që ikën shpejt, njeri i shpejtë. ODISEJA** është poema që na rrëfen **udhëthyerjet** dhjetëvjeçare të Ulisit. **S**-ja, siç thamë, mund të merret si **TH**, nëse edhe në ato kohë të tejhershme ka ekzistuar ky opozicion, ndërsa **D**-ja mund të jetë një **DH**. Pra, ***UDHËTHEJA**, peripeciada e ravgimevet të **Ulisit** nëpër detra. Ndërkaq, **ODISEU** do të mund të shqiptohej në gjuhën jogreke, në gjuhën vendase, ***UDHËTHEU**, njeriu që **theu udhën**, ndaç me kuptimin **tradhtar, njeriu që e tradhtoi etninë e vet**, ndaç me kuptimin **njeriu që e pagoi në këtë mënyrë thyerjen e udhës**.

Një çështje e katërt apo e pestë, për t'u zgjidhur, është **kultura kreto-mikenase**. A kanë qenë të parët tanë, të parët e shqiptarëvet, ata që e kanë krijuar atë kulturë, apo ka qenë atje ndonjë popull tjetër? Nëse ka qenë një popull tjetër atje, atëherë gjurmë të asaj kulture nuk do të duhej të kishte në ish-Iliri. Nëse gjenden gjurmë të asaj kulture, si psh muret e stilit ciklop, mënyra e ndërtimit të të ashtuquajturave shtëpi-qytete, mënyra të qeverisjes si në **Kretë** e në **Mikenë**, gjurmë mitesh të ngjashëm me ata të atyre 2 qytetërimeve, ritet e varrosjevet etj. Kjo është punë sidomos e arkeologëvet, por edhe e studiesvet të arkitekturës, e etnologëvet etj.

Një çështje e pestë apo e gjashtë mbetet ajo e ndërtimit të **kolonivet** të grekëvet të lashtë. Thuhet se filan qytete brgdetarë i themeluan grekët dhe numërohen një tufë qytetesh, të cilëvet duket sikur ua kanë vënë ata gurin e themelit. Thuhet që këto koloni janë krijuar për tregti dhe se për metropolet e tyre ata kanë qenë një burim i madh pasurimi. Pyetja është kjo:

A vërtet janë grekët ata që i themeluan këta qytete?

Këtu vjen prapë në ndihmë, përveç arkeologjisë dhe shkencave të tjera, edhe gjuhësia. Psh. **BIZANTIN**, thonë grekët se e kanë themeluar ata. Mirëpo ne na duket se ky emër vendi, gjuhësisht mund të shpjegohet vetëm me shqipen: ***MBIZANËTË**, me kuptimin *mbi ngushticë, mbi vendin ku ngushtohet deti, ku i ZIHET gryka detit*. Krs. me **ZANË**, i **ZANUN**, i **ZËNË**. Formanti **-(Ë)TË** do t' ishte mbaresë shquese e emrit asnjans: **(TË) ZAN-ËTË**. Në anën tjetër të gadishullit **DYRRAHU (Durrësi)** na del: ***DY RRAHE**. Në shqipen e sotme **RAH** do me thënë *vend i shpyllëzuar midis një pylli*. Prapë edhe këtu lind dilema: *A janë aq të vjetra në gjuhën shqipe fjalët: MBI, ME ZANË, DY edhe RRAH?* Nëse janë, atëherë s' kemi pse dyshojmë në një të këtillë shpjegim për emrat e hershëm, as të **Bizantit**, as të **Durrësit**.

Pyetje tjetër: *Kanë qenë apo nuk kanë qenë popuj të kulturuar, dmth popuj me qytetërim, ata popuj, ku grekët kanë sajuar kolonitë e veta?* Këtu, për të ndriçuar shkallën e zhvillimit të pellazgo-ilirëvet, duhet të bëhen jo studime vetëm për të dëshmuar praninë greke, por edhe për të dëshmuar praninë dhe veçantitë e vendësve. Dimë që kolonizuesit evropianë, në shekujt që kaluan, bënë që të tjetërsohen kontinentet. A bënë tjetërsim të popullsisë sonë grekët, kur erdhën si kolonë në brigjet e detit tanë? Nëse nuk kanë bërë tjetërsim të popullsisë, kjo do të thotë që kultura e paraardhësve tanë nuk ka qenë në nivelin e kulturës së kolonëve.

Çfarë ishin **dakët, thrakët, maqedonët dhe epirotët** në raport me ilirët nga njëra anë, dhe në raport me grekët nga ana tjetër? Këtë çështje duhet ta ndriçojë **ballkanologjia** saktë dhe qartë. A kishin afri njëri me tjetrin popujt që përmendëm apo ishin etni krejt të ndryshme? Në lidhje me afritë apo largitë midis ilirëve dhe dakëve, mund të na ndihmojnë sadokudo 2 gjuhët tona, sepse janë gjuhë të gjalla. Edhe gjuha rumune është e gjallë, sado që është e latinizuar. Kurse në lidhje me thrakët dhe maqedonët është më e vështirë. Ndërkaq, puna e epirotëve, emërtim ky që ka lëvizur disa herë drejt veriperëndimit, do parë jo vetëm në gjuhën të thuash shtetërore, që ata mund ta kenë përdorur ndonjëherë, por edhe në gjuhën që e ka përdorur populli dhe do parë çfarë mund të quhet **ndikim** i kulturës greke dhe çfarë do t'ishte **vetë kultua greke**. Sidoqoftë, ne aktualisht mendojmë që **epirotët s'kanë qenë tjetër veçse ilirë të jugut**. Ndërsa **maqedonët kanë qenë të afërt me ilirët**, në mos të njëjtë, dhe krejt të ndryshëm nga grekët.

Koha ilire

Iliria para pushtimit romak.

Kjo është koha të cilën shqiptarët duhet ta njohin si histori të vetën. Nuk mund të mjaftohemi me një vështrim panoramik. Periudha deri në sh VI p.e.s. nuk është studiuar thuajse fare. Për këtë epokë duhet të bëhen kërkime jo në 1 por në disa disiplina. Arkeologjia, kuptohet, jo vetëm në territorin gjymtak të “*Shqipërisë Londrase*” prej 28000 km katrorë, por që nga Istria e rrjedha e epërme e lumit Sava deri në Pind (të paktën deri në Pind) e nga Beogradi deri në Selanik. E gjithë kjo hapësirë është atdheu ynë **i dikurshmi**, një pjesë e të cilit është edhe **i sotmi**. (Në njohjen e kësaj pjese të historisë sonë mund të ndihmojë, siç po shohim, edhe gjuhësia, sidomos antroponimia, toponimia, hidronimia. Por mund të hyjnë në shërbimin e

studiuesvet edhe gjenetika, analizat e ADN-së, në rastin e hapjes së varrezavet tumulare, numizmatika etj.

Periodha nga sh V p.e.s. e deri në pushtimin romak njihet diç më mirë, por nuk i është kushtuar pasioni i nevojshëm.

Kur merresh me jetën e të parëvet të tu, duhet pasion. Duhet nderim e devocion ndaj atyre, pa të cilët ne nuk do të kishim ardhur në jetë. Në një thellësi kohe deri në 10 breza, njeriu (individ) ka 2 046 paraardhës. Kur është autokton, ai i ka rreth vetes varret e të gjithë atyre paraardhësve. Kurse në 20 breza numri i paraardhësve shkon në 1 991 900 (një million e nëntëqind e nëntëdhjet e një mijë e nëntëqind). Kudo që ta hedhësh hapin, nëse je autokton, të duket sikur të gjithë ata paragjyshër të tu janë aty. Është puna e tyre, janë muret, është dheu, janë dëshirat, shpresat, peripecitë, tragjeditë. Mirëpo 20 breza s'janë më shumë se 600 vjet. Po kur mendon se ne kemi qenë këtu 2 500 vjet, 3 500 vjet, 4 000 vjet?! Të jesh një popull i lashtë, s'është gjë e pakët. Është një krenari dukshëm e veçantë në krahasim me krenarinë e atyre që janë ardhës. Një arab që ka ardhur këtu në Ballkan nuk i ka të parët e vet këtu. Nuk e ndien erën e tyre, nuk ua sheh dheun, nuk ua sheh gurët. Ndërsa shqiptari, që rron këtu në vendin e vet, një copë tjegull të marrë, mund t'i shkojë mendja: ***Këtë mund ta ketë prekur edhe dikush prej të parëvet të mi. Ndjesë pastë!*** Sigurisht, kur nuk kemi të bëjmë me ndjenja e mendime kuazimodernësh të çoroditur.

Në 2 shekuj e gjysmë, deri sa kanë ardhur përfundimisht romakët, ne kemi pasur **mbi 60 mbretër**. Shqiptarët duhet t'i njohin ata mbretër. T'ua dinë emrat, të dinë ndonjë gjë nga jeta e tyre, të dinë vendin, mbretërinë, ku kanë qenë mbretër. Këta mbretër duhet të mësohen nëpër shkolla e jo të na ndodhë që, kur pyet ndonjë shqiptar: ***A kemi pasur mbretër ne në të kaluarën?***, ai të të përgjigjet: ***Po, e kemi pasur 1 mbret, Ahmet Zogun.***

Të 60 mbretërit ilirë nuk kanë qenë “*mbretër*” të fisevet “*të egër*”, por kanë qenë mbretër popujsh të qytetëruar. Këtë e dëshmojnë qytetet e shumtë që i kemi pasur ne në ata shekuj. Që popujt e Ilirisë kanë qenë popuj të qytetëruar, e dëshmojnë monedhat që kanë qarkulluar e që janë gjetur nga arkeologët në të gjithë hapësirën ilire. E dëshmojnë sendet zbukurues, e dëshmojnë armët, e dëshmon qeramika, mënyra e ndërtimit e fortifikimit të qyteteve, ujësjellësit, akveduktet. Në mënyrë të veçantë e dëshmojnë flotat tona të asaj kohe, aq të fuqishme, sa ato i shërbyen Romës si *kazus belli* (*casus belli*), për të filluar pushtimin e shteteve tanë.

Të gjitha këto është e domosdoshme t’u shpjegohen bukur e me pasion njerëzvet tanë, rini e të moshuar, në mënyrë që shqiptari ta kuptojë që ne nuk jemi një komb pa rrënjë. Nuk jemi pa rrënjë e nuk jemi as rrënjëshkullur.

Ne po i japim këtu emrat e atyre qyteteve sipas trevave ku janë ndodhur dhe emrat e mretërve, jo sipas shteteve ku kanë sunduar, por sipas alfabetit. Është detyrë e historiografisë që t’i trajtojë gjërat më përshkrueshëm dhe është detyrë e muzeologjisë ta paraqesë të shkuarën tonë më shikueshëm. Është detyrë gjithkështu edhe e arteve figurativë, veçanërisht e skulpturës.

Qytetet në Iliri

Në trevat e **japodëvet** ishin qytetet: Metuli, Terponi dhe Vendi (Vendoni ose Avendoni).

Në **Panoni** (të Epërme e të Poshtme) ishin qytetet: Vizontioni, Valina, Vakontioni, Teutiborgu (Teutibarku), Tauruni, Solua, Skarbentia, Sisopa, Siroga, Serbitioni, Segesta, Savoria, Salinoni, Saldisi, Sala, Sabarira, Rittioni, Rispia, Praitorioni, Potobioni, Parsioni, Olimakoni, Noviodunoni, Nauporti, Mursela, Mursaminori, Mursamairi, Marsonia, Magniana, Lugiononi,

Lussonioni, Lentuloni, Kurta, Kornaku, Kivalisi, Kibala, Karrodunoni, Karpisi, Karnuti, Kartisa, Jubaloni, Grai, Emona, Kuminioni, Cibali, Brigationi, Bononia, Bolentioni, Berbisi, Bassantisi, Basiana, Arsaku, Andautonioni, Alusioni, Akuinkoni, Aciminku, Abiundria, Sirmi (Mitrovica e Sremit e sotmja).

Në **Myzi** ishishin qytetet: Viminaci, Prikornia, Ortheomarhosi, Margu, Marcianopoli, Gratiana, Dionisopoli, Aureumi (Aureo Montea), Konstantiola, Singiduni (Beogradi i sotëm).

Në **Dakinë e Brendshme** ishishin qytetet: Turibusi, Remisiana, Ratiaria, Pautalia, Kartobalosi, Valeriani, Zana, Kuimedaba.

Në **Dardani** ishishin qytetet: Veklanumi, Ulpiana, Theklana, Damastioni, Sintia, Sarnonti, Merioni, Kratiskara, Justinopoli, Bederiana (Më vonë: Justiniana e Parë), Akuasi, Naisi (Nishi i sotëm), Skupi (pranë Shkupit të sotëm). (Vo! Në Dardani, si dhe gjatë, ka pasur edhe një numër të madh të quajturash **fortesa**, por që nuk emërtohen si qytete, prandaj nuk i shënuam.)

Në **Paioni** ishishin qytetet: Noraku, Dobera, Bimazosi, Dylazora, Alorosi, Abydoni.

Po fillojmë tani krahun e bregdetit. Në **Istri**: Pola, Parentioni, Nesatikumi, Neapolisi, Tergesti (Triestja e sotme), Kreksi (ishull e qytet).

Në **Liburni** ishishin këta qytete: Aenona, Alvona, Apsorosi, Arausa, Ardotioni, Argyrunti, Arukkia, Ausankalei, Adra, Blanona, Burni, Dyyrta, Fulfinioni (në ishullin Kurrikta), Halupsi, Idasta, Korkumi, Krepsa, Lopsika, Nedini, Kurikoni (edhe ky në ishullin Kurrikta), Ortopla, Promona, Salvia, Senia, Sidronia, Skardona, Stulpi, Tarsatika, Taliasoni, Varvaria, Vegi, Volkera, Voporui, Akuilea.

Në **Dalmati** ishishin qytetet: Siparuntoni, Aleta, Issa (ishull dhe qytet, Visi i sotëm), Spalationi (Aspalatoja, Spliti i sotëm), Epidauri (Ragusiumi, Dubrovniku i sotëm), Aikuoni, Andetri, Aseria, Bigesti, Bonki, Bulua, Dalmi, Enderoni, Epeti,

Akuoni, Fari (ishull dhe qytet), Herona, Jadera (Zara e sotme), Magnumi, Naroni (Vidi i sotëm), Nutria, Oiminakioni, Onaioni, Sinoti, Petunti, Saloniana, Setovia, Siklisi, Stridoni, Traguri (sot: Trogiri), Thermidava.

Në **Illirinë Qendrore** ishin qytetet: Dorrsiku, Dorakioni, Dizeri, Dimali, Dibolia, Denda, Daulia, Bylisi (Hekali i sotëm), Bunna, Boluri, Uskana, Durni, Dyrrahu (Durrësi i sotëm), Enhelana, Epikaria (Puka e sotme), Eugeni, Evia, Gerunti, Harpuia, Helidonioni, Karavandi, Keraka, Knidi, Koragu, Krysondyona, Orgesa, Pelioni, Kodrioni, Kolkini (Ulqini i sotëm), Lissosi (Lezha e sotme), Rizoni (Risani i sotëm), Diokleja, Batua (Budva e sotme), Adria, Magia, Melitusa, Meteoni (Meduni i sotëm), Narbisi, Oidantioni, Olympeja, Rraknosi, Sardosi, Sarnusi, Sationa, Sidoni, Syberosi, Skodra (Shkorda e sotme), Skampa (Elbasani i sotëm), Polyheriupolisi (Antipatrea), Lyhnidi (Ohri i sotëm), Sesaretosi, Partha, Aiginioni, Akamanta, Akrolisi, Akruj, Akulina, Albanopolisi (Zgërdheshi i sotëm, nëmos një tjetër diku në Mirditë), Ankyra, Antipatrea (Berati i sotëm), Apollonia, Abria, Abroni, Arnisa, Arrha, Astraia, Bantia, Bargului, Basania (Pllana afër Lezhës), Bojoja.

Në **Illirinë Jugore** ose, siç thuhej ndryshe, në **Epir**, ishin qytetet: Thronioni, Trampya, Timori, Skeuptoni, Skuptoni, Oresteja, Omfalioni, Nikopoli (Akta, Preveza e sotme), Myoni, Listrioni, Kassiopi, Herakleja, Helaoni, Hekatonpedoni, Haradrasi, Hadrianopoli, Fotika, Foiniku (Finiqi i sotëm), Euroia, Euria, Eurimena, Eriboia, Elateja, Egini, Efyra, Celetri, Buthroti (Butrinti i sotëm), Bunima, Buketi, Baiakeja, Atheneja, Astahoni, Argoi, Argitasi, Aponi, Anaktori, Amyrnaia, Ambrakia (Arta e sotme), Akarnanoni, Tymfaia, Pandosia, Kyhiri, Pasaroni (kryeqyteti i Molosisë), Oriku, Onhesmi (Saranda e sotme), Amantia, Antigoneja, Aulona (Vlora e sotme).

Në **Maqedoni**, për të cilën nuk mund të pohojmë me

siguri se ishte pjesë etnikisht e padallueshme prej Ilirisë, por për të cilën dimë me siguri se nuk ishte një vend i helenëve, ishin qytetet: Apollonia e Maqedonisë (Polina e sotme), Azori, Pelagonia (Manastiri i sotëm), Lebaeja, Akmeoni, Parthikopolisi, Philippi, Serai, Skydra, Stobi, Alalkomena, Almani, Almopia, Alori (Paleohori i sotëm), Amfipoli, Antania, Arasoni, Araurosi, Barnusi, Beroia (Veria e sotme), Bragylosi, Bajani, Kalikumi, Celisi, Dioborosi, Dioni, Edesa, Eordeja, Eraklia, Euporia, Europi, Eustraioni, Gortyna, Harmonia, Heraklia, Ksantika (Zervohori i sotëm), Pynda, Herkuli, Geminda, Edesa, Bata, Asigonia, Akanthosi, Alga, Acerdosi, Herkui, Idomenia, Ihna, Kasandra, Kalenidini, Libaeja, Mieza, Neapolisi, Nikedesi, Olynthi, Pella, Primula, Stubera, Tauriana, Thurisi, Verpei, Zapara.

Që nga brigjet e lumit Sava e deri në kufi me Helladën janë rreth **350 qytete**. Vepruam kështu metodikisht, duke i shënuar të gjithë emrat, marrë në librin *Ilirët dhe Iliria*, botim i Prishtinës, 1979, sepse, po të jepnim shifrën e thatë **350**, edhe vetë përfytyrimi do të na mbetej i thatë. Janë rreth **350 qytete**, rreth tyre shtrihen me mijëra fshatra, vendbanime malësorësh dhe skllëvërish që punojnë tokat dhe ruajnë bagëtitë. Një pjesë e këtyre qyteteve janë shumë të hershëm, një pjesë më të vonë, por krejt kjo kurrsesi nuk tregon as kulturë “*fisesh*”, as formë “*fisnore*” të jetesës. E gjithë kjo **pakundështueshëm** tregon një shkallë të lartë zhvillimi dhe **pa një të këtillë njohje shqiptarët as për afërsisht nuk mund ta njohin vetëveten**.

Mbretërit tanë të kohës aq të qytetëruar të Ilirisë janë: (Po i japim me alfabet, thjeshtë sa për t’i njohur si emra dhe për të shmangur thatësinë shifrore të informacionit)

1. **Admeti**, mbret molos, fill. i sh V p.e.s;
2. **Afeida**, mbret i afeidantëve të Molosisë;
3. **Agi**, mbret i paionëve;

4. **Agroni**, mbret i ardianëvet, 250-231 p.e.s;
5. **Aiakidi**, mbret molos, i ati i Pirros;
6. **Aineu**, mbret legjendar ilir (Kur themi *legjendar*, ndonëse mund të mos ketë ekzistuar si person, ai prapëseprapë përfaqëson mbretër, ekzistencë mbretërisht);
7. **Aleksandër Molosi**, mbret i molosëvet, i ati i Neoptolemit II, 362-326 ose 345-331 p.e.s;
8. **Aleksandri II**, mbret i Epirit, biri i Pirros, 270 p.e.s;
9. **Alketa I**, mbret i molosëvet, biri i Tharypës, 390-373 p.e.s;
10. **Alketa II**, mbret i molosëvet, biri i Arrybës, 313-312 p.e.s;
11. **Aminandri (Amyna)**, mbret i athamantëvet të Epirit;
12. **Antiohu**, mbret i orestëvet të Epirit ose të Maqedonisë;
13. **Arryba**, mbret molos;
14. **Atali I Soteri**, mbret i Pergamit (A është Epir?);
15. **Audoleoni**, mbret i Paionisë, 310 p.e.s; 16. **Bardhyli**, mbreti i parë i enkelejvet;
17. **Bardhyli i Ri**, mbret i enkelejvet, aleat me Pirron; 1
8. **Batoja**, mbret i dardanëvet, biri i Longarit;
19. **Deidameia**, mbretëreshë e Epirit, 230 p.e.s;
20. **Eumeni**, mbret i Pergamit, Epir?;
21. **Fyla**, mbret i Efylës, Epir;
22. **Genti**, mbret i labeatëvet, 181-168 p.e.s;
23. **Gerioni**, mbret mitologjik i Epirit;
24. **Glaukia**, mbret i taulantëvet, 302 p.e.s;
25. **Kalidika**, mbretëreshë e thesprotëvet;
26. **Kliti**, mbret i enhelejvet, trashëgimtar i Bardhyllit, mbas 344-s p.e.s;
27. **Longari**, mbret i dardanëvet;
28. **Longari**, mbret i agrianëvet të Paionisë;
29. **Maleo**, mbret (legjendar) i pellazgëvet;
30. **Monuni**, mbret i taulantëvet, sh IV p.e.s;
31. **Monuni**, mbret i dardanëvet;

- 32.**Mytili**, mbret i taulantëvet, biri i Glaukut, 302-270 p.e.s;
 33.**Neoptolemi**, mbret i molosëvet, i ati i Aleksandër Molosit, 302-298 p.e.s;
 34.**Neoptolemi II**, mbret i molosëvet, 317 p.e.s;
 35.**Oroidi**, mbret i paravejvet në Epir;
 36.**Pirroja**, mbret i Epirit, biri i Aiakidit, 307-272 p.e.s;
 37.**Pirroja II**, mbret i Epirit;
 38.**Pleurati**, mbret në Ilirinë Qendrore, i ati i Agronit;
 39.**Pleurati**, mbret në Ilirinë Qendrore, i biri i Skerdilajdit, i ati i Gentit, 181-180 p.e.s;
 40.**Pleuria**, mbret i taulantëvet, 338 p.e.s;
 41.**Ptolemeu**, mbret i molosëvet, i nipi i Pirros, 231 p.e.s;
 42.**Skerdilajdi**, mbret i ardianëvet, Iliri Qendrore, i ati i Pleuratit;
 43.**Teuta**, mbretëreshë në Ilirinë Qendrore, regjente e Pinesit, 232-228 p.e.s;
 44.**Teutana**, mbretëreshë e liburnëvet;
 45.**Tharypi**, mbret i Epirit, 430-390 p.e.s.

Mbretër të Maqedonisë, që, siç thamë, s'e dimë saktësisht nëse janë të së njëjtës etni me ilirët, por e dimë që sidoqoftë janë më të afërt me ne se me helenët:

- 1.**Aeropi**;
- 2.**Aleksandri I**, 495-450 p.e.s;
- 3.**Aleksandri II**, 369-365 p.e.s;
- 4.**Aleksandri i Madh**, 356-325 p.e.s;
- 5.**Aleksandri IV**, biri i Aleksandrit të Madh dhe Roksanës;
- 6.**Amynta I**, 495 p.e.s;
- 7.**(Amynta II)**; 8.**Amynta III**, 382-370 p.e.s;
- 9.**Antigon Dostoni**, 229-220 p.e.s;
- 10.**Antigon Gonata**, 277-239 p.e.s;
- 11.**Argeu**;

12. **Demetri II**, 239-229 p.e.s;
13. **(Filipi I)**;
14. **(Filipi II)**;
15. **Filipi III Arideu**;
16. **Filipi IV**;
17. **(Filipi V)**;
18. **Karani**, mbreti i parë i Maqedonisë;
19. **Kasandri**, 316-297 p.e.s; 20. **Perdika I**; 21. **Perseu**.

Këtu na kanë dalë **350 qytete dhe 66 mbretër**, përkundër pasaktësive e mangësive që mund të ketë, sepse na mungojnë tmerrësisht studimet. **Nuk besojmë të ketë ndonjë popull rrotull nesh me një të kaluar kaq të madhe**, me një traditë qytetërimi kaq gjëmimtare, të përhapur në këtë mënyrë, edhe në kohë, edhe në hapësirë. Megjithatë, ndërsa psh në Paris, në Vjenë apo në Stamboll, sapo të ulesh në një restorant ose të zësh dhomë në një hotel, e para gjë që do të të kujtojnë ciceronët dhe guidat, janë mbretërit dhe sulltanët e atyre vendeve dhe lashtësitë e atyre qyteteve, ne na vijnë nxënësit nga Theranda në Durrës dhe, kur kthehen: **“Çka patë?” “Pamë dritëret dhe krevatët e dhomavet ku fjetëm.”** Na shkojnë grupe qytetarësh nga Tirana në Shkup dhe: **“Çka patë?” “Pamë një kryq të madh 64 metra të lartë.”** (Të cilin e kanë ngritur sllavët, për të na u mburrur sikur janë ata që e kanë prurë krishtërimin aty.) **“Po ndonjë gjë nga historia e shqiptarëve a patë?” “Pamë xhami, në Shkup, në Tetovë e kudo që shkuam. Pamë edhe restorante ku nuk të shërbehej as edhe një shishe birra.”** E thamë pak parës që ne shqiptarët nuk jemi rrënjëshkullur, por, me të këtilla informata, s’ka si të mos na krijohet përshtypja që **ne**, megjithatë, **i kemi të kalbura një pjesë të madhe të rrënjëveve. I kemi të kalbura një pjesë të madhe të rrënjëveve, për shkak se një pjesë e degëveve dhe e fletëveve tona na janë vetëtharë tashmë. Me degë e fletë të thara, rrënjët nuk mund të mbahen gjallë.**

Koha e pushtimit romak.

Në gjysmën e dytë të sh III (232) dhe në gjysmën e parë të sh II (168) p.e.s. Roma arriti t'i nënshtrojë të gjitha mbretëritë e Ilirisë. Në Jug na i shkatërroi mbi 70 qytete, në Veri një qytet istriot arriti ta pushtojë vetëm kur aty s'kish mbetur më asnjë mbrojtës i gjallë. Mjaftojnë këta 2 shembuj për ta pasur të qartë tragjedinë: Flakë zjarresh që shuhen jo me shkulma uji, por me shkulma gjaku. Por pyetja më e ftohtë që mund të bëjë një shqiptar, nip i dikujt që shpëtoi ndoshta rastësisht pa u shkruar në ata zjarre romakësh para 2 200 vjetësh, është kjo: ***Pse nuk e pushtuam ne Italinë, por e pushtuan ata Ilirinë?!*** Faji doemos ka qenë dhe mbetet i romakëve, por gabimi fatal ka qenë pa tjetër i yni. Ne duhej të ishim aq parapritës, aq **strategë**, sa ata të mos guxonin as të na mësynin, jo më të na shkatërronin në atë farë feje.

Mjaftojnë 2 apo 3 rrënjë kalbëse.

Ashtu si secili prej nesh, në qytetërimin tonë dhe në mbretëritë tona të Antikitetit, është i prirur dhe duhet të jetë i prirur për të njohur atje rrënjët tona **ngjallëse**, madje për t'u krenuar me to e për t'u mbajtur me dinjitet pas atyre rrënjëve, ashtu secili prej nesh duhet të shikojë, në atë qytetërim tonin dhe në ato mbretëri, edhe rrënjët tona **kalbëse**. Të mos kish pasur brenda vetes, qoftë 2 apo 3 rrënjë kalbëse, historia jonë nuk do të kish rezultuar me të tillë shkatërrime, siç rezultoi në fundin e Epokës së Vjetër dhe siç do të përsëritej shumë herë në 2000 vjetët që do të pasonin.

Rrënja më kalbëse, më vetasgjësuese, në mbretëritë tona të Antikitetit, ka qenë **mospraktikimi**, kushtimisht të themi: **SI DUHEJ, i shkrimit në gjuhën ilire**. Duke qenë mbretëri, vetëkuptohet që ato mbretëri e kanë pasur një administratë. Administrata dihet që punon, përveç me gojë, edhe me të shkruar.

Janë mbajtur shënime mbi tregtinë, janë bërë regjistrime tatimpaguesish, janë derdhur monedhat, janë gdhendur emrat e të vdekurvet mbi rrasa varresh. Por ai shkrim, me sa duket, nuk është konsideruar si një veprimtari **identifikuese**, vetafirmuese edhe në pikëpamje etnike. Prandaj edhe është përdorur, si duket, në gjuhë të huaja. Nuk është lodhur kush me atë punë. Ose, edhe në qofshin shqetësuar 5 apo 10 njerëz largpamës, 100 të tjerë jo vetëm s'e kanë vrarë mendjen në kahen e duhur, por mund edhe t'i kenë përqeshur individët vizionarë.

Duke qenë pjesë e një të këtillë brumi, edhe vetë mbretërit duket se nuk kanë bërë kujdes lidhur me kultivimin **shkrimor** të gjuhës vendëse. Të tjerët e kanë lulëzuar dramaturgjinë, e kanë zhvilluar filozofinë, e kanë shkruar historinë, kanë bërë edhe harta gjeografike, kanë mbajtur statistika, në një kohë kur ne, **duke qenë çdo i treti ilir një poet i lindur**, nuk e kemi **shkruar** poezinë tonë. Ky është një mjerim i llojit të veçantë. Një lloj filozofie mbrapshtane: *Të shkruash?! E ç'po fiton se po shkruan? A mos po të japin bukë ato miza të hedhura si kokërdhi miu mbi lëkura kecash?!* (Kështu duhet t'i kenë **ironizuar** të parët tanë shkronjat dhe pergamenat)... (Ose na i kanë asgjësuar ata që janë trembur prej madhështisë sonë, duke shfrytëzuar suksesshëm elementët kastravecorë, trangulorë, të vetë qinies sonë!)

Një tjetër rrënjë kalbëse, e lidhur me të parën, të kalbëzuarit e së cilës ka arritur deri në brezat tanë në formën e një gangrene, ka qenë **moskultivimi me vetëdije i patriotizmit**. Po kujtojmë këtu një episod që ka të bëjë me njërin prej mbretërve më të mëdhenj të Antikitetit tonë, me Pirron. Pas asaj fitores me shpirt ndër dhëmbë, e cila i dha edhe famë gjithënjëzore Pirros tonë, Pirroja u mundua të hyjë në bisedime me romakët. U arrit të sajohej një takim me njërin prej personaliteteve të Romës dhe Pirroja ngarkoi një karvan karrocash me dhurata për romakun,

flori, diamante etj., dhe shkoi për bisedime. Mirëpo, fjalët e personalitetit të lartë të Romës ishin këto: ***Kaloje ushtrinë tënde matanë detit, pastaj m'i jep dhuratat!*** Sigurisht, kjo nuk dëshmon asgjë për mungesë patriotizmi te Pirroja, por dëshmon m'anë tjetër që **romakët e kishin patriotizmin emblemë: *Pa Romën je askushi, me Romën je gjithçka.***

Që njerëzit tanë nuk e kanë pasur patriotizmin **emblemë**, dëshmojnë një varg dukurish "***të vogla***" e të mëdha, që nga ajo që thamë, të mosshkruarit e gjuhës sonë, te sëmundja e mercenarizmit që zotëronte e zotëron në masë tek ne, deri te **të mbingarkuarit e popullit të vet** nga ana e mbretërve **me taksa** të papërballueshme.

Por ne po ndalemi prapë te të shkruarit apo të mosshkruarit e gjuhës vetjake, si shenja më e qartë e të qenit apo të mosqenit patriot. Vetë moskrijimi i shkrimit në gjuhën ilire (ose të mosruajturit), në një kohë kur fqinjët tanë, të ardhur këtu pas nesh, e kanë krijuar dhe e kanë kultivuar shkrimin në gjuhët e tyre, tregon për një mungesë indinjuese të **sedrës etnike. *Po shkruaj në gjuhën e tij. Kush po lodhet tash me gjuhën që ai, i huaji, nuk e merr vesh!?*** Njerëzit tanë i kanë mësuar gati me **servilizëm** gjuhët e popujve të tjerë, në një kohë që, si duket, as që u ka shkuar ndërmend t'u kërkojnë të tjerëve që edhe ata ta mësojnë gjuhën tonë. Kjo është një **mungesë patriotizmi krejt lakuriqe**. I kemi shkruar edhe emrat tanë ashtu siç i donin ato, gjuhët e huaja. E kjo është një mungesë krejt lakuriqe jo vetëm e patriotizmit, por edhe e dinjitetit më elementar vetjak, personal.

Po sjellim prapë ndërmend një episod të ndodhur po këtu, në hapësirat tona, nga 1 300 a 1 400 vjet më vonë e që lidhet me zhupanin e Sërbisë, Stefan Nemanjën, dhe një tjetër që lidhet me një nga prelatët tanë më të shquar, Fran Bardhin. Stefan Nemanja, në një dokument, një aktmarrëveshje me Republikën e Raguzës, e cila, sipas traditës, ishte e shkruar latinisht, nuk nënshkroi

me shkronja latine, as me emër të latinizuar: *Stephanus*, por nënshkroi me shkronja cirilike dhe me emrin ashtu siç e kishte. Zhupani i Sërbisë, **Stefan Nemanja**, ka qenë një popujvrasës dhe një qyteteshkatërrues, qyteteshkrumbues, por këtu gjithkush është i detyruar t'ia heqë kapelen. **Fran Bardhi** ynë, ndërkaq, patriot i dëshmuar dhe njeri me vlera vërtet të larta morale, e shkruan emrin e vet krejt papërgjegjshmërisht të latinizuar: *Francus Biancus*. Kështu i kemi edhe **pllakat e varrevet**. Shko në Muzeun arkeologjik të Durrësit, shko në Apolloni, shko në Butrint. Shko sot në varrezat e çamëvev ortodoksë në Pargë apo në Prevezë, i kanë varret greqisht. Shko në Tivar, shqiptarët e Tivarit i gdhendin varret e vet sllavisht. **A ka vetëposhtërim më të pakonceptueshëm se të vazhdosh të tallesh me vetëveten edhe pasi të kesh vdekur?!**

Koha e barabartësisë në Perandorinë e Romës.

Në mbarim të Epokës së Vjetër ilirët bënë një kryengritje të madhe, por nuk fituan thuajse asgjë, sepse nuk kishin **strategji vetjake**. Që nuk kishin **strategji vetjake**, **strategji për vete**, e tregojnë fjalët që tha Batoja i desidiatëvev kur po e gjykonin për ta ekzekutuar. “*Pse ngritët krye?*”, e pyeti Tiberi. “*Sepse ju kishit prurë këtu ujqërit për të ruajtur dhentë.*” Pra, nuk kishin **strategji** as për t'u çliruar prej pushtuesit, as për mënyrën se si do të mund të organizohej jeta, mbasi të ishin çliruar. Kërkesa e vetme e ilirëvev ishte që të mos keqtrajtoheshin prej romakëvev.

Sigurisht që Roma nuk do të dërgonte kurrë “*dele*” për të ruajtur “*delet*”. Megjithatë, jeta do të vazhdonte edhe ashtu. Perandoria e Romës tashmë shtrihej thuajse në krejt Evropën, në Azi të Vogël, në Lindje të Afërt dhe në Afrikë, në pjesën veriore. Midis këtyre tokave ndodhej Deti Mesdhe. Popujt, me sa duket, as që mund të mendonin për t'u mvehtësuar. Ata do të

përpiqeshin vetëm sa për ta zbutur sundimin e romakëve të dhe për këtë **duhej kërkuar një filozofi humane, jo separatiste, por përkundrazi, gjithëbashku**. Roma kish bërë bashkim ushtarak, popujt duhej të bënin bashkim shpirtëror. Kështu, mendojmë ne, do shpjeguar **lindja dhe përhapja e krishtërit** në Mesdhe e më vonë në krejt Botën. Popujt e Azisë së Vogël, të Lindjes së Afërt, të Greqisë dhe të Ilirisë, qenë të parët që e bënë të vetin krishtërimin. Ai i thërriste njerëzit jo të çliroheshin me anë të shpatës, por të çliroheshin me anë të dashurisë për njëri tjetrin. Ishte pra një përpjekje pacifiste, e cila gjithsesi nuk do të mund të kurorëzohej me sukses pa sakrifikuar jetë njerëzish.

Kaluan 2 shekuj. Anëmbanë Perandorisë tashmë kishin ndryshuar shumë gjëra. Romakët (latinët) u detyruan më në fund të shpallin **barazinë juridike** për të gjithë shtetasit e lirë. Ishte kjo një aleancë internacionale e skllavopronarëve, me qëllim që të bëhej e mundur mbajtja e mëtejshme nën sundim e skllavërvet. Ilirët përfituan nga një e tillë barazi dhe shumë shpejt ia arritën që të luajnë rol jo vetëm në strukturat lokale të qeverisjes, por të ngjiten deri në majat më të larta të shtetit. Duket se në këtë proces ilirët i favorizoi fakti që një shumicë e popullsisë sonë, prej Istrisë e deri në Pind, kishin qenë tradicionalisht jo skllavërv por **malësorë të lirë**. Në një pjesë të mirë të shekujve III, IV dhe V të e.s. këtë perandori, që ne po e quajmë, krahasimisht me kohën e sotme, "*Unioni Euro-mesdhetar i Antikitit*", e kanë qeverisur ilirët. Janë më se një duzinë perandorësh tanë, të cilët jo vetëm kanë qeverisur, por edhe kanë lënë gjurmë në historinë e atij shteti vërtet të stërmadh për kohën. **Diokleciani** bëri reformat e mrekullueshme, si në kupolën shtetërore, ashtu në riformulimin administrativ të provincave. **Konstantini i Madh** e bëri fenë e krishterë një fe shtetërore dhe në atë mënyrë hapi, edhe me legjislacion, epokën e re në historinë e religjioneve të dhe

në përgjithësi të një zhvillimi të ri social në shkallë botërore.

Kur themi: “*Unionin Euro-mesdhetar të Antikitetit*”, alias Perandorinë Romake, e kanë qeverisur ilirët, ne duhet të mbajmë parasysh 3 apo 4 të vërteta. 1. Ilirët kanë zënë vende të rëndësishëm jo vetëm në krye të shtetit, por në krejt administratën shtetërore. Sidomos në territoret ku banonin vetë ilirët, si dhe në sferën ushtarake, ku ata “*natyrshëm*” dëshmoreshin më të aftë. Do kuptuar kështu që **qysh prej fillimit të sh III të e.s. e këndej ne nuk duhet të konsiderohemi më si vend apo popull i pushtuar prej romakëve.**

1. Nuk mund të quhesh popull i pushtuar, kur e ke perandorin të gjakut tend.

2. Ajo kastë shtetërore ilire, e cila u preokupua aq shumë për mbarëvajtjen e asaj perandorie, nuk gjeti dot, si duket, as më të voglën arsye për të krijuar një **strategji për vete**, për etninë së cilës i përkiste. Ata njerëz, ata paraardhës të shqiptarëve, bënë politikë **gjithështetërore, gjith Evropiane, gjith mesdhetare**, por nuk menduan aspak që një ditë ai shtet edhe mund të shpërbëhej.

Ç’duhej të bënin ilirët, nëse ai shtet një ditë shkatërrohej?!

3. Në po këta shekuj, në kohën kur jo vetëm ilirët, por asnjëri nga popujt e qytetëruar të atij “*Unionit*” nuk po gjenin dot ndonjë rrugë tjetër të së ardhshmes, turma popujsh të paqytetëruar, armatosur me logjikën për të plaçkitur çdo gjë që mund t’u hynte në punë dhe për të rrënuar çdo gjë që nuk u hynte në punë, e mbuluan krejt vendin me kufoma dhe me gërmadha. Popujt e lashtë, mes tyre edhe ilirët, u detyruan t’i nënshtrohen procesit të një simbioze të re me popujt imigrantë: vandalë, sllavë, normanë, gotë, longobardë, hunë, avarë, sllavë, kotrigurë...

4. Në asnjë shkollë të mesme, as në fakultet, të Evropës së sotme dhe të Mesdheut të sotëm, as në Itali, as në Francë, as në Angli, as në Spanjë, as në Algjeri, as në Libi, as në Egjipt, as në Izrael, as në Siri, as në Turqi dhe as në Greqi, nuk u thuhet

nxënësve dhe studentëve që vendet e tyre i kanë qeverisur dikur paraardhësit e shqiptarëve të sotëm. As në filma. Trajtohen nëpër filma tema të furtunshme të asaj kohe, por **asgjëkundi nuk thuhet që kryepersonazhet e atyre furtunave kanë qenë paraardhës të këtyre të sotmëve shqiptarë**, për të cilët diskutohet me dekada: ***T'i pranojmë apo të mos i pranojmë në BE?!*** Na e kanë, vallë, frikën (instinktivisht) se mos i qeverisim prapë?!

Por ne nuk e kemi qeverisur ***“Unionin Euro-Mesdhetar të Antikitetit”*** më keq se eropianët e tjerë. E vetmja e metë e jona e dallueshme ka qenë që ne nuk kemi menduar **për vete si etni**. Kemi menduar kryesisht **për vete si person dhe për “Unionin”**. ***Të shpëtojmë “Unionin”!*** Kjo ka qenë deviza jonë e atyre shekujve. Jo: ***Të shpëtojmë Ilirinë në radhë të parë, pastaj, natyrisht që, do të kujdesemi edhe për “Unionin”***.

[Të njëjtin mentalitet do ta vëmë re te arnautët (pasardhës të ilirëve), në kohët kur Perandoria Osmane u quajt: ***I Sëmuri i Bosforit. I Sëmuri i Bosforit*** ishte shtrirë për të vdekur, ne bënim çmos për ta shpëtuar. Përrjashtim bënë, për fatin tonë të mirë, vetëm Rilindësit tanë. **Ata** e pajisën me **sy** Kombin tonë.]

Zanafillat e të copëtuarit tonë.

Atdheu ynë nuk është copëtuar për herë të parë në vitet 1878 apo në 1913. Copëtimi i parë (të themi më saktë, i ish-Atdheut tonë), pas një jete thujse 6-shekullore të përbashkët (gjysmën e kohës i robëruar, gjysmën tjetër disi më i lirë), ka ndodhur më 395-n të e.s. Perandori iberikas Teodosi e ndau përmidis Perandorinë e Romës (***“Unionin Euro-Mesdhetar të Antikitetit”***) dhe me atë rast ai e ndau edhe Ilirikun. Thonë se punonte kundër nesh dhe se përpiquej për të na dëmtuar. Vija e quajtur ***“e Teodosit”*** niste në Singidun (Beogradin e sotëm) dhe soste në Gjirin e Meduas (Shëngjinin e sotëm). Ndarje më

të keqe për ne nuk mund të kishte. Të qe vënë kufiri në Trieste (dhe mund të vihej) ka të ngjarë që historia jonë të kish rrjedhur ndryshe.

Sidoqoftë, në lidhje me këtë kohë, ka një këndvështrim që duhet të jetë i qartë për historiografinë. Në fund të sh IV të e.s. (viti 395) ilirët, siç thamë, nuk mund të konsiderohen më si një popull i robëruar. Statusi i tyre kish 3 shekuj që ishte ndryshuar. Ata ishin pjesë e barabartë e popujvet përbërës të Perandorisë së Romës. Si e tillë, ajo pjesë e ilirëve që u ndodh në lindje të “*Vijës së Teodosit*” më 395-n, nuk ka si të konsiderohet popullsia e robëruar. Prej kujt do t’ ishte e robëruar ajo pjesë e Ilirikut?

Latinët (romakët), edhe sikur të vazhdonin të quheshin pushtues, kishin mbetur në perendim. Ata madje, jo shumë kohë më vonë do të zhbëheshin duke u zëvendësuar me të tjerë etnitete.

Ajo pjesë e popullsisë ilire, pra, që mbeti në trevat lindore, në të quajturën “Perandori Romake Lindore”, duhet konsideruar si pjesë shtetformuese e asaj perandorie.

Edhe pjesa perendimore e Ilirikut i kishte atributet e shtetformimit njëlloj si popujt e tjerë perendimorë, por ajo, me ndarjen prej pjesës lindore, hyri në të tjera rrjedha. Duke mos pasur një **strategji vetjake, strategji për vete**, ajo pjesë e ilirëve, në vend që të krijonte një shtet të vetin, siç edhe i krijuan popujt e tjerë më në perendim (të dalë nga simbioza me të ardhurit), iu nënshtrua asimilimit gradual prej të ardhurve (që në rastin tonë nuk ishin sive, normanë, longobardë apo gotë, por ishin sllavë). Edhe kjo është e rëndësishme të dihet.

Në pjesën lindore, gjatë gjithë shekullit VI në krye të shtetit kanë qenë ilirët. Vetë kryeqytetin e Perandorisë Romake Lindore e kishin themeluar mirëfilli ilirët. Që nga koha e Antikitetit të Hershëm ai qytet, siç e kemi thënë, mbante emrin **BIZANT**, pra, ***MBI ZANËTË** dhe, në është për t’i besuar shpjegimit

gjuhësor, ai është qartësisht një themelatë e protoshqiptarëvet shumë të lashtë. Në sh IV, pikërisht mbi themelet e **BIZANTIT** të dikurshëm, prapë një perandor i yni, **Konstantini i Madh**, ka ndërtuar aty **KONSTANTINOPOLIN**, madhështor dhe thaujse krejt të ri.

Në shek. VI, 2 shekuj më vonë, një tjetër perandor i yni, **Justiniani i Madh**, i ka bërë atij qyteti plotësime nga më të mrekullueshmit, përfshirë aty edhe kishën e madhërishme të Aghia Sofisë. Në këtë mënyrë, krejt historiografia e **KONSTANTINOPOLIT**, Stambollit të sotëm, duhet të rishikohet mbi bazën e të dhënave autentike të historisë e jo mbi bazën e dëshirave të njërit apo tjetrit historishkruar.

Shprehjet “*perandori ynë*” “*perandorët tanë*”, përdorur prej nesh në një libër tjetër para këtij, një mik i yni, tek po pinim një kafe në “*Bozhur*” të Prishtinës, na i quajti si “*të papërshatshme*”. Por ne, me gjithë vërejtjet e miqvet, nuk mund të heqim dorë nga pohimi se ata ishin mirëfilli **perandorët tanë**, ashtu siç do të jenë **vezirët tanë** edhe ata të Stambollit të mëvonshëm, pavarësisht se ç’rol luajtën në histori, njërit apo tjetrit.

Justiniani i Madh ka bërë për vendin e vet aq shumë, sa Ai, jo e meriton, por zëri i tij, i shuar para gati 1500 vjetësh, e kërkon me ngulm një monument shumë të madh mu në qendër të Shkupit, ndërtuar prej **shqiptarëvet** dhe me paratë dhe artin skulpturor **të shqiptarëvet**.

Me qëllim për t’u mbrojtur vendi prej barbarëvet, Ai ka ndërtuar në krejt hapësirën ilirike lindore përmbi 400 fortesa dhe i ka pajisur ato që të gjitha me armatimin dhe me efektivin përkatës.

Për ta çliruar Kishën Ilire prej Kishës Greke, Ai ka themeluar në Justiniana Prima (në Shkupin e sotëm) **Kryeipeshkinë e Ilirikut Lindor**. Ky do të jetë një institucion aq i rëndësishëm për ne, sa do të duheshin studime të posaçëm kushtuar veçanërisht

këtij institucioni. (Vazhdim i po asaj vepre, të themeluar prej Justinianit të Madh, ka qenë më vonë Arqipeshkvia e Tivarit, e themeluar në sh XI.)

Për të ribashkuar Atdheun, të cilin e kish pasë ndarë përgjysmë iberiku Teodos, Ai pat dërguar atje kryekomandantin e vet, të shumëdëgjuarin Belizar, gjithashtu i gjakut ilir, dhe e pat realizuar përkohësisht bashkimin.

Edhe sot krejt trualli ku banojnë shqiptarët është i mbushur me themele ndërtimesh, dikur nga më madhështorët, të cilët janë bërë këtu në kohën pikërisht të atyre 2 perandorëve tanë: **Konstantinit të Madh dhe Justinianit të Madh**. Kanë bërë këta 2 njerëz kaq shumë për vendin dhe për etninë e vet, njëri para ndarjes së Ilirikut, tjetri pas ndarjes, e megjithatë historiografia botërore, kur përmenden këta, as në cep të mendjes nuk e ka për të vënë në dukje se **ishin paraardhës të shqiptarëve**. Në të gjithë fakultetet juridikë të botës studiohet “**Kodi**” i famshëm i **Justinianit**, por asnjëri prej pedagogëve nuk ua bën të qartë studentëve të vet që **ky Justinian në jetën e tij të përditshme ka folur po atë gjuhë që flasin edhe sot shqiptarët**.

Kemi madje edhe në Tiranë fakultet juridik me emrin “**Justiniani i Parë**” por as aty pedagogët nuk u flasin studentëve të për Të si për një paraardhës të tyre. Kjo është shenja më e mirë për të treguar se në vitin 395 nuk u zu fill copëtimi vetëm i Atdheut të dikurshëm të shqiptarëve, por u zu fill e vazhdon edhe sot **copëtimi edhe i vetëdijes dhe i shpirtit të shqiptarëve**.

Uzurpimi = rirobërimi

Më në fund, të themi se në sh VII ka ndodhur vërtet **rirobërimi** i pjesës lindore të Ilirikut, këtë radhë jo prej latinëve por prej grekëve dhe jo me forcën e armëve por me trukun e **uzurpimit**. Perandori Herakli, në të vërtetë armen e

jo grek, ka vendosur në administratë, pra ka shpallur si gjuhë zyrtare të “*Perandorisë Romake Lindore*” gjuhën greke. **Kaq ka mjaftuar** për t’u rikthyer në robëri, jo një popull, por disa popuj. Krahas dhe pas kësaj, grekët kanë marrë në duart e veta **edhe fronin perandorak, edhe kreun e kishës**. Është tepër e rrëzikshme të jetosh në të njëjtin shtet me popuj të tjerë, kur nuk të funksionojnë armët e **vetëruajtjes**. Ilirët janë përpjekur në të gjithë shekujt pasues për të rimarrë veten, por nuk ia kanë arritur dot, sepse në asnjë rast ata nuk kanë krijuar dot një **strategji** suksesarritëse të mirëmenuar.

Sllavët në Gadishullin e Ilirikut

Perandori Herakli u ka bërë edhe një “*nder*” tjetër ilirëvet. Ai i ka lejuar sllavët, me dekret perandorak, që të vendosen në Ilirik. Justiniani ynë kish bërë kështjella, që të mos hyjnë dot as avarët, as sllavët, as dikush tjetër në vendin tonë, Herakliu, sapo erdhi në fron (100 vjet mbas Justinianit), formuloi dhe nënshkroi dekretin, me anën e të cilit u jepte leje banorëvet që ndodheshin në veri të lumenjvet Sava e Danub, për t’u vendosur ku të donin (në tokat bosh) në jug të këtyre lumenjve.

Kish 2 shekuj që popullsia sllave, e grumbulluar dhe e shumuar gradualisht në Vojvodinën e sotme, në Hungarinë e sotme dhe më në veri, depërtonte në tokat e Ilirikut dhe bënte plaçkitje, kryesisht duke ndjekur nga mbrapa kalorësit avarë. Por në të gjithë rastet forcat ushtarake të perandorisë, megjithëse të dobësuar, ia kishin dalë që t’i zbrapsnin e t’i rikthenin në vendbanimet, që më parë s’kishin qenë të tyret, por që tashmë i kishin zaptuar. Me sa duket, edhe ata vetë, mbasi mbusheshin me plaçkë të grabitur dhe me robër, për vete dhe për avarët, të cilëve u shërbenin, (këndeje edhe emri: *servus, sërb*) preferonin më shumë për t’u rikthyer nga kishin ardhur, sesa të qëndronin

midis popullatës, së cilës i kishin shkaktuar e po i shkaktonin aq shumë dhimbje.

Mirëpo, kur u pajisën me **leje shtetërore** (të cilën ndoshta as që e kishin kërkuar), ata morën familjet e veta dhe u ngulën kryesisht në tokat që shekujt e stuhishëm i patën lënë pa pronarë. Për shkak të shkretimevet që i kishin bërë barbarët që në shek. V, popullsia ilire ishte rralluar dhe shumë toka kishin mbetur pa pronarë konkretë. Pikërisht në të tilla prona pa pronarë konkretë u ngulën sllavët dhe formuan aty të quajturat **skllavini**. Rrjedhimisht, kurrsesi nuk duhet nënkuptuar që rrotull atyre skllavinive nuk kishte më popullsi vendëse. Përkundrazi, në të gjithë territorin e gadishullit të moçëm ka pasur **me shumicë** popullsi vendëse. Nuk duhet menduar gjithkështu që përtej lumenjvet Sava e Danub ka pasur një popullsi aq të madhe sllave, sa ajo e ka **përmytur** sa myll e çel sytë krejt gadishullin tonë.

Mbështetur në një të këtillë riformulim të konceptit të derisotëm të historiografisë, sipas të cilit sllavët e kanë **mbuluar** me popull të vetin krejt gadishullin, duke asgjësuar aty automatikisht ndonjë “**mbeturinë të fundit**” të lashtovendësve “**të romanizuar**”, ne mbrojmë idenë që **lashtovendësit kanë vazhduar të jenë të pranishëm në të gjitha kohët në krejt hapësirën e Gadishullit të Ilirikut dhe se ata kanë përbërë themelin e qytetërimit të sllavëve të mëvonshëm.**

Në pjesët lindore të gadishullit e në drejtim të pjesëve qendrore, në Bullgarinë e sotme dhe në një pjesë të Maqedonisë dhe Paionisë së dikurshme, janë ndodhur në Mesjetën e Hershme 3 substrate të popujvet të lashtë dhe 2 popullata të ardhura. Popujt e lashtë ishin: thrakasit, maqedonët dhe ilirët. Sa afër a sa larg njëri-tjetrit ishin etnikisht ata popuj mbetet për t’u studiuar. Konsideratë e rëndësishme për ne është që ata popuj, jo për një kohë të shkurtër, por për një kohë të gjatë, kanë pasur rol themelor **dhënës** ndaj popujvet të ardhur.

Popujt e ardhur ishin: një pjesë bullgaro-mongole dhe një pjesë sllave. Shkrirja e këtyre 2 popullatave, bullgaro-mongole dhe sllave, pas mendimit tonë, ka ardhur kryesisht nëpërmjet martesave. Femrat sllave, që martoheshin me meshkuj bullgaro-mongolë, u mësonin fëmijëvet të vet gjuhën e vet, jo gjuhën e burrave. Mjaftuan ashtu 3 breza që e gjithë popullsia bullgaro-mongole (kotrigure) të mos fliste më gjuhën e etërve të vet, por të fliste gjuhën sllave, gjuhën e nënavet të veta.

Shtetet që krijuan, pas 2 a 3 shekujsh, sllavo-bullgarët dhe sllavo-maqedonët, ishin **veçanërisht të dhunshëm** dhe kjo doemos i ka arsytet e veta.

Në territoret perendimorë të gadishullit, në Kroaci, në Dalmaci, në një pjesë të Bosnjës, lashtovendësit kanë qenë gjithashtu një faktor themelor **dhënës** në krejt kulturën e sllavëve të ardhur. Dallimi kryesor midis pjesës lindore dhe qendrore, nga njëra anë, dhe pjesës perendimore të gadishullit nga ana tjetër, duket se ka qenë (në këtë të fundit): **simbioza paqësore**. Popullsia vendëse, duke mos pasur shtetin e vet, nuk ka përbërë pengesë për ardhësit. Kështu që ardhësit nuk e kanë ndier nevojën e ndërhyrjeve shkatërruese me armë. Kanë marrë ç'u është dashur prej vendësve (mënyrën e të punuarit të tokës, mënyrën e të tregtuarit, festat, veshjet, tipet e shtëpive, lundrimin), kanë krijuar shtetin e vet dhe jeta ka vazhduar në rrjedha më "**normale**" sesa në lindje e në qendër. Jeta ka vazhduar më "**normale**", por lashtovendësit janë denaturuar, janë bërë sllavë në krejt ato hapësira. Madje një i tillë sllavizim "**normal**", dmth. pa masakra e pa luftëra, ka mbërritur deri në Grykat e Kotorrit e tani ka ardhur edhe më në jug, deri në Tivar: Shumë shqiptarë të Tivarit, sot, po parapëlqejnë "**paqësish**" ta quajnë veten "**kroatë**".

Në pjesët e tjera të Ilirikut, Sërbi e sotme, Bosnjë Lindore, Travuni (Hercegovinë e sotme) Diokle-Zentë (Mali i Zi i

sotmi dhe Shqipëri e sotme Veriperendimore prej Tivarit deri në lumin Mat), Dardani (Kosovë e sotme), 2 Epirët (Shqipëri e sotme Jugore deri në Artë), historia e marrëdhënivet midis lashtovendësve ilirë dhe sllavëvet të ardhur ka karakteristikat e veta, të dallueshme prej 2 të parave. Në Malin e Zi të sotmin, në Kosovën e sotme, në shtetin shqiptar të sotmin, në pjesët veriore të shtetit që sot quhet Maqedoni, në pjesët veriperendimore të shtetit të sotëm grek, janë krijuar aty-këtu enklava sllave, por ato nuk kanë arritur asnjëherë as të kompaktësohen e as të mbizotërojnë etnikisht.

Në pjesët jugore të Shqipërisë së sotme, midis vijavet Përlep-Ohër-Vlorë dhe Pind-Prevezë, gjurmët e ndikimit sllav nuk dëshmojnë për mbizotërim të popullsisë së ardhur, por për një veprimtari represive të shteteve, sllavo-bullgar apo sllavo-maqedon, të cilët, sapo krijohehin, nxitonin të vetëqueshin “*perandori*”. Dëshmojnë edhe për ndikim e veprimtari të kishës pravosllave, me qendër në Tërnovë apo në Ohër, e cila, në apogjetë e atyre “*perandorive*” vihej plotësisht në shërbim të sllavëvet. Duhet të vëmë re këtu edhe aspektin e prirjes drejt sllavizimit, nga ana e vetë popullatës vendëse, si “*kundërvënie*” ndaj presionit të ashpër të grekëvet për t’i greqizuar. Fenomeni “*për inat të sime vjehrrë vete flë me millonanë*” është shumë i përhapur ndër ne.

Në Sërbinë e sotme, në Sanxhakun e sotëm, në pjesët lindore të Bosnjës së sotme, popullsia lashtovendëse ka qenë me shumicë, por atë e kanë dëmtuar shumë rrymat heretike të **arianizmit** dhe më vonë të **bogumilizmit**. Duke qenë e pambrojtur prej qendrave të Kishës së Krishterë, përkundrazi duke qenë e anatemuar, ajo popullsi është bërë shumë shpejt viktimë e sllavëvet të ardhur, të cilët nga shekulli në shekull vinin duke u fuqizuar, thjeshtë falë ruajtjes së gjuhës. Familjet feudale sllave, të pasuruara në ndërkohë dhe të pajisura me

ofiqe pushtetarësh, herë prej perandorëvet të Bizantit, herë prej mbretërve hungarezë (të cilët tashmë kishin zënë vend në rrafshullat përtej Danubit e Savës), kanë mundur të bëjnë ç'të duan me atë popullsi, madje edhe ta masakronin në masë, duke mos i dhënë llogari askujt. Ka të dhëna që popullsia heretike, ariane dhe bogumile, e cila jetonte në këto hapësira, ka pasur në atë kohë edhe një **literaturë** të vetën, të cilën zhupanët sllavë e kanë asgjësuar njësoj si vetë lexuesit e asaj literature. Mbetet për t'u hulumtuar se në ç'gjuhë kanë qenë shkruar ata libra.

Pikërisht në këto hapësira është krijuar edhe shteti i parë sërb, **shteti i Rrasës**. Vetë emri **RRASË** i kryeqendrës së atij shteti dëshmon që ato treva kanë qenë banuar me shumicë vendësish, madje deri vonë, deri në sh XII në mos edhe më këndej. [Historia e Peshterit (**POSHTERIT**) pret për t'u studiuar gjithanësisht: Në fusha të ekonomizimit, si në blegtori etj., (dhentë e Peshterit janë të veçanta), në traditë gojore, në këngët popullore, veçanërisht epika legjendare, si dhe në çdo aspekt tjetër historiko-etnologjik.]

Në Dardaninë e dikurshme (në Kosovën e sotme) **dhe në Paioninë e dikurshme**, filluar prej Nishit e mbaruar në Përlep e në Dibër, elementi sllav ka qenë shumë i pakët. Kjo ka ndodhur për arsye se, në kohën kur perandori Herakli ka dhënë lejen që në tokat bosh të vendosen sllavë, tokat në këto hapësira, duke qenë të rrafshëta e pjellore, i kanë zotëruar latifondistët vendës (ish-skllavopronarë të fazës së kalimit në feudalizëm). Pra, **nuk ka pasur toka bosh**. Një pakicë sllavësh të ardhur, kanë mundur të vendosen vetëm në disa pjesë kodrinore dhe këta banorë të rinj, duke qenë banorë kodrash, janë quajtur **goranë**.

Në fund të sh XII dhe në fillim të sh XIII **Kosova e sotme**, pikërisht duke mos qenë e banuar me sllavë, nuk ka mundur të "**aneksohet**" si disa treva të tjera, por **është pushtuar me forca ushtarake** prej dinastisë sërbe të Nemanjiqvet. Të kish

qenë Kosova e banuar me sllavë, sërbët e Rrasës nuk do t'ishin detyruar të ndëmerrnin ekspedita ushtarake, madje shumë të ashpra dhe të zgjatura në kohë, për t'i bërë të vetat ato toka.

Për më tepër, me qëllim që t'u mbyllej feudalëvet të mundur josllavë çdo rrugë rikthimi në pronat e veta, psh Dukagjinëvet, Kosanëvet, Kobilëvet, Bogdanëvet e të tjerë, që ishin tërhequr në male apo ngushtuar në prona më të vogla, dinastët sërbë, të udhëhequr e udhëzuar prej **Shën Sava Nemanjiqit, njërit prej më largpamësveve strategë të asaj dinastie**, kanë praktikuar në shkallë të gjërë **metodën e kalimit të tokave, me gjithë bujkrobër, në pronësi të manastireveve**. (Sigurisht, Shën Sava Nemanjiqi, më parë i ka uzurpuar manastiret e Kosovës, siç e akuzon kryepeshkopi i Ohrit në një letër, i ka mbushur ata manastire me klerikë sërbë, pastaj i ka hyrë punës së “*dhurimit*”.) duke qenë një tokë **pronë e kishës**, e cila në gjuhën greke quhej **metoh** (dhe së këndejmi sërbët e sotshëm Rrafshin e Dukagjinit e quajnë **Metohi**), një ish-pronar laik e ka shumë vështirë për ta rimarrë. Prandaj krejt historia e Sërbisë Mesjetare është e mbushur me dokumente të quajtur **hrisovula**, me anën e të cilaveve monarkët u “*dhuronin*” manastireveve, tashmë **pravosllavë**, qindra e mijëra hektarë toka. Ia dhuronin kështu **vetëvetes**, sepse kisha pravosllave s'ish tjetër veçse armë ideologjike dhe prone ekonomike e drejtpërdrejtë e monarkut. Kjo ish njëkohësisht një mundësi më tepër që bujkrobërit, të quajtur **meropsë**, të sllavizoheshin nën presionin e murgjveve pravosllavë.

Shtojmë edhe këtë, që Kosova deri në sh XV në disa dokumente, madje edhe turke, quhej **Toka e Konstantinit**. Ne mendojmë që në rrënjën e emrit **KOSOVË** qëndron pikërisht emri i **Konstantinit të Madh**. Ndryshimet fonetike nga ***e Konstantinit** (***e Konstit**), me prapashtesën sllave –**OV(O)**, vënë më vonë, janë realisht të mundshëm, siç ka ndodhur psh te **STAMBOLL**, ardhur nga **KONSTANTINOPOL**, ku janë

reduktuar apo ndryshuar më shumë se gjysma e tingujvet. Trevë më e ngushtë, e cila e ka ruajtur atë emër në një formë pak më të ndryshme, është ajo e Kosanicës (ndoshta: **Kostënza*) në pjesën veriore të Kosovës. I fundit sundimtar i asaj treve, siç duket, ka qenë ai që epika serbe e quan Kosaçiq Ivan e i cili në arbërishten e atëhershme mund të jetë thirrur: **Gjon Konstënza* ose, në një formë më të evoluar: **Gjon Kosanca*.

Edhe në trevat e Diokle-Zentës së dikurshme (Mali i Zi i sotmi dhe Shqipëria Veriperendimore prej Tivarit deri në lumin Mat), numri i sllavëve ka qenë prapë shumë i kufizuar. Megjithkëtë, në sh XI, duke përfutur nga ligjet ushtarako-feudalë që Bizanti i zbatoi, si edhe gjetkë, edhe në Themën e Durrësit, disa individë e familje sllave arritën të fuqizoheshin. Një e tillë familje sllave, e quajtur *VOJISLLAVLJEVIQ*, e cila kish lidhje gjinie edhe me Nemanjiqtë e Rrasës, ia doli të krijojë aty një mbretëri mjaft të fuqishme. Jeta e asaj mbretërie, përmes kontradiktavet të përgjakshme në gjirin e vetë pjesëtarëve të dinastisë, ka zgjatur diku rreth 100 vjet. Por, duke qenë se kjo dinasti ishte një dinasti sllave, në historiografinë shtrembëruese, e cila për fat të keq është zotëruese në ballkanistikë, është nënkuptuar sikur edhe popullsia e kësaj mbretërie ka qenë sllave. Që kjo s'është aspak e saktë, këtë e vërtetojnë shekujt e mëvonshëm, të cilët u kaluan nën sundimin e dinastisë serbe të Nemanjiqvet, e prapëseprapë popullsia aty, përkundër të gjitha përpjekjeve për ta tjetërsuar, mbeti përgjithësisht një popullsi arbërore, madje deri në Kotorr e deri në Cetinjë. Sllavizimi i arbërvet të Malit të Zi të Moçmit është kryer nga sh XV e këndeje dhe kjo ka ndodhur si rezultat i veprimtarisë së Mitropolisë Pravosllave të Cetinjës nga njëra anë dhe i presionit islamizues të pushtuesvet osmanë nga ana tjetër.

(Shënim që u takon kapitujvet të mëvonshëm: E njëjta dukuri “*e të fjeturit me millonanë për inat të vjehrrës*” ka ndodhur

edhe me çamët ortodoksë në Jugun tonë. Ata kanë shkuar drejt greqizimit në shenjë kundërshtimi ndaj islamizimit.)

Iliro-albanizmat në gjuhët sllave

Ne nuk do t'u hyjmë këtu argumentimevet të hollësishëm. Bëmë vetëm një parashtrim fare të shkurtër të historisë sonë që nga ardhja e sllavëve e këndej. Duam vetëm të vëmë në dukje që kultura e lashtë e ilirëve, tashmë iliro-arbërore, filluar prej shek. VII e këndej, deri e pakta në sh XII, ka ndikuar shumë fuqishëm në krejt kulturën sllave, jo vetëm ndër sllavët e Jugut, por edhe te ata të Lindjes.

Në ilustrim të kësaj që thamë, po sjellim me këtë rast vetëm një pjesë të vogël **iliro-albanizmash**, që i gjejmë sot në gjuhët sllave dhe që sllavistika e derisotme, fatkeqësisht, as që i ka vënë re. Por, para se t'i rendisim dëshmitë e gjuhës, duam të vëmë në spikamë nja 2 a 3 pika, të cilat ballkanologjia e veçanërisht albanologjia dhe sllavistika (përfshirë aty edhe sllavistikën jashtëballkanike), do të duhet t'i mbajnë parasysh për t'i korrigjuar në të ardhshmen.

1. Kontaktet midis parashqiptarëve (protoshqiptarëve) dhe sllavëve nuk kanë ndodhur vetëm në trevat ku sot jetojnë shqiptarët, ose në një periferi të ngushtë përrreth këtyre trevave, por kanë ndodhur në një hapësirë gjeografike shumë më të gjërë, e cila fillonte në rrjedhat e epërme të lumit Sava dhe shtrihej deri në Selanik e në Konstantinopol. Në Konstantinopol, sepse atje ish kryeqyteti i shtetit të tyre dhe njerëzit shkonin atje më shumë se kudo gjetkë. Kjo ishte hapësira ku parashqiptarët jetonin në ata shekuj. Por sllavët kishin kontakte të përditshëm me pjesëtarë të kësaj popullate edhe jashtë këtyre hapësirave, atje ku sot jetojnë rusët, ukrainasit, bjellorusët, çekët, sllovakët. Parashqiptarët, në kuadër të shtetit të Bizantit, lëviznin në ato hapësira sllave

në radhë të parë si tregtarë, por edhe si zejtarë, muratorë, drupunues, artistë, si lundëtarë, si nëpunës a përfaqësues të shtetit dhe sidomos e në numër të konsiderueshem, si misionarë të krishtërit. Shkonin atje bashkë dhe krahas me pjesëtarë të tjerë të Perandorisë Romake Lindore, me grekë, me dakë, me armenë, me thrakas, me sllavë të Jugut, dhe përhapnin në ata vise kulturën e Perendimit. Gjuha ruse, kjo që është sot, i ka themelet e pasurimit të vet pikërisht në gjuhët që vinin prej Gadishullit të Ilirikut. Më saktë, gjuha ruse i ka themelet e pasurimit të vet: në latinishten, në ilirishten dhe në greqishten. Kur themi **THEMELET E PASURIMIT**, kemi parasysh, midis tjerash, **FONDIN THEMELOR** të fjalorit rus: **СОЛНЦЕ, ЛУНА, МОРЕ, СМЕРТ, ЖИЗНЬ**... Fondi themelor i fjalorit rus është i mbushur së pari me fjalë latine. Mirëpo, dihet nga rrethanat historike që atë lëndë **latine** nuk ua kanë çuar rusëvet latinët. Atëherë, kush ua ka transmetuar rusëvet leksikon latin? Doemos popujt e lashtë të Gadishullit të Ilirikut, midis të cilëve më të shumtët në numër, po edhe ndër më të familjarizuarit me gjuhën latine, ishin parashqiptarët. Kjo është një tezë, e cila detyrimisht duhet të zërë vend në studimet e ardhshëm dhe, ose të argumentohet me sa më shumë mbështetje faktike, ose të hidhet poshtë për mungesë argumentesh.

2. Teza që parashqiptarët ishin “*një popull blegtoral*”, ndërsa sllavët e ardhur ishin “*një popull bujqësor*”, kjo përrallë entuziastësh të ekzaltuar, njëkohësisht edhe cinikë, nuk i qëndron kritikës shkencore. Ajo duhet të zëvendësohet me pohimin që parashqiptarët, si një popull i lashtë i këtij vendi, kanë qenë bartës dhe transmetues të **gjithanshëm** të qytetërimit ndër sllavët e ardhur. Sllavët e ardhur morën prej parashqiptarëve: Edhe mënyrën se si bëhej bujqësia, edhe mënyrën si mbaheshin e shtoheshin bagëtitë, edhe mënyrën si ndërtoheshin qytetet, që prej bërjes së një shtëpie deri te muret e kështjellavet,

edhe mënyrën si bëhej tregtia, edhe mënyrën si lundrohej në detra e liqene, edhe mënyrën si nxireshin e përpunoheshin mineralet, mënyrën si administrohej shteti dhe, më në fund, edhe mënyrën se si duhej t'i luteshin Zotit. Të gjitha këto, sllavët e ardhur, i kanë marrë, si prej ilirëve, në kontaktet e tyre të përditshëm rreth e rrotull enklavave të tyre të quajtura **skllavini**, ashtu edhe prej popujve të tjerë të këtushëm lashtovendës. Duhet theksuar se, në një formë të veçantë, sllavët morën kulturë e qytetërim edhe prej grekëve, kryesisht për 2 arsye: së pari, grekët, në ata shekuj (shekujt VII, VIII dhe IX) kishin në duart e veta pushtetin qendror të Perandorisë Romake Lindore dhe së dyti, grekët u dhanë sllavëve **shkrimin**, gjë që sllavët i shndërroi në **etni të vetëjetueshme**. Që të bëhesh **etni e vetëjetueshme**, në radhë të parë duhet që të kesh **shkrimin tend**, me të cilin të shkruash **gjuhën tënde**.

3. Teza e Shtadtmyllerit mbi formimin ose formësimin e kombit arbëror në hapësirat e Matit të sotëm, Mirditës, Krujës e Librazhdit, nuk ka të bëjë fare me **ekzistencën madhore** të etnisë parashqiptare në Gadishullin e Ilirikut. Ajo ka të bëjë thjeshtë me emrin **ARBËNË**, që e kish zanafillën pikërisht në këta vise, si dhe me faktin që, për shkak të qëndresës **epokale** që i patën bërë këta vise sllavizimit, si dhe helenizimit, këtë emër e bënë të vetin edhe ata ish-**“fise”** të tjerë iliro-epiroto-maqedonas, të cilët nuk ishin sllavizuar apo helenizuar deri atëherë. Vetëm kështu mund të pranohet teza e Shtadtmyllerit. Përndryshe, nëse pretendon që **ARBËRIT “u shpërndanë”** prej Matit e prej Fanit dhe zaptuan **fizikisht** veriun, veriperendimin, lindjen, juglindjen deri në Thesaloniqi dhe jugun deri në Ambraki, ajo tezë vetëvetiu bie poshtë njëherëpërgjithmonë.

4. Gjuha **kishtare starosllave**, e quajtur ndryshe **gjuha sllave e vjetër kishtare**, e cila përmendet shumë në sllavistikë e, lidhur me të, edhe në albanologji, është një gjuhë **tepër e re** në krahasim

me gjuhën e parashqiptarëvet. Ajo ka zënë fill të dokumentohet jo më parë se në sh IX. Duke qenë kështu një gjuhë **shumë e re**, ajo nuk mund të merret si gjuhë **dhënëse**, në raport me parashqipen, të paktën deri në sh X, kur shkrimi sllav, i formuluar prej Cirilit e Metodit, kish filluar ta shndërrojë gjuhën sllave në gjuhë kulture. Pra, deri në sh X gjuha shqipe duhet të ketë shumë pak huazime prej sllavishtes. Përkundrazi, deri në shek. X është parashqipja, krahas me gjuhët e tjera lashtovendëse, ajo që u ka dhënë lëndë jetësore, jo vetëm gjuhëvet sllavojugore, por të gjitha gjuhëvet sllave.

Këto ishin 4 tezat tona të cilat do të duhet të trajtohen në të ardhshmen në thellësinë dhe në gjërësinë që u takon.

Po sjellim tash këtu një numër të vogël, nga numri mjaft i madh i toponimevet dhe i hidronimevet që sllavojugorët i kanë **trashëguar prej parashqiptarëvet** anembanë ish-Gadishullit të Ilirikut: Dikur ARBA, sot RAB, ishull në Dalmaci. Dikur AUTARIATAE, “*fis*” në Prebalitanë, sot TARA, lumë në shtetin Mali i Zi. HADRIATICUM, sot JADRANSKO MORE, Deti Adriatik. Dikur BOSANIOS, sot BOSNA, lumë në shtetin Bosnjë e Hercegovinë. Edhe vetë makrotoponimi BOSNJË është i trashëguar prej parashqiptarëvet. Dikur BRATTIA, sot BRAC (Braç), ishull në Dalmaci. Dikur DRAVUS, sot DRAVA, lumë në shtetin Kroaci. Dikur DRINUS, sot DRINA, lumë-kufi midis shtetevet Bosnjë e Hercegovinë dhe Sërbi. Dikur DALMATAE, sot DALMACIJA, trevë bregdetare në shtetin Kroaci. Dikur DECADARON, sot KOTOR, qytet në shtetin Mali i Zi. Dikur PHARUS, sot HVAR, ishull në Dalmaci. Dikur HISTRI, “*fis*” ilir, sot ISTRRA, gadishull në shtetin Kroaci. Dikur ISSA, sot VIS, ishull në Dalmaci. Dikur IADER, sot ZADAR (Zarë), qytet në Dalmaci. Dikur CORKYRA NIGRA, sot KORČULA (Korçulla), ishull në Dalmaci. Dikur CURICTAE, sot KRK (Kërk), ishull në Dalmaci. Dikur LABEAT, sot BLATO (Blato),

emërtim malazias për Liqenin (e Shkodrës). Dikur MELITE, sot MLJET, ishull në Dalmaci. Dikur METEON, sot MEDUN, vendbanim në shtetin Mali i Zi. Dikur MARGUS, sot MORAVA, lumë në shtetin Sërbi. Dikur NARONA, sot NERETVA, lumë në shtetet Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci. Dikur NAISSUS, sot NIŠ (Nish), qytet në shtetin Sërbi. Dikur OENEUS, sot UNA, lumë në shtetin Kroaci. Dikur PANNONIA, provincë, sot PANONSKA RAVNICA (Fusha e Panonisë), në shtetin Kroaci. Dikur RISINIUM, sot RISAN, qytet në shtetin Mali i Zi. Dikur SISCIA, sot SISAK, qytet në shtetin Kroaci. Dikur SAVUS, sot SAVA, lumë në shtetet Kroaci dhe Sërbi. Dikur SIRMIUM, qytet, sot SREM, krahinë në shtetin Sërbi. Dikur SALONE, sot SOLIN, qytet në shtetin Kroaci. Dikur TERGESTE, sot emërtimi sllav: TRST (Tërst) për Trieste, qytet në Itali. Dikur TRAGURIUM, sot TROGIR, qytet në Dalmaci.

Kur themi *trashëguar*, nënkuptojmë që, kur kanë ardhur sllavët, në krejt këta vise ka banuar dikush. Ndryshe s'kishin si **trashëgoreshin** këta emra vendesh, lumenjsh etj. etj. Këtij konstatimi të pakundërshtueshëm në i shtojmë edhe këtë: Në të gjithë këta vise, popullsia lashtovendëse ka jetuar, në fqinjësi me kolonitë e imigrantëve, për një kohë shumë të gjatë, të paktën 3 shekuj, pa u asimiluar. Gjatë gjithë kësaj kohe ajo nuk ka reshtur **së dhëni** popullatës së ardhur, jo vetëm elementë të gjuhës e të kulturës shpirtërore, por **elementë të rëndësishëm** të të gjitha fushave të jetës e të jetesës. Sllavët gjithashtu nuk kanë reshtur së absorbuari prej vendësve gjithçka që atyre u duhej.

Dëshmi, që sllavët nuk kanë reshtur së absorbuari kulturë iliro-arbërore, janë edhe njësitë onomastike të mëposhtme. Dhe kjo ka ndodhur, siç e kemi thënë tashmë disa herë, jo veç në vendet ku jetojnë edhe sot shqiptarët, por në krejt hapësirat ku dikur kanë jetuar të parët e shqiptarëvet.

BALTOVO, vend në Sllavoni, Kroacia veriore, shpjegohet me fjalën shqipe *baltë*...

(Me qenë se qëllimi i këtij libri nuk janë analizat etimologjike, ne do të mjaftohemi këtu vetëm me një renditje të thjeshtë, pa u ndalur në shpjegime. Kërkojmë ndjesë për ata toponime të cilët mund të mos rezultojnë vërtet të burimit iliro-arbëror, sepse dihet që etimologjia është shkenca më e pasigurtë dhe më e pabesë në Botë.)

BOSANSKE LIGATICE, në Bosnjë, nga *ligatë*. BREZOVICA, në Mal të Zi, nga *i bardhë* (**badhëzë*). BERI, në Mal të Zi, nga *bari*, ruajtës bagëtish. BRIÐE (Brigje), trevë në Mal të Zi, banorët: BRIÐAŠI (brigjashi), nga *breg*. BRIÐEZA (Brigjeza), gjithkështu në Mal të Zi nga *breg*. BUKUMIRI, në Mal të Zi, nga *bukë* dhe *mirë*. BULLGARI, vend i bullgarëve, nga *bulgër*. (Vo! Duhet parë dhe mundësia e kundërt.) BURMAZI, në Hercegovinë, nga *burë i madh*. CETINJE (në dokumente: Zentina), në Mal të Zi, nga *me zanë* (**zantinë*). CUCE, në Mal të Zi, nga *sutë* (**tësutëzë*). CUCIĆI (Cuciqi), në Mal të Zi, nga *sutë* (**të sutë*). DRETELJ, në Hercegovinë, nga *dredhël*. DINARA, në Dalmaci, nga *dhi*. OMBLA, në Dalmaci, nga *i âmbël*. FOĀANSKE LIGATICE (Foçanske Ligatice), në Bosnjë, nga *ligatë*. FRUSHKA GORA, në Vojvodinë, nga *me fry*. FIRZA, në Mal të Zi, nga *fier*. ÐENOVIĆI (Gjenoviqi), në Hercegovinë, nga *gji* (deti). ÐEĀ (Gjeç), në Bosnjë, nga *Gjekë*. ÐINOVO BRDO (Gjinovo Bërdo), në Mal të Zi, nga *Gjin*. MIHALJANE, në Mal të Zi, nga *mbi halënë*. KRAJINA, në Bosnjë, nga *krah* (anë). UKRAINA, vend i ukrainasvet, nga *krah* (anë). KRUSI, në Mal të Zi, nga *krueth*. KRIMALJ, në Mal të Zi, nga *krye mal*. LEKIĆI (Lekiqi), në Mal të Zi, nga *Lekë*. LJEŠANKA NAHIJA (Leshanska Nahija), në Mal të Zi, nga *Llesh* ose *Lesh*. LEŠKOVI DO (Leshkovi Do), në Mal të Zi, nga *Leshko*. LIGATI, në Bosnjë, nga *ligatë*. LOVĀEN (Llovqen), në Mal të Zi, nga *lak* (leqe). LJIG, në Sërbi, nga *i lig*. LUGOMIR, në Sërbi, nga *lug i mirë*. MAJEVICA,

në Bosnjë, nga *majë*. MALONŠIĆI (Malonshiqi), në Mal të Zi, nga *mal*. MIRAS, në Mal të Zi, nga *i mirë*. MORAČA (Moraça), në Mal të Zi, nga *me ra* (**mëratësha*). NIKŠIĆ (Nikshiq), në Mal të Zi, nga *Nikë*. NJEGUŠI, në Mal të Zi, nga *mjegull* (dikur: *niegull*). OKLJAJ, në Kroaci, nga *me qa* (dikur: *me kla*). PERAST, në Mal të Zi, nga *rrasë* (**mbë rrasëtë*). PEŠTAN (Peshtan), në Sërbi, nga **poshtënë*. RAČA (Raça), në Sërbi, nga *me ra* (**ratësha*). RAS, në Sërbi, nga *rrasë*. RIPANJ, në Sërbi, nga *me rjepë*. ROGAME, në Mal të Zi, nga *rogë*. SENJ, në Kroaci, nga *thinjë*. SINJAJEVINA, në Mal të Zi, nga *thinjë*. SPUŽ (Spuzh, në dokumente: Spëllzh), në Mal të Zi, nga *s* dhe **pyllzë*. SORE, në Mal të Zi, nga *sorrë* (?). SUKA, në Mal të Zi, nga *sukë*. SUKEZA, në Mal të Zi, nga *sukëz*. SUTJESKA, në Mal të Zi, nga *sutë*. ŠALJEZA, në Mal të Zi, nga *shalë*. ŠEKULARE (Shekullare), në Mal të Zi, nga *me (u) shkulë*. ŠINĐON (Shingjon), në Mal të Zi, nga *Shën Gjon*. ŠTEK (Shtek), në Mal të Zi, nga *shteg*. UGNJE, në Mal të Zi, nga *ujë* (**ujna*). UB, në Sërbi, nga *ujë* (**ujbë*, krs. *ubël*). VERIGE, në Mal të Zi, nga *varg*. ZALAZI (Zallazi), në Mal të Zi, nga *zallzë*. ZAŠTEK (Zashtek), në Mal të Zi, nga *shteg*. ZETA (dikur Zenta), në Mal të Zi, nga *me zanë* (**zenëtë*).

Do të renditim tash një varg tjetër albanizmesh në gjuhët sllave. Janë **patronimet**, llagapet apo emrat e familjevet, të cilët në mënyrë fare konkrete dëshmojnë për procesin e sllavizimit të shumë banorëve parashqiptarë në të gjitha ato hapësira. Kjo na dëshmon që ne nuk u kemi dhënë sllavëvet vetëm kulturë, por edhe përmbajtje të konsiderueshme gjenetike.

Vëmë në dukje që të gjithë këta patronime janë vërtetuar jashtë Shqipërisë. Jo jashtë Republikës së Shqipërisë, por jashtë Shqipërisë! Pra, përtej kufijvet të Atdheut tonë, në hapësira të gjëra ku banojnë sllavët.

BALJAŠEVIĆ (Balasheviq), nga *balash*; BALJEVIĆ

(Baleviq), nga *balë*; BALJOŠEVIĆ (Balosheviq), nga *balosh*; BULATOVIĆ (Bullatoviq), nga *baltë*; BRIĐANIN (Brigjanin), nga *breg*; BURIC (Buriq), nga *burrë*; BURMAZOVIC (Burmazoviq), nga *burrë i madh*; CUCKIĆ (Cuckiq), nga *sutë* (**tësutësë*); ČALOVIC (Çaloviq), nga *i çalë*; DEDIĆ, nga Dedë; DREKALOVIC (Drekalloviq), nga *Ndrekë*; GAŠIĆ (Gashiq), nga *Gashi*; ĐOKIĆ (Gjokiq), nga *Gjokë*; ĐOLOVIĆ (Gjolloviq), nga *gjolle*; ĐONOVIĆ (Gjonoviq), nga *Gjon*; ĐEKANOVIĆ (Gjekanoviq), nga *Gjekan*; EGRIC (Egriq), nga *i egër*; ГУРЕВИЧ (Gureviç), Rusi, nga *gur*; KALJEVIĆ (Kaleviq), nga *kalë*; KALEZIĆ (Kaleziq), nga *kalëzë*; KILIBARDA, nga *kalë i bardhë*; KLJAJEVIĆ (Klajeviq), nga *me qa* (dikur: *me kla*); KLJAJIĆ (Klajiq), nga *me qa* (*me kla*); KRCUNOVIC (Kërcunoviq), nga *kërcu(n)*; KRIJEVIĆ (Krijeviq), nga *krye*; LALEVIĆ (Llaleviq), nga *lalë*; LALIĆ (Llaliq), nga *lalë*; LEKIĆ (Lekiq), nga *Lekë*; LEKOVIĆ (Lekoviq), nga *Leko*; LEŠEVIĆ (Lesheviq), nga *Llesh*; LEŠIĆ (Leshiq), nga *Llesh* ose *Lesh*; LEŠKOVIĆ (Leshkoviq), nga *Leshko*; LEŠOVIĆ (Leshoviq), nga *Llesh*; LJOPIĆIĆ (Lopiçiq), nga *lopë*; LJUMEZIĆ (lumeziq), nga *lumëz*; MALEŠOVIĆ (Maleshoviq), nga një rasë e vjetër e arbërishtes: **ënë malëshi(t)*; NIKEZIĆ (Nikeziq), nga *Nikëzë*; NILOVIĆ (Nilloviq), nga *Nilë*; NUŠIĆ (Nushiq), nga *Nush*; PLJAKIĆ (Plakiq), nga *plak*; PRENTIĆ (Prentiq), nga *Prend*; PRENTOVIĆ (Prentoviq), nga *Prend*; ŠALJIĆ (Shaliq), nga *shalë*; ŠEŠELJ (Sheshel), nga *sheshël*; ŠEŠLIJA (Sheshlija), nga *shesh*; ŠKULETIĆ (Shkuletqi), nga *me shkulë*; ŠKUNDIĆ (Shkundiq), nga *me shkundë*; ŠOĆ (Shoq), nga *shok*; ŠOŠKIĆ (Shoshkiq), nga *shoshkë*; ŠTEKOVIĆ (Shtekoviq), nga *shteg*; ŠTILJANOVIĆ (Shtilanoviq), nga *me shti* (*shtijë*); VEŠOVIĆ (Veshoviq), nga *vesh* (*Vesho*); VUKŠALIĆ (Vukshaliq), nga *Vukë* dhe *shalë*; ZEMIROVIĆ (Zemiroviq), nga *zâ (i) mirë*; ZOGOVIĆ (Zogoviq), nga *zog*; ZOTOVIĆ, nga *Zoto*.

Rrënjët e një pjese të këtyre patronimeve janë të importuara edhe në shqipen. Kështu që, siç ndodh shumë shpesh në marrëdhëniet ndërgjuhësore, shqipja në ata raste nuk është dhënëse e parë, por është ndërmjetëse. Siç thamë edhe pak parë, Kombi shqiptar këta emra familjesh i ka dhënë **me gjithë njerëz**. Te toponimet ka dhënë **tokën dhe emrat**, te patronimet ka dhënë **edhe njerëzit, edhe emrat**. Njerëz, pasardhësit e të cilëve, si do të shohim më vonë, kanë bërë kërdrinë mbi bashketniasit e vet të dikurshëm.

Sa i përket **fjalorit të përgjithshëm**, në qarqet shkencorë ka zotëruar dhe zotëron mendimi se gjuhën shqipe e ka përmblytur leksiku sllav, thuajse në të njëjtën masë me leksikun latin, ndërsa roli dhënës i shqipes në gjuhët sllave, thuhet, ka qenë aq modest, sa gati nuk ia vlen as të përmendet. Kjo ka ndodhur nga mosnjohja e historisë. Ose mosdashja për ta njohur historinë. Studiuesit i kanë vështruar shqiptarët në gjendjen që janë sot. Nuk i kanë perceptuar në thellësi të kohëve. I kanë konceptuar në sinkroni, jo në diakroni. Puna ka ardhur deri atje, sa kur gjendej një tufë fjalësh në rumanishten, të njëjta ose të ngjashme me shqipen, shkencëtarët injorantë habiteshin: **Si ka mundur të ndodhë një gjë e tillë?! Ku janë takuar këta 2 popuj?!** Dhe as që u shkante mendja atyre pseudodijetarëve që këta 2 popuj kanë kaluar një jetë të tërë, **para “Romës”, gjatë “Romës” dhe pas “Romës”**, shekuj pa mbarim, në fqinjësi dhe në përbashkësi. Merret me mend se sa larg mendjes së tyre ishte dhe është mundësia që parashqipja të ketë dhënë farë kontributi psh edhe në gjuhën ruse. Përmirësimin në këtë fushë do të mund ta sillte vetëm një **rishikim nga e para i balkanologjisë**, i substratit ballkanik, si në raport me etnitë më të vjetra, helenë dhe latinë, ashtu edhe në raport me etnitë që kanë ardhur më vonë në histori, sllavë e të tjerë.

Janë me mijëra njësitë leksikore, të cilat sllavistika dhe

albanologjia duhet t'i rishikojnë e rishqyrtojnë, në pikëpamje etimologjike, duke pasur këtë herë në themel të vëmendjes faktin historik shumë të rëndësishëm që iliro-arbërishtja është gjuhë shumë më e vjetër se starosllavishtja kishtare. Ne, sërish të detyruar, për shkak të temës, që t'i lëmë për një rast tjetër shpjegimet më të përimtuar, do të renditim këtu një numër **fare të vogël** prej atyre fjalëve, të cilat mendojmë se duhet t'i rishqyrtojnë albanologjia dhe sllavistika në të ardhshmen.

Si tituj të njësisvet kemi vënë fjalët e sllavishtes jugore qendrore, pastaj kemi shënuar hamendjen tonë, nga ç'fjalë e parashqipes mund të ketë shkuar ajo në atë gjuhë, kemi sugjeruar, në mjaft raste, shtrirjen e atyre fjalëve edhe në gjuhën ruse. Është e kuptueshme që, një pjesë lexuesish, të cilët nuk janë të udhëzuar në punë të gjuhësisë, mund t'i kapërcejnë pa i lexuar pasazhe të kësaj natyre.

1.BALEGA, bajgë, nga **balëgë*. (Fam.fjal. më se 4 njësi)

BARZAST, i bërthylët, nga **i bardhëzë*.

BDETI, me ndejtë zgjuar, nga **me bdi* (me pritë ditën).

BIGAR, stalaktit, çmërs, bigorr, nga **mbi gur*.

BILJKA, bimë, nga **me mbi*. (fam. fjal. më se 7 njësi)

BLATO (bllato), 1.baltë, 2.liqen, nga **balëtë*. Krs. rus: БОЛЛОТÓ (ballato). Fam.fj: më se 9 njësi)

BLAVOR (bllavor), bullar, nga **bullar*.

BOS, i z bathur, nga **bath* [(z)bath, (m)bath]. Krs. rus: БОСОЎ (basoj). Fam.fj: më se 10 njësi)

BRAV, berr, nga **berr*. Fam.fj: më se 9 njësi)

10.BREG, breg, nga **mb(ë) reg*. Krs. rus: БÉРЕГ (bjerjeg). Fam.fj: më se 15 njësi)

BREME, barrë, nga **e barme*. Krs. rus: БРÉМЯ (brjemja). Fam.fj: më se 15 njësi)

BREZA, mështekën, nga **bardhëzë*. Krs. rus: БЕРÉЗА

(bjerjoza). Fam.fj: më se 9 njësi)

BRIGA, brengë, nga **me bre*. Fam.fj: më se 17 njësi)

BUJATI, me u hazdisë, me u fry, nga **mb(ë) ujë*. Krs. rus: БУЙНЫЙ (bujnjë). Fam.fj: më se 16 njësi)

BUJOL (bujoll), kovë e vogël druri, nga **mb(ë) ujëlë*.

BUJON, lëng mishi, nga **mb(ë) ujënë*.

BUNAR, pus, bunar, nga **me bunue*. Fam.fj: më shumë se 3 njësi)

BUS, plis dheu, bucë, nga **butësë*. Fam.fj: më se 13 njësi)

CILJ, cak, qëllim, nga **me qëllue*. Krs. rus: ЦЕЛЬ (cel). Fam.fj: më se 4 njësi).

20.**DIM**, tym, nga **tym*. Krs. rus: ДЫМ (dëim). Fam.fj: më se 29 njësi)

DINAR, monedhë (e njohur jo vetëm te sllavët), nga **dhi*, njësi shumë e hershme shkëmbimi. Fjalë e përhapur në shumë popuj. Fam.fj: më se 3 njësi)

DLETO, daltë, nga **dalëtë*.

DRHTATI, me u dridhë, nga **dridh(ëh)*. Krs. rus: ДРОЖАТЬ (drozhat). Fam.fj: më se 10 njësi)

DRUGA, drugëz, nga **dru*.

DRVO, dru, nga **dru*. Krs. rus: ДЕРЕВО (djerjevo). Fam.fj: më se 58 njësi). Është një shembull se si, gjuhët, pasi të kenë huazuar qoftë edhe një fjalë të vetme, mund të pasurohen pafundësisht me mjetet e vet. Kështu ndodh edhe me tokën: Të merr ai tjetri një pëllëmbë vend dhe ndërton aty për vete një qytet. Por ka një dallim: Kur tjetri të ka marrë tokën, i dëmtuari je ti, kurse kur të ka marrë fjalën, je ti ai që ndjehesh mirë. Ndjehesh mirë, sepse janë të parët e tu... je ti ai që u ke dhënë kulturë të tjerëvet.

FRULA, fyell, nga **me fry*. FRULAŠ (frullash).

FRUS, fruth, nga **fruth*.

GRABITI, me grabitë, me rrëmbye, nga **(kë)rrab(ë)*,

(kjo nga **me rrëmbye*). Krs. rus: ГРАБИТЬ (grabit). (Fam.fj: më se 33 njësi).

GRAD, qytet, nga **gardh*. Krs. rus: ГОРОД (gorod), por edhe ОПОЛОТ (apallot), kështjellë, nga ПЛОТ, *gardh*. Fam.fj: më se 68 njësi)

30.GRANICA, kufi, nga **guranëzë*. Krs. rus: ГРАНЬ (granj), cak, kufi, nga **guranë*. Fam.fj: mëse 21 njësi)

GREJATI, me ngrohë, nga **me ngrohë* (e kundëra: *me ngri*). Krs. rus: ГРЕТЬ (grjet). Fam.fj: më se 19 njësi)

GREPŠA (grepsha), dantellë, nga **grep*.

GRINTAV, që grindet, nga **me u grindë* (**me gri*). Fam.fj: GRINTATI, GRINTAVAC, rimarrë prej nesh me formën *grindavec*.

GRINUTI, me u vërsulë, me u hedhë, nga **me u ngritë*.

GRINJA, tenjë, mole, nga **me gri*. (Fam.fj: më se 27 njësi)

GRKLJAN (gërklan), laring, nga **grykël*. Fam.fj: GRKLJANI (gërklani), GRKLJANSKI (gërklanski).

GRLO (gërlllo), fyt, nga **ang* (**angërlë*). Krs. rus: ГОРЛО (gorllo). Fam.fj: më se 28 njësi)

GROB, varr, nga **gropë*. Krs. rus: ГРОБ (grob). Fam.fj: më se 19 njësi).

ГОРСТЬ (gorst), grusht, nga **gurëstë*.

40.HALABUKA (hallabuka), zallamahi, nga **hallabyk!* (Nëpër të folme krahinore të shqipës njihet fjala-pasthirrmë: *Hallabyk!*) Fam.fj: HALABUČITI (hallabuçiti), TARLABUKA (tarllabuka), TALABUKA (tallabuka).

HLEB, bukë, nga **elbëh*. Krs.rus: ХЛЕБ (hljeb). Fam.fj: më se 13 njësi)

HRANA, ushqim, nga **me hanger* (**e hangërnë*). Krs. rus: ХРАНИТЬ (hranjit). Fam.fj: më se 33 njësi).

HUNJAVICA, rrufë, nga **hundë*. Fam.fj: më se 4 njësi).

HVALA (hvalla), falemnderit, nga **lauh* – **hual-* **fal*.

Krs. rus: ХВАЛІА (hvalla). Fam.fj: më se 30 njësi).

ЯКОРЬ (jakor), spirancë, nga **hekur*.

КАСА, tinar, fuçi, nga **kadëzë*. Krs. rus: КАДКА (kadka).

КАЈАТИ СЕ, me u pendue, nga **me kajtë* (mund të jetë forma dialektore e njohur e trevavet veriore). Krs. rus: КАЯТЬСЯ (kajatsa). Fam.fj: më se 15 njësi).

КАЛЈАС, dhëmb syri (te kali), nga **kalë*.

КАТУН, tëbanë, nga **katund* (**kë-të-end*).

50.КАЗАТИ, me kallëzue, nga **kalli* (**kallëzë*). Krs. rus: ПОКАЗАТЬ (pakazat). Fam.fj: më se 65 njësi).

КИША, shi, nga **kë-shi*. Fam.fj: më se 14 njësi).

КЛАС (kllas), kalli, nga **kallës*. Krs. rus: КОЛОС (kollas). Fam.fj: më se 13 njësi)

КЛЕТ, me mallkue, **me kla* (ndoshta dikur **me këlye*). Krs. rus: КЛЯСТЬ (kljast). Fam.fj: më se 25 njësi).

КЛЈУН, sqep, nga **kël-hundë*. Krs. rus: КЛЮВ (kljuv). Fam.fj: më se 21 njësi)

КЛЈУСЕ, gërdallë (kalë), nga **kalë-së*. Krs. rus: КЛЯЧА (kljaça) Fam.fj: КЛЈУСАД, КЛЈУСИНА.

КОКУЛИКА, e qethur e rrumbullakët në majë të kokës (te priftërinjtë), nga **kokë-ulë* ose **kokë-(ë)l(ë)-zë*.

КОЛЕНО, gju, nga **gëlun*. Krs. rus: КОЛЕНО (kaljeno). Fam.fj: më se 7 njësi).

КОРАК, hap, nga **k(ë)rah-kë*. Fam.fj: më se 13 njësi).

КОРЕН, rrënjë, nga **kë-rra-një*. Krs. rus: КОРЕНЬ (korjenj). Fam.fj: më se 17 njësi).

60.КОСА, kosë, mjet korrës, nga **korrësë*. Krs. rus: КОСА (kasa). Fam.fj: më se 24 njësi).

КОШУТА (koshuta), drenushë, sutë, nga **kë-sutë*. Fam.fj: më se 5 njësi).

КРАЈ, skaj, mbarim, nga **krah*. Krs. rus: КРАЙ (kraj). Fam.fj: më se 37 njësi. Midis tyre edhe emir i një shteti.)

KRASTA, dregëz, nga **me krue* (**kruestë*). Fam.fj: më se 11 njësi).

KRESTA, lafshë, nga **krye* (**kryestë*).

KREŠTATI (kreshtati), me bërtitë (sa ke në kokë), me krrokatë, nga **krye* (**kryestë*), nëse s'është onomatope. Krs: KREŠTALICA (kreshtalica), grifshë.

KRILO (krillo), krah (shpendi), nga **krah* [**krih-(ë)lë*] Krs. rus: КРЫЛО (krëllo). Fam.fj: më se 17 njësi).

KRINKA, maskë koke, nga **krye* [**kry(e)n-kë*].

KRUH, bukë, nga **grunë* [**gru(në)h*]. Fam.fj: më se 4 njësi).

KRULENJE, gurgullim, nga **krue*, burim. KRULITI, me gurgullue (**me krulue*).

70.KUKOLJ, bimë që i ka farëzat të kokëluara, të mbledhura në një guaskëz, nga **kokë-l(ë)*.

KUKURUZ, misër, nga **kokërrzë*. Krs. rus: КУКУРУЗА (kukuruza). Fam.fj: më se 10 njësi).

LJAGA, njollë (e pistë), nga **me lagë*.

LAKAT (llakat), bërryl, nga **(i) lakëtë*, i kthyeshëm. Krs. rus: ЛОКОТЪ (llokot). Fam.fj: më se 11 njësi).

LJIGAV, i jargët, nga **lye-gë*. Fam.fj: LJIGAVAC, LJIGAVOST.

LIZATI, me lëpi, nga **me lye-zë*. Krs.rus: ЛИЗАТЬ (ljizat). Fam.fj: më se 33 njësi)

LUG (llug), korie, pyll i vogël, nga **me ulë* [**ul(ë)-g(ë)*], me metatezë. Krs. rus: ЛУГ (llug). Fam.fj: më se 6 njësi).

MAGARAC, gomar, nga **(ë)më-gar*. Fam.fj: më se 11 njësi).

MAGLA (maglla), mjegull, nga **m(ë)-ag-ëlë*. Fam.fj: më se 15 njësi).

MLEČANIN (mlečanin), venedikas, nga **(ë)m(ë)-let* (Krs. arbërisht: *lëti*, për *latin*). Forma të tjera në sllavishtet: MLECI,

venedikasit, U MLECIMA, ndër venedikas, MLETAČKI (mletački), i Venedikut.

80.MLEKO, qumësht, tàmël, nga **(a)m-ël-kë*. Krs. rus: МОЛОКО (mallako). Fam.fj: më se 16 njësi).

MRAK, errësirë, nga **me u errë* [**(ë)m(ë)-err(ë)-k(ë)*]. Krs. rus: МРАЧНЫЙ (mraçnjë). Fam.fj: më se 16 njësi).

MRAZ, ngricë, nga **mardhëzë*. Krs.rus: МОРОЗ (maroz). Fam.fj: më se 30 njësi).

NEDELJA, e dielë, javë, nga **diell* [**n(ë) e diele*]. Krs. rus: НЕДЕЛЯ (njedjelja). Fam.fj: më se 9 njësi).

ODRIPAN, zhelan, me rroba rripa-rripa, nga **rrip*, **i rjepur*, i bërë rripa-rripa.

ORAH, arrë, nga **arrëh*. Krs. rus: ОПЕХ (arjeh). Fam.fj: më se 10 njësi).

OŠURITI (oshuriti), me përvëlue, nga **zhur*, shkrumb. POŠURITI (poshuriti).

OTAC, atë, nga **atë* [**at(ë)-s(ë)*] gjegjësisht [**at(ë)-ac*, **at-(j)ec*]. Krs. rus: ОТЕЦ (atjec). Fam.fj: më se 9 njësi).

PEČI (peqi), me pjekë, nga **me pjekë*. Krs. rus: ПЕЧЬ (pjeç). Fam.fj: më se 40 njësi).

PELENA, shpargën, nga **pjellënë*. Krs. rus: ПЕЛЕНА (pjeljena). Fam.fj: më se 6 njësi).

90.PIRITI, me fry në zjarr, me fry era, nga **pir*, rrënja e emrit pirust, etnonjësi ilire shumë e njohur. Fam.fj: më se 12 njësi).

PITATI, me pyetë, nga **me pyetë*. Fam.fj: më se 33 njësi).

PITI, me pi, nga **me pi*. Krs. rus: ПИТЬ (pjit). Fam.fj: më se 46 njësi).

PIZMA, urrejtje, mëri, nga **pezëm*. Fam.fj: më se 4 njësi).

PLANINA (pplanina), mal, nga **pyllënë*. Fam.fj: më se 11 njësi).

Po e ngarkojmë kështu lexuesin me një lëndë përshtypjerisht

të panevojshme. Por vetëm përshtypjerisht, sepse thelbërisht, në një libër si ky, të këtilla përkujtesa janë më se të kërkueshme. Do të shohim më poshtë që janë madje më se të domosdoshme. I ke dhënë tjetrit, në këtë rast popullit fqinj verior, bashkë me **tokën e bukës**, edhe **emrin e bukës**, i ke dhënë emrin e qytetit, i ke dhënë emrin e fushës, e ka marrë prej teje mënyrën si punohet toka, ka mësuar prej teje si ndërtohen kështjellat, fortesat (me gardh e me gur), ka mësuar prej teje ritet për t'iu lutur Zotit. Duke pëfituar nga **pastrategjia** jote, ta ka marrë Singidunin (Beogradin), ta ka marrë Naissusin (Nishin). Tash kërkon edhe Mitrovicën, Deçanin, Brezovicën, madje edhe Durrësin!

Në anë tjetër, fqinji jugor, pasi i ka marrë prej nesh emrat e perendivet, mënyrën si nxiren mineralet dhe si bluhen meli dhe gruri, ta ka rrënuar paharrueshmërisht Trojën (pas gjasave që rrinë ende nën mjegull), t'i ka marrë ishujt, të Egjeut dhe të Jonit, bashkë me të gjithë mitet, ka arritur t'i përfshijë në kufijtë e vet shtetërorë edhe Artën, Janinën, Grebenenë, dhe tash kërkon Himarën, Grykën e Këlcyrës, madje mundësisht edhe Kavajën, pasi t'ia ketë nxjerrë edhe asaj eshtrat përmbi dhe!

Nuk po merremi më tutje psh me shenjat që na ofron Virgjili te “Eneida” e tij, apo me të fshehtat që ende rrinë të mbuluara nën varret e etruskëvet, por po duam të themi: ***A nuk meriton pak më shumë dashamirësi ky Komb kaq i madh në qenien e vet dhe kaq i marginalizuar në politikën e përditshme?!***

PLEME, fis, nga ***e pjellme**. Krs. rus: ПЛЕМЯ. Fam.fj: më se 17 njësi).

POJAS, rrip i leshtë, brez që ngjishet rreth ijevet, nga ***ije** (***ijas**). Krs. rus: ПОЯС (pojas). Fam.fj: më se 6 njësi).

POJITI, mu dhënë ujë (bagëtitvet), nga ***ujë**. Fam.fj: më se 4 njësi).

POKLISAR, lajmëtar, kumtar, nga ***me klithë**.
POKLISARSTVO.

PRAG, prag, nga **për-ag*. Krs. rus: ПОРОГ (parog).

PRČ (përç), cjan i patredhur, cjan mbarsës, nga onomatopeja **përc* dhe prapashtesa *-(*ë*)*sh*. Fam.fj: më se 14 njësi).

100.PRDA (përda), pordhë, nga **pordhë*. Fam.fj: më se 21 njësi).

PRISPETI, me mbërritë, nga **i shpejtë* (**i spe-të*). Krs. rus: УСПЕТЬ (uspjet). Fam.fj: më se 30 njësi).

PRLJATI (përlati), me fëlliqë, me ndy, nga **me përlye*. Fam.fj: më se 11 njësi).

PRLJITI (përliti), me djegë pak, me përvëlue, nga **me përvëlue*. Fam.fj: më se 8 njësi).

PRPUŠKATI (përpushkati), me përpushë (pula), nga **me përpushë*.

PRSA (përsa), parzma, nga **parësë*. Fam.fj: më se 15 njësi).

RAME, sup, nga **krah-më*. Fam.fj: më se 10 njësi).

RAVAN, i rrafshët, nga **me ra*. Krs. rus: РАВНИНА (ravnjina). Fam.fj: më se 46 njësi).

PA3 (raz), herë, ndoshta nga **herëzë*.

REKA, lumë, nga **me rrjedhë* (**rrjedhkë*). Krs. rus: РЕКА (rjeka). Fam.fj: më se 8 njësi).

110.REKESA, zbatice e detit, nga **rrëkesë*.

RONITI, me zhytë, me rrëzue, nga **me ra* (pjesorja e vjetër: **ranë*). Krs. rus: РОНЯТЬ (ronjat). Fam.fj: më se 18 njësi).

РУКОПАШНЫЙ (rukopashnëj), trup me trup, nga **ruka*, dorë, dhe **pash*.

RUNDAV, me qime, me push, nga **me rrue* (**i rruntë*). Fam.fj: më se 16 njësi)

SENO, sanë, bar i thatë, nga **me tha* (pjesorja e vjetër: **thanë*). Krs. rus: СЕНО (sjeno). Fam.fj: më se 8 njësi).

SINJAST, i përhimë, nga **thinjë*. Krs. rus: СИНЕТЬ (sinjet). Fam.fj: më se 12 njësi).

SISATI, me thithë, nga **me thithë*. Krs. rus: СОСАТЬ

(sasat). Fam.fj: më se 20 njësi).

SLAMA (sllama), kashtë, nga **lâmë* (**s-lâmë*). Krs. rus: СОЛОМА (salloma). Fam.fj: më se 14 njësi).

SOKO(L) [soko(II)], fajkua, nga **zog-ël(ë)*. Krs. rus: СОКОЛ (sokall). Fam.fj: më se 14 njësi).

STADO, kope, grigjë, nga **stan* [**(i)(e) stantë*]. Krs. rus: СТАДО (stado).

120.STOPANIN, zot shtëpie; stopan, nga **tëbanë* (**s-tëbanë*). STOPANICA.

STRANA, brinjë, nga **stër-anë*. Krs. rus: СТОРОНА (starana). Fam.fj: më se 30 njësi).

STREHA, strehë, nga **stër-re* (vend ku nuk shikohesh, vend ku nuk vihesh re). STREJA.

STRM (stërm), i rrëpinët, nga *me stër-ra* [*(i) stër-ramë*]. Fam. fj: Më se 12 njësi).

STROPOSHTATI SE, me u rrëzue, me u rrokullisë, nga **me u stër-poshtë*.

STRUGATI, me gërrye, nga **dru* (**s-dru-gë*). Krs. rus: СТРУЖКА (struzhka), bujashkë. Fam.fj: më se 9 njësi).

STRUKA, strugë, mbulesë e leshtë kundër shiut, nga **stër-uj(ë)-gë*. E njëjta prejardhje duket se haset edhe te emri **STRUGA**, shtrat lumi (pa ujë), vathë, zgavërr.

SVRAKA, laraskë, nga **sorr(ë)-kë*. Fam.fj: më se 5 njësi).

ŠEPATI (shepati), me çalue, nga **me shqepue* (**me u shqepë*). Fam.fj: më se 11 njësi).

ŠPELUNKA (shpellunka), strofull, nga **shpellë*.

130.ШПЕНЕК (shpjenjok), thumb i tokëzës, nga **me shpue* [**shpuen-k(ë)*].

ŠPINAKL (shpinakëll), një prej pëlhurave (velave) të anijes, nga **shpinë* (**shpin-ak-ël*).

ШПИДЕЛЬ (shpindjelj), bosht, nga **me shpue* [**shpuen-të-(ë)l*]

ШПОРА (shpora), mamuzë, nga **me shpue* (**shporë*).

ШПУЉКА (shpuljka), gjep, rrotull, masur (në makinë qepëse), nga **me shpu* (**shpie*) ose **me shpue*.

ЅPURAK (shpurak), akrep, nga **me shpue* (**shpuer-ak*).

ЅTIPATI (shtipati), me pickue, nga **me shtypë*. Krs. rus: ШИПАТЬ (shçipat). Fam.fj: më se 19 njësi).

ЅTRUNJAČA (shtrunjača), dyshek, nga **me shtrue*. Fam. fj: më se 3 njësi).

ЅTUR (shtur), i zbrazët, i thatë, nga **me shthur* ose *(*i*) *vështirë*. Fam.fj: më se 3 njësi).

ЅUT (shut), shyt, pa brirë, nga **shyt*. Fam.fj: më se 5 njësi).

140.ЅUTJETI (shutjeti), me heshtë, nga **me shue* (zërin) (krs: *zâ i shutë*). E njëjta formë në rusisht ka kuptim tjetër, të kundërt me heshtjen. Fam.fj: më se 8 njësi).

TALAS (tallas), valë, dallgë, tallaz, nga **thellës*. Fam.fj: më se 6 njësi). (Edhe në greqisht kjo fjalë duhet të jetë një iliro-albanizëm)

TATA, atë, nga **të-atë*. Dim: TATICA.

TETKA, hallë, teze, nga **të-et* (motra e të et). Krs. rus: ТЕТКА (tjotka). Fam.fj: më se 13 njësi).

TMURAN, i errët, i mbyllët, nga **murr* (**të murrënë*).

TRK (tërrk), vrap, nga **turr*. Fam.fj: më se 37 njësi).

TROHA, thërrime, nga **trohë*. Fam.fj: më se 23 njësi).

TURA, lëmsh, shkul, tufë, vandak, nga **turrë*. Fam.fj: më se 15 njësi). Foljen **POTURITI**¹ G.Majeri e krahason me *turr*, por nuk besojmë të jetë i saktë.

TURIN, turi, nga **turi(n)*. Fam.fj: më se 5 njësi).

UBAO, ubël, pus në trevat karstike të Dinaridevet, i cili nozullohet me ujë të pastër nga burime të nëndheshëm. Vjen ose nga **ujbël* [**uj(ë)-b(ë)-ël*], ose nga **ujâmbël*.

150.URDA, urlë, qumësht i ntrashur, i thartë dhe i kripur, nga **urdh* (**urth*), djegësirë në grykë nga thartira që vjen prej

stomakut.

USAHNUTI, me shterrë, me tha, nga **me tha(h)*. Krs. rus: СУХОЙ (suhoj). Fam.fj: më se 71 njësi). (Vo! Rrënja e të gjitha këtyre fjalëve është **sah* [**tha(h)*] Të gjithë ndryshimet e tjerë tingullorë janë zhvillime të brendshëm të sllavishtevet.)

UŠULJATI SE (ushuljati se), me u futë barkas, nga **shul*, *shulas*

VAL (vall), valë, dallgë, nga **valë*. Krs. rus: ВАЛ (vall). Fam.fj: më se 7 njësi).

VAJKATI SE, me shprehë keqardhje, me u qa, nga **vaj* (vajtim).

VATRA, zjarr, nga **vatër*, vend ku ndizet zjarri. Fam.fj: më se 13 njësi)

VEDRO, enë druri, vedër. Ka në rrënjë fjalën **dru* dhe është iliro-albanizëm në disa gjuhë. Krs. rus: ВЕДРО (vjedro). Fam.fj: VEDARCE, VEDRICA.

VERIGA, vargua, zinxhir, nga **me var* (**varg*) (**me vjerrë*). Krs. rus: ВЕРЕНИЦА (vjerjenjica). Fam.fj: VERIŽICA (verizhica), VERIŽNI (verizhni), ВЕРЁБКА (vjerjovka).

VIG, kurth, grackë, nga **vig*, kalim i ngushtë.

VIRITI, me përgjue, nga **me vu re*. Fam.fj: nmë se 10 njësi).

160.VLAGA (vllaga), lagështirë, nga **me lagë*. Krs. rus: ВЛАГА (vllaga). Fam.fj: më se 8 njësi).

VRAN, i zi, nga **me vra* (pjesorja e vjetër: **vranë*). Krs. rus: ВОРОНОЙ (varanoj). Fam.fj: Më se 16 njësi).

VRAS, ngërç, nga **me vra* (**vras*, që vret).

ЗАРНИЦА (zarnjica), vetëtimë, nga **zjarr* (**zjarnëzë*).

ЗАРЕВО (zarjevo), flakë e kuqe e zjarrit, nga **zjarr*.

ŽAR (zhar), prush, nga **zjarr*. Krs. rus: ЖАР (zhar). Fam.fj: më se 34 njësi).

165.ŽEĆI (zheqi), me djegë, nga **me djegë* (**dégō*). Krs. rus: ЖЕЧЬ (zhjeç). Fam.fj: më se 21 njësi).

Besojmë se kjo është një lëndë e mjaftueshme **nisëse**, për të dëshmuar që ndikimi i iliro-arbërbvet në kulturën e sllavëve, jo vetëm në gjuhë, por në krejt kulturën e atyre popujve, ka qenë krejt ndryshe nga ç'është përfytyruar deri më sot.

Lënda që parashtruar kërkon punë institucionale. Fonetistë, njohës të morfologjisë, njohës të ligjeve të fjalëormimit, mbi të gjitha, njohës jo të sipërfaqshëm të gjuhëve përkatëse. Nëse do të vërtetohej gjithanësisht dhe bindshëm që këto 165 fjalë-bazë, apo shumica e tyre, janë vërtet iliro-albanizma, atëherë, duke llogaritur të gjitha njësitë leksikore që lidhen me këto fjalë-bazë, do të dilte që vetëm prej këtyre dhe vetëm në gjuhët sllavohugore qendrore e rusishte të ketë mbi 2000 iliro-albanizma. Themi mbi 2000, **vetëm prej këtyre**. Po prej së tjerash që nuk janë renditur këtu?!

Sidoqoftë, për të gjithë, edhe për ata që nuk u përkasin këtyre degëve, mendojmë se është tashmë e qartë: Deri në shekullin X kahja e ndikimit kulturor ka qenë: Nga banorët e lashtë të Ilirikut në drejtim të sllavëve, qoftë të atyre të ardhur, qoftë edhe të tjerëve, jashtë Ilirikut. Vetëm në shekullin X e këndeje fillon ndikimi i sllavëve mbi popujt e gjetur dhe kjo ndodh për 2 arsye:

Se sllavët tashmë e **shkruanin** gjuhën e tyre dhe se ata ia dolën të krijojnë **shtetet e vet**.

Ia dolën të krijojnë shtetet e vet, **me kishë të vetën** dhe **me administratë në gjuhë të tyre**.

Kjo, midis tjerash, bëri që, ndërsa sllavët zgjeroheshin, arbërit, një ndër etnitë **ushqyese** të kulturës së sllavëve, të sillleshin deri në zgrip të zhdukjes. Por zhdukja nuk ka ndodhur, vetëm falë vitalitetit të jashtzakonshëm e në shumë aspekte të çuditshëm e të pabesueshëm, që kjo etni ruan në vetëvete në disa mijë vjet.

Erdhi, pas romakëve pushtues, pas grekëve usurpues dhe

pas sllavëvet, edhe **Turku**, kulturasgjësuesi më i kobshëm për Kombin tonë. Edhe ai, me krejt qenien e tij regresmbjellëse, na sollli deri në teh të greminës së mosqenies, por prapë nuk ndodhi shuarja totale. Shpëtuam për pak. U ringjallëm. Erdhëm kështu si erdhëm deri në shekullin XXI. Tash duhet kujdes i madh. Tash vërtet duhet kujdes i madh.

Shënim: Mbasi kish përfunduar krejt ky libër dhe ne po bënim përmirësimet e fundit, falë ndihmës së Prof.Dr.David Lukës dhe z.Lindë Luka, drejtoreshë e bibliotekës universitare në Shkodër, na ra në dorë “*Fjalori etimologjik i gjuhës ruse*” i dijetarit gjerman Maks Fasmer (Max Vasmer). Është një vepër disavëllimëshe, përkthyer nga gjermanishtja në rusisht dhe botuar në Moskë më 1964. I konsultuam edhe me këtë fjalor shembujt që ishin sjellë këtu si iliro-albanizma në gjuhën ruse. Gjuhëtari M.Fasmer ka bërë atje dhjetëra krahasime të secilës fjalë ruse me fjalë të të njëjtit kuptim apo të afërta në gjuhë të tjera, por vihet re që pothuaj asnjërës prej këtyre që kemi marrë ne si shembuj (gati 80 copë) nuk i është përcaktuar prejardhja. Madje 19 prej këtyre i ka krahasuar edhe me fjalë të shqipes, gjë që te sllavistë të tjerë rrallë haset, por prapë shihet që mosnjohja sa duhet e gjuhës sonë, sidomos e ligjevet të fjalëforminit dhe e tingujndryshimevet, ka bërë që as ky dijetar të mos arrijë në konkluzione, qoftë të veçeveçshëm, qoftë përgjithësues. Në këtë mënyrë, gjatë konsultimit fjalë për fjalë edhe të fjalorit të M.Fasmerit, ne e pëforcuam mendimin që shtegu, tashmë i hapur, do t’i çojë gjuhëtarët (ata që do të merren me këtë fushë në të ardhshmen) në zbulime mirëfilli bafasues, por njëkohësisht tepër të dobishëm në marrëdhëniet midis kombevet.

SHQIPTARËT DUHET TË DINË:

PSE NUK JANË ATA QË DUHEJ DHE QË MUND TË ISHIN ?!

Pakujdesia, vetjake dhe kolektive!

Përgjigjemi që në fillim: **Ka munguar kujdesi i individit ndaj tërësisë, së cilës i përkiste.** Si pasojë, ka munguar edhe kujdesi kolektiv ndaj vetëvetes. Kur themi *ka munguar*, kuptojmë, nga njëra anë, *nuk ka qenë kujdesi i çdo individi në lartësinë e duhur*, nga ana tjetër, *shpeshherë ka ndodhur edhe më tragjikja: Duke u kujdesur jashtë së pranueshmes për vetëveten, shumë individë, të vegjël apo të mëdhenj, e kanë dëmtuar të ekzistuarit tonë, qenien tonë, shumëfish më tepër se ç'do ta dëmtonte cilido i huaj.*

Këtu duhet të përqëndrohemi sa herë që hedhim sytë në të shkuarën. Dhe pikërisht **këtu** duhet të përqëndrohemi edhe sa herë që ne vetë kryejmë ndonjë punë apo themi ndonjë fjalë: *Unë, si individ, sa edhe si po bëj kujdes ndaj tërësisë së cilës i përkas?*

Kjo që po themi, nuk është ndonjë filozofi e madhe. Do ta shohim që vërtet nuk është ndonjë punë as e vështirë për t'u kuptuar, as e pamundshme për t'u zbatuar. Është thjeshtë një kujdes, të cilin mund dhe duhet ta ketë kushdo dhe i cili, natyrisht, rritet sa më i ngritur të jetë personi në pozitë shtetërore, apo në ndonjë tjetër pozitë.

Është thjeshtë një kujdes! Por kur mungoka ai kujdes, ardhkan tragjedi! Ardhka gjak! U mbuloka trualli me kufoma të masakruara!

E gjithë historia e etnisë sonë, krahas madhësisë, është e

mbushur plot me masakrime të popullsisë prej të huajvet. Kjo, sigurisht, tregon dobësinë, frikën dhe, krahas dobësisë dhe frikës, edhe pashpirtësinë e vetë masakruesvet. Por kjo dukuri tejet e dhimbshme tregon njëkohësisht edhe pakujdesinë, naivitetin dhe paaftësinë e **vetë ne**, si dhe bashkësisë së cilës i përkasim ne.

Tragjeditë.

Po e zëmë fillin qysh prej tragjedisë trojane. Nëse është e vërtetë që trojanët kanë qenë pjesë e paraardhësve tanë, atëherë naiviteti i tyre, i cili, me pranimin e Kalit të Drunjtë, ia ka vënë kapakun më të turpshëm heroizmit 10-vjeçar të një morie trimash të vet të papërmbysshëm, është sinteza më domethënëse e krejt historisë sonë të mëparshme dhe të mëvonshme. Kanë kaluar 3200 vjet dhe ende vazhdojnë të na ankohen fëmijët e djegur dhe gratë e therura të trojanëve. ***Pse u treguat aq të përgjumur mu në çastin kur duhej të rrinin më zgjuar se kurrë?! Mos ju lëntë të qetë as në fund të Hadit gjaku ynë i derdhur dhe i piksur nëpër rrasat e qytetit tonë të mashtruar, dhe mos ju lëntë të qetë shkrumbi i trupave tanë aq të njomë!***

Nuk po ndalemi në ç'ka ndodhur në 1000 vjetët që kanë pasuar. Por pas 1000 vjetësh vjen pushtimi i Ilirisë prej romakëve. Shkrumbi i qyteteve, të djegur e të rrafshuar prej sish (Vetëm në pjesën jugore mbi 70!) (Jo 70 shtëpi, por 70 qytete!), vjen prapë deri në kohën tonë dhe, fëmijët e djegur, gratë që hidheshin prej mureve, mallkojnë përsëri: ***Mos ju lëntë të qetë as në fund të Hadit gjaku ynë, i derdhur dhe i piksur në faqet e shkëmbinjvet!*** Era e fëmijëve të përcëlluar ngrihet përsëri në qiellin tonë: ***Pse na lindët, o prindër, kur nuk ishit të zotët për të na mbrojtur?!***

Pyetjet janë: Pse guxuan romakët ta sulmojnë Ilirin? Pse s'qemë ne aq të fortë, aq të zotë dhe aq të organizuar,

sa Romakut as të mos i shkonte mendja për të na sulmuar?

500 a 600 vjet më vonë, madje duke qenë vetë ne në krye të atij shteti, që quhej **Perandori Romake**, prapë nuk qemë në gjendje për t'i mbrojtur fëmijët tanë, këtë herë prej heshtavet dhe prej thikavet të barbarëvet. Ata fëmijë të njomë, ato vajza të pafuqishme, ato nuse e gra, prej të cilavet një pjesë edhe shtatzëna, u shndërruan në kufoma prej kalorsëvet të ardhur që nga Skithia a Mongolia. Lexojmë Hieronim Eusebin dhe Prokopin e Cezaresë, që shkruajnë për ato zezëri dhe na pupërrohet lëkura. Barbarët, ndonëse kishin emra të ndryshëm, hunë, gotë, avarë, sllavë apo vandalë, nuk bënë punë të ndryshme. Ata bënë të gjithë të njëjtën punë: Masakronin popullatën tonë! Digjnin, rrënonin, shkatërronin, rrëmbenin, ndërsa ne nuk ishim në gjendje t'ua gjenim marifetin. **Hapu, tokë, e jepua krimbavet burrat tanë, politikanët tanë, priftërinjtë tanë, sundimtarët dhe ushtarakët tanë, tregtarët !.. Kalbi, o tokë, të kalburit !**

Justiniani i Madh ndërtoi mbi 400 fortesa në të gjithë hapësirën ku mund të depërtonin popullvrasësit. Por ata që perandori i madh, i pagjumi Justinian, i la prapa në krye të shtetit, siç duket, i kish zënë gjumi i kobshëm i përtacisë e i paaftësisë dhe nuk qenë në gjendje t'i përdornin ato fortesa. Nuk qenë gjendje ata, apo ndoshta Justiniani s'e kish menduar mirë atë lloj mbrojtjeje, kjo ka pak rëndësi. Rëndësi ka që barbarët vazhduan të na vrasin, të na therin e, ç'të zënë gjallë, t'i çojnë me turma për në vendet ku ata banonin, kurse ne nuk e gjetëm dot as mençurinë, as dinakërinë, as forcën, as vullnetin, për t'i mbrojtur jetët e atye që vriteshin, që digjeshin nën gërmadha apo që graheshin drejt Veriut si kope bagëtish. Më në fund, po ata barbarë i gjetën mënyrat për të na i zënë edhe tokat, pjesën më të madhe të tokavet, kurse ne nuk i gjetëm dot mënyrat, as për t'u mbrojtur, as për ta shfrytëzuar ardhjen e tyre, me çfarëdolloj politike, të dobishme për ne. Pse të na ketë ndodhur kështu ?! Kjo është pyetja, e cila pa ndërprerje e godet nga brenda

ndërgjegjen tonë, si një lëkurë daulleje.

Vijnë shekujt 10, 11, 12, prapë me arbërvasës !. Njëfarë Stefan Nemanja, lindur në Dioklenë e lashtë ilire si foshnjë refugjati, rritur e fuqizuar në Rrasën tonë malore, ushqyer me sindromën e urrejtjes, jo vetëm ndaj nesh, por ndaj kujtdo që mund t'ia zinte rrugën, mbyllur prej të vëllezërve nëpër shpella, për shkak të tiparevet të tij prej egërsire, nuk rreshti së rrënuari, gjer në themele qytetet tanë në Diokle e në Dardani. Kur themi: ***nuk rreshti së rrënuari gjer në themele***, nuk mund të mos na kujtohen qindra Troja dhe nuk mund të mos u drejtohem prapë mbrojtësve të atyre qyteteve: ***Si, ore burrat e dheut, nuk gjetët një mënyrë efikase për t'i mbrojtur ata mure që ju vetë i kishit ndërtuar !? Si nuk gjetët një mënyrë efikase për të mbrojtur familjet, për të cilat nuk mund të dyshohet se ishin krijesat tuaja më të shtrenjta e më të dashura për ju ?!***

Një “**lojë**” makabre që nuk mund të harrohet kurrë.

Të 2 shekujt që i kaluam nën sundimin e Nemanjiqvet nuk mund të quhen ndryshe veçse shekuj të arbërvasjes, arbërdrydhjes, arbërshuarjes, arbëtkurrjes, deri në shkallën e mosqenies. E dëshmojnë këtë më së miri relacionet e arqipeshkvinjvet të Tivarit, por edhe dokumente të tjerë. Këtij kapitulli të kobshëm të arbërvasjevet e arbërposhtrimevet, duket se ia ka vënë kapakun më të zi familja e zezë e Preluboviqvet në Janinë. Kjo familje kish marrë prej kohësh nofkën ***albanoktonos (arbërvasës)***. Sipas Mihal Dukasit, pjesëtar i shtëpisë perandorake bizantine, sundimtari i Janinës, Atanasije, si duket, një prej pinjoqvet të Preluboviqvet, bënte “**lojëra**” me arbërit vendës, duke u prerë hundën ose organe të tjerë dhe duke i lënë ashtu të vdisnin në agoni. Faik Konica, në lidhje me këto “**lojëra**” të Atanasije Preluboviqit, shkruan afërsisht kështu:

Disa krerë feudalë arbër e kërcënuan Atanasijen me një ekspeditë ndëshkimore, nëse ai nuk do t'i ndërpriste krimet

kundër arbërvet. Atanasije (Preluboviqi) u përmbajt për një farë kohe dhe e martoi vajzën e vet me princin më të fuqishëm, Gjin Shpatën. (si i mori kështu me të mirë krerët e arbërvet) ai i rifilloi (përndjekjet, madje edhe më të egra se më parë). (Duke parë këtë tradhti të vjehrrit të vet) Gjin Shpata mblodhi ushtri dhe e rrethoi Janinën. Mirëpo, në kohën kur ne kishim dhënë e po jepnim prova se nuk dimë t'i mbrojmë arbërit, Atanasije Preluboviqi edhe i rrethuar, dinte ta kryente zanatin e arbërvasjes. Ai ngrinte në muret e kështjellës një flamur të bardhë, shenjë e armëpushimit, dhe ia dërgonte rrethuesit, dhëndrit të vet arbër, një shportë të mbushur me sy të nxjerrë nga kokat e masakruara të atyre arbërve që ndodheshin brenda kështjellës. Kjo do të thoshte: ***Po e zgjate rrethimin, o dhëndër, unë do të t'i lë pa sy të gjithë bashketniasit e tu, të paktën këta që i kam këtu brenda.*** Atëherë, si u përsërit kjo “*lojë*” makabre disa herë, Gjin Shpata e lëshoi rrethimin. (Krs.L.8,2004, f.112-113) Preluboviq të pas kësaj, e vazhduan punën e tyre deri sa i shfarosën të gjithë arbërit e Janinës.

Nuk kemi aspak ndërmend t'i fajsojmë as Nemanjiqtë, as Preluboviq të. Ata e kanë fajin në natyrën e tyre. Ata i kanë marrë me vete në varr edhe mallkimet e viktimave të tyre. Por bishën nuk e zë as barra e fajit, as mallkimi. **Ujqërit nuk fajsohen. Fajsohen barinj të!** Qoftë edhe të rrafshit të Gjin Shpatës, të cilin historiografia e ka cilësuar dhe duhet ta cilësojë si arbërin më të devotshëm të kohës.

TURQIA

Në sh XIV kur arbërvrasësit sllavë nuk kishin pushuar as nuk kishin ndërmend të pushonin së nxjerri sytë arbërvet, sa kohë që ne nuk kishim një **strategji** efikase, ia behën nga Lindja turqit osmanë.

200 vjet iu deshën Turqisë për ta pushtuar krejt tokën arbërore: Nga viti 1371, kur, pas Betejës së Maricës, ata hyjnë në Arbëri, deri më 1571, kur, pas gati 100 vjet qëndrese me shpirt ndër dhëmbë, bien në dorën e tyre gjithshkatërruese edhe Ulqini e Tivari. (Vo! Në librat tanë janë dhënë data të tjera. Mos ua vini veshin libravet që nuk mbështeten në logjikën e dokumenteve!) Kanë vazhduar, në këtë rrugë të zyrtë kohësh, ploja të panumërta të së njëtes pamje: Vra arbër (që më vonë morën emrin shqiptarë) dhe mos iu përgjigj askujt. Të gjithë qytetet tanë janë zbrazur thuajse tërësisht përpara zjarrit dhe hanxharit të turqvet osmanlli. Kanë ikur ata që kanë shpëtuar gjallë dhe është mbushur Italia me “*rracë*” arbëreshe. Nga 1371-shi deri më 1912-n, që bëjnë gati plot 5 shekuj e gjysmë, po të numërohen plojat në popull, pas qëndresavet dhe pas kryengritjevet, çuarjet me togje e tufa arbëresh, sidomos arbëreshash, në tregjet e skllërvet, vdekjet nga skamja dhe shuarjet e krahinavet të tëra nga epidemitë, fitohet përshtypja sikur më shumë janë asgjësuar se sa kemi lindur. Atëherë vjen vetiu habia e madhe, ndoshta një nga habitë më enigmatike në të gjithë historinë botërore: ***Si ia kemi arritur të mbijetojmë ?!***

Në një letër të ipeshkvit Nikollë Mekajshi, dërguar më 1599-n kardinalit S.Xhorxhio, bëhet paralajmërimi i frikshëm se, në tërësinë tonë etnike, formësuar në dhjetëra shekuj, shiheshin

tashmë qartë dukuritë që bartnin rrëzikshmërinë rrënoqethëse të shpërbërjes sonë përfundimtare dhe kërkohet ndihma e Perendimit : Një pjesë e popullsisë po kalonte në ortodoksinë greke, një pjesë tjetër në ortodoksinë pravosllave dhe një pjesë po islamizohej. Fill mbas një të këtillë alarmi, i cili dihet se nuk ish i pari që shkonte në Evropë, në truallin e Arbërisë u mbajtën 3 kuvende të rëndësishëm. Njëri, më 1602 dhe 1603 në Dukagjin të Matit, me 1600 delegatë. (Vetëm numri i pjesëmarrësve në këtë kuvend dëshmon që ne, edhe pas të gjithë rrebeshevet të shekujvet XV e XVI, ende ishim një popull mjaft i madh.) Kuvendi i dytë u mbajt në afërsi të Podgoricës, në kullën e madhe të Lalë Ndrekalit të Kuçit, krahinë e cila ende nuk ishte sllavizuar. **Kuvendi** i tretë u mbajt mu në Prokuplë, në njërin nga pikat më veriore të Arbërisë. Prej të 3 këtyre kuvendeve iu çuan Evropës mesazhe alarmi shumë të fuqishëm, por ish e kotë: **Ne duhej t'ia dënim vetë.** Iu çuan më vonë Evropës mesazhe, memorandume e thirrje: Prej Imz.Pjetër Budit, erdhi mbyjtja e tij, prej Imz.Fran Bardhit, erdhi vdekja e parakohshme e tij, prej Imz.Pjetër Bogdanit, erdhën trokllimat e kockavet të tija nëpër dhëmbë qensh, sepse turqit ua hodhën ato kocka qenvet.

Po japim në pak faqe një numër episodesh, për të kuptuar sa shumë ka hequr ky Komb, tashmë jo vetëm prej sllavëve e grekëve, të cilët gjithsesi nuk na u hoqën, por edhe prej turqvet. **Do cekur këtu që autorët e keqtrajtimevet e të reprezalievvet nuk kanë qenë përherë osmanllinj të ardhur nga Azia. Të ardhur nga Azia ishin pushteti dhe feja (ideologjia), ndërsa bartësit e atij pushteti dhe të asaj feje (islamizmit), ushtrues të zellshëm të dhunës, ishin vetë vendësit, bijtë e po këtij populli. Kjo është mynxyra më kurrizkërrusëse se cdo mynxyrë tjetër.**

“Klerikët provuan (prej ushtruesvet të pushtetit

turk-osmanlli. GjD) *mbi kurrizin e tyre dhunë fizike dhe morale deri në ekzekutim me vdekje. Nga gjithë ajo plejadë mund të veçojmë: Pjetër Budin, Dom Ndre Kalamashin, prifti i Gjakovës, Pjetër Mazrekun, vikar apostolik në malet e Shqipërisë, Dom Nikë Grubetin, Anton Pavllloviqin, misionar apostolik i Trepçës, i Vuçitërnit e i Prishtinës, Pjetër Bogdanin...*” Kështu thuhet në librin *“Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit, 1506-1839*“ f.130, shkruar nga Petrikë Thëngjilli. (Të dhënat që do të renditen në vijim, janë marrë po nga ky libër.) *“Të panumërt ish in ata (besimtarë) që martesat nuk i shpallnin në kishë, nga frika se turqit, kur shihnin ndonjë vajzë (nuse) të bukur, e donin për vetë”* (f.126) Rreth 30 seli arqipeshkvore, ose qendra kishtarë, u zhdukën dalëngadalë, veçanërisht në krahinën e Shkodrës dhe të Drinit të Ulët. (f.118) Në dioqezën e Shkodrës kishte pasur më shumë se 300 kisha, tani pothuaj të gjitha të rrënuara. (f.118) Në vitin 1602 Kisha e Zojës së Ngjitur në Qiell, në Prizren, digjet 3 herë dhe plaçkitet prej *“turqvet”*. (f.117) Po në atë vit prishet, rrënohet tërësisht, abacia e Shënkollit në Breg të Bunës, në afërsi të Ulqinit (f.117) Në vitin 1603, kundër ipeshkvit të Shkodrës, Imz.D.Andreasit, kishin shpifur, e kishin arrestuar dhe e kishin dënuar me vdekje. E kanë shpëruar disa të krishterë, pasi kanë paguar një sasi të mirë të hollash. (f.130). Në fshatin Letnicë, që ndan Malin e Zi (të sotmin) me Kosovën, u vra një prift katolik shqiptar. (f.130) Më 1609 sulltani katolikët e Tivarit i quan francezë. Po e citojm: *“Marin Bici, fetar dhe antivarens (dmth tivaras, GjD) i të krishterëvet frëngj në krahinën e Tivarit”* (f.127) (Mund të merret me mend se çfarë mund të ndodhë në një shtet ku kryesundimtari i njej kaq pak nënshtetasit e vet). Më 1611 kisha e Shën Markut në Mirditë është gjysmë e rrafshuar prej *“turqvet”* (f.124) (Emërtimi *“turk”*, kuptohet, është po aq i *“saktë”* sa emërtimi *“frëng”*).

Më 1611 Imz.Marin Bicin, në Shëngjergj e morën disa *“turq”*

dhe kishin vendosur ta vrisnin në një pyll, por, me ndërhyrjen e një prifti, ata e lanë të lirë, me kusht që të ndanin plaçkën përgjysmë, ndonëse ai kishte dokument të rregullt nga sulltani. (f.130) Po më 1611 thuhet që në Lezhë kisha e Shënkollit është zaptuar prej *“turqvet”* dhe është kthyer në xhami qysh prej 40 vjetësh (f.130). Në Prizren 2 kishat më të bukura të qytetit janë kthyer në xhami (f.122). Në Malin e Zi të Shkupit një kishë madhështore kthehet në xhami (f.122). Më 1613, me urdhër të sulltanit u prishën të gjitha kishat e ndërtuara *“pa leje”* në sanxhakun e Ohrit (f.121). Më 1624, priftin e Malësisë, Dom Markun, *“turqit”* e akuzojnë, e lidhin, i kërkojnë para, ai nuk ua jep, e çojnë në Shkodër te kadiu, kadiu e nxjerr të pafajshëm dhe e liron, por ata e vrasin (f.131). Më 1625 në Arbëri gjendeshin kisha të panumërta, por krejtësisht të rrënuara (f.118). Viti 1628. Në krahinën e Pultit, nga 78 kisha dhe manastire kanë mbetur vetëm 3 kisha dhe 5 manastire, edhe ata të rrënuar (f.118). Po në vitin 1628 shohim që priftin Dhimitër e arrestojnë dhe e çojnë në kështjellën e Shkodrës, me kërcënimin se do ta ngulin në hu, por paguan 60 talerë dhe i shpëton vdekjes (f.131). Viti 1629. I peshkvi i Lezhës, Imz.Orsini, gjatë 7 vjetëve është grabitur 4 herë prej *“turqvet”*. Në lidhje me peripecitë e Imz.Orsinit ka shumë njoftime, por ne nuk do të ndalemi (f.125). Në vitin 1629, Dom Andre Karlin, famullitar i Pëdhanës së Lezhës, e torturoi një *“turk”*, sa ishte një mrekulli e madhe se si qëndroi gjallë. Qëndroi gjallë, por e humbi arsyen prej torturavet (f.131). Më 1632 kisha e shën Palit në Dukagjin është rrënuar dhe zhveshur nga çdo pasuri e tundshme dhe e patundshme (f.125). Viti 1633. *“Turqit”* kërcënojnë arqipeshkvin e Tivarit se do t'i presin rrugën dhe se do ta zhveshin nga çdo gjë, siç kishin bërë (edhe herë të tjera) në Tivar e në Prizren (f.132). Viti 1636. imz. Mark Skura, ipeshkëv i Arbënisë, ishte i detyruar t'i numëronte kadiut një sasi të madhe të hollash dhe duhej t'u bënte dhurata

krerëvet më kryesorë (f.129). Viti 1637. Kisha e Karmës në Pukë, dikur me 10 priftërinj, tani e degraduar plotësisht (f.118). Kisha e Shën Palit në Kabash (Pukë) është tërësisht e degraduar (f.118). Kisha e Arësit (Pukë) nuk ka mure, por në vend të tyre ka drurë dhe është e mbuluar me kashtë (f.118). Në Koman kanë mbetur vetëm gjurmët e një kisha, por kishë nuk ka (f.118). Viti 1638. Në Spas (Pukë) kisha e Shën Sebastianit është e rrënuar (f.118). Në fshatin Glas kisha është e rrënuar dhe e rrëzuar (f.118). Kisha e Shën Shtjefnit (Pukë), dëmtuar 2 ose 3 herë prej “*turqvet*” (f.118). Viti 1640. Me rastin e shkatërrimit të misionit në Durrës, 2 misionarë u ngulën në hunj (f.130). Ipeshkvi i Sapës sulmohet me shpatë dhe torturohet egër prej një “*turku*”, aq sa atë e shpëton një i krishterë, duke e kaluar përtej lumit gjysmë të vdekur (f.132). Viti 1641. Katedralja e Elbasanit ishte shkatërruar nga “*turqit*” (f.119). Metrpolia e Durrësit gjendet e rrënuar me themel prej “*turqvet*”. Edhe pjesa më e madhe e kishavet (në dioqezën e Durrësit) janë shkatërruar (f.119). Të gjitha kishat në Spas, Pukë e Iballë janë rrënuar (f.119). Imz.Fran Bardhi i bën dhurata prej frutash e sendesh të shijshëm qeveritarit të Shkodrës, Mehmetbeut, që ishte dashamirës i myslimanëve dhe dashakeqës i të krishterëve. Përndryshe nuk mund të kryente detyrën e arqipeshkvit (f.128). Qeveritari u përpoq të arrestonte G.Mazrekun me shpifjen se ai vinte nga Malta për të hetuar gjendjen e arbërvet. Iu desh të paguante 20 talerë, përndryshe do t’ishte ngulur në hu i gjallë (f.128). Viti 1643. Dom Gjon Lili, vikar i Kosovës dhe famullitar i Novobërdës, u persekutua prej “*turqvet*”, aq sa u detyrua të largohet nga Atdheu (f.132). Viti 1644. Në Bendë, nga 20 kisha famullitare, vetëm 12 janë të mirëmbajtura. (Më vonë edhe ato janë shkatërruar. GjD) (f.120) Në Kanovi nga 23 kisha famullitare, kanë mbetur të parrënuara vetëm 4 (f.120). Në Durrës nga 90 kisha famullitare kanë mbetur të parrënuara vetëm 14 (f.120). Imz.Mark Skura

njofton që në dioqezën e Kanovisë janë shkatërruar shumica e kishavet, midis tyre ajo e Shën Stefanit në Çirnë, e shën Stefanit në Okshtun dhe e shën Martinit në Kukanj (f.132). Më 1649, në muajin prill, **“turqit”** ngulin në hu 2 klerikë dhe 6 besimtarë të krishterë (f.132). Po shënojmë këtu një frazë të asaj kohe nga relacioni i Gjon Kolësit: **“Tiranët, shumë mizorë, kurrë nuk ngopen, duan përherë e përherë më shumë të holla, dhurata e ç’u ka ënda, me njëmijë angari e përdhunime”** (Nuk e dimë për ç’lloj përdhunimesh është fjala. GjD) **“Atë që nuk e nxjerrin me të mirë, e duan me forcë”** (f.129). I vitit 1649 është edhe ky njoftim: **“Bëhet e ditur se disa priftërinj janë martirizuar, të tjerë u vendosën në Venedik dhe në Dalmaci”** (f.130). Imz. Gjergj Vladanji ndenji i fshehur 24 ditë në një fshat të Malit të Zi, me bukë meli e me ujë, që **“turqit”** të mos e kapnin (f.132). Në Tivar iu pre koka 73 të krishterëvet, të zgjedhur prej fshatrash përrreth (f.133). Gjergj Vuskoviqi, në shërbim të tij si misionar (në Shestan, GjD), ka qenë i sulmuar 2 herë prej **“turqvet”**, për t’ia prerë kokën (f.133). Viti 1650. G.Mazreku ishte burgosur tashmë 4-5 herë, lidhur e vënë në pranga, por besimtarët e kishin liruar, duke parapëlqyer (siç thuhet, GjD) të hynin vetë atje (f.133). Dom Andre Kalamashi u torturua i lidhur këmbë e duar, u var në sheshin e qytetit, iu pre koka dhe iu dërgua Vezirit të Madh (f.133). (S’e dimë nëse ai Vezir i Madh ka qenë arnaut apo me prejardhje arnautësh. I lutemi lexuesit të mos na keqkuptojnë për ironinë ! GjD). Po në vitin 1650 Pjetër Mazreku ia prenë kokën me shpatë dhe ia lanë varur mbi supe (f.133). Dom Nikë Grubesa, ngarkuar me një hu mbi supe, u shëtiti nëpër rrugët e Shkodrës, por i shpëtoi martirizimit nga një shumë të hollash (që u dhanë për të) (f.133). Dom Anton Pavllloviqin e rrahën për vdekje, sepse kishte marrë nën mbrojtje një djalë që osmanët kërkonin ta kthenin me forcë në fenë islame (f.133). Viti 1656. Imz.Pjetër Bogdani, kur u emërua

(ipeshkëv) në Shkodër, u burgos nga i biri i pashait dhe u dënua me 1 muaj burg, iu rrëmbye kali dhe iu ndalua letërkëmbimi me Italinë (f.134). Viti 1664. Imz.Pjetër Bogdani burgoset përsëri. Më vonë është burgosur 3 herë me radhë, është keqtrajtuar dhe është kërcënuar se do të dënohej me vdekje (f.134). Pashai i Ohrit, pasi e sulmon dhe e djeg Mirditën, gjen në shtëpinë e ipeshkëvit të Lezhës 38 njerëz të fshehur dhe i vret të gjithë, bashkë me famullitarin Dom Markun (f.134). Në vitin 1680 Dom Vinçenc Mateviqi, mësues e misionar në Janjevë, ka braktisur detyrën për shkak të përndjekjeve (f.134). Më 1688, me urdhër të pashait plaçkitet kisha e Janjevës dhe shkatërrohet çdo gjë që nuk mund të merrej me vete. Ky vandalizëm është përsëritur 3 herë (f.124). Më 1689 Imz.Pjetër Bogdanit, forcat ushtarake osmane ia djegin shtëpinë, kurse atë vetë e arrestojnë, e zhveshin lakuriq dhe e shëtisin nëpër qytetin e Prizrenit (f.134). Në Ulqin, kisha e stilit renesans e ndërtuar në vitin 1510, u ndërrua në xhami (f.134).

Në vitet 1726-1733, për shkak të reprezalieveve nga ana e pushtetarëve myslimanë të Shkodrës (Përfaqësues të Shestanit shkojnë për t'iu ankuar pashait të ri të Shkodrës për një vrasje që u kishin bërë bejlerët e Tivarit. Pashai jep urdhër dhe vriten edhe këta.), ndodh eksodi gjurmëlënës i shesanasvet për në Zarë të Dalmacisë.

Në vitet 1737-1739, po për shkak të reprezalieveve, ndodh një tjetër eksod i katolikëve shqiptarë nën udhëheqjen e arqipeshkëvit të Shkupit, Imz.Mëhill Sumës. Ata vendosen në Srem dhe, me kohë, shkrihen me sllavët.

Në vitin 1769 fillon shkatërrimi tragjik i Voskopojës, njerës prej qendrave tona më progresiste kombëtare të shekullit XVIII. Pashallarët dhe bejlerët tanë myslimanë nuk krijojnë akademi, por shkatërrojnë akademi.

E kemi formuluar konstatimin tonë në një libër tjetër tonin të mëparshëm, që **xhamia** në vendin tonë, në Arbëri që më vonë u

quajt Shqipëri, nuk ka qenë tjetër veçse **institucioni ideologjik i pushtuesit**. Lënda që e paraqitëm deri këtu besojmë se është e mjaftueshme për ta rikonfirmuar një konstatim të tillë, si dhe për ta pranuar prej të gjithë atyre shqiptarëve që i gjykojnë gjërat me objektivitet, po edhe me sinqeritet.

Sidoqoftë, të gjitha këto që po renditim këtu, travajat, strapacat, varg i pashkëputur ngjarjesh që nuk duhej të na kishin ndodhur, shtrojnë përpara nesh **një dhe vetëm një kryepyetje: *Përse lejuan të parët tanë të na ndodhin të atilla kërdi e shkatërrime të paperceptueshëm* ?!** Thërrasin dhe vazhdojnë të thërrasin, që nga dheu ku janë tretur, pa një pllakë varri përsipër : Fëmijët e shkrumbuar, të virgjërat e përdhunuara, pastaj të shitura e rishitura në tregjet e skllëvërvet, nusët dhe gratë e përdhunuara, pastaj edhe ato të shitura e stërshitura, syjeshilët, vdekur nga uria, të talentuarit, “*vullnetet e ndrydhun*”, “*vullnetet e shtypun*” (Kujto Migjenin!), që lindën e vdiqën pa mundur të kryejnë jo një fakultet, siç bënin mijëra bashkëkontinentasit e tyre, po as edhe një ditë shkollë, ku të mësonin të paktën alfabetin e gjuhës së vet ! Të gjithë thërrasin: ***Përse ?! Cili është shkaku ynë i brendshëm i të gjitha këtyre zezërive të pafundme* ?!**

Jemi ngopur tashmë me “*arsyetimet*” e studiuesvet gjakftohtë, me nerva prej leshi, në dukje objektivë, por në thelb jodecizivë dhe rrjedhimisht edhe joobjektivë: ***I këtitllë ishte pozicioni gjeografik i Atdheut tonë. Ka qenë rrugë kalimi për pushtuesit. Kemi pasur armiq të shumtë. Kanë qenë armiq të fuqishëm e tepër mizorë.*** Të gjitha këto kanë në vetëvete të vërteta e pjesë së vërtetash, por asnjëra prej këtyre nuk është thelbi i çështjes. **Thelbi i çështjes jemi vetë ne.** Të ndodhur përballë të atillë rrëziqeve, përse nuk i kemi gjetur rrugët e shpëtimit ?! Jo: Përse nuk i kemi **kërkuar**, por: Përse nuk i kemi **gjetur** dhe **realizuar** rrugët e shpëtimit e, si rrjedhojë, edhe rrugët e progresit !?

Prapë barbarët! Ne prapë të paparambrojtur!

Në shekujt XIX e XX krijohen prapë situata si në shekujt e Antikitetit. Këtë herë nuk vijnë barbarë prej së largu, por janë **këtu** të ardhurit e dikurshëm, ata që i rifillojnë korret. Nëse helenët e qëmotshëm i marrim më të vonë se trojanët dhe masakrën e Trojës e vlerësojmë si një masakër të ardhurish mbi vendësit (mjerisht për pakujdesinë vendimtare të vetë vendësve), atëherë ngjarjet në Shqipërinë e Jugut, në Çamëri e gjetkë nuk duhet të merren ndryshe, veçse si vazhdim i masakravet të Trojës. Përshkrumbjet dhe përgjakjet në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme, duhet të konsiderohen si vazhdimi i përshkrumbjeve dhe i përgjakjeve të shekujve V, VI e këndeje. **(Prapë, mjerisht prej pakujdesisë sonë përherë e më tragjike, përherë e më mallkimlënëse nga ana e atyre që shuhën pa qenë vetë fajtorë.)**

□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□

Kemi përpara një dorëshkrim të **Hasan Dinos nga Paramithia**. Ai ka shënuar këtu ata tmerre që i ka përjetuar vetë, pikërisht në vitet kur nuk duhej të përjetonte tmerre, por të gëzonte të mirat e jetës në vendlindjen e vet, jo të robëruar, por të lirë.

Më 1913-n, 6 muaj mbasi Evropa e kish **miratuar** pushtimin e asaj pjese të Shqipërisë nga ana e shtetit grek, grekët vrasin në Paramithi 74 shqiptarë. 2 i marrin nga qyteti e 72 i mbledhin nga fshatrat, i çonjnë në një përrua jashtë qytetit dhe i copëtojnë me sëpata e me thika.

Më 1918-n grekët vrasin në Smokovinë të Margëllëçit 6 vetë. Në Galbaq të Filatit vrasin 5 vetë, 2 nga të cilët i djegin me benzinë. Në Lopës të Filatit vrasin 2 vetë.

Më 1921, grekët vrasin po në Lopës 3 të tjerë.

Vjen viti 1940. Ushtria e Metaksait vret e masakron nëpër Çamëri 350 shqiptarë.

Më 1945-n në Filat vriten 36 ushtarë shqiptarë, në kohën kur ata po ktheheshin nga ushtria greke! Jo nga ndonjë ushtri antigreke!

Në të gjithë këta vite, shkruan paramithioti Hasan Dino, pinjoll i një familjeje me shumë merita për Atdheun, grekët jo vetëm që i vrisnin njerëzit tanë (tashmë shtetas të tyre), por vrasjet ata i bënin me mënyrat më barbare të mundshme. (Lexuesi duhet ta dijë që grekët quajnë barbarë popujt jogrekë. Por në këtë rast, ata janë barbarë nga më të egrit.) I copëtojnë me sëpata e me thika, i djegin me benzinë duke u shkaktuar vdekje të lemerishme, u ngulin gjilpëra nën thonj, gravet, për t'u tallur me to para se t'i vrasin, u fusin mace në çitjane, i çnderojnë duke i përdhunuar, të tjerëvet u vënë vezë të nxehta nën sqetulla, varin njerëz mbi tym, i rrahin deri sa të vjellin gjak, i vrasin rrugëve, siç vriten qentë bastardë, vrasin fëmijë, djem të rinj, pleq e kë të shohin në rrugë, i kapin dhe i detyrojnë për të hapur vetë varret e vet dhe të fëmijëvet të vet, pastaj vrasin fëmijët në sy të prindit e më në fund edhe vetë prindin, i thërrasin gjoja për t'u komunikuar diçka dhe i therin të gjithë, çojnë në ishujt e Egjeut me qindra dhe atje i vdesin duke i rrahur.

I ndjeri Hasah Dino na ka shënuar edhe një të dhënë shumë interesante, e cila do të duhej t'u shërbente sidomos atyre grekëve të sotëm, të cilët studiojnë e analizojnë politikat e atdheut të tyre. Pushtetarët grekë u ofronin shqiptarëvet myslimanë shuma të konsiderueshme parash, me kërkesën që ata të deklaroheshin turq. Sot shteti grek u jep para shqiptarëvet ortodoksë, me kusht që këta shqiptarë të deklarohen grekë. Është punë e tyre, por ne do të pyesnim: A kështu do ta krijojnë kombin e vet grekët? Një komb i tillë s'ka si cilësohet ndryshe veçse: **komb surrogato**.

Na duhet të nxjerrim këtu edhe një listë shqiptarësh tanë, ortodoksë të Çamërisë, të cilët nuk kanë pasur aspak turp

për t'i shërbyer pushtuesit në dëm të bashkëfshatarëve dhe bashkëkombasvet të vet, vetëm e vetëm sepse këta ishin myslimanë. Dhimitros Hajdhushis nga Pleshovica e Filatit. Hristo Bilbili, Jorgo Drubadi, Vasil Danello dhe Har Driamandi, të 4-të nga Sajadha e Filatit.

Pano Çino nga Dragami i Paramithisë. Ky ishte një vegël e llojit të veçantë. Policia greke i thërriste njerëzit në zyrat e veta, u kërkonte të dorëzonin armët edhe kur këta nuk kishin armë. I torturonin dhe i lëshonin duke u thënë: **Po nuk e solle armën, do të të marrim prapë.** Pano Çinua i shkante fshatarit të rrahur dhe i thoshte: **Ta gjej unë një pushkë.** Fshatari e blente pushkën për 2 napolona dhe e dorëzonte në polici, për të mos iu përsëritur tortura. Pano Çinua e merrte prapë po atë pushkë dhe ia shiste një tjetri. Në këtë mënyrë ky shqiptar i pafytyrë e ka shitur e rishitur një pushkë të vetme 300 herë në 300 fshatarë të ndryshëm dhe ka marrë prej tyre 600 napolona. Fshatarët e njihnin pushkën. Por ishin të detyruar ta blinin. Të njëjtën metodë kanë përdorur edhe serbër në vitet 1950 nëpër Kosovë. **Në mos zënshim mend prej një përvoje të këtillë, edhe ne ose nipërvet tanë, e njëjta histori ka për t'iu përsëritur.**

Një kategori tjetër shqiptarësh që i angazhonte dhe i paguante Greku nëpër Çamëri, ishin vrasës ordinerë. Të tillë kanë qenë Panatezejtë dhe Koço Nikolla në Paramithi, Vasil Ballumi në Margëlliç, Andon Tasho dhe Sholi Mitro në Gumenicë dhe Ilija Kalo në Filat. Kapiten Elefter Strugari dhe kapiten Hristo Stavropullo janë zbatuesit e urdhërit të Napolon Zervës për masakrën në Paramithi, për të cilën do të flasim pak më vonë.

Gjithsesi kaq do të duhej të na mjaftonte për të kuptuar **sa shumë të këqia kemi në radhë të parë ne brenda vetes.** Dikur, kur e kishin pushtetin, myslimanët tanë keqtrajtonin të krishterët tanë: I vinin për të shirë driza në lëmenj, këmbëzbathur.

Tani që në Çamëri e kanë pushtetin të krishterët tanë,

“Në Sefer u dogj e gjallë një grua bashkë me ndihmësin e saj katolik”

“Në Gjylekatë një gruajë shtatzënë iu çu barku me bajonetë dhe iu nxor krijesa (nga barku)” (f.187)

Gjithsej në Terste, Senicë, Verban, Lubishtë dhe Gjylekatë u masakruan 238 vetë (f.187).

Edhe në Preshevë shpëtuan (gjallë) shumë pak (f.187).

Në kasaphanën e Ferizajt u vranë 1200 shqiptarë (f.186).

Lumë: 400 burra, që u dorëzuan vetë, u çuan në Prizren dhe u vranë në grupe, 40 deri 60 në ditë (f.188).

Pranë stacionit të Kumanovës, të ikurit (700-800 vetë) qenë kapur, lidhur dhe *“u vranë duke i copëtuar sikur të ishin kafshë”* (f.185).

Në afërsi të Shkupit u masakruan 2000 shqiptarë (f.184).

Midis Kumanovës dhe Shkupit u vranë 3000 shqiptarë (f.184)

“Njerëzit nxiren nga shtëpitë dhe vriten si minjtë. Nuk kalon ditë pa patur vdekje të tmerrshme shqiptarësh. Lumi është mbushur me kufoma.” (f.184).

Jo larg Prizrenit 5000 shqiptarë myslimanë u masakruan (f.184)

“Gjenerali Jankoviq i detyroi paritë (e Prizrenit) me revolver në dorë të nënshkruanin një deklaratë falenderuese drejtuar kral Petar-it për ‘çlirimin’ nga ushtria serbe”. (f.187)

Pastaj : “Meqë nuk kishin kuaj, ata morën 200 shqiptarë për t’i ngarkuar me nga 50-60 kg dhe pastaj, natën, nëpër rrugë të këqia, i çuan 7 orë larg në krahinën e Lumës.” (f.187).

Në rrethin e Prishtinës 5000 shqiptarë zhduken nga terrorizmi masiv serb (f.186)

Shtypi shkruante se vetëm gjatë 2 muajvet të parë (të vitit 1912) në Kosovë u vranë mbi 25000 shqiptarë (f.190).

“Në të 2 anët e rrugës (rajoni i Gjakovës), shkruan

publicisti sërb Tomiq, nuk pashë veçse fshatra të djegur e të rrafshuar me tokë. Rrugët ishin mbushur me trekëmbështa, në të cilët ishin varur trupa shqiptarësh.” (f.189).

Në Gërdhesh të, Malziu i Pukës, sërbët therën 72 gra, pleq dhe fëmijë. Mjedën, afër Shkodrës, e kthyen në hi e pluhur (f.189).

(Po në atë vit, Kranja e Shkodrës, nga fshatrat Draganj e Blacë deri në Arbnes, është djegur e shpërngulur krejtësisht, prej ushtrisë malazeze. GjD)

Viti 1913.

Një diplomat i huaj raporton: ***“Një sërb nga Çagllavica (Prishtinë) u mburr se me dorën e tij ka vrarë 100 shqiptarë”*** (f.221).

Në Sop të Kërçovës, ***“nga një sërb u lidhën të gjithë muhamedanët që kishin mbetur akoma në fshat, rreth 200 vetë, u çuan në xhami, u mbuluan me sanë dhe u dogjën të gjallë”*** (f.222).

Në Ujëzi, midis Gjakovës dhe Prizrenit, u dogjën 20 pjesëtarë të një familjeje. Disa fëmijë që tentuan të iknin, u ndaluan duke i therur me bajoneta (f.222).

Në Pejë u masakruan 1300 shqiptarë, sepse nuk deshën të konvertohen në fenë pravosllave (f.216).

Përdhunohen gjatë rrugës për Kërçovë dhe në fund vriten 10 gra e 9 vajza nga Fushëllazari (Ohër) (f.217).

Në Nishor të Suharekës pushkatoen 42 vetë (f.192).

Gjatë çarmatimit në Krrabë e në Çermenikë (Elbasan) sërbët kanë vrarë 20-30 shqiptarë (f.194).

Një tentativë arratisjeje nga burgu i Prizrenit rezultoi me së paku 19 të vdekur (f.194).

Një forcë shqiptarësh kryengritës luftuan kundër ushtrisë sërbe afër kufujve të Prizrenit... Në atë luftë u vranë 200 shqiptarë (f.196).

“Mund të them se Luma nuk ekziston më. Kudo kufoma, hi e pluhur. Ka fshatra me 100 deri 150 shtëpi ku nuk ngeli

njeri i gjallë.” (f.199).

Në Topojan të Kukësit afër 400 vetë u vranë grumbuj-grumbuj me mitraloz, në vende të tjerë u dogjën gjallë në shtëpitë e tyre (f.200)

Një officer malazez thotë: “Shqiptarët në fillim i vrisnin me pushkë dhe patllake, por së shpejti erdhi urdhëri se s’kishte levërdi të shpenzohej municioni, prandaj shqiptarët do të thereshin me thika. Dhe kështu i ndanin në grupe, nga 40 deri 50 vetë, i rreshtonin në 2 rreshta me fytyra të kthyer nga njëri-tjetri dhe atëherë oficerët ose nënoficerët i thernin një nga një në qafë.” (f.194).

Në 2 fshatra midis Prizrenit dhe kufirit oficeri komandues, me anën e kryetarit të fshatit, mbledh të gjithë të rriturit, 83 vetë, dhe i pushkaton (f.201).

Në fshatrat Lojmë e Nimçë (rrethinë e Prizrenit) i mbledhin me anë të kryepleqvet, gjoja për t’u regjistruar, dhe i vrasin: 36 lojmëjanë dhe 54 nimçjanë (f.201).

Genocidi në Lumë e Opojë (përmbledhëse): Mbi 672 të masakruar, shumica gra e fëmijë dhe 573 shtëpi të bëra hi. (f.202-203).

Në rajonin e gjërë të Gjilanit, në 19 fshatra pati masakra nga më të egrat, vetëm në Kabash u masakruan 47 vetë (f.203).

Edith Durham shkruan për krahinën e Gostivarit: ***“Ka fshatra me 100, 150 ose 200 shtëpi ku tani s’gjindet asnjë frymë. I mbledhin njerëzit me togje nga 40 ose 50 vetë dhe i shkojnë në bajonetë deri tek i fundit. Në Reçan të Gostivarit, serbët, pasi pushkatuan 30 vetë, 200 gra, fëmijë e pleq i mbyllën në 2 shtëpi dhe i dogjën të gjallë”*** (f.203).

Në Zdunjë të Gostivarit djegin 37 gra, fëmijë e burra. Të nesërmen 9 të tjerë i çojnë në Vakuf të Benicës dhe i masakrojnë. ***“Alije Maksutit, kufomë, iu gjet vajza 7-muajshe mbi gjirin e saj”*** (f.203).

Në Simnicë të Gostivarit djegin 113 shtëpi dhe vrasin

18 vetë (f.203).

Pas 8 ditësh, sekretari i nënprefekturës ftoi me emër 22 vetë, i lidhën gjoja për t'i çuar në nënprefekturë dhe i masakruan në Vakuf të Benicës (f.204).

Në katundin Gjinovicë (Gostivar) djegin 7 shtëpi me njerëzit brenda. Vetëm në 2 prej tyre, 17 vetë (f.203).

Në Vertok pushkatojnë 18 vetë dhe i groposin në Bigorë. 40 i çojnë e i pushkatojnë në Vakuf të Benicës (f.204).

Në Kalisht të Gostivarit, rrugës për në Pozheran, i vrasin dhe i therin 43 vetë (f.204).

Në Çergan vrasin 32 vetë, duke i çuar për në Gostivar (f.204).

Në Qafë të Gostivarit masakrohen 65 gra, pleq e fëmijë (f.204).

Qyteti i Dibrës, nga 20000 banorë bie në 2000 banorë. Një pjesë e popullatës që mori arratinë, u masakrua. "**Katundet që u dogjën, s'kanë numër**" (f.205).

Në Gjoricë qenë masakruar 14 vetë bashkë me plakun e katundit. Qenë mbytur edhe 2 gra e 6 fëmijë (f.205).

Në Zogaj 124 shtëpi qenë djegur dhe masakruar 12 vetë: 4 hedhur në zjarr, 4 therur dhe, pasi janë kthyer edhe njëherë, kanë vrrarë edhe 4 të tjerë (f.206).

Në Maqellarë u therën me majën e bajonetës 16 vetë (f.206).

Bllaca qe plaçkitur, pastaj i qe vënë zjarri nga të 4 anët. Të gjithë fshatarët qenë masakruar (f.206)

Në Allajbeg digjen 65 shtëpi dhe masakrohen në mënyrë të tmerrshme 23 vetë, midis të cilëve 7 gra dhe 1 fëmijë 5 vjeç (f.206).

Në Vajnik i djegin të 15 shtëpitë që ka ai fshat, therin 4 njerëz duke vrapuar pas tyre dhe 1 vajzë të re e mbytin (f.206).

Në Luzni masakrohen 45 vetë (f.206-207).

Në Deshat u shkrumbuan 15 shtëpi dhe u hodhën në flakë e u dogjën të gjallë: 3 fëmijë dhe 2 gra (f.207).

Në Pilat-Mëhallë, therin me bajoneta dhe i hedhin në zjarr 2 burra dhe 2 fëmijë (f.207).

Në Peshkopi digjen 57 shtëpi dhe masakrohen 6 vetë (f.207).

Në Qafë-Bulqizë pushkatohen 13 vetë (f.207).

Numri i myslimanëve të masakruar prej bandavet serbe është... në Kërçovë 184, në Çallopek 47. Fshatrat Lop, Zajaz e Lesani janë djegur dhe banorët flitet qenkan vrarë (f.207).

Në Tetovë u arrestuan 400 shqiptarë myslimanë, dhe u ekzekutuan të shumtët gjatë transportit për në Shkup (f.208).

“Afër Shkupit u therën si berra 2000 shqiptarë.” (f.208).

Në Ujëzi, pranë Drinit, 32 vetë u mbyllën dhe u dogjën në një shtëpi (f.208).

Forcat serbomalazeze në Plavë-Gusi kanë pushkatuar 720 burra. Nga këta 559 në Qafë të Previsë, 150 në Brezovicë dhe 11 brenda në Plavë (f.209).

Të atit të Shaban Kolinës të Gusisë ia nxorën sytë me bajonetë për së gjalli në prani të fëmijëve të gruas. Në Budovicë të Plavës, Rexhep K. Feratajn e lidhën në trungun e një dardhe, ia nxorën sytë me thikë dhe në fund e dogjën së gjalli (f.209).

Prijësit si Halil Haxhia në Drenicë, Fejzulla Lipoveci në Klinë, Hetem Korineni i Hotit (të Plavës) dhe Hetem Dobrosheva, dhe 18 të tjerë, të gjithë u ekzekutuan nga serbët (f.209).

Viti 1914.

Në krahinën e Përdrinit, në 18 fshatra, Ostrozup etj., vriten 227 shqiptarë dhe janë djegur 1032 shtëpi (f.211).

Në Rahovec u pushkatuan 40 vetë pa gjyq (f.212)

Nga Manastiri u shpërngulën 20000 vetë (f.227).

Mbi 7000 të shpërngulur nga fshatrat përrreth, gjenden në Manastir. Por serbët nuk i lejojnë as aty (f.230).

Nga Dibra (me rrethe) u shpërngulën afër 3000 dibranë, që lanë shtëpitë të djegura dhe arat të shkretuara (f.227).

Në Mat, në Çermenikë, në Tiranë dhe në Elbasan, ndodhen 80000 të ikur (f.227).

Nga viset jugorë (të Shqipërisë), të pushtuar (prej Grekut), ikën 100000, nga të cilët 30000 vdiqën nga uria (f.228).

Vitet 1916 – 1918.

1916. Në Smirë të Vitisë bullgarët vrasin 21 shqiptarë (f.236).

1917. Në Lubishtë të Vitisë bullgarët vrasin 8 shqiptarë (f.237).

Në Zhitijë të Vitisë bullgarët vrasin 8 shqiptarë (f.236).

Në Gjylekar të Gjilanit bullgarët vrasin 61 shqiptarë (f.236).

1918. Në Podgoricë e Malësi të Madhe malazeztë pushkatojnë 20 vetë (f.259)

Nga viti 1912 deri në vitin 1918 në Kosovë e gjetkë llogariten mbi 200000 të masakruar dhe po aq, 200000, të shpërngulur (f.229).

Viti 1919.

Në fshatin Cërnallukë (Rozhajë-Senicë) vriten 9 vetë (f.261).

Në Tërgovishtë (Gjakovë) vriten më se 100 shqiptarë pa kurrfarë shkakut (f.261).

Në Akovë (të Peshterit) 800 vetë u vranë barbarisht. Morën 46 vajza, prej të cilave 6 i dhunuan, tjerat, për të pësuar të njëjtin fat, i çuan në Mal të Zi (f.261).

Në Koshutan, Koshuticë, Bukël, Bisirnicë vranë 21 vetë dhe grabitën 1390 kokë bagëti (f.261).

Në Rozhajë numri i viktimave arrin, deri më 1919-n, 700 vetë (f.263).

Në 10 fshatra të Mitrovicës u masakruan 190 vetë “**Kënaqem kur derdh gjak shqiptari**”, thotë kapiteni Millan Kllapiq. (f.269).

Në 105 fshatra të Vushtrrisë u masakruan 1007 njerëz. (Në Qeqeli 12, në Kullë 43, në Kopiliq 7, në Tristeniq, 13, në Popovë 23) (f.269).

Në Kërninë të Istogut janë vranë 17 vetë, janë djegë 30 shtëpi, janë grabitë 20000 bagëti (f.262).

Në Çellopek të Pejës vriten 16 vetë (f.262).

Në Beran të Pejës, 11 vetë (f.262).

Në Prishtinë ushtria serbe ka therur më se 4800 gra, foshnja e pleq. Vetëm në 3 katunde janë vranë 1400 vetë (f.270).

Naçallniku i Gjakovës dogji fshatin Batushë, lidhi në trungjet e shelgjevet 11 burra (dhe, tek po digjeshin shtëpitë) i bëri shoshë (f.271).

Në Radavc të Istogut forcat serbe në një familje vranë 15 vetë (f.271).

Në Jabllanicë të Pejës vranë 78 burra, gra e fëmijë (f.271)

Prapë në Jabllanicë të Pejës serbët hyjnë brenda në faltore, i lidhin të gjithë, bashkë me hoxhën, dhe i vënë zjarrin xhamisë, duke i djegur të gjithë për së gjalli (f.271).

Në vilajetin e Kosovës, vetëm në 2 muaj, janar-shkurt 1919, janë vranë 12370 shqiptarë dhe janë djegur 6100 shtëpi (f.271).

Në Plavë, Gusi e Rugovë nga 8 deri 25 shkurt numrohen 844 të masakruar (f.262)

Ndërsa më 20 mars, po në trevat e Plavë-Gusisë, u masakruan 942 burra, 399 gra dhe 360 fëmijë dhe dogjën 945 shtëpi (f.271).

Në një raport të 20 marsit 1919 lidhur me genocidin në Plavë-Gusi thuhet : ***“Sërbët masakruan me mitralozë 356 fëmijë, pleq, plaka e burra sakatë, i dogjën në zjarr duke kërcyer rrethrotull zjarrit VALLEN E VËLLAZËRIMIT BALLKANIK”*** (Fjalët me shkronja të mëdha, GjD) (f.263).

Në 17 fshatra të Prizrenit vriten 376 vetë dhe digjen 85 shtëpi (f.270).

Në Tetovë vriten 30 vetë dhe digjen 636 shtëpi (f.270)

Në Istog, në 1 ditë ushtarët e Sërbisë vranë 160 dhe i lanë pa shti në dhe deri sa zunë të qelben në fushë (f.270).

Sërbët, në vitet 1918-1919, në Kosovë kanë mbytur e vranë 30000 vetë, kanë djegur 168 katunde me 4869 shtëpi (f.271).

Përfundimisht, nga pjesa e Shqipërisë, mbetur nën Jugosllavi, nga viti 1919 deri më 1940, veç këtyre që u panë ku shkuan, do të shpërngulen për në Turqi edhe 500000 shqiptarë të tjerë (f.329).

Viti 1920.

Në Istog, në mëhallën e jashtme të qyteti, vritet Hysen

Sejdija bashkë me 5 djemtë e tij dhe 94 të tjerë, burra, gra, fëmijë, pleq e plaka (f.282).

Në Bjellopojë të Istogut sërëbët kanë kapur e lidhur 22 vetë, i kanë shpënë në mes të natës në një pyll dhe i kanë therur që të gjithë me bajoneta (f.282)

Në Uçë të Istogut morën 9 vetë, i lidhën këmbë e duar në një kullë dhe i vunë zjarrin kullës. Rëmbyen 20000 krerë bagëti dhe 25000 kuintalë drithë (f.282)

Rakinica u rrënuar me artileri. Në vendin e ngjarjes u gjetën 43 kufoma shqiptarësh (f.282).

Në Dibër sërëbët kanë djegur më se 300 katunde. 30000 shqiptarë kanë ikur (f.284 dhe 340).

Fshati Pesoçan në Dibër shfaroset i tëri brenda 1 nate, sepse dikush prej atij fshati paskish vrrarë 1 xhandar (f.284).

Në Lumë 400 shtëpi janë bërë rrafsh me tokën. Në Buzmadh ka 19 të vrrarë. Në krejt Lumën, të vrrarë 55 burra e 12 gra (f.340).

Në Plavë-Gusi në 28 vendbanime (qytete e fshatra) masakrohen (prej malazezëve) 893 burra, 440 gra dhe 472 fëmijë. Në 13 fshatra të tjerë masakrohen (po prej malazezëve) edhe 1173 burra, 514 gra dhe 544 fëmijë. Gjithsej të masakruar 4036 shqiptarë, nga këta 1046 fëmijë e 954 gra. Digjen 6050 shtëpi, rrëmbehen 73884 bagëti të imta dhe 17842 bagëti të trasha (f.283).

(Dhe themi: *Pse është e varfër Shqipëria?!)*

Viti 1921.

Protestë e 10 prillit 1921: “*Një shtet që brenda 10 ditësh vret 3800 njerëz, sa të këqia (të tjera) do të bëjë ?*” (f.291).

Në fshatrat e Gostivarit janë masakruar 408 shqiptarë, ndër të cilët 79 gra e 5 fëmijë. (f.292).

Në Gjeshovicë (të Gostivarit) u vranë 9 burra, u dogjën 13 të tjerë e 7 gra. Gjithsej 29 vetë (f.292).

Në Kalisht të Gostivarit u vranë 43 vetë (f.292).

Në Banjë të Prizrenit 15 burra mbyten duke i rrahur me dru (f.287).

Në Cernallukë të Prizrenit 5 vetë, në Ofzhevc të Vushtrrisë 10 vetë, në Pallancë të Vushtrrisë 10 vetë, në Bratje 10 vetë. Të gjithë këta janë mbytur duke i rrahur me dru (f.287).

Në relacionin Pejë-Gjakovë digjen 300 shtëpi trekatëshe dhe vriten 350 vetë (f.291).

Në bjeshkë të Isniqit të vrarë 27 vetë, të grabitura 7000 kokë dhen dhe 3000 lopë e qe (f.293).

Në bjeshkët e Junikut, Carabregut etj vriten 131 vetë, për t'u grabitur bagëtitë (f.294).

Në Jabllanicë sërbët vrasin 39 vetë (f.294).

Në rajonin e Pejës masakrohen 200 djem të moshës deri në 10 vjeç, 300 gra të reja dhe 270 pleq (f.292).

Në Plavë-Gusi 26 foshnja mbyten në barqet e gravet (f.292).

Në Shabran të Prishtinës masakrojnë 10 fëmijë dhe gra. Në rrethina të Prishtinës 16 vetë. Në Bellopojë (Prishtinë) njëherë 19 e njëherë 25, kryesisht gra, fëmijë, pleq. Janë masakrime nga më të përbindshmit. (f.288-290).

Në Llap e Gollak: Në Podujevë 28 vetë, në Keqekollë 490 vetë, në Prapashticë 1020 vetë, në Shubran 31 vetë, në Bjellopojë 30 vetë, në Nishec 14 vetë, në Gërdovc 25 vetë, në Llupc të Epërm 12 vetë. Janë masakra të papërfytyrueshme. (f.287).

Përmbledhëse: Në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, mbi 2000 shqiptarë të masakruar vetëm në 3 muajtë e parë të vitit 1921 (f.292).

Përmbledhje tjetër: Të vrarë 12371, të mbytur në tortura 625 (f.294).

Një tjetër statistikë përmbledhëse për vitin 1921: Në Prizren-Lumë, 956 të mbytur e të vrarë, në Vushtrri 2394, në Prishtinë 4950, në Ferizaj 1885, në Gjilan 900, në Preshevë 345, në Plavë-Gusi 1810, në Pejë 1840. Gjithsej të vrarë, të masakruar e të mbytur me të rrahura: 15676 shqiptarë (f.291).

Vitet 1922-1924.

Në Raushiq vriten 16 burra, plaçkiten 20 shtëpi, vlera 20000 napolona, dhe rrëmbehen 500 krerë bagëti, të trasha e të imëta (f.297).

Prill 1922: Në Obërgjan vriten 8 burra, plaçkiten 200 shtëpi, vlera 50000 napolona, dhe rrëmbehen 15000 krerë bagëti, të trasha e të imëta (f.297).

Në Ruhot vriten 6 burra, plaçkiten 20 shtëpi, rrëmbehen 3000 bagëti, të trasha e të imëta (f.297).

Në Lutogllavë vriten 6 vetë, rrëmbehen 1000 krerë bagëti dhe 40000 kuintalë groshë, grurë, misër (f.297).

Në Prapaçan vriten 7 vetë, trupat e tyre hidhen në një pus me qëllim që të mos gjenden për t'i varrosur. (f.297).

Prill-maj 1922: Në Isnij vriten në bjeshkë 8 barinj dhe rrëmbehen 9000 krerë dhen (f.297-298).

Në Tërstenik vritet një plak 80 vjeç dhe rrëmbehen 1500 krerë bagëti e 15000 kuintalë drithëra (f.298).

Në Shtup vriten 6 njerëz dhe rrëmbehen 1100 krerë bagëti (f.298).

Në Buçaj të Pejës vriten 8 burra, digjen 15 shtëpi dhe bëhen grabitjet e rastit (f.298).

Në Buçane vrasin 9 vetë, djegin 15 shtëpi, rrëmbejnë 1000 bagëti (f.298).

Në shkurt 1923, në Junik sërbët vrasin 60 burra, në Gjakovë burgosin 150 (f.303).

Në tetor 1923 prapë në Junik vrasin 10 burra e në Rasnjë 3, midis tyre edhe 1 fëmijë 6 vjeç (f.303).

Në Dumnicë xhandarmëria sërbe masakron dhe vret 23 vetë, shoqëruar, sipas traditës së tyre, me skena nga më makabret të djegies për së gjalli në zjarrin e shtëpivët (f.305-306).

Vitet 1941-1947.

1941. Në Hot (afër Hanit të Hotit), 15 të vrarë, prej malazezëvet. Në Rabnicë të Podgoricës 9 të vrarë. Kolë Ucit në

Triesh, 29 vjeç, ia nxjerrin sytë dhe ia presin veshët (f.383-384).

Në Pejë 15 të vrarë, në Gjakovë 12 të vrarë, në Byc 3 gra të reja, vrarë me fëmijë në gji, në Rogovë 13 të vrarë (f.383).

Gjithsej në rrethinën e Gjakovës, pushkatuar 260 shqiptarë (f.383).

Në Sanxhak (Senicë), në fshatin Visoçkë, 12 vetë digjen në një shtëpi (f.393).

Në fshatrat e Medvegjës masakrohet popullata, përmenden 4000 frymë, por nuk del qartë sa janë vrarë (f.405).

Janar 1943. MASAKRA E BIHORIT.

Fëmijë të masakruar 701 (kryesisht me thika).

Fëmijë të djegur 705 (përcëlluar në zjarr).

Fëmijë të ngrirë 447 (vdekur nga të ftohtit).

Gra të vrara 340.

Gra të masakruara 185.

Gra të ngrira 266.

Burra të vrarë 590.

Burra të masakruar 185.

Burra të ngrirë 119.

Vgdekur urie 103 vetë.

Zënë rob 251.

Të plagosur: Burra 359, gra 275. Shuma, përjetëpangushëlluese, 4526. Shtëpi të djegura 1763 (f.401).

1944. Në Banjë e Podvoricë (në luftime) çetnikët vrasin e plagosin 70 vetë (f.405).

Në Prizren, brenda 1 dite, pushkatohen 70 vetë (f.445).

Po në Prizren, mëhalla e Tabhanes, pushkatohen 350 vetë (f.445).

“Aty ku buron lumi i Istogut, të gjithë të pushkatuarit i hodhën në një gropë. Ishin aq shumë të vrarë e të masakruar, sa u qelb uji e as kafshët nuk e pinin për një kohë të gjatë” (f.446).

Në Istog, Muzhevinë, asgjësohet 1 familje me 13 anëtarë (f.446).

Në Kizhijë, prerë me bajoneta 8 vetë dhe 1 hedhur gjallë në zjarr (f.444).

Në Polan (Ferizaj) janë pushkatuar 28 vetë (f.444).

Në Prishtinë, pushkatuar më shumë se 200 vetë (f.445).

Në katundet e Mitrovicës pushkatuar më tepër se 2000 vetë (f.445).

Në Vushtri, vrarë e fshehur në plehëra, 400 vetë (f.445).

Në Skënderaj, çarë e copëtuar me sëpata, 250 vetë (f.445).

Në Prekaz pushkatuar 18 vetë (f.445).

Në Velegllavë të Gjilanit, masakruar 35 vetë. Theren me bajonetë 7 gra e 2 fëmijë. (f.443).

Në Caravojkë dhe Stanevë, mbytur 75 vetë. **“Plakut Myftar Hajdari, i cili djalin e kishte partizan, (partizanët sërbë) i kanë prerë gjuhën dhe mandej e kanë përvëlur me ujë valë”** (f.443).

Në Qarr, therur me thika 21 vetë. **“Kufoma të copëtua, pa hundë, pa sy, pa veshë e pa krahë”** (f.443).

Në Gjilan janë pushkatuar mbi 1000 vetë (f.443).

Burgosur në Kumanovë dhe vrarë gjatë transportimit për në Vranjë, 100 vetë. (f.444).

Në Gjilan, asgjësuar gjithsej 8000 shqiptarë. **“Për shumë net rresht janë pushkatuar pa asnjë procedurë nga 40-50 shqiptarë. Në një rast, vetëm brenda 1 nate janë pushkatuar 140 shqiptarë”** (f.444).

Në Medvegjë, zhduken 7 shqiptarë dhe mbeten varrhumbur (f.437).

Në Gostivar, pushkatuar mbi 100 vetë (f.437).

Në Tetovë, 80 vetë (f.437).

Në Derven të Shkupit, vrarë 200 vetë (f.437).

Në Gostivar, vrarë 20 vetë (f.438).

Në Vrapçisht të Gostivarit, më se 150 vetë (f.438).

Në Presek, vrarë 12 vetë. **“Për të terrorizuar të tjerët”** (f.438)

Në Zhegë të Gostivarit, therur me thika 12 vetë. **“pasi i zhveshën, i shpuan me thika e bajoneta dhe pastaj i nxorën jashtë dhe i pushkatuan”** (f.438)

Arrestuar në Gostivar dhe pushkatuar në Kodrën e Gradishtit, 75 vetë (f.438).

Në Pirok të Gostivarit, vrarë 27 vetë (f.439).

Në kampin e Gostivarit, janë pushkatuar më shumë se 300 vetë (f.439).

Në Tetovë, monopoli i duhanit, ku gjendeshin më tepër se 10000 vetë, janë masakruar mbi 1200 vetë (f.439).

Po në monopolin e duhanit, **“i zgjodhën 500 djem të rinj, i dërguan për në Shklup, gjoja për t’i inkuadruar në forcat partizane... dhe i zhdukën”** (f.439).

Në Gradec të Tetovës, vrarë 35 vetë (f.439).

Në Nikadinë të Tetovës, vriten 18 vetë (f.439).

Në Raçicë të Madhe e të Vogël, vriten 40 vetë (f.439).

Një oficer i OZN-ës, me dorën e tij vrau 50 vetë (f.439).

Në Zajaz të Kërçovës pushkatohe 320 burra e djem të rinj, që nga moshja 13 vjeç e lart (f.439).

Në Bojan të Shkupit pushkatohe 76 burra, gra e fëmijë (f.439).

Në Bllacë të Shkupit vriten 160 burra dhe 50 fëmijë (f.439).

Në fshatin Saraje të Shkupit vriten 25 vetë (f.439).

Në Bllacë, Karadak i Shkupit, pushkatuar me mashtrim rreth 100 vetë (f.440).

27 të tjerë, po të Bllacës, i çuan te Ujë e Thartë, përtej Hanit të Elezit, dhe i pushkatuan (f.440).

Në fshatrat e Karadakut të Shkupit përvëlohe me ujë valë 83 vetë (f.440).

Në Sopot të Kumanovës, bëjnë përdhunime dhe vrasin 20 burra (f.440).

Në Bukuroc të Preshevës 36 vetë **“i grumbulluan në një**

dhomë dhe i mbytën me ujë të valuar” (f.441).

Në Bukurocë të Keqe të Preshevës. Rrethojnë fshatin para mëngjesit, zgjojnë banorët, i vënë të hapin një gropë 2 m të thellë. Në zjarr ishte vënë një fuçi me ujë, ajo po vlonte. Thirrën 27 vetë të moshave e sekseve të ndryshëm, burra, gra, fëmijë. Ua lidhën duart, ua mbështollën gojën dhe i lëshuan në gropë. Derdhën mbi ta fuçinë me ujë. Trupat e tyre shkrinë si qiriri (f.441).

Në Qarr të Gjilanit, therin me thika natën dhe vrasin 21 vetë të moshave të ndryshme (f.442).

Në Sedllar të Kamenicës masakrojnë 3 vetë (f.442).

Në Desivojë të Kamenicës masakrojnë 15 vetë (f.442).

Në Krajnidell të Kamenicës vrasin barbarisht 12 vetë (f.442).

Në Koretinë të Kamenicës, në 1 familje, vriten 11 vetë (f.442).

Në Hogosht masakrojnë 16 vetë (f.442).

Në Lisovicë, vrasin 7 vëllezër. *“Ishin muratorë. I çuan në ‘burgun-shtëpi’ ku i torturuan rëndë. Ua gozhduan duart në dysheme dhe para syvet të tyre dogjën për së gjalli djalin 6-vjeçar, Mursel Qerimin” (f.442).*

Në Ponesh të Gjilanit masakrohen 12 vetë. Edhe komunistët sërbë kishin të njëjtën parullë si prindët e tyre: *“Mos kurseni thikën, kurseni fishekun !”* (f.442).

Në Shahiq të Gjilanit, Sali Shahiqi, më **28 nëntor 1944**, gjeti në shtëpinë e tij **12 pjesëtarë të familjes** të vvarë. (Na kujton 28 Nëntorin e vitit 1912. Ata duan ta vrasin 28 Nëntorin tonë ! GjD) (f.442).

Në Tabelie e Vitkovicë, në luftime me çetnikët, vriten 54 luftëtarë (f.405).

Rrugës për në Tivar dhe brenda në Tivar, sipas këtij burimi, janë vvarë e masakruar 3000 shqiptarë të Kosovës. Burime të tjerë japin shifra të tjera (Krs.f.456).

Në Kaçanik, Gjilan, Kamenicë, Viti e Preshevë, gjatë Luftës së Dytë janë vvarë, prej ushtrisë partizane jugosllave, 12000 shqiptarë (f.474).

Nuk ka nevojë ta ushqejmë veten me mendimin e kurrfarë hakmarrjeje. As për t'i bërë fqinjët më të mirë se ç'janë, nuk mund të pretendojmë. Atë tjetrin nuk mund ta mësosh se si duhet të sillet. Atij tjetrit duhet t'ia **imponosh** që të mos sillet ndaj teje siç do ai. Kjo është detyra jote. Dhe kjo mund të arrihet vetëm atëherë kur ti je tepër serioz në sjelljet e tua. Të mos i biesh kujt në qafë, por t'ia bësh me dije edhe atij se nuk je gjethe dushku. Të parët tanë s'e kanë realizuar një të tillë kërkesë nga më kryesoret në jetën e një kombi, prandaj dhe i kanë përjetuar të gjithë tmerret e mundshëm. Pasardhësit tanë nuk duhet t'i çojmë më në të tilla humnera të lemerishme.

SHQIPËRIA, Ç'ËSHTË?

ANTIKOZMETIKË

“Po sot, Shqypni, pa m’thuej si je?!”

Prapë, edhe sot, mbas 130 vjetësh:

“Posi njaj lisi i rrxuem përdhe!”

Në vend që të lumturohemi se jemi me 2 shtete, mbushemi përditë me trishtim e me keqardhje.

Njëri shtet 100-vjeçar, i cili ende s’ka mësuar si bëhen një palë zgjedhje. Detyrohen të vijnë nga 20 herë në vit të dërguar të Botës, për të na treguar si duhet të sillemi njëri me tjetrin. Pagan Bota njerëz për të **“monitoruar”** shqiptarët, pale a po dinë të shkojnë te kutia e votimit apo po marrin brinjat duke gjuajtur shoshoqin me gurë.

Tjetri shtet, aty-aty, sa edhe Sllovenia, por i cili, ndryshe nga Sllovenia, ka nevojë ta mbajnë për dore, si dadoja kalamanin. Herë një UNMIK e herë një EULEKS. Pagan edhe aty Bota **“vëzhgues”**, a po votojnë, burri për vete e gruaja për vete, apo po e merr kryefamiljari tufën e fletëvet e po e rras në kuti në emër të krejt collëvet.

A e shihni çfarë buzëqeshjesh kanë ata njerëz që vijnë për të na mbikqyrur?! Kanë buzëqeshjen e atij që hyn në një kopsht zoologjik dhe shikon atje: sorkadhe, ketra, mjellma, fazanë, çakej, arinj, ujqër. Shikojini me vëmendje buzëqeshjet e tyre, kur dalin në television!

Tragetet i marrim me qëra, avionët e udhëtarëvet i marrim me qëra, ndërsa hekurudhat e trenat tanë, janë modeli më i shëmtuar i shkatërrueshmërisë. I shpirtit tonë?! I edukatës sonë?!

Apo çfarë tjetër mund të themi?! Ç'epitet mund t'i vëmë vetes, kur shohim një të tillë katandisje?!

E mbushëm Botën me punëkërkues! E mbushëm Botën me rregullashkelës! Me djem të rinj që kalben burgjevet, me prostituta, me lypësa, me trafikantë nga më të “*kualifikuarit*”!

I mbushëm varrezat me varre 20 e 30-vjeçarësh! S'na vjen të hapim televizorin, se s'ka ditë që nuk hyn në dhe një djalë i ri, një vajzë, një nënë e re, një fëmijë, copëtuar nga përplasjet e çmendura.

Shtete pa ushtri. Pa aviacion, pa tanke, pa flotë lufte, pa artileri. Madje, njëri prej këtyre shteteve, pa të drejtë për të pasur ushtri, siç i ka gjithë Bota. Sërbisë, ushtria e së cilës i vuri flakën ballkanit dhe e mbushi Ballkanin me varre massive civilësh, nuk ia hoqën ushtrinë, ne na e çarmatosën UÇK-në, sapo u vulos “*Kumanova*”. Republika e Shqipërisë e kish ushtrinë dhe iu asgjësua. 2 pyetje të mëdha që shtrojmë ne, janë këto: Pse u la pa forcë mbrojtëse Republika e Shqipërisë, pikërisht në kohën kur pushtetin e kishin marrë antikomunistët? Pse iu hoq e drejta për të pasur një forcë mbrojtëse Kosovës, në kohën kur ajo forcë e vogël çlirimtare ishte 100% aleate e NATO-s? Sado i painformuar **konkretisht** të jetë njeriu, përgjigjia e vetme është kjo: *Ekzistojnë ende tentakula të fshehta për ricopëtimin e Shqipërisë! Traktati i fshehtë i Londrës nuk është fshirë përfundimisht nga agjenda e pazarllëqevet në lidhje me këto hapësira ku jetojnë shqiptarët. Sa kohë që shqiptarët të jenë të tredhur nacionalisht, ai traktat do të mbetet në fuqi.*

Shtete, ku nuk gjen dot qoftë edhe 1 kompani ekonomike me, ta zëmë, 3000 punëtorë e nëpunës të punësuar. Edhe Gjermania Lindore ka qenë vend komunist, po shihni si e ka ekonominë!

Shtete me toka të braktisura dhe me pyje që, në mos i djegshim, i presim e, në mos i përfshim, i djegim.

Me politikanët, që zanatin kryesor e kanë: të shajnë e të

shpifin kundër njëri-tjetrit, pa pikë burrërie. Si pashallrët në kohën e Turqisë dhe si më të këqinj të mbretër të Ilirisë. I vetmi profesion i tyre, i nivelit real të doktoraturës, si t'ia vjedhin votat kundërshtarit.

Një komb që i ka me dhjetëra deputetët në parlamentet grek e turk, dhe s'e di që i ka. S'e di që i ka, sepse ata nuk deklarohen shqiptarë. S'e di që i ka, sepse atyre as që u shkon ndërmend të kërkojnë të drejta nacionale për zgjedhësit e vet. Janë me dhjetëra kryetarët e bashkivet, **shqiptarë**, në Turqi e në Greqi, të cilët profesion kryesor kanë, të nivelevet të doktoraturës, të fshehurit, të kamufluarit, si **joshqiptarë**. Si grekë, si turq, si çfarë të duash tjetër, veç **shqiptarë jo**. Ata dridhen nga frika se mos rrotull tyre po përhapet ndonjë opinion që nuk janë grekë e që nuk janë turq.

Një komb që ka frikë nga regjistrimi i vetëvetes! A ka në Botë ndonjë komb tjetër, ku pjesa pozitive e tij të jetë e detyruar të dalë nëpër rrugë me flamur, me flamurin kombëtar, dhe të bërtasë: **Mos na regjistroni** !? Vetëm një komb i tredhur nacionalisht mund të ketë frikë nga regjistrimi.

Ç'mund të themi tjetër, mbas krejt kësaj që thamë për veten tonë, përveç:

“Po sot, Shqypni, pa m'thuej si je?”

“Posi njaj lisi i rrxuem përdhe!”

Krejt natyrshëm, do të mund të flisnim edhe ndryshe, sepse ekziston ndër ne edhe ajo e vërtetë që mund të quhet entuziaste. Por, **a do t'ia vlente tash të mereshim me kozmetikë nusesh?!**

REVY VETINDINJUESE

DY PARALELE ARKITEKTURA E SHKATËRRUAR E ATDHEUT

Një nip i familjes sonë u kthye nga një shëtitje nëpër Itali. Më parë pat jetuar atje 5 vjet si emigrant, por nuk e kish njohur Italinë. Tani, mbasi ka mbaruar këtu fakultetin, është bërë inxhinier dhe është rregulluar ekonomikisht, shkoi në Itali jo si emigrant, por si shëtitës, si turist.

“Unë tani e pashë Italinë.” Më tha. “Më parë kisha parë vetëm një lavazh (vendin ku punoja) dhe nja 2 rrugë të Firences. Tani e pashë Firencen, pashë Venecian, pashë Milanon dhe mund të them që e pashë Italinë për herë të parë.”

“Cila është, pra, përshtypja jote?”

“Përshtypja ime” tha ai “është: që ne kemi jetuar në terr e në skëterrë 5 shekuj.”

Kjo ish tema e cila autorit të këtyre shkrimeve ia ka ndrydhur shpirtin e pakta që në moshën 15 vjeç e këndej. Ai kujton:

Janë ca rrëpira ku mezi kalon dhia, përsipër fshatit Togjemil, afër Tivarit. Një ditë po udhëtonim andej im atë dhe unë, për të dalë në Shkallë të Bardhë. Duke u përshkuar me vështirësi permidis shkurevet, unë hasja në ca fragmente muresh dhe ndalesha. Im atë e vinte re, por nuk fliste. Kur dolëm më lart, te Kroni i Shkallës, që është një pasuri e papërsëritshme natyrore, e lënë plotësisht jashtë vëmendjes së njerëzvet, u ulëm dhe po prisnim të na thahen djersët, pastaj të pinim ujë. Tata më tha:

“A i pe ato megja andej kah erllëm?”

“I pashë.”

“Ato i kanë bënë të parët tonë lle kjo tregon se na dikur nuk kena kjenë kshu si jena sot.”

Aty dëgjova për herë të parë edhe emrin ILIR. “Në vakt t’ilirëvet” tha tata “ky vend ka kjenë plot me gjin”.

Im atë ish një njeri i ditur. Ai zotëronte 5 gjuhë të huaja dhe në shtëpinë tonë të varfër, në ata vite, kish gjithfarë fjalorësh: turqisht-frëngjisht, greqisht-frëngjisht, fjalorë turqisht me shkronja arabe të transkribuar krahas shkrimit arab me shkrim latin, fjalorë të greqishtes së vjetër, një fjalor i H.Bariqit shqip-sllavishte jugore qendrore. Por mua më mbeti në shpirt dhimbja e murevet të kohës ilire, tash të rrënuar kaq keq.

Olsi, kështu quhet nipi i familjes sonë, na foli për Milanon e për Venecian. Na kish prurë edhe një kalendar për vitin 2008 me pamje të Firences.

“Çdo gjë ish më se e mrekullueshme.” Tha ai “Fasadat e ndërtesave, rrugët e ngushta nëpër Venecia, Duomo në Milano, Galeria, La Skala. Ndërkaq, ne s’kemi asgjë, as të ngjashme me ato që ka Italia.”

Ish një e vërtetë tepër e hidhur. Koha e Turqisë s’na kish lënë asgjë nga ajo kulturë ndërtimore e shekujvet të mëparshëm. Themi *koha e Turqisë*, por ne e dimë që më shumë se Turku e kemi prishur vetë ne. I kemi prishur ne, të turqizuarit! Na u kujtuan Kotorri dhe Dubrovniku, të cilët nuk arritën t’i pushtojnë osmanët, por që i sllavizuan sllavët. Ata janë thujse njësoj si qytetet e Italisë. Ndërsa ne nuk i kemi as Tivarin e atëhershëm, as Ulqinin, as Shkodrën, as Lezhën, as Durrësin, as Vlorën, as Artën, as Nikopolin, as Krudjen, as Dibrën, as Ohrin. Madje as Prizreni s’është qyteti i dikurshëm. Është krejtësisht i orientizuar. Nuk themi se është keq, por themi se nuk është ai që ka qenë dikur. Në Pejë e në Graçanicë janë ruajtur vetëm

kishat tona të sllavizuara. Ato të mirëfilltat që dikur i patëm bërë **për vete**, mund të gjenden vetëm nën dhe ose në formë themelesh.

Por ne sërish po na shtyn vetëvetiu brenga edhe më thellë në kohë. Ku janë Dimali, Bylisi, Amantia, Antigonea, Foinike, Apollonia, Dyrrahu, Albanoni, Theranda, Ulpiana, Damastioni, Ulcinioni, Oleotopolisi, Meteoni, Diokleja, Svaciumi, Drivasti, Lisusi, Petrela, Petaralba, Stelushi, Uksana, Skupi?!

Ai terr 5-shekullor që na e ka prurë Perandoria Osmane dhe që thujse na ka mbytur tërësisht, aq sa na duket mrekulli, kur kujtojmë se jemi ende gjallë, i ngjan çapëlimit që i bëjnë ujçërit një **dreri** të rrëzuar qysh më parë prej egërsiravet të tjera. Egërsirat e tjera, psh lukuni çakenjsh dhe hienash, e kanë rrëzuar **drerin** në mes të rrahut, ia kanë çarë e grisur lëkurën, ia kanë derdhur një sasi gjaku. Kur kanë ardhur ujçërit, **dreri** ka qenë i shtrirë. Ai është ngritur dhe është mbrojtur me gjithë fuqinë e vet, por më në fund është rrëzuar sërish dhe ujçërit i janë derdhur përsipër. Dikur është gëdhirë. Egërsirat kanë qëndruar në pyll, në përgjim për t'iu sulur prapë.

Kjo është Shqipëria. Prandaj dhe monumentet tanë të arkitekturës (**bukuria e drerit**), ose janë groposur, ose janë thërrmuar e kthyer në rërë.

ARKITEKTURA E SHKATËRRUAR E SHPIRTIT

Por ne na shqetëson shumëfish më tepër fakti që ky serial netësh të errëta (Romë, Bizant, barbarë, sllavë, turq), të mbushura me furtuna e me zjarre rrufeshë, nuk na ka shkatërruar vetëm arkitekturën e qyteteve të fshatrave, por na ka shkatërruar edhe **arkitekturën shpirtërore**, shpeshherë edhe trupore, të njeriut tonë. Fan Noli, si dhe shumë të tjerë rilindës, e ka parë dhe e ka shprehur me shumë dhembje këtë të vërtetë tonën kaq trishtimprurëse:

*“Anës detit i palarë,
Anës dritës i paparë,
Pranë sofrës i pangrënë,
Pranë dijes i panxënë”...*

...“Trup e shpirt i sakatosur!” (Vep.1,f.94)

Nuk po marrim aspektet kur ne jemi të mirë e të zotë. Të mos ishim të mirë e të zotë, të mos kishim cilësi nga ato që rrallëkush i ka ndër popujt e tjerë, ne sot nuk do të përmendeshim gjëkund, as për mirë, as për keq. Vetëm në kapitujt e historiografisë ndoshta do të kujtohej ndonjëherë emri ynë, por edhe atëherë si t’u thoshte mendja atyre që shkruajnë.

Nuk do të merremi, pra, në këta rreshta me aspektet e **vitalitetit** tonë. Do të merremi, madje ashpër, me aspektet e **mortalitetit** tonë. Me ato cilësi që na **vdësin** ne si Komb, që na mbysin, ose që na renditin midis fundrrinave, gjë që më së shpullëshmi përjetohet kur shkojmë në dogana: Të gjithë i lënë të kalojnë lirshëm, ne na ndalin mënjane, për të na kontrolluar *“ndryshe”*.

Gjithkund e shohim arkitekturën e dekompozuar, të thyer e të shkatërruar, të shqiptarit të sotëm! E shohim në çdo hap që bëjmë dhe në çdo ditë të re që gëdhijmë: Në punë, në rrugë apo thjeshtë duke lexuar titujt e gazetave, duke dëgjuar e parë emisionet e lajmevet, bisedat televizive dhe ato jotelevizive. Në rrugë, kur bie shi dhe kur nuk bie shi. Sa herë që shohim si e ka hapur dikush kanalën nëpër asfalt dhe si e ka mbyllur, pasi ka mbaruar punë, e shohim shprtin sakat të njeriut tonë të përditshëm.

Çoji 2 ose 5 punëtorë (punëtorë “*llaçi*” apo punëtorë “*kazme*”) në një punë, jepua punën në mëngjes dhe lëri aty deri në darkë! Shko në mbrëmje dhe shiko sa punë të kanë bërë dhe si ta kanë bërë punën! Për faqe të zezë! Po nuk u ndenje mbi kokë, ata nuk të bëjnë asnjë punë. Shqiptari **punëtor** ose nuk do, ose nuk di ta bëjë punën si duhet. Shqiptari **zyrtar** ose nuk di ose nuk do që ta bëjë punën si duhet. Shqiptari **polic** nuk bën punën e policit, por bën punën e përfitimit të kundraligjshëm. Shqiptari **mjek** pjesën më kryesore të mendjes së vet e shpenzon jo për të shëruar të sëmurët, por për t’u pasuruar prej të sëmurëve. Shqiptari **jurist** rrezaton më shumë padrejtësi se sa drejtësi. Shqiptari **mësues** shpeshherë e bën veten karikaturë të mësuesit. Shqiptari **doganier** e shndërron doganën në institucion të shkeljes së rregullavet doganore.

I bëjmë **ministra** shqiptarët, e ata nuk dinë ta bëjnë punën e ministrit. Një minister që nuk ka frikë prej asaj çfarë mund të shkruajë historia nesër për të, është i cekët mendërisht, por është edhe moralisht difektoz. I bëjmë (ose bëhen vetë) **kryeministra**, e ata nuk dinë të jenë kryeministra. Një kryeministër, i cili në çdo veprim apo fjalë të tijën nuk e çon mendjen te ajo çfarë do të shkruajë nesër historia për të, nuk ka **strategji** as për vete, jo më të ketë **strategji** për kombin e vet. I bëjmë **kryetarë komunash** e **kryetarë bashkishë** e ata nuk i kryejnë ato punë as përafërsisht ashtu si duhet.

Madje më shumë **nuk duan** se nuk dinë. Të gjithë këta, krejt kjo pamje e mbrapsht njerëzish të kohës sonë, ndaj të cilëve nuk po shpifim, por janë realisht të tillë, na ngjajnë me një **mori skulpturash të thyera e të copëtuara**. Dikush ka gjysmë koke, dikush ka çerek koke, dikush ka vetëm një dorë, dikush s'ka as kokë as parzma, por i kanë mbetur vetëm... ca organe të tjerë.

Nuk po duam t'i përmendim tash me emra disa nga ata që po na vijnë në mendje. Ata nuk janë shqiptarë, por janë fragmente fytyrash të shfytyruara. Një që i shet të huajit një pasuri kombëtare shqiptare, duke parë sa fiton **vetë**, personalisht ose klanërisht, prej asaj shitjeje, ai nuk është shqiptar. Ai është baltë.

Një që e derdh ujin e hidrocentraleve (E **derdh! Jep urdhër që të hapen portat!**), me qëlim që, pasi të jenë boshatisur liqenet, të **"detyrohet"** të blejë dritë **"me prokurim të drejtpërdrejtë"** dhe të mund të fitojë ashtu, **për vete e për klanin**, disa miliona euro... Një që mbledh ujin në liqenet e hidrocentraleve, për të fituar me atë ujë, **për vete e për klanin**, e në fund ua derdh **"tepricën"** shkodranëve përsipër... Ata janë jo baltë, por më keq se balta.

Elementi që u mungon më së shumti këtyre qindra mijë shqiptarëve të shekullit XXI, që nga punëtori i llaçit deri te kryeministri, është **PATRIOTIZMI**. Jo ai patriotizëm që shprehet vetëm me fjalë, por **patriotizmi konkret dhe i vërtetë**. Kur 1000 elektrikistë nuk i mbledhin paratë e dritavet si duhet dhe kur 500000 familje e vjedhin dritën, cili do të jetë rezultati? Rezultati kuptohet: Atdheu mbetet pa drita.

Për të parë ku është rroposur shqiptari i sotëm, po **përfytyrojmë** shtatoren e një mbrojtësi të dikurshëm të Krujës, psh shtatoren e Vrana Kontit, punuar dikur në mermer, nga një dorë mjeshtri. Ajo ka qenë dikur e vendosur në hyrje të kështjellës, por kanë ardhur turqit dhe e kanë shkallmuar. Copërat e asaj skulpture kanë marrë përroin poshtë dhe sot i gjen një këtu e një

atje nëpër fushat e nëpër përrenjtë e Fushë-Krujës. **Kjo është skulptura e shqiptarit të sotëm.** (Jo e të gjithëvet, por e atij, për të cilin po flasim).

Prandaj shqiptari i sotëm (ai për të cilin po flasim), i shkull vreshtat, i pret ullinjtë, i thyen xhamat e seravet, i vjedh e i djeg magazinat e tregtisë, i shkatërron vagonat e trenit, i vjedh ikonat e Voskopojës, i vjedh qilimat e xhamisë, vjedh edhe padronin atje në megrim, vjedh ose vret edhe kushëririn e vet, në kthim nga mërgimi. **Nga ky brumë dalin ministrant.** Kuptohet që ata s'mund të jenë më të mirë.

Shkon në Turqi shqiptari e bëhet turk, shkon në Greqi shqiptari e bëhet grek, e pushton Mali i Zi shqiptarin e bëhet më malazez se vetë malaziasia...

Në intervistë përpara vetes

Të këtille “*gjqe*”, që do t'i shohim këtu poshtë, bëjnë madje edhe shqiptarët indiferentë, ata moskokëçarësit, le më të tjerët, ata që shqetësohen kur shohin batërdi rretherrotull. Të gjithëve u pulsojnë nëpër mendje vargje pa mbarim pyetjesh.

Psh: Pse jam një njeri i pashkollë? Edhe prindët e mi kanë qenë pa shkollë. Pse kanë qenë edhe ata pa shkollë? Edhe gjyshërit e mi kanë qenë pa shkollë. Pse kanë qenë edhe gjyshërit e mi pa shkollë?

Cfarë shteti kemi pasur para 200 vjetësh, para 300 vjetësh, që i ka lënë paraardhësit tanë kaq analfabetë e, psh, anglezët shteti i tyre i ka shkolluar? Cfarë shteti kanë pasur ata popuj që sot janë popuj të shkolluar?

Mirë. Bëhen edhe të tjera pyetje: Gjyshi im nuk ka pasur shtëpi të mirë. As gjyshi i gjyshit tim nuk ka pasur shtëpi të mirë. Pse s'ka pasur gjyshi i gjyshit tim shtëpi të mirë, që unë ta kem atë shtëpi edhe sot të trashëguar? Pse s'e ka pasur ai një shtëpi të trashëguar 6 breza ose 16 breza, e ta kem edhe unë 12 ose 22 breza të trashëguar një shtëpi, në mes të një qyteti ose

afër një qyteti shumë të madh? Dhe të kem aty sende që më kanë lënë gjyshërit, të kem piktura që kushtojnë 20000 euro, të kem bizhuteri e diamante të rrallë. Pse nuk i kam unë këto, siç i kanë shumë të tjerë nëpër Botë, psh në Hollandë, në Danimarkë, në Francë. Cfarë shteti kemi pasur ne, ta zëmë, para 22 brezash?

Ne nuk kemi as rrugë të mira. (Tani po mundohemi t'i ndërtojmë, duke vjedhur sa të mundim gjatë ndërtimit të tyre) Italia dhe Gjermania kanë rrugë shumë të mira. Ka rrugë të mira edhe Zvicra, që është një vend më malor se ky i yni. Pse ne nuk kemi rrugë të tilla? Pse gjyshërit dhe paragjyshërit tanë nuk kanë arritur të bëjnë rrugë e hekurudha, siç i kanë bërë të tjerët? Kemi dëgjuar që ka qenë një inxhinier shqiptar, i cili ka projektuar një tunel diku në Evropë. Pse s'u projektua ai tunel këtu, në Bjeshkët e Nemuna, në mënyrë që ato të mos mbeteshin përjetë të nemuna?

Ekonomi e dobët. Përse?!

Përse punëtorët e nëpunësit tanë marrin kaq pak para, kur punojnë këtu në Shqipëri e të tjerët (ose ata të njëjtët) marrin 3-fish, 5-fish apo 7-fish më shumë në vende të tjerë?

Përse nuk e kemi rrjetin e ujësjellësavet të bollshëm dhe të rregullt, kur dihet që vendi ynë ka ujë natyror me tepricë? Përse ka me mijëra ndërhyrje në tubacionet e ujësjellësavet, aq sa shpeshherë pimë ujë fekalesh bashkë me ujin tjetër?

Përse s'e kemi të zgjidhur problemin e dritës, me gjithë ekzistencën e **disa** hidrocentraleve dhe me gjithë mundësitë natyrore që ka vendi ynë? Pse s'e kemi të mirëmbajtur rrjetin e shpërndarjes? Pse s'e kemi çmimin e dritës më të ulët? Dhe, në fund, përse duhej t'ia shisnim një të huaji entin shpërndarës të energjisë?

Pse nuk kemi telefoni të zhvilluar ne shqiptarët, në mënyrë që çdo familje, në qytet e në fshat, t'i ketë edhe telefonin fiks edhe internetin? Dhe t'i ketë të lirë, siç i ka gjithë Bota.

Pse kemi kaq shumë papastërti nëpër fshatra e nëpër qytete? Grumbullime të neveritshëm mbeturinash pranë çdo vendi ku banojnë shqiptarët! Shkurre anash rrugëvet! Barishta e ferra që të gërvishtin fytyrën, kur hyn në një katund! Erë të keqe ujërash të zez deri edhe nëpër plazhe. Përse gjithë ky pisllek në Atdheun e shqiptarëvet?!

Përse nuk i kemi objektet turistikë tërheqës e funksionalë? Kështjellat e vjetra, objektet e kultit, çesmat, liqenet, shkëmbinjte, që i ka bërë vetë natyra objekte turizmi, kanionet, shpellat karstike, pyjet, livadhet, pse s'i reklamojmë në mënyrë të atillë që turisti i huaj të ketë dëshirë për të ardhur këtu? Dhe pse s'ia krijojmë ambientin turistit, që të mos pendohet se ka ardhur këtu? **Ne, mikpritësit me nam! Mos ia pafsha bojën më Shqipërisë!** Thonë një shumicë turistësh, kur largohen këndeje.

Pëse nuk kemi një bujqësi tërheqëse, që jo t'i lutemi tregut të huaj për të bërë kontrata, por të na lutet ai ne? Pse s'kemi fruta? (Kemi, por na kalben përtokë, poshtë pemëvet) Pse s'kemi perime e zarzavate? (Kemi, por, në pikun e tyre, na kalben përrenjve e kanaleve) Pse s'kemi grurë, misër e patate? Pse i kemi lënë djerr tokat tona e shkojmë e punojmë në tokat e Grekut e të Italianit?

Pse s'kemi lloje frutash të famshëm? Lloje rrushi, lloje fiku, agrume, mollë, kumbull, gështenjë, që të vijnë e të na i kërkojnë skandinavët, ukrainasit, rusët? (Kemi, por i kalbim ne vetë skutavet dhe kasollevet)

Pse s'kemi vaj ulliri me shumicë dhe pse, kur duam ta shesim vajin e ullirit, e përziejmë me vaj bimësh ose edhe me lubrifikant ?

Pse s'kemi bagëti të mira e të mjaftueshme për ne dhe për tregun e jashtëm, që jo të blejmë ne në Poloni e në Hungari viça e lopë, por të vijnë të huajtë e të blejnë ndër ne?

Përse nuk kemi një **industri** dinjitoze në Shqipëri (një të

atillë që vërtet të mund të quhet **industri**), siç i kanë psh, Italia, Çekia, në mënyrë që prodhimet tanë të kërkojnë nëpër Botë?

Pse t'i blejmë gjatë tenxheret, pjatat, pantallonat, këmishat, kopsat e këmishavet, shtrydhëset e frutavet, sobat me gaz, syzat e gjysmëqorravet, syzat e diellit, orët, fletoret, bojën e murevet, shatat, kosat, qentë e racës, kafazat e zogjvet dekorativë, bluarëset e mishit, kabllot elektrikë, llamarinat për të mbuluar kasollet e magazinat tona, tubat plastikë, plasmasin, brekët e banjos, sutjenat dhe shamitë e hundëve?.. Të paktën disa prej këtyre, pse s'i prodhojmë vetë? Pse t'i blejmë të gjitha këto përjashta e askush prej popujvet të tjerë të mos thotë: ***Po shkoj t'i blej në Shqipëri këta mallra, se ata i prodhojnë më mirë se kushdo tjetër!***

Pse nuk kemi lulishte të mjaftueshme nëpër qytetet tanë? Të mjaftueshme dhe të bukura, për të ndenjur e për t'u kënaqur në to e jo të mbushen njerëzit me nerva edhe kur kalojnë rastësisht andej!?

Pse kemi kaq shumë vrasje njerëzish deri edhe në familje? Pse vriten shqiptarët njëri me tjetrin? A pak na kanë vrarë të huajtë e prapë po na vrasin?!

Pse ka në Shqipëri vjedhje dhe grabitje, aq sa në momente të veçantë, familja të mos bëjë dot gjumë të qetë? Aq shumë vjedhje ka, sa ke frikë, ta lësh makinën përpara shtëpisë! Pse ka kaq shumë vjedhës, sa njeriu të mos rrijë dot i qetë as në autobusin urban? Pse ka kaq shumë vjedhës, sa emigranti ynë atje në megrim, duhet të ruhet më shumë prej bashkëkombasvet të vet, se sa prej vendasvet të atjeshëm?

Pse ne u bëmë të famshëm në Ballkan e në Evropë psh për "***industrinë***" e pasaportavet falso e nuk u bëmë të famshëm psh për zhvillimin e kapitalit financiar, si ruajtës të besueshëm të depozitavet bankare dhe të ishim pasuruar **me këtë rrugë**, jo me "***industrinë***" e falsifikimit të dokumenteve?!

Pse u bëmë të famshëm për kalimin e klandestinëvet nëpër Adriatik e Jon e nuk u bëmë të famshëm psh për zhvillimin e nautikës sportive e turistike në brigjet e detravet tanë dhe në liqenet tanë? Të kemi 5 a 6 porte për jahte e për kano.

Pse na ndodhën aq shumë shkatërrime në 91-shin e në 97-n? Aq shumë nxjerrje jashtë përdorimit të uzinavet, të fabrikavet, të kombinatevet, të hekurudhaves, shkatërrim i flotës detare, asgjësim i plotë i vreshtavet?! Prerje pa dhembje e agrumevet, e ullinjvet, e arravet, e pishavet! Djegie të pishnajavet! Plaçkithje të magazinavet! Djegie të arkivavet! Vjedhje dhe shitje kushedi se ku të objektevet muzealë me vlera për Kombin tonë! Thyerje vandale të xhamavet të seravet tona të shumta! Zmontim i të gjithë instalimevet nëpër miniera! Pse na ndodhën të gjitha këto e nuk ndodhën ato të tjerat, që thamë pak më parë? Pse nuk i ndodhi Kombit tonë e kundërta, që t'i kishim ruajtur ato që i kishim bërë në kohën e diktaturës dhe të kishim ndërtuar të tjera edhe më të mira e më moderne pas diktaturës?! Diktatura, të themi atë që është, u vu në vendin tonë me plane të studiuar mirë. Po kundërdiktatura, pse s'u pru me një plan të pëlqyeshëm, që çdo gjë të shkonte për së mbari?! Psh, të projektonte shkencërisht mënyrën se si do të krijohet klasa kapitaliste në Kombin tonë!

Pse kemi kaq shumë të burgosur ne shqiptarët nëpër burgjet e Shqipërisë dhe nëpër Evropë? Në Greqi, në Itali, në Zvicër, në Gjermani. Pse një pjesë e Kombit tonë nuk di të jetojë jashtë burgjevet, por “*ia ka qejfi*” të futet atje e të myket atje?!

Pse po e poshtërojnë veten kaq shumë **prostituta** shqiptare nëpër Botë? Pse po e poshtërojnë veten dhe pse po e turpërojnë Kombin, të cilit i përkasin? Dhe pse kemi midis nesh kaq **pseudofilozofë**, kaq pseudoshpjegues të këtij fenomeni poshtërues gjithënjëzësor, që me një gjysmë fjalie e nxjerrin të ligjshëm, e justifikojnë **këtë fytyrë tonën prej kurve**?! Këta pseudofilozofë “*opinionistë*” e bien nganjëherë aq të natyrshëm prostitucionin, sa dëgjuesit i vjen keq, i vjen inat, pse s'i ka edhe

ai nënën apo motrën prostituta.

Pse po na shfaqen me mijëra përdoruesit e drogës nëpër Shqipëri, po edhe jashtë Shqipërisë, nëpër rrugicat e shkallaret e ndyta të qyteteve? A s'mund të rrijë shqiptari pa e provuar edhe ky atë “*ëmbësirë*” që i ka shkatërruar e po i shkatërron edhe kombe më të fuqishëm se ne?! Pak i kemi të këqiat e tjera?! Apo, atje ku rrojnë lakuriqët e natës, rrojnë edhe kërmijtë e krimbat!?

Pse ne shqiptarët kemi kaq shumë korrupsion në të gjitha zyrat tona? A nuk mund të rrojë shqiptari pa marrë ryshfet? A nuk mund të rrojë shqiptari pa dhënë ryshfet?

Pse Kombi shqiptar ka më shumë kontrabandistë se tregtarë normalë, të rregullt e që do të vepronin brenda ligjeve të biznesit shtetërisht të miratuar? Pse kaq shumë kontrabandistë sheqeri, vaji, kafeje e makaronash, kontrabandë naftë, kontrabandë armësh? E, në mos pastë naftë e armë, atëherë le të bëjmë kontrabandë viçash “*të Maqedonisë*”! Pse kaq shumë trafikantë droge, madje edhe me “*karrierë*” botërore? Pse kaq shumë trafikantë njerëzish? Pse kaq shumë trafikantë të organeve të njerëzore dhe të foshnjave? Pse të ketë shqiptar që e kërkon burimin e pasurimit deri edhe te lypësat e mjerë dhe te sakatët, te njerëzit pa këmbë, pa dorë, pa sy, te njerëzit gjysmamendsh, ulokë e idiotë? A i ka hije njeriut, po fjalën e kemi për shqiptarin, a i ka hije shqiptarit që të merret me një të tillë “*tregti*” kriminale e të ndyrë?! Të ndyrë moralisht, por edhe në pikëpamje vizuale, ta marrë dreqi!

Në fund të fundit, përse ne shqiptarët kemi një krim kaq “*mirë*” të organizuar e nuk kemi një shtet, 2 shtete apo 3 shtete të mirorganizuar?! Pse njerëzit tanë **dinë** të organizohen “*shumë bukur*” për të bërë krime, por nuk dinë të organizohen për të pasur një administratë shtetërore të denjë për një komb të moçëm?! Krimi i organizuar i yni është i aftë të vërë edhe shtetin në shërbim të tijin, ndërsa shteti nuk është i aftë të organizojë shtetasit e vet

për t'u pasuruar me punë të mira. Ka edhe në vende të tjerë krim të organizuar. Por ne nuk po duam të flasim tani për këtë punë. Ne nuk po duam ta shtrijmë këndvështrimin tonë në drejtim të vetëjustifikimevet. Ne po duam të ndalemi vetëm këtu: **Përse ne shqiptarët të jemi të aftë, të ORGANIZOHEMI për të bërë punë të këqia e nuk qenkemi të aftë të ORGANIZOHEMI për ta bërë Atdheun tonë përditë e më të bukur, përditë e më të pasur, përditë e më të lakmueshëm e të pëlqyeshëm, në radhë të parë për vetë ne, të zotët shumëshekullorë të këtyre tokave e ujërave, e pastaj edhe për të tjerë?! Për ne, që të mund të rrojmë këtu me ëndje edhe për shumë shekuj të tjerë, ndërsa për të huajtë, të vijnë e të na shohin dhe të**

shkojnë prapë nëpër vendet e tyre.

FORMULË VETËQORTIMI:

NA PLAÇIN SYTË !

Na duhet prapë të rikthehemi te kapitujt që na rrëfejnë e rirrëfejnë pësuarjet tona tragjike shumëshekullore dhe të pangushëllueshme. E bëjmë këtë për të lidhur më mire pasojat me shkaqet. Sepse, në i quajtshim fatkeqësitë tona *përvitshmëri*, duhet ta dimë që ato vijnë nga **përditshmëritë**.

Sa herë që shohim mangësi në çfarëdo fushe të jetës sonë, duhet, është e nevojshme, është e domosdoshme, t'i themi vetes: ***Më plaçin sytë!*** ose: ***Na plaçin sytë ! Përndryshe, u lëmë mundësi të tjerëvet të na i nxjerrin sytë me bajoneta.*** Por ne, me sa duket, as që e kemi përdorur ndonjëherë këtë lloj **autoqortimi**.

Kur një vajzë adoleshente e derdh kafën mbi furnelë, e ëma shkon dhe i thotë: ***Pse, moj bijë kështu?*** Kur e njëjta vajzë e djeg, e shkruvbon, bukën në furrë, e ëma shkon sërish dhe i thotë si edhe më parë: ***Pse, moj bijë?*** Por kur po ajo vajzë e derdh prapë kafën mbi furnelë, e djeg prapë tavën në furrë, e bën prapë kekun thëngjill, atëherë nëna nuk thonë më : ***Pse, moj bijë?*** I thonë: ***Të plaçin sytë!*** Edhe vajza vetë, po nuk mësoi ta qortojë veten, kurrë nuk ka për të mësuar si bëhen punët. Kështu ndodh edhe me bariun, kur ia ha ujku dhentë. I thonë të tjerët: ***Ku e pate mendjen? Ku i pate sytë?*** Por i thotë edhe bariu vetëvetes: ***Më plaçin sytë mua! Si nuk i ruajta më mirë?!***

Përshkrumbjet dhe përgjakjet e të gjithë visevet të Shqipërisë: Të Shqipërisë Veriore, të Shqipërisë Jugore, të Shqipërisë

Lindore, të Shqipërisë Qendrore, e kanë pajisur Kombin tonë me **përvojën** e djegies së shtëpivet tona, me **përvojën** e vrasjes së njerëzvet tanë, me **përvojën** e dhunimit të femrave tona **nder-ruajtëse**, me **përvojën** e çarjes së barqevet të nusevet tona shtatzëna.

Por **ne**, me sa duket, nuk kemi zënë mend prej të tilla **përvojave** dhe prej të tilla **pësuarjeve** ! Përse ?!? Sepse nuk i kemi përpunuar dot **strategjitë** dhe **taktikat efikase**. Jo **strategji** koti, por **strategji efikase**. Ndërkaq **Ata**, keqbërësit tanë, i **kishin** strategjinë edhe taktikën makabre të vendosjes dhe të ngulimit në tokat tona. Dmth, i kishin strategjitë dhe taktikat **edhe të shfarosjes sonë**. Ne s'i kishim **shtrategjinë** dhe **taktikat** tona.

Pyetja vazhdon të shqiptohet e të rishqiptohet me ngulm: ***Përse nuk i kemi përpunuar dot strategjitë dhe taktikat e mbrojtjes së njerëzvet tanë dhe të tokavet tona*** ?! I kemi parë në ç'mënyrë na kanë hyrë sërbët në Prokupje, në Kosanicë, në Kurshumli, në Toplicë, në Vranjë. Kemi duruar "**stoikisht**" masakrat. Na rruat "**stoicizmi**"! Kemi bërë kundërmësymje. Kemi bërë edhe protesta: ***Na dogjën, na vranë, na plaçkitën, na përzhunë*** ! Por ç'kemi **MENDUAR, THËNË** dhe **BËRË**, (Jo si ca popullata anemike, por si një Komb i vërtetë !), në mënyrë që **ATA**, kushdoqofshin, të mos ua mësynin dot, të mos guxonin t'ua mësynin, nja 40 vjet më vonë, Mitrovicës, Prishtinës, Prizrenit, madje edhe Lezhës ! Artës, Pargës, Janinës, madje edhe Gjirokastrës ! Edhe Vlorës! **Kjo** është çështja që duhet zgjidhur një herë e mirë.

Si në shekujt kur kanë ardhur barbarët, edhe këtë herë, dmth në shekujt XVII, XVIII dhe të paktën një pjesë të shekullit XIX, ishim ne ata që i mbanim në dorë frenat e një shteti shumë të madh. Atëherë të Perandorisë së Romës, tash të Perandorisë Osmane. Mburremi që i kemi "**dhënë**" Turqisë 35 kryeministra. S'ka si të mos konkludojmë që etnosi ynë, ose më saktë, Kombi

ynë, sepse tashmë ndodhemi në fazën e krijimit të kombevet, kish në vetëvete, pra, në përbërjen e vet, një klasë pasanikësh shumë të fuqishme. Mund të përmendim me qindra: vezirë, pashallarë, komandantë të shquar të ushtrisë osmane, reformatorë të shtetit turk, tregtarë, deri në zotërimin e monopolevet në mallra shumë të rëndësishëm, që i sillnin lirat e verdha me thasë, jo në 1 vit, por në 1 javë e në 1 ditë. Si erdhi atëherë puna që sllavëvet dhe grekëvet iu dha prapë mundësia që të bënin plojë mbi Kombin tonë ?! Përgjigjja është e shkurtër: **ATA** i kishin të gatshme **strategjinë** dhe **taktikat** e tyre. (Nuk është e vërtetë që kanë filluar me Naçertanien dhe me Megaliidhenë. **Strategjitë** e tyre **ATA** i kanë shumë më të hershme.) Ne nuk i kishim as **strategjinë**, as **taktikat** tona. Ç'të themi me këtë rast?!

Marrim vetëm një aspekt, në dukje fare të vogël: **ATA**, shpeshherë duke mos pasur as bukë thatë, për të mbushur barkun, punonin me këmbëngulje për të hapur shkolla në gjuhët e tyre dhe njëkohësisht punonin edhe më me këmbëngulje për të mos lejuar ne shqiptarëvet që të hapnim shkolla në gjuhën tonë. (Le që ne s'na shkonte fort mendja te shkollat.)

A do të ndodhte kështu, nëse ne do t'i kishim pasur të përpunuara e të vëna në zbatim **strategjitë** dhe **taktikat** tona të të jetuarit **si tërësi etnike**? Pashallarët tanë kujdeseshin për haremet dhe i mbanin haremet me të gjiitha të mirat, por për të hapur shkolla, apo për t'u dhënë nga një copëz bukë bejtexhinjvet tanë të mjerë, as që e kishin në refene. Në rastet kur afroheshin luftërat, e para masë e ngutshme që merrnin pashallarët tanë, ishte evakuimi i haremit, që të mos u ndodhte gjë e keqe gravet të haremit, Allahu Mëshirëmadh na ruajttë ! Të mos u ndodhte gjë e keqe femravet, more burrë, se meshkujt bëjnë si bëjnë ! Jo femravet që pillnin fëmijë e shtonin Kombin ! Ato le t'i thernin sllavët edhe grekët ! Ato le të mbeteshin paçavure korijejet të Shqipërisë, një këtu një atje, njëra afër fëmijës së vet therur gjithashtu, tjetra ndarë fëmijësh të therur, por ngjitur e kacafytur

me përdhunuesin.

Edhe në paç kuturisir për ta shitur Atdheun, mos e shit krejt, o të njeri i pamend ! Se pastaj, ç'do të të mbetet tjetër për të shitur !? Me se do të rrosh pastaj ?! Tregohu i zgjuar, or kryeizgjuari i Dovletit ! Ta ka prurë fati që je bërë i pasur. Mendo si do ta ruash atë pasuri. Mendo si do t'ua lësh pasardhësvet të tu atë mall që e ke grumbulluar! !

Puna e parë do t'ishte, të mos e rrjepësh popullin tënd me barrë të rënda tatimesh, që kurrizi i tij të mos i mbajë dot. Kemi shembull mbretin Genc. Ai e kish ngarkuar aq shumë popullin e vet me taksa, sa, kur e pushtoi Shkodrën pretori romak, Anici, i tha parisë së vendit: *Ne do t'ju marim gjysmën e taksavet që i paguanit mbretit tuaj*. Dhe populli, qoftë edhe përkohësisht, mbeti “*më i kënaqur me pushtuesin*” se sa me mbretin e vet. Kemi shembull edhe Balshajt. Ata e patën bashkuar për një çast thuajse krejt Arbërinë. (Në të vërtetë, u bashkua vetë Arbëria me ta, se i gjeti më të përshtatshëm, pas robërisë dyshekujshe nën dinastinë serbe të Nemanjiqvet.) Por ata, Balshët, bënë budallallëqe në fushën ushtarake, pastaj, për t'i riparuar budallallëqet, ia shtonin popullit tatimet deri në atë masë, sa populli nuk mbante dot më. E humbi kështu dinastia e Balshajvet simpatinë në popull dhe u shua siç shuhet një dorëz kashte.

Puna e dytë, paralel me të parën, të cilën e kanë praktikuar të gjithë të suksesshmit e Botës, është, t'ia rritësh lavdinë vendit tend, duke grumbulluar rreth vetes filozofë, poetë, arkitektë, skulptorë, muzikantë, piktorë, historishkrues, filologë. (Të kujtojmë vetëm dukën e Vajmarit! Sa ia rriti ai lavdinë Gjermanisë, duke mbajtur rreth vetes, dmth duke financuar, krijues si Gëteja e si Shileri ?!)

E treta është: Të mos e lësh popullin pa shkollë, sepse, kur të të sulmojë ai që sulmon, popullin injorant do të ta vërë përpara e do të ta shkelë me këmbë e me thundra, si një tufë mizash të dheut.

Në Prokuple, Kurshumli, Toplicë e Kosanicë, para se të na i shkretetonin sërëbët, sigurisht që kemi pasur midis popullit edhe njerëz të kamur. Edhe ushtrues të pushtetit kemi pasur. Por ata as që i kanë kaluar nëpër mendje të këtillë parime **strategjikë**, për t'u siguruar ashtu jetë të gjatë edhe pushtetit edhe pasurisë së tyre. Ata nuk i hëngri merakun nëse populli rreth tyre ishte i varfër, ata nuk kishin hapur shkollë në gjuhën arbërishte, që njerëzit të dinin çka janë, ata nuk kishin grumbulluar rreth vetes as historianë, as poetë, as gazetarë. Mirëpo, në po ato kohë kur në Kurshumli e Prokuple dëgjohej vetëm zëri i ndonjë hoxhe gjysmëanalfabet, edhe ai zë, arabisht e jo shqip, në Beograd, pra, pak më në veri, **gëlonin** gazetarët, poetët, historianët, me rrëfimet e tyre, herë të rremë e herë të vërtetë, por që popullin sërb e kompaktësonin.

Ku janë tani ata pushtetarë e ata pasanikë shqiptarë të Toplicës e të Kosanicës?! I ka kalbur dheu! Ai dhe, i shkelur prej këpucëve me thumba të ushtrivët sërbe dhe i bërë gjurma-gjurma prej mushkavet të Sërbisë!

Edhe në Çamëri e njëjta gjë ka ndodhur, si në shekullin XIX ashtu edhe në shekullin XX. Mezi kish dalë një çam i ditur. Edhe ai, për të hapur universitet turqisht në Turqi, jo shqip në Janinë. Në Janinë Alipashë Tepelena kish hapur gjimnaz në greqisht! Mos i ndritë shpirti! Pse nuk hapi shkollë shqipe Aliu?! Alfabeti shqip ekzistonte prej shekujsh. Nuk mund të justifikohemi me “*kohën*” dhe “*rrethanat*”. Nuk mund të themi më: ***Sulltani u dha ATYRE e nuk na dha NE. Sulltani privilegjoji ortodoksët grekë edhe sllavë e ne nuk na privilegjoji, sepse konsideroheshim turq.*** Ne i kishim njerëzit tanë brenda në pallatin e sulltanit. Në qoftë se do t'u kish shkuar mendja, a nuk do të mund ta siguronin ata një copë **privilegj** për të hapur ca shkollë arnautçe në Arnautllëk? Përgjigjja do t'ishte: ***Ata ishin myslimanë dhe për myslimanët as që bëhej fjalë të kish mejtepe***

e medresera në gjuhë që s'ishin të Allahut. Kundërpyetjet e kundërpërgjigjet mund të vihen varg njëra pas tjetrës, por përgjigjja përfundimtare do të jetë prapë po ajo: Në shekujt XIX e XX ne na bënë kasaphanë fqinjët tanë dhe e vetmja mundësi e jona ishte, të vdisnim “*burrërisht*” “*pa bërtitur*”, siç thotë një nga informacionet e atyre kohëve, kur na lidhnin nga 50 vetë kokë më kokë dhe na i ngulnin në qafë bajonetat. Pika “*burrërisë*” sonë !!!

Ç’meritojnë tani ata paraardhës tanë?! Tani, që gjysmë milioni çamëve nuk u jepet e drejta as të shkelin në Çamëri, le më t’i punojnë e t’i gëzojnë tokat e veta, të bëjnë tregti, industri e detari në vend të vet, kurse një gjysmë milioni çamë ortodoksë nuk dinë as të shkruajnë shqip?! A meritojnë lule mbi varre, apo...?! Jemi velur me “*justifikimin*”: *Grekët bënë politikë kështu, sërëbët bënë ashtu... Ata kishin përkrahjen e Patriarkanës, e cila siguronte...* Po njerëzit tanë ku ishin?! Në c’g... të s... ishin futur të fuqishmit tanë të atyre kohëve?! Plot ka qenë sulltanati me **arnautë** në të gjitha kohët! Pse nuk bënë politikë shqiptare ata, që ishin më të fuqishëm se Patriarku? Nëse funksionarët anglezë, gjermanë, francezë, italianë, çekë apo polakë, që punojnë në organet qendrorë të Bashkimit Evropian, nuk do t’i shikojnë edhe interesat e anglezëve, gjermanëve, francezëve, italianëve, çekëve apo polakëve, ç’do t’u hynte në punë atyre kombeve Bashkimi Evropian?! Për çfarë na hynte në punë ne Perandoria Osmane, kur **arnautët**, nga që nuk e ngopnin dot barkun me trahana, i thurnin himne trahanasë?!

Shihni çfarë ka ndodhur në vitin 1944! Shqiptari Napolon Zerva u jep vartësvet të vet orientimin “taktik” për veprime kundër myslimanëve bashkëvendës. Ai thotë: “*Çamëvet duhet t’u afrohem* (“*Çamëvet*”)! Sikur vetë nuk ishte çam! GjD) *dhe t’i marrim me të mirë, që të mos na ikin nga duart deri sa të zëmë kufirin. Pasi t’i kemi mbyllur si bagëtitë në vathë, jo vetëm njerëz që nuk do të lëmë të gjallë, por edhe macet e tyre*

do t'i shkojmë në thikë" (Krs.L.8,2004, f.118)

Zbatimi i parë praktik i atij "*orientimi*" fillon në Paramithi. Forcat e armatosura të Zervës i afrohen natën Paramithisë nga të 4 anët. Në mëngjes vetë komandanti i trupës shkon te myftiu dhe arrin t'ia mbushë mendjen se ato forca "*nuk kishin asnjë punë me çamët*", prandaj çamët duhej t'i ulnin armët dhe të rrinin të qetë në shtëpitë e tyre. Myftiu i Paramithisë i besoi Kalit të kalbur të Trojës, dhe i udhëzoi besimtarët e vet që të mos "*provokonin*" luftë. Ndërkaq, grupe ushtarësh grekë (Ose shqiptarë ortodoksë, ne nuk e dimë cfarë ishin, GjD) shpërndahen nëpër rrugët dhe sheshet e Paramithisë, duke thirrur si tellallë: "*Urdhërohen të gjithë ata që kanë armë, t'i dorëzojnë menjëherë, se qetësinë dhe rendin do t'i mbajë ushtria. Askush të mos frikësohet. Ne ju konsiderojmë si vëllezër. Duhet të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin.*"

Dhe qorrat e Paramithisë, verbanët e mjerë, (Kujt nuk i vrerosez shpirti, kur i përfytyron?! Kujt nuk i rrjedhin lotët!?) vanë t'ia dorëzonin armët ushtrisë "*rendruajtëse*". Sigurisht, këtu e kish bërë punën e tij edhe, ndoshta i vetmi "*intelektual*" i atij qyteti, myftiu kryeqorri. Ende pa mbaruar mirë dorëzimi verbëror i armëve, ushtarët e Napolon Zervës, të shqiptarit Napolon Zerva, janë derdhur mbi popullatën me të shtëna armësh. Me të dëgjuar të shtënat, njerëzit kanë braktisur shitoret dhe ia kanë dhënë vrapit, kush këndeje e kush andej. Vritej kushdo që u dilte ushtarëve përpara. Rrugët dhe sheshet u mbushën me kufoma. Kur masakruesit u turrën për të therur një djalë 6 muajsh, e ëma e mbuloi djepin me trupin e vet. Atëherë ata ia ngulën asaj thikën në kurriz: kuptohet, therën edhe nënën, edhe foshnjën poshtë nënës. Therën edhe djalin tjetër dhe, më në fund, e shuan krejt atë familje, duke vvarë edhe të atin e fëmijëvet. Në një shtëpi tjetër shohim të theret një vajzë, pak më tej 3 djem të së njëjtës familje, 1 grua dhe 2 vajzat e saja i

kanë mbërthyer me gozhdë në një mur shtëpie. Një burrë e kanë vrrarë, kurse me të bijën, para se ta vrisnin, janë argëtuar. Dmth e kanë përdhunuar. I bukur argëtim! Aty rrotull i kanë therur ose vrrarë edhe 12 a 13 të tjerë. “***Në tërë Paramithinë***”, thuhet në një dëshmi, “***dëgjoheshin kujet dhe vajet rrënqethës, të pleqvet, të të rinjvet dhe të fëmijëvet, që i shuanin shpresat e fundit nën krismat e armëvet, nën preset e thikavet dhe nën goditjet çarëse të sëpatave***” (Krs.L.8, 2004,f.118-119)

Gjithkush mund të thotë si t’ia marrë mendja, por ne vazhdojmë të ngulim këmbë në konkluzionet tanë, nga ata më të hidhurit, që të mbeten gogël në fyt e s’të lënë të marrësh frymë. ***A dorëzohen armët në një të tillë situatë?! A ka ky popull njerëz të mençur në gjirin e vet?! A ka udhëheqës? A ka farë organizimi?*** Mirë se banorët e Paramithisë nuk mund të dinin çfarë u ka thënë Napolon Zerva vartësve të vet në Janinë. Nuk mund të dinin, sepse s’i kishin në shtabin e tij agjentët e vet, ashtu siç duhej t’i kishin. Po ngjarjet që kishin ndodhur më 1912-1913-n a aq shpejt i kishin harruar paramithiotët?! Po shportat me sy njerëzish “***dhurata***” të arbërvasësve Preluboviq, përse të mos i mbanin mend Çamëria dhe krejt Shqipëria, sado që ajo lemeri kish ndodhur para 566 vjetësh? (***Ja përse duhen shkollat!*** Nuk duhen shkollat vetëm për të ditur sa petale ka luledelja.) Një thënie e urtë ka qenë formuluar disi kështu: ***Miu mund të më kalojë pa pandehur njëherë përmbi mustaqe. Në më kaloftë herën e dytë, e kam unë fajin, jo miu.*** Po thika e shqiptarëshfarosësve sa herë na i ka çarë gjokset ne?! Po zjarret e shqiptardjegësve, sa herë na i kanë shkruar edhe shtëpitë edhe njerëzit brenda tyre?! Dhe prapë nuk paskemi mësuar të mbrohemi?! Ishim njerëz pa shkollë, po thua?! Epo mirë! Aty i kishim, rrotull nesh popujt e shkolluar. Pse nuk u shkolluam edhe ne, në mënyrë që të dinim secili jo çfarë ka ndodhur para 566 vjetësh në Janinë, por edhe para 2500

vjetësh dhe në atë mënyrë të dinim të ruheshim, edhe prej të prituravet edhe prej të paprituravet?!

Krahas kësaj, ne kemi edhe një tjetër konstatim nga ata më të hidhurit, sa, kur i kalojmë nëpër mendje, na dhemb koka gjithë natën: Në ditët kur u sakatua në atë farë feje Paramithia, ç'bënin psh lushnjarët? Po durrësakët ç'bënin? Ata ngroheshin në diell, sespe ishte fundi i qershorit. “*Ne bëmë sa mundëm*”, na përgjigjet njëri prej këtyre. “*I pritëm dhe i strehuam vëllezërit çamë në shtëpitë tona dhe në tokat tona.*” *Nuk mjafton!* u themi ne. *Duhej shpëtuar Paramithia para se të digjej, jo mbeturinat e banorëvet të Paramithisë, që mezi kishin mbërritur gjallë në Lushnjë e në Durrës! Dhe, për të shpëtuar Paramithinë, duhej të kishin menduar ME KOHË, si lushnjarët dhe durrësakët, ashtu edhe tetovarët* (që po digjeshin vetë), *bihorasit* (që po akulloheshin vetë), *edhe Isniqi, edhe Vushtrria.*

Në po atë vit, midis mijëra të tjerëvet, na u vranë, në një gështenjore në Zajaz të Kërçovës, 320 burra e djem. I kapën siç kapen qetë e parmendës dhe viçat, dhe i çuan jo në parmendë, por në thertore. Vite më vonë ish-komunistët sllavomaqedonë talleshin me ne, që kishim mbetur gjallë: *Ju i keni varrezat e dëshmorëvet atje, nën gështenja.* 3 apo 5 sllavë që ishin vranë, i kishin pëmendoret aty. Ne s’kishim ku të vinim as një tufë lule.

Rrojmë në vendin tonë. Është kohë luftërash. Është kohë **midis** luftërash. Ose është kohë **pas** luftërash, kur të gjithë e dinë se një ditë prapë do të ketë luftëra. Si ore, të mos jetë në gjendje Kombi ynë të ketë një udhëheqje unike, një fe apo ideologji udhërrëfyese, një inteligjencë të kualifikuar, një kuadër ushtarak të aftë e të gatshëm për t’u mbrojtur në mesnatë e në mesditë, një spiunazh që punon për Kombin të cilit i përket, jo për të tjerët, elementë këta të cilët të jenë në gjendje ta ruajnë Kombin të paktën prej genocidesh, në mos prej së tjerash ?!

Në vitet 1990 sërëbët na i helmuan nja 7000 nxënës

shkollash. Gjithë Bota çohet peshë kur i shikonte në televizor si përpëliteshin, si hidheshin përpjetë dhe si binin përtokë ata fëmijë. Ishte jo vetëm një torturë psikike dhe fizike, por ishte edhe një **ulje**, një **poshtërim nacional**, një e tallur me Kombin Shqiptar: ***Ja ç'mund t'ju bëjmë ne!*** S'do mend që përballë një të tillë poshtërimi duhet të ishte ngritur i gjithë Kombi më këmbë. Tiranasi, shkodranët, korçarët, vlonjatët, duhet të kishin dalë nëpër rrugë me ngulmimin më kategorik të mundshëm: ***Mos na i helmoni fëmijët, se nuk ju durojmë më!***.. Ndoshta rrethanat nuk na lejonin që të rrëmbenim armët dhe t'i binim Beogradit, por të dilnim e të shpreheshim nëpër rrugë, askush nuk mund të na ndalonte. Mirëpo, çfarë kemi bërë ne, në Korçë, në Tiranë, në Shkodër dhe në Vlorë?! Puna jonë më e dukshme ka qenë kjo: U kemi dërguar kosovarëvet, jo në Kosovë, por në Germani, njëfarë Gëzim Malaj, i cili me ***“bioenergjinë”*** e tij ua ka boshatisur xhepat prindërvet fatkeqë të atyre fëmijëve fatkeqë. Në të njëjtët vite, ushtarët grekë na i rrihnin djemtë me qyta pushkësh dhe me thumba këpucësh, kur të donin dhe ku të donin. Dhe po në ata vite, në Bari të Italisë prodhoheshin gomone nga më modernet, për të na i mbytur djemtë në Adriatik e në Jon në mënyrë sa më të ***“solistikuar”***. Në vend që të diskutonte dhe të vendoste, gjë që mund ta bënte brenda 1 jave, për të na i hequr vizat, Evropa prodhonte për ne gomone dhe motorë me sa më shumë kuajfuqi. Ne, si tërësi, pa i përzier këtu individët tanë pozitivë dhe pjesët tona pozitive, s'kishim asnjë talent tjetër, përveç ***“talentit”*** të inferioritetit. **Të gjitha të tjerat janë përralla boshe, nëse nuk je në gjendje t'i dalësh zot vetes në kohën e duhur dhe në mënyrën që të jep rezultatin më të mirë.** Së paku në atë mënyrë që nipërit e ardhshëm të mos rrinë kokulur për shkak të

pamençurivët të tua.

KËTU KA DIÇKA

Të jetosh në një vend kaq të pasur dhe të përshtatshëm për t'u bërë edhe më i pasur, dhe të jesh Kombi më i varfër në Evropë, këtu pa tjetër **ka diçka**. Të kesh qenë dikur një etni shumë e madhe, ndoshta në ndonjë periudhë më e madhja në Evropë, dhe të jesh katandisur ndër kombet më të vegjël, aq më keq, më pak të respektuar, këtu prapë **ka diçka**.

Sepse nuk mund t'i thuash vetes *i respektuar*, as *minimalisht i respektuar*, kur ai tjetri të diskuton: *T'ia njohim apo të mos ia njohim pavarësinë*? (Kosovës, asaj pjese të kombit shqiptar që vetë gazetarët apo parlamentarët e Botës mund t'ia mbajnë mend kohën kur është pushtuar prej sërbevët). *T'ia japim apo të mos ia japim vizat?! Ta pranojmë a të mos e pranojmë në OKB?! Ta pranojmë a të mos e pranojmë në BE?! (Asnjë prej këtyre pyetjeve nuk është bërë për Slloveninë!)*...

Nuk mund të quhesh *Komb i respektuar e i nderuar*, kur ai tjetri (sllavomaqedoni), para se t'u thotë fëmijëvet të vet: *Mësoni shqip!*, guxon e u thotë fëmijëvet të shqiptarëvet: *Mësoni gjuhën time!*

Ka diçka këtu dhe këtë diçka duhet vetë ne ta gjejmë e ta shërojmë.

Na zuri sh XX pa një universitet, me mbi 90% analfabetë. Është faji ynë! Lëre Turqinë në punën e saj! Ulqinakët aty e kishin Venedikun, aty e kishin Dalmacinë, që kishin shkolla e universitete dhe që flisnin e shkruanin secili në gjuhën e vet. Shkonin ulqinakët përditë në ata vende, por kur erdhi puna, e

panë veten vetëm me një Hafiz Ali Ulqinak që paska ditur të shkruajë **edhe** shqip! Të gjithë ulqinakët e tjerë, trima e detarë të zotë, por dërrasë për nga arsimi ! Ulqinakët kishin një flotë të madhe anijesh me vela e me rrema, por kur erdhi koha, nuk ditën t'i kthejnë anijet e veta në avullore, se s'dinin as ç'është avulli. Nuk ditën ulqinakët t'i kthejnë anijet në avullore, sepse e kishin lënë veten në fundin e injorancës. Kur folëm për Ulqinin, kemi folur për krejt Shqipërinë e asaj kohe.

Por nuk mund t'i thuash vetes komb i arsimuar, as atëherë kur qindra mijë pjesëtarë të tu, nuk prekin libër me dorë nga dita kur mbarojnë universitetin deri sa të vdesin. Ata janë **injorantë** më të përbuzshëm se një që nuk ka shkuar kurrë në shkollë. Kemi shumë të tillë dhe deri sa të kemi të tillë, ne do të vazhdojmë të emërtohemi: **Komb injorant**.

Në vazhdim të kësaj ideje, një njeri që mbaron 8 apo 9 vjet shkollë dhe nuk di të lexojë e të shkruajë (nuk i përdor për asgjë mjeshtrinë e të lexuarit e të shkruarit), s'ka si emërtohet ndryshe veçse: **injorant**. Një që mbahet për mysliman dhe s'e ka lexuar Kur'anin, ai mund të **quhet** mysliman, por nuk mund të **jetë** mysliman, dhe është pa dyshim një **injorant** nga më të mirëfilltët. (Kemi parë me dhjetëra shoferë që e mbajnë Kur'anin te xhami i përparmë i makinës, por që s'ë kanë hapur asnjëherë kapakun e tij.) Një katolik që nuk e ka lexuar Biblën, përkthyer në shekullin XX prej një prifti nga Kllezna, (për turp të të gjithë ilirëvet, të të gjithë arbërvet dhe të të gjithë shqiptarëvet që kanë jetuar para tij), ai katolik, pra, që nuk e lexon atë Bibël, është një **injorant**, i cili të mos shpresojë se mund të bëhet as katolik, as shqiptar ndonjëherë. Madje një që e quan veten mysliman, mund të jetë mysliman, por, po nuk i pat lexuar Biblën, veprat e Balzakut, Sen Simonin, Mark Tuenin, Darwinin, Marksit, Fojerbahun, Niçen, Bjelinskin, ai gjithsesi mbetet një mysliman **injorant**. Po kështu edhe për katolikun, le ta lexojë 5 herë Biblën, po nuk i

lexoi edhe Kur'anin, edhe librat e tjerë që u përmendën e që s'u përmendën këtu, ai sërish **injorant** ka për të vdekur.

Mund të jesh një murator i mirë, por po nuk njohe historinë e Kombit tënd, gjeografinë e vendit tënd, je pa tjetër murator, por je një murator **injorant**. Duhet ta dish mire edhe gjuhën, që të mos quhesh **injorant**. (Do ta shohim në një kapitull më vete sa keq e dinë shqiptarët gjuhën shqipe. Deri edhe profesorët!) Mund të jesh shitës i shkathtë, por po nuk dite edhe shumë gjëra të tjera, dhe jo vetëm nga ato që shikohen nëpër filma, epiteti **injorant** nuk të ndahet. Mund të jesh rrobaqepës i mirë, mund të jesh ushtarak i mirë. Në të vërtetë, nuk je as ushtarak, as shitës, as murator dhe asgjë tjetër, kur je një **injorant**. Aq më pak mund të jesh i vlefshëm për Kombin tënd, kur je kaq apo aq **injorant**.

Kur je **injorant**, nuk mund të jesh i vlefshëm për Kombin tënd, dhe këtë mund ta ilustrojmë me 1 shembull të vetëm, midis shumë shembujve të tjerë: Kur je **injorant**, ti nuk di as pse duhet të votosh, as si të votosh, as për kë duhet të votosh. Ti, në rastin e votimevet, je thjeshtë viktimë e berihavet. (S'po dinë për kë të votojnë as ata që nuk janë **injorantë**, le më ata që janë bosh fare nga njohuritë.)

Turma të tilla **injorantësh**, sado të mençur të jenë nga natyra, mund t'i rrahësh kur të duash (I mbledh gjoja për dokumenta, u fut drunë dhe i nis nga kanë ardhur.) Mund t'i shfrytëzosh me taksa e gjoja e ryshfete, si të të dojë qejfi. Mund t'i masakrosh kurdo që ta shohësh ti kohën të përshtatshme: Shpall luftë ose nuk shpall luftë fare, futesh në vendin e tyre... Le të jenë trima mbi trimat, mund t'i therësh tufa-tufa. Mund t'ua copëtosh atdheun, mund t'u marrësh për hiç gjë pasurinë nëntokësore e mbitokësore, mund t'i gënjesht në tregti. Mund t'i futësh në ushtrinë e drogëkultivuesvet dhe të drogëshpërndarësve dhe, kur s'të duhen më, t'i heqësh qafet, t'i futësh në burgje apo t'i kurdisësh që të vriten njëri me tjetrin. Mund t'ua bësh fërtele

ekonominë familjare, le më atë kombëtaren, që ata as që e njohin fare. Ku marrin vesh **injorantët** ç'është ekonomia kombëtare, ç'janë interesat kombëtarë, si lidhen ata me interesat individualë, ç'është politika kombëtare, ç'është diplomacia!.. Mjer ai Komb që shumicën e vet e ka të zhytur në kënetën e **injurancës!**

□□□□□□□□□□□□□□□□□□□□

Njeriu që e ka edukuar veten për të qenë njeri për së mbari, në çdo mbarim dite bën konkluzionin: ***Sa punova sot ?*** Jo: ***Sa ndjenja ?***, por: ***Sa punova ?!*** Dhe jo: ***Vdiqa, u rraskapita, u rropa duke punuar, më ra bretku !*** Por: ***U lodha vërtet, ama e bëra një punë.*** Në ditët kur nuk ka bërë punë, njeriu që e ka edukuar veten për të qenë njeri për së mbari, e ndien veten të pakënaqur, e kalon mbrëmjen i trishtuar dhe vendos që të nesërmen të mos e fillojë më si të djeshmen. Ky është etaloni. Sa njerëz të këtyllë kemi ne në mesin tonë dhe sa nga ata që janë e kundërta ?

Është folur në librat tanë të etnografisë për **odat e famshme** të burravet ose odat e miqvet dhe janë cilësuar ato oda si vatra të edukimit tonë kombëtar. Si shkolla, si universitete !

Intriga e parë që na imponohet, është kjo: Ikrijo ose i trashëgoi Kombi ynë ato oda, dhe mirë bëri! Po shkolla të mirëfillta dhe universitete të mirëfilltë, siç i kishin vendet e tjerë të Evropës, pse nuk bëri Kombi ynë ?! Përgjigjemi: ***Na kish zaptuar Turku !*** dhe themi: ***Mirë që i kishim ato oda, se përndryshe, ishim në rrëzik për t'u shpërbërë, për t'u dekompozuar.***

I kemi pranuar, pra, dhe i pranojmë si institucione pozitive. Janë këngët që u kënduan në ato oda, është proza popullore, janë thëniet e urta, janë gjëgjëzat, lojërat, ngjarjet historike që nuk liheshin në haresë (ndonëse gojarisht), janë mençuria dhe mprehtësia e pjesëmarrësve, që viheshin në provë në të tillë tubime. Mirëpo, në të njëjtat oda, origjinisht pozitive, kanë

depërtuar edhe jo pak elementë rriqërorë. Ta zëmë: Pirja pa kufizim e duhanit, deri në trulllosje, ose infiltrimi i mentalitetit oriental, deri te ndërrimi i emrave, jo vetëm i personave që mbledheshin në ato oda, por edhe i **heronjvet të epikës legjendare dhe të baladave**. Heronjtë e dikurshëm homerikë u bënë Mujë, u bënë Halilë, u bënë Ymeragë.

E mbi të gjitha, veçoria më rriqërore e odave tona, ka qenë kultivimi në to i mospunës, i parazitizmit, i dembelisë. Ndërsa në Zvicër njerëzit humbnin ditë, muaj e vite, për të realizuar modele orësh sa më të përsosura, ndërsa nëpër Evropë alkimistët bënë me mijëra eksperimente, për të **“shndërruar”** në flori lëndët që s’ishin flori, ndërsa një Edison bënte me mijëra prova për të krijuar llampën elektrike, nëpër odat tona gjithë natën luhej filxhanash. **Evropianët e tjerë e mësonin veten me punë, ne e mësonim veten për të ndenjur pa punë.**

Tani dalim nëpër Tiranë a nëpër Prizren, a ku të duash ti, dhe i shikojmë lokalet plot, kafiqet e famshëm, në të gjitha orët e ditës. Ditën bëjmë **“jetë dite”** nëpër bare e kafene, natën bëjmë **“jetë nate”** nëpër disko e pabe. Po kur punojmë ne shqiptarët?! A e kanë traditë shqiptarët që në çdo mbarim dite të bëjnë konkluzionin: **Sa punova sot?!**

Apo pyetjet që i bëjmë ne vetes janë: **Sa ndenja sot? Sa u kënaqa duke mos punuar, duke u argëtuar, duke kërcyer, duke tjerë muhabetë e duke sajuar marifete të pafundmë, sipër një makiatoje? Sa u mërzu, duke mos zgjidhur asnjë punë? Ose: Sa mish qengji hëngra? E shtiva apo s’e shtiva dot në dorë flanen?!**

E lidhur pikërisht me dembelizmin, si edhe me veçori të tjera negative që po i renditim këtu, është ai që ne mund ta quajmë **mizerabiliteti njerëzor**. Natyrisht, askush nuk dëshiron ta quajnë **njeri mizerabël**, por ja që, nëse është dembel, është mirëfilli edhe mizerabël. Një kryetar bashkie apo komune, i cili nuk është

tjetrin. Nganjëherë për hiçgjë, nganjëherë për plot gjëra, por, që të gjitha vijnë prej sëmundjes së rëndë të **budallallëkut**.

Një nxënës shkolle, i cili i var shpresat e notës së mirë të të kopjuarit, s'është tjetër veçse një nxënës, apo edhe student, **budalla**. Dinak, i shkathtë, por në thelbin e vet **budalla**. **Budalla**, sepse: Kush dëmtohet më së shumti në këtë mes ?! Ai vetë ! Më e keqja është që, nëse gjendet midis nxënësve dhe studentëve ndonjë që nuk e praktikon të kopjuarit, quhet ai **budalla**. Dihet se ku e çon Kombin një e tillë turmë pseudo të mençurish.

Një i ri, i cili e blen patentën e shoferit pa e mësuar mirë dhe me seriozitetin e duhur, profesionin e shoferit, është një i tillë **budalla**, të cilit ai **budallallëk** mund t'ia mbyllë jetën pa i mbushur ende të 24 vjetët. Edhe ai që e ka mësuar më së miri profesionin e shoferit, por nuk e ka përvetësuar profesionin e disiplinës qytetare, hyn në të njëjtën kategori të **budallenjvet**, ose jetëshkurtër tragjikë, ose jetëshkurtues tragjikë. Nga shumësia e të tillë **budallenjve** jetëshkurtues, të shumtën e herëvet jo vetëm të vetëvetes, njeriu i ynë i sotmi detyrohet të ulë kokën, për të mos i parë anash rrugëvet lapidarët e panumërt dhe tufat e pafundme e të kota të lulevet. *Mjerë familjet që i kanë rritur e s'i kanë më këta djem !* Themi me vete dhe nuk gjejmë dot ngushëllim. Por përfundimi, logjik dhe i ftohtë akull, është prapë po ai: **Budallai**, duke qenë e zeza e vetes, është e zeza dhe mjerimi i shumë të tjerëvet, filluar prej nënës që e ka lindur.

Një vajzë që kuturis të bëhet grua qysh 13 vjeçe a qysh 15 vjeçe, pa marrë parasysh shkallën e ngasjevet fiziologjike, s'ka si emërtohet ndryshe veçse *vajzë budallaqe*. **Vajzë budallaqe** me pasoja shumë të rënda për atë vetë, po edhe për më të dashurit e mundshëm të një femre: për fëmijët, që ajo do të lindë ose që, për shkak të një të tillë **budallallëku**, nuk ka për t'i lindur kurrë. Sa dëme i sjell Kombit një **budallalëk** i këtillë, i cili mund të jetë

cilin mund ta specifikojmë mirëfilli si një **nacionalservilizëm**. Këto vatra janë:

1. Në Çamëri, ortodoksët çamë, përfshirë bashkë me ta edhe ortodoksët shqiptarë të Janinës, Konicës, Kosturit, Follorinës etj. Njerëz të mençur, njerëz me një mençuri tradicionale, dhe përsëri: **Servilë ndaj Grekut !** Pse dreqin kështu ?!

2. Në Rekë të Dibrës, ortodoksët e asaj treve, bashkë me ortodoksë të tjerë shqiptarë, përhapur andej e këndej në shtetin maqedon dhe përzier me sllavomaqedonët. Ruajtur vetëveten në 6 shekuj të sundimit otoman, tani shkojnë e **shkrihen me Sllavin !** Pse dreqin kështu ?!

3. Një pjesë e himariotëve, një pjesë e dropullitëve (historikisht jo grekë), e tani së fundi aty-këtu edhe në ndonjë mjedis tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, hapur, **për fëmijët shqiptarë**, psh në Korçë, **shkollë greke !**

4. Treva e Tivarit, ku strumbullari i këtij **nacionalservilizmi** janë katolikët e Shestanit, influenza e të cilëve dalëngadalë po shtrihet edhe në ndonjë fshat të Ulqinit. Edhe këta, ruajtur 4 shekuj prej sundimit otoman, shkojnë e shkrihen me malazezët, madje duke e ditur që Malazezi nuk i do.

5. Treva myslimane e Plavës, bashkë me pjesë të tjera myslimane shqiptare në Rozhajë e në Sanxhak, po edhe në Tivar e Podgoricë. Janë bërë dikur **muhamedanë**, tani bëhen, për nga gjuha, **sllavë**, dhe s'dinë si ta quajnë veten: Turq, malazezë, boshnjakë, apo thjeshtë myslimanë, (duke e konsideruar veten më farefis me arabët se me shqiptarët).

6. Në Prizren, në Tetovë dhe në ndonjë qytet tjetër tonin, ka pasur ose edhe ka grupe banorësh që ende e quajnë veten turq (**servilizëm i trashëguar**). Këta, kur Sllavomaqedoni kërkon të ngrejë shtatoren e Aleksandrit të Madh në Shkup, për të qenë të **“barabartë”** me Sllavomaqedonin, i thonë: **Duam të ngrejmë**

edhe ne një xhami në sheshin e Shkupit.

7.Në të gjithë skajet e Shqipërisë: **Mijëra tabela hotelesh, dyqanesh e lokalesh në gjuhët perendimore ! S'të vjen të hysh në qytetet tanë! Të neveritet Atdheu, mbuluar puçrrash e dregëzash të servilizmit pa nevojë!**

Në diasporë, numri më i madh i shqiptarëve të infektuar me këtë lloj **servilizmi specifik**, ndodhet **në shtetin turk**. Aty, sipas disa të dhënave të publikuara, ka shumë milionë shqiptarë, të cilët regjistrohen si turq, shkollohen në shkollat turke, nuk kërkojnë shkolla shqipe dhe gradualisht vijnë duke u shkrirë me turqit. E njëjta sëmundje e **servilizmit, e kameleonizmit**, është tashmë e përhapur në të gjithë diasporën tonë anembanë Globit, aq sa në mjaft raste krijohen edhe skena tragjoko-komike: Kushërinj të parë apo të dytë, njëri flet greqisht, tjetri italisht, i treti anglisht, i katërti gjermanisht. Asnjëri nuk di shqip, sepse prindët e tyre, jo vetëm kanë qenë **miopë, injorantë, dinakë dhe të trashë mendërisht**, por edhe **servilë** nga më konformuesit, **kameleonë** të mirëfilltë. Kameleoni është kafsha më servile ndaj natyrës. Ai i përshtatet çdo lloj ambienti, por kurrë nuk mund të quhet **kafshë e bukur**.

Pikënisjet e këtij lloj **nacionalservilizmi** ndër shqiptarët (sepse atë e kanë në shkallë të ndryshme edhe kombe të tjerë), janë disa llojesh: E para pikënisje është **përkatësia fetare**. Myslimani shqiptar e ka ndjerë veten fetarisht të njëjtë me turkun dhe e ka quajtur **“të nevojshme”** të barazohet me të **edhe nacionalisht**. (Pa e **“ditur”** që arabosauditi është mysliman, por nuk është turk.) Në krahun tjetër, myslimani shqiptar e ka ndjerë veten fetarisht të njëjtë me boshnjakun sllav dhe e ka quajtur edhe ai **“të nevojshme”** për t'u sllavizuar. Ortodoksi i Çamërisë, duke qenë i së njëjtës fe me grekët, e ka ndjerë veten **“më të afërt”** me grekët se sa me bashkëkombësin e tij mysliman. (Pa e **“ditur”** që edhe bullgari është ortodoks, por nuk është

grek.) Në periudha të zeza të historisë sonë, ky dallim fetar, ka arritur të shndërrohet edhe në tragjedi, të cilat për “*dekor*” kanë pasur dhe kanë pellgje gjaku që nuk thahen kurrë. Ortodoksi i Rekës është i së njëjtës fe me Sllavin e Maqedonisë. Duke mos pasur kishë autoqefale me liturgji në gjuhën shqipe, siç nuk i kanë as ortodoksët tanë të Jugut, në Çamëri, Janinë e gjetkë, ashtu edhe ata në shtetin maqedon, por edhe ortodoksët e krahut të Kuçit, sipër Podgoricës, apo dy-tre fshatra të Shestanit, u janë mbështetur në mënyrë **servile** fqinjëvet të tyre joshqiptarë. Ulqinaku i fesë myslimane edhe sot, kur rastis që e fejon vajzën me një sllav të Sarajevës, shkëlqen prej gëzimit dhe mburret përpara të gjithë fqinjëvet: *E fejova vajzën në Sarajevë!* Ndërsa në rastistë që vajza t’i dashurohet me ndonjë djalë vendi, por të fesë katolike, asaj familjeje i nxin fytyra dhe bën çmos për ta prishur atë dashuri. Katoliku i Shestanit ka mbetur si peshku në zall dhe nuk di nga t’ia mbajë, sepse me pjesën myslimane nuk bën dot krushqi. Në anë tjetër, malazetë, përveçse kanë pushtetin, janë edhe të krishterë.

E njëta “*filozofi*” po e udhëheq edhe sot atë pjesë të himariotëve që po duan ta quajnë veten grekë. “*Himara është kriqi!*” bërtiste mu përpara kamerës njëri nga ata himariotë, miopë edhe servilë, njëkohësisht edhe i trashë mendërisht. Fjalët që thuhën se në Shqipëri ka harmoni fetare, janë vetëm pjesërisht të vërteta. Ato janë prodhim fatlum i mendjevet të ndritura të rilindësve tanë, një modus vivendi i pazëvendësueshëm, por, në vazhdoftë Greku të na prishë varret, në vazhdoftë Islami të na përdorë si “*avanpost*” për të “*islamizuar*” Evropën, në vazhdoftë Evropa të na ngjyrosë me “*ngjyrë jeshile*”, ne, o duhet të kemi mendjen dhe guximin **antiservil, antikameleon**, të Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe të Rilindësve, o do të pësojmë disfatën më të madhe në histori, këtë herë të pariparueshme.

Pikënisja e dytë e servilizmit tonë nacional është **përkatësja shtetërore**. U pushtua, siç dihet, pjesa më e madhe e Shqipërisë prej shteteve fqinjë. Shqiptarët që mbetën të pushtuar, në një pjesë të madhe, pandehën se kështu do të mbeten përgjithmonë. Ashtu siç ndodhi edhe në kohën e Turkut, kur pjesa më e madhe e arbërvet pandehën se Turqia do të jetë “*e përjetshme*” dhe thanë: ***O burra të bëhemi myslimanë !***, ashtu ndodhi edhe me këta që, në vitin 1913, mbetën jashtë shtetit shqiptar: ***O burra të bëhemi grekë ! O burra të bëhemi malazezë ! Kush të na vijë këtu, ne bëhemi si ai !***. Njohim bashkëkrahinas tanë, të cilëve malazezët ua kanë vrarë të afërmit ose ua kanë djegur shtëpitë, e këta jo vetëm që janë regjistruar “*malazezë*”, por mundohen të mburren se janë “*malazezë*”. Mirëpo, të tjetërsohesh në pikëpamje nacionale, mund të të duket punë e lehtë në fillim dhe mund të të duket një punë e levërditshme. Por më vonë, një i tillë **servilizëm** aq naiv, do të të shpërblehet me situata jashtzakonisht të papëlqyeshme. Në mos te vetë ti që e ke bërë “*kthesën*”, doemos te pasardhësit e tu. Pasardhësit e atyre që, duke gjykuar tepër cekët, e kanë filluar denacionalizimin (duke mos u shkolluar në gjuhën amëtare, duke ndryshuar formën e mbiemrit e të emrit, duke u regjistruar tjetër për tjetër etj), do të ndodhen në pozita tepër të vështira, sepse, nga njëra anë, do ta shohin që pala thithëse nuk i pranon si pjesë të vetën, e nga ana tjetër, duke mos zotëruar gjuhën e të parëve të vet, e kanë shumë të vështirë të rikthehen te vetëvetja. Jo vetëm kaq, por vetë ata, duke qenë tash brez më i ndërgjegjshëm e duke mos qenë **servile e kameleonë** si paraardhësit, gjithsesi e ndiejnë veten keq dhe kërkojnë të rikthehen në origjinë. Piktori i madh Abedin Dino, ndonëse ishte shqiptar, nuk dinte të fliste shqip. Dinte turqisht, dinte frëngjisht, dinte rusisht, por shqip nuk dinte. Ai donte të vinte e të hapte ekspozitë në Shqipëri, donte edhe t’i ndihmonte materialisht piktorët shqiptarë, por s’i bëri dot as

njërën, as tjetrën. Në Turqi i ka 3 monumente, në Shqipëri asnjë.

Ka, në anë tjetër, edhe të atillë që, duke e ditur që nuk janë çfarë deklarohen, mundohen në çdo rast të ekspozohen si të tillë. Në kohën e Romës kish ilirë të atillë që shiteshin më romakë se vetë romakët. Në kohën e Mesjetës një shumicë arbëresh, ose tregoheshin më grekë se grekët, ose, kur i sundonin sllavët, më sllavë se vetë sllavët. Në kohën e turkut pat arnautë “*turq*”, më të thekur se vetë turqit. Ata bënëin kërdrinë mbi arbërit, mbi kombin e vet, për t’iu rrëfyer bashkëvendësve si më i fuqishmi i të fuqishmëve: ***Ja kush jam unë!*** Historia është e mbushur plot me mizori të arbërve të turqizuar mbi pjesën tjetër të arbërve që nuk i nënshtroheshin pushtuesit. Kur erdhën prapë sllavët edhe grekët, dolën përsëri bastardë me shumicë prej Kombit tonë. ***O burra, kush bëhet më sërë se sërë! O burra, kush bëhet më grek se greku!***

Pikënisja e tretë e natyrës **servile** të shumë shqiptarëve na shfaqet te **pushtetarët**. Pushtetarët tanë, sapo arrijnë të zënë ndonjë post (Jo të gjithë, natyrisht, se do të na kish marrë lumi me kohë) shtyhen kush e kush të tregohet sa më “*i përzemërt*” dhe sa më “*i sinqertë*” me të huajtë. More, le të jetë ai i huaji një zorrë! Ky dëshiron t’ia shprehë mikpritjen në shkallën më të lartë të mundshme. E ka me gjithë mend. Se, ta ketë për diplomaci, gjysma e së keqes. Ai i huaji, vetëkuptohet që do të përpiqet të përfitojë sa më shumë prej “*përzemsisë*” së këtij lloji shqiptari. Pikërisht këtu shfaqet edhe ana më fatale e një të këtillë vetie! “*I përzemërti*” shqiptar nuk mund t’u bëjë ballë kërkesave të të huajit dhe ndodh ashtu falja, dhurimi për hiç gjë i interesave të Atdheut dhe i pasurive të Kombit! Mjafton t’i japë ai i huaji, për të cilin dihet se nuk është budalla, pushtetarit tonë, **si person, privatisht**, një dhuratë të majme dhe: Iku koncesioni! E mori koncesionin i huaji më me levërdi se në cilindo vend tjetër!

Servilizmi i katërt, karakteristik për ne shqiptarët, është **servilizmi gjuhësor**. Servilizëm skandaloz! Po japim 2 shembuj

për të ilustruar këtë që thamë:

1.Një malaziasë 54-vjeçare, lindur, rritur dhe gati plakur në Ulqin, nuk di fare të flasë shqip. ***Pse kështu?*** E pyesim ne. ***Sepse***, thotë ajo, ***nuk jam interesuar që ta mësoj. Shqiptarët, me të cilët kam pasur kontakt qysh fëmijë dhe më vonë si nëpunëse, kanë folur gjithmonë me mua në gjuhën time, prandaj dhe, me thënë të drejtën, nuk e kam ndier nevojën për ta mësuar gjuhën e vendësvet.***

2.Një shqiptare, me prejardhje nga Shestani, lindur e rritur në Tivar, është martuar në një familje shqiptare në afërsi të Ulqinit. Familja ku është martuar ajo, flet rregullisht shqip. Në fshatin ku është martuar ajo, nuk ka asnjë familje sllave. Kanë kaluar 6 vjet nga ardhja e saj në këtë familje dhe në këtë fshat, dhe nuk ka “*mësuar*” ende të flasë shqip. Nuk pranon të flasë shqip as me të shoqin, as me vjehrrën, as me bashkëfshatarët. Ka 2 fëmijë dhe nuk u flet shqip, por sllavisht. Për të mos ia prishur qejfin nuses, edhe plaku e plaka u flasin 2 nipërve sllavisht. E pra, gjyshja dhe nëna e asaj nuseje, para se të zbrisnin në Tivar, nuk kanë ditur as edhe një fjalë sllavisht. Krejt familja e saj, ku ajo ka lindur, është një familje thjeshtë shqiptare. Ajo familje e ka futur në përdorim gjuhën sllave thjeshtë për **servilizëm**, për **konformizëm**, nga sëmundja jonë (s’ dua të them: e pashërueshme) e **kameleonizmit**. Ndërkaq kjo, bija e asaj familjeje, vazhdon me zell të madh ta kultivojë gjuhën e huaj edhe te fëmijët e vet, duke përbuzur në mënyrë skandaloze gjuhën e të parëvet të vet. Ç’të thuash tjetër për **servilizmin** tonë në fushë të gjuhës?!

Illirët, edhe para se të na ketë pushtuar Roma, e kanë **pasur** fjalën **pulë**. Nuk ka mundësi të mos e kenë pasur fjalën **pulë**, sepse pulat janë mbajtur ndër ne edhe para Romës. Por të parëvet tanë u ka pëqyer më shumë fjala e huaj dhe e kanë harruar fjalën e vet. Skandal! Edhe fjalën **qiell** e kanë pasur. Edhe fjalën **kalë** e kanë pasur. Pse i ndërruan?! Pse nuk e dimë ne si u kanë

thënë të parët tanë **pulës, qiellit** edhe **kalit**? Erdhën turqit dhe duhej pa tjetër t’u **serviloseshim** edhe atyre, duke folur si ata. Tani ne, pasardhësit e arbërvet, nuk dimë si ta shprehim ndryshe gëzimin, veçse në gjuhën arabo-turke: *Shyqyr!* Edhe kur na pëlqen diçka, jemi të detyruar prapë të shprehemi arabo-turqisht: *Mashallah!* Sidomos, kur dalim nëpër Tiranë a nëpër Prishtinë dhe kur shikojmë morinë e tabelavet të dizajnuara aq bukur në gjuhën **angleze**, nuk mund të mos themi “*gjithë entuziazëm*”: *Mashallah na qoftë!*

Sapo i kthjem sytë nga Evropa e nga Perendimi, puna e parë e jona ishte: *Të prishim gjuhën shqipe!* Për këtë nuk mund të themi se është **servilizëm**, sepse askujt nuk po i shkon mendja t’i shikojë e trajtojë ndryshe ata shqiptarë që nuk flasin shqip e ndryshe ata që e ruajnë gjuhën e vet. Ky është më shumë **budallalëk** se sa **servilizëm**. Madje duhet të dimë që të huajtë, kur vijnë në Tiranë, në Shkup apo në Prishtinë, më shumë do të donin të shihnin tabela shqip se sa në gjuhët e tyre. Pra, Nuk është kjo puna e prishjes së gjuhës shqipe as **budallallëk**. Është **hajvanllëk**.

Servilizmi, kameleonizmi, injoranca, budallallëku, hajvanllëku, janë shkrirë në Kombin tonë tragjikisht më një. Si do të mund të dalim këndej?!



E mban shqiptari anglezin në shtëpi. 2 familjet afrohen e duhen, e duan njëri-tjetrin, sikur të ishin farefis. Arrijnë deri në shkallën sa anglezi ta konsiderojë shqiptarin si vëlla. Më në fund, pa kurrfarë faji nga ana e anglezit, shqiptari kurdis “*planin*” dhe e **vret** mikun mu në shtëpi të vet. E vret dhe përpiket që ta fshehë kufomën. Një i këtillë kriminel monstër nuk turpëron vetëm veten, por turpëron krejt familjen, turpëron fisin, turpëron ambientin ku ky monstër ka jetuar dhe ku është formuar si

kriminel, turpëron edhe Kombin, të cilit i përket.

I lakmojnë shokut të vet, bashkëfshatarit të vet, një zinxhir floriri. Duan t'ia marrin. Përse t'ia marrin?! Përse duhet t'ia marrësh atij tjetrit atë që s'është e jotja?! I zoti i zinxhirit nuk e jep zinxhirin. Ata e **mbytin me gishta e me thonj**. E mbytin dhe e hedhin në lumë. Po përsëritim prapë atë që thamë më parë: Turpërojnë familjet, turpërojnë krahinën, turpërojnë Kombin.

Këtu kemi 2 gjëra që duhet të sqarohen:

1.Krimineli nuk di ç'është turpi. Turpin e mban në fytyrë ambienti, në të cilin rritet krimineli.

2.Ai komb, në përbërjen e të cilit rastet e krimevet janë të rrallë, nuk mund, nuk ka arsye që të emërtohet si komb kriminelësh. Por kur krimet përsëriten njëri pas tjetrit, kur s'e kalon dot një natë pa dëgjuar për ngjarje të përbindshme, atij ambienti, ku të tillë përbindësia rriten, atij kombi ku edukohen, qoftë edhe vetedukohen, të tillë përbindësia, nuk mund të mos i vihen edhe epitete tepër të rëndë: ***Ky është një ambient kriminelësh! Ky është një komb kriminelësh!***

Me këtë rast, qoftë edhe vetëm me ato ç'kemi lexuar **në faqet e këtij libri**, që s'janë as e dhjetëmijëta pjesë e të tilla kronikave, ne nuk mund të mos konstatojmë që **edhe kombet përreth nesh** e kanë merituar një emërtim të tillë: ***Kombe kriminelësh!***

Mirëpo, midis kriminalitetit në popujt që i kemi këtu rrotull dhe kriminalitetit në Kombin tonë, ka dallime shumë të dukshëm.

1.Ata e planifikojnë krimin **shtetërisht** dhe e kryejnë në momentet që u përshtaten atyre më së miri.

2.Ata mundohen dhe, ndonjëherë, si në rastin ndaj nesh, ia arrijnë që objektin e krimit ta kenë jashtë kombit të vet.

3.Ndryshe nga ne, ata ia arrijnë që në sytë e Botës të mos klasifikohen si kombe kriminelësh.

4.Ata, me anë indoktrinimesh sistematikë e shumëvjeçarë, prodhojnë brenda vetes mijëra kriminelë, mirëpo veprat e

donin të dinin që kështjella kërkon **sakrifica**. Shteti nuk krijohet dot dhe nuk mbahet dot më këmbë pa **sakrifica**. Kushti është që secili prej pjesëtarëve të aftë për punë, apo edhe për luftë, të jetë i gatshëm **për t'u sakrifikuar**. Ky është kushti: ***Të kuptojnë pjesëtarët e një bashkësie: që janë bashkësi dhe që bashkësia nuk mund të qëndrojë, po nuk pranoi, sinqerisht, secili prej tyre, që të bëjë, jo me fjalë, por praktikisht, me vepra, sakrificën që i takon.***

Pesha potenciale e **sakrificës** individuale është e shkallëvet të ndryshme. Ajo mund të konsistojë thjeshtë në zbatimin e orarit të punës, në lodhjen gjatë punës, në veçimin e një pjese të fitimevet për tërësinë (kuotizacionet, tatimet, taksat, donacionet), por në një shumicë rastesh pesha e **sakrificës** individuale në interes të bashkësisë mund të bëhet shumë shumë e madhe: Mund të arrihet deri atje, sa t'i kërkohej individit që të japë edhe jetën. Madje mund t'i kërkohej individit që të japë, për interes të bashkësisë, edhe më shumë se jetën: Të sakrifikojë gruan e t'i lërë fëmijët jetimë. Ose të sakrifikojë edhe fëmijët.

Balada, duke u marrë pikërisht me këtë kulm të kërkesës për sakrificë, thotë që të 3 vëllezërit pyetën një njeri të shenjtë dhe ai ua tregoi mënyrën se si mund të ndërtohej kështjella dhe si mund të qëndronte më këmbë ajo kështjellë. Ata duhej, në radhë të parë **të lidhnin besën për të qenë të sinqertë** ndaj njëri-tjetrit, pastaj sakrificën ta bënte ai, të cilit do t'ia sillte fati. Njeriu i shenjtë u tha që njërit prej tyre, qysh të nesërmen, do t'i duhej të sakrifikonte gruan e vet, nënën e fëmijës së vet.

Marrë në veçanti, pesha individuale është vërtet tepër e rëndë, por pesha kolektive e sakrificës s'është më shumë se 17%. Ata janë 3 vëllezër dhe kanë secili nga 1 grua. Dmth janë 6 pjesëtarë, njërit prej të cilëve i kërkohej për t'u sakrifikuar. Fëmijët edhe pleqtë nuk kanë detyrime të vetëfljohen.

Vëllezërit ia dhanë fjalën njëri-tjetrit se do t'ishin të sinqertë,

por 2 prej tyre nuk e mbajtën fjalën. Ata u treguan gravet të veta, gratë gjithashtu u treguan të pasinqerta me kumatën dhe, në fund, sakrificat nuk u bë me **“urdhër”** të fatit, por me **hile**. U muros nusja e vëllait më të vogël. Ajo la fëmijën e vet jetim. Kështjella u ndërtua, por e gëzuan të pasinqertët, ata që nuk e meritonin. E gëzuan **hileqarët**. (Do të mund të cilësoheshin edhe me fjalë më të ashpra, por ne po ndalemi në kaq. Po i quajmë vetëm **hileqarë**.)

Po të merren të 6 pjesëtarët si 100% të njerëzvet që u takonte për t'u sakrifikuar, del që 4 prej tyre, 66,6%, ishin **hileqarë**, të cilët kërkonin të rronin në kurriz të vëllait të vet. Vetëm 33,3% qenë të gatshëm për të bërë sakrificë. E bënë sakrificën dhe prandaj u ndërtua kështjella.

U ndërtua kështjella, qëndroi kështjella, por ne shqiptarët (sepse balada është e jona) duhet ta kuptojmë (natyrisht, në mënyrë të figurshme) që, qysh në ato kohë të largëta, **këto kështjella apo kështjellëza të Kombit tonë i ka mbajtur më këmbë sakrificat e madhe e vetëm 33,3% e pjesëtarëve**. Dhe duhet të kuptojmë kështu që, po të kishim më pak **hileqarë** në gjirin tonë, nuk kish pse të ishim sot vendi më i varfër në Evropë dhe vendi ku vetë ne nuk gjejmë ëndje për të jetuar.

Ne duhet të pranojmë që 66,6% e Kombit tonë nuk është përmirësuar ende, sepse, po t'ish përmirësuar ky 66,6%, ne nuk do të iknim prej vendit tonë. Do ta gjenim **këtu** punën, do ta krijojmë **këtu** pasurinë dhe do t'ishim të kënaqur **në shtetin tonë, në qytetin tonë, në fshatin tonë**.

Jemi pra, gjithnjë konvencionalisht, 66,6% e Kombit tonë njerëz **jo të sinqertë**. Jemi vetëm 33,3% njerëz të punës serioze në dobi jo vetëm të vetëvetes, por në dobi edhe të Atdheut. Jemi madje 33,3% njerëz të mrekullueshëm, nga më të mirët që ka njerëzimi. Por kjo nuk është e mjaftueshme. Kjo shifër na lë ne shqiptarëve gjithë jetën mu në fund të Botës.

Mjafton të kesh **hileqarë** 66,6% të parlamentit, të atillë siç ishin 2 vëllezërit më të mëdhenj te balada jonë, dhe krejt punët e shtetit, edhe të Kombit, të na shkojnë së prapthi. Mjafton të kesh **hileqare** 66,6% të administratës... Mjafton të kesh **hileqarë** 66,6% të gjykatësve, mjafton të kesh **hileqarë** 66,6% të policëveve, të kontrolluesve, të tatimbledhësve, të doganierëve, të tenderuesve, të përmbaruesve, të dritëfaturuesve dhe të dritëpaguesve...

Kështu, duke e marrë si më realen shifrën 10 milionë të shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri, pa futur këtu diasporën, na del shifra e hidhur që 6 milionë e 666 mijë prej nesh jemi **hileqarë** dhe vetëm 3 milionë e 333 mijë jemi shqiptarë të devotshëm.

Kjo shifër është vërtet e ashpër. Ky konstatim është vërtet i rëndë. Asnjëri prej nesh nuk dëshiron të jetë pjesë e këtij 6 pikë 666 milionëshit... Madje secili mund të mendojë që i takon ajkës së Kombit, atij 33,3-përqindëshit.

Por ne **nuk jemi të detyruar t'i besojmë baladës**. Janë sondazhet dhe statistikat ato që mund ta bëjnë verifikimin. Sa vëllezër kemi që ua bëjnë me **hile** vëllezërve të vet? Vëllezër që nuk flasin njëri me tjetrin, vëllezër që rrihen e që edhe vriten. Jo për një gardh, siç thuhet shpesh nëpër gazeta, por për një **hile**, për **mungesë sinqeriteti** vëllazëror! Sa gra ka që ua bëjnë me **hile** burrave? Sa burra ka që ua bëjnë me **hile** nënavet të fëmijëve të vet? Ua bëjnë me **hile** dhe i detyrojnë të heshtin, se kërcet druri! Sa fëmijë nuk duan të jenë mirënjohës ndaj prindërve? (Për aq sa kanë mundur të bëjnë prindët për ta!) Po sa burra "**zot shtëpie**" ka, që gjysmën e të ardhurave të familjes i lënë nëpër restorante e klube, ndërsa gratë e fëmijët e tyre ushqehen me bukë thatë e me gjizë?!

Sa punëtorë kemi, në shkallë Kombi, që punëdhënësi të mund t'ua japë punën në mëngjes dhe të mos ketë frikë se do t'ia kryejnë keq? **Punëtorëvet tanë duhet t'u rrih gjithë ditën**

mbi krye dhe prapë s'ta bëjnë punën ashtu si duhet, thonë punëdhënësit. Sa zyrtarë kemi që i kryejnë punët e veta pa **hile**, qoftë ndaj shtetit, qoftë ndaj vartësve apo eprorëve, qoftë ndaj publikut? Sa zyrtarë kemi që nuk pranojnë ryshfet? Sa zyrtarë kemi që nuk japin ryshfet, kur kërkojnë punësim? Sa zyrtarë kemi që nuk bëjnë makinacione, dmth **hile**, duke shfrytëzuar vendin e vet të punës? (Nëse do të rrinim këtu të numëronim llojet e makinacioneve, nuk do të na mjaftonte 1 libër) A kemi administrata **hileqarësh** apo kemi administrata njerëzish të sinqertë? Sa policë, rrugorë apo të llojeve të tjerë, kemi që janë mirëfilli policë e jo ryshfetxhvatës? Sa gjykatës kemi që janë mirëfilli gjykatës? Më në fund, ministrat e kryeministrat shqiptarë, a janë udhëheqës të ndershëm e të devotshëm në shërbim të Kombit tonë, apo janë të atillë që historiografia do të detyrohet t'i cilësojë **negativë**, siç ka ndodhur në shumicën e rasteve?!

Ky është testi, i cili na jep përgjigjen: Jemi një komb **hileqarësh** apo jemi një komb njerëzish **dinjitozë**?!

NJË DIARE KRONIKE

Është vetëm një aspekt, por është shumë domethënës dhe imponues për t'u ndalur, si një ferrë që të tërheq për rrobash. Në shqip i thonë: *barku i keq*. I thonë edhe *skurlë*. Sidoqoftë. Është sëmundje e bezdisshme, e cila, psh në raste kolere, mund të marrë përmasat e një këdie.

Këtu, fjalën *diare* (ndryshe: *bark i keq*, *heqje barku*, *bizgë*, *skitë*), në lidhje me dukuritë e të quajturave *radhë*, që shqiptarët janë të vetëdetyruar t'i përjetojnë, veçanërisht brenda Republikës së Shqipërisë, thuajse në çdo punë që kërkon njëfarë organizimi, afërmendsh, nuk po e përdorim me domethënie e saj të drejtpërdrejtë, por me kuptim të figurshëm. Për mirësjellje, mund t'i quajmë "*radhë*", por në të shmtën e rasteve ata janë **grumbuj** amorfë me karakteristikat e një kopeje të çfarëdoshme. Po numërojmë disa prej tyre, ndonëse ato mund të shfaqen edhe në shembujt më të paparashikueshëm.

Në Kohën e Enverit, diare të tilla sociale kishte në stacionet e autobusëve. Duhej të çohesh në orën 3 të mëngjesit, të zije gjoja radhën për të marrë biletë, të shtyheshe deri sa të të mbulonin djersët nga koka deri në fund të këmbëve, të të griseshin xhaketa dhe këmisha dhe në orën 6 ose 7 mund të ktheheshe në shtëpi pa marrë biletë. Ose do ta merrje biletën, duke u munduar të harroje adhapin e madh që kishe hequr. Ka qenë te Sahati stacioni I autobusëve të Tiranës. Por të tilla "*punishte zhgënjimi*", nacional edhe shtetëror, kishte në çdo qendër rrethi. Në Kohën e Enverit të tilla "*diare*" përjetonte

populli edhe atje ku shitej qumështi, edhe atje ku shitej gjiza, edhe atje ku shiteshin bukë të sapodala nga furra, edhe në ditën e fundit të dhjetorit, kur dilte ndonjë artikull (mish, verë, fruta), të cilët u duheshin njerëzvet për të festuar Vitin e Ri. Të dilnin për hundësh, edhe Viti i Vjetër, edhe Viti i Ri.

Sot, mbasi Epoka e Enverit ka perenduar në moskthim, i njëjti fenomen i “*diarësë*” gjithpërfshirëse është po aq i neveritshëm. Në dyert e ambasadavet, grumbuj të përditshëm, turma njerëzish që flënë atje në mes të rrugës (përveç fundjavës, kur **padronët** pushojnë). Në zyrat e gjendjes civile, sidomos kur vijnë emigrantët për pushime dhe lodhen këtu më shumë se ç’lodhen 11 muaj atje ku janë degdisur. Në ambientet para Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në libraritë në çdo fillim viti shkollor.

Në sekretaritë e universiteteve. Në pikëkalimet kufitarë, aq sa të huajtë na ironizojnë: *Erdhëm në Shqipëri! Këtu duhet të kesh nerva të fortë*. Grumbuj, ku gjendet një rubinet uji. Grumbuj në zyrat e kadastrës. Grumbuj ku paguhen dritat. Grumbuj ku merren pensionet. Grumbuj, jo radhë, por turma qeniesh pa dinjitet, përpara Stadiumit “Qemal Stafa”. Atje policët dinë të rrahin, por nuk dinë të vënë rregull.

Çfarë duhet të bëjnë shqiptarët, për të shpëtuar nga kjo “*sëmundje zorrësh*”, kaq e bezdisshme?! Mos duhet një ministri e posaçme?! Ku ta vëmë? Pranë Ministrisë së Kulturës, pranë Ministrisë së Arsimit, pranë Miniastriisë Rendit, apo përballë ndonjë spitali të sëmundjeve nervore? Diçka duhet!

I kanë edhe popujt e tjerë të këtilla sëmundje, që i sjell anarkia në administratë, por ata, sidoqoftë, ia kanë arritur t’i zgjidhin secili në mënyrën e vet. Vetëm ne kemi mbetur duke mbajtur brekët në duar.

A MUND TË SHPRESOJMË ?!

Shqipëria është një vend që, të paktën në ditët tona, nuk mund të përfytyrohet dot, nga njëra anë, **pa ushtarakë të huaj**, nga ana tjetër, pa ushtarakë vendës, që janë 2 kategorish: ose të korruptuar (dmth të dëmshëm) ose të pavlefshëm (prapë të dëmshëm).

Atje ku pjesë të Shqipërisë ndodhen në përbërje të shteteve joshqiptarë apo të shteteve gjoja edhe shqiptarë (shteti grek, shteti maqedon, shteti serb, shteti malazias), është dukuri “*e natyrshme*” të shohësh gjithandej policë dhe ushtarakë të huaj. Në Tivar, në Manastir, në Janinë, në Preshevë, ushtarët dhe policët e huaj janë zotër të padiskutueshëm. Shqiptarët aty s’bëjnë as gëk as mëk. Edhe kur tentojnë, si psh në Preshevë, të armatosurit e huaj hyjnë nëpër dhomat e gravet tona si në kotecin e pulavet.

Por as Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, nuk zunë dot karar pa forca ushtarake të huaja. Kosova, pa llogaritur Anamoravën, më 2009-n kish 15000 ushtarakë të huaj dhe mbi 2000 policë të Euleksit. Republika e Shqipërisë, më 2007-n, 95 vjet mbas Shpalljes së Pavarësisë, pat nevojë për 7000 trupa të huaja. Ftesën ua bëri Bashkim Finoja. Por edhe në kohë të tjera, ushtarakët e huaj vërdallë i kemi pasur dhe i kemi: “*Pelikani*”, Guardia di financia, NATO-ja, instruktorë e inspektorë gjithfarësh...

Përballë një të këtillë së vërtete, shqiptarët duhet detyrimisht të pyesin: ***Ç’popull qenkemi ne, që u dashka të rrojmë nën koburet e të tjerëvet?! Izraelitëvet, moldavëvet, zviceranëvet,***

luksemburgasvet, sllovakëvet, Qipros Greke, sllovenëvet, kroatëvet, armenëvet, gjeorgjianëvet, a uparaqitet domosdoshmëria për t'u sunduar prej policëvet të huaj? Tokat e atyre kombeve, a kanë nevojë për t'u mbrojtur prej ushtrivet të huaja?

Ky është, pa dyshim, **njëri prej turpevet tanë më të rëndë**. Por, a e njohim këtë lloj turpi ne shqiptarët? A e ndiejmë ne shqiptarët sa poshtërim, sa ulje, sa injorim na bëhet, secilit prej nesh, kur një pordhac sërb, malazez, sllavomaqedon apo grek, vjen e na fryhet me kobure pas bythës nëpër rrugët e rrugicat e vendbanimevet tanë?!

Jemi vërtet fajtorë! Jemi fajtorë ndaj vetëvetes! Secili prej nesh duhet sërish të reagojë tepër seriozisht, jo duke u shfytyruar e duke bërë “*trimëri*” një këtu e një atje, por duke kërkuar mënyra të mençura, që Kombit tonë të mos i ndodhë më kështu në të ardhshmen.

Nuk po duam ta banalizojmë problemin, por, kur kemi qenë nxënës, shpeshherë na shkante mendja: Ne fëmijët, a nuk mundkemi të rrimë urtë **vetë**, të mos hidhemi si të marrë e të mos çojmë kaq shumë pluhur, sa të na mbushen mushkëritë plot me baltë?! Pse u dashka të na qetësojë mësuesi, me thupër apo me të bërtitura?!

Mirë, kur jemi fëmijë. Po kur rritemi, kur marrim pasaportat, a nuk bëhemi dot aq seriozë, sa të mund të veturdhërohemi?! Përfundimisht, prapë na sillet rrotull e njëjta pyetje: Ç’popull jemi ne?! A jemi një popull kalama i përjetshëm apo jemi një popull i matufjepsur tashmë?

Më një anë, siç thamë, kemi ushtarakët e huaj, që vijnë në vendin tonë (në Preshevë, në Manastir, në Tivar, në Plavë, në Filat, po edhe në Durrës), o për të mbrojtur shtetin përkatës prej nesh, o për të na mbrojtur ne, po prej nesh. Vijnë në vendin tonë dhe marrin rrogat për atë punë. M’anë tjetër, lexojmë përditë nëpër gazeta (si për ironi, më së shumti te gazeta “*Albania*”),

se si ushtarakët tanë (me **-ish** edhe pa **-ish**), kërkojnë pensione dhe rroga më të larta se cilido profesion tjetër. I kërkojnë këta privilegje me shumë të drejtë ushtarakët tanë, sepse na e kanë ruajtur Atdheun si s'ka më mirë: Disa dhjetëra gra e fëmijë na i kanë djegur të gjallë në flakë baruti (Frankth, Gërdec e ku kanë mundur), 2000 tanke na i kanë çuar për skrap në Zhelezarën e Nikshiqit, flotën luftarake na e kanë zhytur në det, për t'u ndryshkur atje dhe për t'u zbuluar në të ardhshmen si relike muzeale...

Në të njëjtën kohë, një tjetër gërvishtje i bëhet mendjes sonë, kur meditojmë për të këtillë **“diamante”** të Kombit, të cilit i përkasim. Ajo kategori e ushtarakëve tanë që quhet polici (Kemi, falë Perendisë, nja 10 a më shumë lloje e nënloje policie), kur shërben këtu, në vend të vet, është ngulmërisht dhe pandalshmërisht e prirur për të marrë prej këtij populli sa më shumë **“shpërblime”** (**“kafe”** shpeshherë milionëshe), përveç rrogës që gjithashtu e marrin prej të njëjtit popull. Nuk po ndalemi në përimtimin e këtij lloj korrupsioni. **Ky lloj korrupsioni është evident në çdo ngjarje që ndodh në këtë vend dhe që ka apo mund të ketë lidhje me këtë kategori të ushtarakëve tanë:** Në aksidentet rrugorë, në grindjet, rrahjet e vrasjet midis banorëve, në kultivimin dhe tregtimin e narkotikëve, në ruajtje-mosruajtjen skandaloze të pyjeve, në prodhimin e inerteve, në industrinë ndërtimore, në dogana, në policinë tatimore, në policinë përmbarrimore, në policinë kufitare, në të gjithë llojet e trafiqeve të paligjshëm, deri te kasta e hajdutëve e vegjël të xhepave, të cilët doemos kanë nevojë të organizohen, të ruhen e të mbrohen nga policia.

Gjithkund e gjen policin tonë, i cili në çdo rast përpiket të marrë diçka përmbi rrogë. E kjo **“diçka”** shpeshherë arrin përmasa fenomenale. Pyetjet janë: 1. Po atje, në Bosnjë a në Afganistan a e kanë këtë cilësi ushtarakët tanë? Këtë **“dhunti”** për ta rritur rrogën në shpinë të boshnjakëve dhe afganëve?

2. A mos e ka vetë populli ynë fajin, që e kemi policinë të këthillë?
Dhe prapë vijnë pyetjet rrotull kokavet tona: Ç'komb jemi ne shqiptarët?! ***A mund të shpresojmë që një ditë të vetëpastrohemi prej të këthillë pislleku?!***

Duke pritur 100-vjetorin: KU PO SHKON SHQIPËRIA IME ?

Jo me kuptimin e **pronës**, por me kuptimin e **përkatësisë**, çdo shqiptar ka të drejtë të thotë *Shqipëria ime* siç thotë *familja ime, fshati im, qyteti im, krahina ime*.

Më 14 dhjetor 2009 u bë një konferencë, solemne, kushtuar gjuhëtarit të madh shqiptar, Selman Rizës. Kuptohet, në atë konferencë merrnin pjesë gjuhëtarët më të shquar të Kombit ose pjesa më kryesore e një të tillë ajke kombëtare.

Me qëllim që të hapej ai diskutim që duhej hapur, ai që i duhet Kombit, kur flitet për shembëlltyra aq të rëndësishme kombëtare, siç është Selman Riza, trajtesën tonë e filluam kështu: *“Këtë trajtesë të shkurtër për Fjalorin e Selman Rizës e kam shkruar në Ditën e Flamurit. Atë ditë kisha shumë arsye për të qenë i trishtuar. Duke u marrë me botën e këtij patrioti të madh, gjeta një mënyrë për ta kaluar më mirë atë ditë”* (Trajtesa duhet të botohet në përmbledhjen me materiale të Konferencës në fjalë.)

E patëm bërë këtë hyrje intriguese me shpresën që dikush do të çohet e të pyeste: *“Cili ishte shkaku që ti, në Ditën e Flamurit, të ishe i trishtuar?”* ...Do ta kishim filluar përgjigjen në këtë mënyrë: *“Po më vjen mirë që Ju ka tërhequr vëmendjen shprehja ime. Selman Riza ka qenë një i atillë patriot, sa, kur flasim për të, kemi folur edhe për Atdheun dhe, kur flasim për Atdheun, kemi folur edhe në emër të Selman Rizës. Ai është një nga simbolet e atdhedashurisë dhe ne kemi për detyrë ta shpiem më tutje atdhedashurinë e tij, ashtu si edhe të të gjithë*

të tjerëvet, që u shqetësuan dhe u sakrifikuan për Atdheun, secili në mënyrën e vet.

Arsyeja pse unë isha i trishtuar dhe jam i trishtuar sa herë që vjen 28 Nëntori, ishte kjo: Atë mëngjes feste djali im u ngjiti në tarracën e shtëpisë dhe vendosi flamurin. Ime shoqe na pruri kafetë, gotat me raki dhe biskotat. Uruam për Ditën e Flamurit, ndërsa në ekranin e televizorit z.Bashkim Hoxha po lexonte titujt e gazetave, si dikur që i lexonim në mësuesit gazetave të Partisë së Punës para kooperativistëve.

Unë vura re që, ndër të 30 gazetave të asaj dite të madhe, asnjëra nuk kishte as tituj solemnë, as pamje soleme. Prandaj dhe më zuri trishtimi.

Festa e Flamurit është e vetmja festë që u takon, nga njëra anë, të gjithë shqiptarëve, edhe atyre që u ndodhën brenda kufijve të pranuar prej Konferencës së Ambasadorëve në Londër, edhe e atyre që mbetën jashtë këtyre kufijve. Është festë e të gjithë shqiptarëve, sepse Kuvendi i Vlorës nuk shpalli të pavarur vetëm një pjesë të Shqipërisë, por krejt Shqipërinë. Nga ana tjetër, kjo festë është vetëm e shqiptarëve dhe nuk është e dikujt tjetër. Sepse, psh Viti i Ri, që e festojnë edhe shqiptarët, është festë edhe e popujve të tjerë. Krishtlindjet dhe Pashkët janë festa edhe të popujve të tjerë. Bajramet janë festa edhe të popujve të tjerë. Dita e Flamurit, pra 28 Nëntori, është vetëm festë e shqiptarëve. Është festa, e cila na dallon ne prej popujve të tjerë, është emblemë e Kombit tonë, është krenaria e Kombit tonë. Mbështetur në një të këtillë arsyetim, kjo festë duhej të festohej edhe FAMILJARISHT prej të gjithë shqiptarëve.

Por çfarë po na ndodh në të vërtetë? Nga tarraca e shtëpisë sime duken rrethrotull më shumë se 300 shtëpi. Asnjëra prej tyre nuk e ka ngritur flamurin. Pra, në asnjërën prej tyre nuk festohet Dita e Flamurit. Si për ironi, në kulmin e më së

afërmes shtëpi, në kulmin e fqinjit tim më të afërm, valëvitet një flamur italian. Ai e ka vënë atë flamur, gjatë ndërtimit të asaj shtëpie, sigurisht, në shenjë mirënjohjeje që ato para, me të cilat e ka ndërtuar atë shtëpi, i ka fituar jo në Shqipëri, por në Itali. Është puna e tij. (Nuk e di, italianët, në ato shtëpi që ua ndërtojnë shqiptarët, a e ngrejnë flamurin shqiptar, në shenjë mirënjohjeje se ato shtëpi po ua ndërtojnë shqiptarët?)

Sidoqoftë, mua më ngacmon dhe më trishton një e tillë pamje. Përse të mos valëviten, në këtë ditë të shënuar, me qindra flamuj kombëtarë në tarrasat e shtëpivet tona, në dritaret e shtëpivet tona dhe në ballkonet e shtëpivet tona?!

Kam kaluar në ditë të tilla të Festës së Flamurit nëpër Tiranë. Ballkonet e pallatevet shumëkatësh të shqiptarëvet, që jetojnë në kryeqytetin tonë, janë të “zbukuruar”, si çdo ditë tjetër, me këmisha që teren, me peshqirë, me kanotiere, me brekë dhe me sutjena grash.

Kam kaluar nëpër kryeqytet dhe kam vënë re që, në atë Ditë të Madhe Kombëtare, as Universiteti privat “Motrat Qiriazhi” nuk e kish ngritur flamurin, as universiteti “Luarasi”, as libraria “Mehdi Frashëri”. Me këtë, unë kuptoj që as pasardhësit e patriotëvet tanë të dikurshëm nuk e ndiejnë të nevojshme për t’i nderuar paraardhësit e vet, dhe trishtohem duke bërë pyetjen: Ku po shkon kështu Kombi im ?!

Ndoshta e kam gabim. Ndoshta Kombi im e ka rrugën e vet të sigurtë edhe pa e manifestuar në këtë mënyrë patriotizmin e vet.

Por unë prapë trishtohem, sepse, kur vë re që Shën Valentini festohet me bujë të madhe, kur shoh që atë festë e festojnë jo vetëm të dashuruarit, por edhe imoralët e lloj-lloj prostitutësh dhe prostitutash, kur shoh që atë ditë shiten me mijëra suvenire, lule, pako me biskota e me çokollata, shishe me verë, gjerdanë floriri, orë dore. Trishtohem dhe bëj pyetjen: Në Ditën e Festës sonë Kombëtare, pse nuk shiten, fruta, pije,

mish, fishekzjarre, dhurata, aq sa shiten për Shën Valentin ose psh për Vit të Ri?! Në ditën e Shën Valentinit shkëmbehen me qindra mijë mesazhe urimi. Dhurohen edhe kartolina të bukura me “Të dua si shpirt” “Je më e shtrenjta e Botës” “Puç! Puç!”. Në ditën e Vitit të Ri shkëmbehen midis shqiptarëve qindra mijë “Gëzuar!” “Gëzuar!” “Gëzuar!” Mirë bëjnë , por në Ditën e Flamurit përse nuk ka të tillë urime personale midis shqiptarëve njëri me tjetrin?! Ku po shkon Kombi im me këtë lloj mentaliteti nënvlefësues për vetëveten?! A është një komb i mençur Kombi im?! A është një komb krenar Kombi im, i cili të dijë edhe ta manifestojë krenarinë e vet?!”

Kjo do t’ ishte fjala jonë para baballarëve të gjuhës shqipe në atë ditë përkujtimi të Selman Rizës. Mirëpo, ata nuk ma bënë pyetjen: **Pse isha i trishtuar në Ditën e Flamurit?** Nuk ma bënë pyetjen madje as në formë qortimi: *Ne kemi shumë arsye që të jemi të gëzuar, sepse Shqipëria u bë një vend demokratik, sepse Kosova u çlirua etj. etj. Ti na paske arsye që të ndjehesh i trishtuar?!* Nuk u ngacmua askush prej një të tillë deklarate, e cila, në një farë mënyre, duhej të tingëllonte mjaft bombastike.

Pas një të këtillë mosreagimi, fare “*natyrshëm*”, vazhdova të ndjehem thellësisht i trishtuar.

Në Republikën e Shqipërisë ka me dhjetëra universitete privatë. Dikush thotë 30, dikush thotë 50. Secili nga ata universitete ka nga një tufë fakultetesh, por asnjëri prej tyre nuk ka fakultet që përgatit **albanologë**. As për gjuhën shqipe, as për historinë e Shqipërisë, as për arkeologjinë, as për etnologjinë. Pse nuk po ka fakultete të tillë në universitetet tanë privatë? Përgjigjja është nga më trishtimshkaktueset: Pasanikët shqiptarë, që i çojnë fëmijët në ata universitete, nuk duan t’i bëjnë **albanologë** bijtë e bijat e tyre. Nuk duan t’i bëjnë **albanologë**, sepse puna e **albanologut** nuk paguhet. Nuk paguhet sidomos me mënyra korruptive. Kush po i jep rryshfet një albanologu:

Aman, shpjegoje kështu fjalën patate!

Ku po shkon kështu Kombi im?! Ai po ecën nëpër histori pikërisht si një ergjele kuajsh të verbër. Ose edhe më keq: Ai, si një tufë robërish të vetëverbuar dhe të vetëlidhur, po ecën **në strategjitë e kombevet të tjerë**. Në strategjinë e grekëvet, në strategjinë e sërbevet, në strategjitë e popujvet të tjerë të Evropës... ***Thonë ata ashtu, edhe ne ashtu! Bëjnë ata ashtu, edhe ne ashtu!*** Na plaçin sytë, vërtet !

Ndërkaq, shqiptarët duhet ta kuptojnë njëherë e mirë: **Festa e 28 Nëntorit duhet të jetë festa më madhe e shqiptarëve**. Duhet të valëviten me qindra mijë flamuj **kuq e zi** në krejt Shqipërinë e anembanë Globit, duhet të shtrohen në çdo familje dreka e darka, të ketë shëtitje, të ketë urime, të ketë dhurata, fishekzjarre, këngë patriotike. Po nuk u bë 28 Nëntori festa më e madhe e shqiptarëve, në fund të shekullit XXI nuk do të ketë më Shqipëri!

KATASTROFA JONË NË TERMINOLOGJI (SFIDË PYETJESH NË PRAG TË HYRJES NË BE)

(U kërkohet ndjesë personalitetet që i kemi përmendur. Gjithsesi, ata janë pjesë e zgjidhjes. GjD)

1. Si quhet Atdheu i të gjithë shqiptarëve?
2. Cilët janë kufijtë gjeografikë të Atdheut të shqiptarëve?
(A duhet pyetur BE për këtë punë?)
3. Cilat janë pikat skajore të Bregdetit Shqiptar?
4. Sa e gjatë është vija bregdetare shqiptare?
5. Cilët janë lumenjtë shqiptarë, të cilët në gjithë gjatësinë e tyre kalojnë nëpër Shqipëri?
6. Drini i Bardhë a buron në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
7. Drini i Zi a buron në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
8. Mali Sharr a gjendet në Shqipëri?
9. Qentë e Sharrit, si racë, a janë qen shqiptarë apo..?
(Krs. T.Yamazaki, T. Kojima: HUNDE, f.68. ISBN 3-85049-584-6)
10. Korabi në ç' pjesë të Shqipërisë ndodhet? Si e përcaktojnë tekstet tanë të gjeografisë?
11. Krahina e Matit, a është krahinë lindore apo perendimore e Shqipërisë?
12. Treva e Kukësit a është trevë verilindore e Shqipërisë?
13. Presheva a ndodhet gjeografikisht në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
14. Tivari, gjeografikisht, a gjendet në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

15.Për Konicën, në tekstet tanë të gjeografisë, a thuhet se ndodhet në Shqipëri? Nëse jo, pse?

16.Kryeqyteti i shtetit të Maqedonisë, Shkupi, a ndodhet në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

17.Arta, gjeografikisht, ku ndodhet, në Shqipëri apo në Greqi?

18.Suli, gjeografikisht, ku ndodhet, në Shqipëri apo në Greqi?

19.Brezovica, vendi i skijatorëve, a gjendet në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

20.Trepça, gjeografikisht, a është minierë e Shqipërisë? Për minierat e Trepçës, ne në Tiranë, a themi: **Minierat tona?**

21.Liqeni i Ohrit a është liqen i Shqipërisë apo i Maqedonisë?

22.Liqeni i Janinës a është liqen i Shqipërisë apo i Greqisë?

23.Kongresi i Manastirit a është mbajtur në Shqipëri apo në Maqedoni?

24.Lumi Bunë a është lumë shqiptar?

25.Malësia e Madhe a gjendet në Shqipëri? Gruda është pjesë e Malësisë së Madhe. A gjendet në Shqipëri?

26.Ana e Malit a gjendet në Shqipëri? Katërkolla (Vlladimiri) është lokalitet në Anë të Malit. A gjendet në Shqipëri?

27.Dibra a është krahinë e Shqipërisë? Kryeqendër e krahinës së Dibrës është Dibra e Madhe. A gjendet Dibra e Madhe në Shqipëri?

28.A është Prishtina qytet shqiptar?

29.A është Prishtina qytet i Shqipërisë, gjeografikisht?

30.A është Tetova qytet shqiptar?

31.A është Tetova qytet i Shqipërisë, gjeografikisht?

32.A është Mnastiri qytet i banuar me shumicë shqiptare? Jo.

33.A është Manastiri (Bitola) qytet i Shqipërisë, gjeografikisht?

34.A është Gusia qytezë shqiptare?

- 35.A është Gusia gjeografikisht qytezë e Shqipërisë?
36.A është Podgorica qytet me shumicë shqiptare? Jo.
37.A është Podgorica qytet i Shqipërisë? Kryeqyteti i Malit të Zi, ndodhet në Shqipëri, apo në Mal të Zi?
38.Cili është masivi malor lindor i Shqipërisë?
39.Ku ka lindur Bajram Curri? Në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
40.Marko Boçari a ishte nga Shqipëria?
41.Shkodra a ka qenë pjesë e Atdheut të Alipashë Tepelenës?
42.Janina, a ishte pjesë e Atdheut të Luigj Gurakuqit?
43.Konsulli i Republikës së Shqipërisë në Janinë, a gjindet në vend të vet, në Atdheun e vet, apo në ndonjë vend të huaj?
44.Rexhep Qosja a ka lindur në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
45.Josif Bageri a është patriot shqiptar? Ku ka lindur Josif Bageri? Në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
46.Agim Vinca a është poet dhe studiues shqiptar?
45.Agim Vinca, a ka lindur në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
46.Kim Mehmeti, a jeton në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
47.Lorik Cana a është futbollist shqiptar?
48.Ku ka lindur Lorik Cana, në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?
49.Rexhep Qosja, Josif Bageri, Agim Vinca, Kim Mehmeti, Lorik Cana, a kanë lindur në Atdheun e vet, apo jashtë Atdheut?
50.Fatmir Sejdiu dhe Hashim Thaçi janë shqiptarë. A kanë lindur në Shqipëri? Tirana a ndodhet brenda Atdheut të Fatmir Sejdiut dhe Hashim Thaçit?
51.Sabri Hamiti a është nga Shqipëria?
52.Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, a ka vdekur brenda Atdheut apo jashtë Atdheut?
53.Gjergj Kastrioti-Skënderbeu a vdiq në Arbëri? Në cilin shtet vdiq Gjergj Kastrioti Skënderbeu?

54. Azem Galica a u vra brenda Atdheut të vet, apo jashtë Atdheut të vet?

55. Azem Galica a u vra në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

56. Shqipëria a është Atdheu i Ali Podrimjes?

57. Ku ka lindur Ali Podrimja, në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

58. A është Ali Podrimja nga Shqipëria?

59. A është Gjirokastra pjesë e Atdheut të Ali Podrimjes?

60. A ishte Ulqini pjesë e Atdheut të Naim Frashërit?

61. A ndodhet Ulqini gjeografikisht në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

62. Naim Frashëri a ka lindur në Turqi apo në Shqipëri?
Në cilin shtet ka lindur Naim Frashëri?

63. Ndre Mjeda a ka lindur në Turqi apo në Shqipëri?
Në cilin shtetka lindur Ndre Mjeda?

64. Rexhep Ismajli a ka lindur në Sërbi apo në Shqipëri?
(Këto gjëra nuk ka kush t'ia sqarojë Bashkimit Evropian,
në mos ia sqarofshim ne shqiptarët)

65. Filati, a ishte pjesë e Atdheut të Anton Çetës?

66. Faik Konica a ishte shqiptar?

67. Faik Konica a ish nga Shqipëria apo nga Greqia?

68. Kur emigrantët tanë kalojnë kufirin në Qafëbotë, a hyjnë në Greqi gjeografikisht?

69. Kur emigrantët tanë mbërrijnë në Dhodhom apo në Meçovë, si duhet të thonë: Tani kemi hyrë në Greqi, apo: Jemi akoma **në Shqipëri?**

70. Kur një kuksian kalon kufirin në Morinë, a del jashtë Atdheut? Duam të themi: A del jashtë Shqipërisë?

71. Kur një banor i Malësisë së Gjakovës kalon Qafën e Prushit e zbret në Gjakovë, a del jashtë Shqipërisë?

72. Niko Stillo, një studies, çam ortodoks, a është nga Shqipëria?

73. Mirë që për Epirin e Veriut, Vorio-Epirin, e dimë tashmë ku ndodhet. Po Epiri i Jugut, Notio-Epiri, ku ndodhet?

Në Shqipëri apo në Greqi?

74. A është Podujeva pjesë e Atdheut të Bamir Topit?

75. Podujeva a gjendet në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

76. A jeton Ali Ahmeti në Atdheun e vet? Si quhet Atdheu i Ali Ahmetit?

77. Ali Ahmeti, gjeografikisht, a jeton në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

78. Isa Boletini a ishte shqiptar?

79. A ka lindur në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë Isa Boletini?

80. Isa Boletini, a është vrarë në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë?

81. Ku e ka varrin Isa Boletini, jashtë apo brenda Shqipërisë?

82. A mund t'i lihet shtetit të Sërbisë varri i Isa Boletinit?

83. Adem Jashari a është vrarë në Atdheun e vet?

84. A e ka varrin jashtë Shqipërisë Adem Jashari?

85. Kur shkojmë në Skënderaj, pse na pyesin:

Qysh po ia kaloni andej ka Shqipnia?

86. Kur një djalë i ri nga Prekazi niset për Tiranë, a duhet të thotë: ***Po shkoj në Shqipëri?***

87. Për të vizituar varrin e Adem Jasharit, një nxënës nga Përmeti a detyrohet të dalë jashtë Shqipërisë?

88. A është Adem Jashari një hero shqiptar? Filatasit a thonë (A duhet të thonë): ***Adem Jashari është heroi ynë?***

89. Nxënësit e shkollave të Durrësit, kur flasin (nëse flasin) për Adem Jasharin, a thonë: ***Heroi ynë?***

90. Nxënësit e Tiranës, a thonë për Ismail Kadarenë: ***Poeti dhe prozatori ynë me famë botërore?***

91. Nënësit e Tiranës, në e paçin në program, a thonë për Azem Shkrelin: ***Poeti dhe prozatori ynë?***

92. Nxënësit e shkollavet të mesme të Beratit, a thonë për Sabri Hamitin, Eqrem Bashën, Jakup Cerajën, Murat Isakun, Hivzi Sulejmanin, Enver Gjerqekun: **poetët dhe prozatorët tanë?** Apo nuk i njohin fare, nuk ua dinë as emrat?

93. A është për gazetarët e Tiranës Jakup Krasniqi:

Një nga politikanët tanë?

94. A thotë një vlonjat për gazetarët e Prishtinës:

Gazetarët tanë?

95. A është Bekim Fehmiu, për një korçar, për një shkodran, për një pargiot, për një paramithiot, për një tivaras: **Aktori ynë?** A thonë këta pjesëtarë të Kombit shqiptar: **Bekim Fehmiu, aktori ynë me fame botërore, vrau veten tragjikisht?**

96. A është një emigrant shqiptar nga Peja bashkatdhetar me një emigrant shqiptar nga Tuzi?

97. Si quhet Atdheu i një emigranti shqiptar nga Tuzi?

98. Si quhet Atdheu i një emigranti nga Peja?

99. Si quhet Atdheu i një emigranti nga Lushnja?

100. A janë bashkatdhetarë: Një emigrant nga Peja, një emigrant nga Tuzi, një emigrant nga Lushnja, një emigrant nga Kërçova dhe një emigrant ortodoks nga Preveza? A e ndiejnë veten bashkatdhetarë këta njerëz, apo e ndiejnë veten të huaj për njëri-tjetrin?

(Pa e vënë në rrugën e qartësimit dhe të stabilizimit kaosit TERMINOLOGJIK që sot mbretëron shkatërrueshëm midis shqiptarëve, Kombi shqiptar nuk mund të konsolidohet.)

101. A duhet ta festojë **28 Nëntorin**,

Ditën e Shpalljes së Pavarësisë, një banor shqiptar ortodoks i Kosturit, sado që Kosturi nuk është përfshirë në shtetin që u krijuapas **Shpalljes së Pavarësisë?** (Nuk po themi:

A është i detyruar? Por po themi: A duhet? A do të duhej?)

102. Cili është realisht Atdheu i një shqiptari ortodoks filatas?

103. Si quhet Atdheu i një nxënësi shqiptar nga Kumanova?

Si është shkruar në librat e tij të shkollës? Si është vizatuar në hartat e gjeografisë Atdheu i një nxënësi të Kumanovës?

104. Një nxënës nga Kumanova, a thotë për Dritëro

Agollin: ***Shkrimtari ynë Dritëro Agolli?***

105. Një profesor i gjuhës shqipe nga Tirana, a thotë për Besim Bokshin: ***Akademiku ynë?***

106. Për futbollistin Debatik Curri, a themi: ***Futbollisti ynë?***

107. Për Jeronim De Radën a themi: ***Poeti ynë i Rilindjes?***

Në cilin shtet ka lindur e jetuar Jeronim de Rada?

108. Për Nexhmie Pagarushën a thonë përmetarët:

Këngëtarja jonë?

109. A ka lindur në Atdheun tonë apo jashtë Atdheut tonë Ibrahim Rugova?

110. Në cilët vende jashtë Shqipërisë vepron kompania INSIG?

111. Për sallamin EHV a thonë në Ferizaj: ***Ky është sallam vendi, salam i yni?***

112. Për birrën “*Peja*” a themi në Shkodër: ***Është birrë vendi, birrë e jona?***

113. Birra “*Korça*” a është birrë vendi për një gjakovar?

114. Për minierën e Bulqizës a thonë banorët e Shtimjes:

Minierë e vendit tonë?

115. Kur vritet aksidentalisht një minator në Bulqizë, banorët e Dibrës së Madhe dhe banorët e Podujevës apo banorët shqiptarë të Tivarit, a e ndiejnë si fatkeqësi të vetën dhe a thonë: ***Jazëk, qeveria e Tiranës, që s’po vë rregull në minierat tona !?***

116. Cfarë duhet të ndodhë që miniera qymyrgurore e Memaliajt dhe miniera qymyrgurore e Fushëbardhës në Prishtinë të konceptohen si miniera të të njëjtit vend? A duhet më parë t’i përfshijë dikush në të njëjtin shtet këto 2 miniera (Rusia, Kina, Gjermania), apo mund të konceptohen

ashtu edhe pa qenë në të njëjtin shtet, gjersa ndodhen në Shqipëri?)

117. Kur një banor i Maqellarës shkon te halla e vet në Dibër të Madhe, a e quan sikur ka dalë jashtë Shqipërisë?

118. Banka Kombëtare Tregtrare (BKT), meqë është **kombëtare**, a ka degë të vetat në të gjithë qytetet kryesore të Shqipërisë? Psh në Janinë, a ka degë të vetën BKT?

119. Guvernatori i Bankës Shqiptare, Ardian Fullani, a ka folur ndonjëherë për situatën financiare në krejt Shqipërinë?

120. Banka Shqiptare, a është vërtet shqiptare apo çerekshqiptare?

121. Kur një politikan i Tiranës shpall me të madhe **“Paktin kombëtar”** si program të vetin politik, a e ka seriozisht ai njeri apo tallet me Kombin e vet, me termin **“kombëtar”**? Apo s’ia ka haberin cili është dhe deri ku shtrihet Kombi i tij?

122. A mund të flasë një politikan shqiptar për Kombin, pa e përfshirë në këtë nocion krejt Kombin shqiptar?

123. Albtelekomi a vepron, ose, të paktën, a synon të veprojë në krejt Shqipërinë? A ka Albtelekomi filialet e vet në Follorinë, në Manastir e në Tivar? Nëse jo dhe nëse nuk e ka as në program për t’i pasur, a ka të drejtë ai institucion postar të quhet Albtelekom?

124. Shtëpitë botuese të librit shqip, a kanë librari të vetat në të gjithë qytetet e Shqipërisë, të paktën në ata që kanë mbi 15000 banorë?

125. Gazetat që botohen në Tiranë, a shpërndahen në të gjithë qytetet e Shqipërisë?

126. Gazetat që botohen në Tiranë, në Prishtinë e në Shkup, në gjuhën shqipe, a kanë kioska të vetat: Në Tivar, në Podgoricë, në Pazar të Ri (Novi Pazar), në Vranjë, në Veles, në Follorinë dhe në Artë? (Vo! Gazetat e Beogradit

i kanë kioskat e veta në Podgoricë, në Tivar e në Ulqin, ndonëse Podgorica, Tivari e Ulqini nuk janë më qytete të të njëjtit shtet me Beogradin dhe ndonëse ato gazeta shiten shumë pak ose aspak në këta qytete.)

127.Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare a i ka përfshirë nën juridikcionin e vet kishtar të gjithë ortodoksët shqiptarë?

128.Në kishat tona ortodokse të Prevezës, të Janinës apo të Konicës, a thuhet mesha në shqip? Priftërinjtë në këto kisha a predikojnë shqip?

129.Shqiptarët dhe arvanitët që jetojnë në shtetin grek, otodoksët çamë, emigrantët e kohëvet të fundit etj, a llobojnë që shteti grek ta njohë pavarësinë e Kosovës?

130.Eshtë e pamundur të mos ketë në parlamentin e shtetit grek ortodoksë shqiptarë, arvanitë, çamë etj. A bëjnë ata politikë për Kombin e vet?

131.A është normale të vraposh “*për t’u integruar në Evropë*” të paktën pa i shtruar para vetes këta probleme?

132.A mund të shpresojmë që, pasi të jemi bërë anëtarë të Bashkimit Evropian, do të mund t’i përcaktojmë më saktë kufijtë e Atdheut tonë?

133.Apo ndoshta, duke u bashkuar me kombet e tjerë të Evropës, duhet të harrojmë se jemi shqiptarë, ashtu siç patën harruar një shumicë ilirësh se janë ilirë dhe siç patën menduar se ishin turq një shumicë arnautësh ?!

134.Një pjesë e konsiderueshme e Shqipërisë, duke qenë e përfshirë brenda shtetit grek, ka kohë që është anëtare e Bashkimit Evropian. A janë rikthyer te vetëvetja, a janë evropianizuar pozitivisht apo janë greqizuar edhe më keq, ata shqiptarë, pasi janë bërë anëtarë të Bashkimit Evropian?

135.Kur edhe Republika e Shqipërisë, edhe Republika e

Kosovës të jenë anëtare të Bashkimit Evropian, a mund të shpresojmë që në Çamëri dhe në vendet ku jetojnë arvanitët, të hapen shkolla shqipe?

136.A mund të shpresojmë që, në një Evropë të bashkuar, ortodoksët shqiptarë e arvanitë do t'i luten Zotit në gjuhën shqipe, pavarësisht se në cilin shtet jetojnë?

(Vetëm atëherë kur të jemi vetëdijësuar dhe kur t'i kemi hyrë punës për t'i zgjidhur praktikisht problemet që i pasqyrojmë në këto 136 pika, duke shtuar vetë lexuesi edhe mijëra pika të tjera të ngjashme me këto, ne do të bëhemi të denjë për të folur nga pozita të barabarta me kombet e tjerë të Evropës. Përndryshe, statusi ynë real në Bashkimin Evropian do të jetë në një shkallë më të ulët se ai i kombevet të tjerë.)

Sami Frashëri në “*Kamus Al-Alam*”

Sami Frashëri, njëri ndër shqiptarët më të **rilindur** të kohës së vet, ndonëse Shqipëria atëherë nuk gëzonte asnjë atribut shtetëror, nuk ishte kaq i lajthitur në terminologji sa ç'jemi ne. Jo për ilustrim, por për të parë sa kanë qenë Rilindësit më të përparuar në krahasim me ne, po nxjerrim këtu disa fragmente pikërisht nga vepra e Samiut “*Kamus Al-Alam*”, vepër madhore shkruar në turqisht, përkthyer nga Zyber H. Bakiu, botim shqip i Shkupit me titull “*Sami Frashëri, Viset shqiptare në Kamus Al-Alam*”. Në kllapa po vëmë edhe faqen e botimit shqip, edhe faqen e botimit turqisht.

“Popullsia e Shqipërisë shkon afërsisht deri 2500000 frymë, nga të cilët 2000000 janë shqiptarë dhe 500000 janë vllahë, bullgarë, grekë dhe jevgj” (f.25; I,f.149) Duhet të vëmë re këtu që Samiun nuk e pengon aspak fakti që në Shqipëri jetojnë 20% joshqiptarë. Le të jenë 20% joshqiptarë dhe le të jetë Shqipëria pjesë e një shteti joshqiptar, ai vendin e vet e quan Shqipëri.

“Qytetet më të rëndësishëm të Shqipërisë janë: Shkodra, Prizreni, Manastiri, Janina”, “Në radhë të dytë (qytetet e Shqipërisë) janë: Peja, Gjakova, Prishtina, Shkupi, Kalkondolena (Tetova), Dibra, Tirana, Elbasani, Berati, Ohri, Korça, Kosturi, Gjirokastra dhe Preveza”, “Në radhë të tretë [qytetet më kryesorë (të Shqipërisë)] janë: Lezha, Gucia, Plava, Mitrovica, Kumanova, Gostivari, Qyprilia, Prilepi, Resnja, Kruja, Durrësi, Kavaja, Vlora, Tepelena, Përmeti, Delvina, Konica, Filati, Ajdonati (Paramithia), Margëlliçi dhe Parga” (f.2-22;I,f.149) Asnjëri prej këtyre nuk ndodheshin në shtetin e vet, por ndodheshin në Shqipëri! Si ndodhi që sot, në mendjet e shumicës prej nesh, pjesa më madhe e këtyre qyteteve *“dolën”* jashtë Shqipërisë?! Kjo ka ndodhur, sepse ne, pasardhësit e Samiut, jemi më të prapambetur se Samiu.

“Krahinat e Vranjës, Leskovacit e të Kurshumlisë... janë thjeshtë toka të Shqipërisë” (f.15;I,f.149)

“Disa banorë në sanxhakun e Gucisë dhe të Beranës flasin gjuhën boshnjake, por e dine edhe shqipen” (f.181;II,f.1116)
“(Në sanxhakun e Beranës e të Gucisë) popullsia...mendohet të jetë 40000...dhe flasin shqipen e boshnjaken” (f.38;II,f.1269). E kemi lexuar në faqet e këtij libri sa prej këtyre janë masakruar dhe s’është përgjigjur askush për ta. Tani kërkojmë të mos e quajmë *Shqipëri* vendin ku ata ende vazhdojnë të kalben.

“[Në Bijellopolje (Akovë)] gjuha e vendit është shqipja dhe ajo boshnjake” (f.34;I,f.273)

“(Dropulli) Të gjithë fshatrat që gjenden në këtë fushë janë çifligje, bujqit e të cilëvet janë grekë, të sjellë aty nga jashtë qëmoti” (f.66;III,f.2141)

“(Filati) qytet...në nahijen e Çamërisë së Shqipërisë” (f.79;V,f.3466)

“(Gostivari) qytet...në Shqipëri” (f.85;V,f.3305)

“(Gruda) krahinë në Malësinë e Shkodrës, në Shqipëri” (f.87;V,f.3270)

“(Gucia) *qytet...në Shqipëri*” (f.88;V,f.3306)

“(Gjilani) *qytet...në Shqipëri*” “*një pakicë e vogël sllave*” (f.92;V,f.3945)

“*Gjiu i Nartës ose i Ambrakisë është një gji midis Shqipërisë dhe Greqisë*” (f.170;VI,f.4544)

“(Kazaja e Janinës) *Shumica e popullsisë është e krishterë, e përbërë nga grekë dhe vllahë*” (f.106;VI,f.4788-47-91)
 “*Vetëm kazaja e Janinës dhe popullsia e Mecovës dhe e Konicës kanë myslimanë, vllahë, grekë, kurse në 3 sanxhakët e tjerë (Gjirokastër, Prevezë, Berat) popullsia është e tëra shqiptare*” (f.110;VI,f.4788-4791)

“(Kazaja e Kërçovës) *34222 frymë...më shumë se gjysma janë sllavë...13586 janë shqiptarë dhe myslimanë*” (f.117;V,f.3610)

“(Kazaja e Konicës) *25000 frymë, gjysma e së cilës është myslimane e shqiptare, kurse pjesa tjetër shqiptarë të krishterë dhe vllahë*” (f.121;V,f.3781) Samiu s’ka frikë me i përmendë grekët. Por në Konicë nuk i përmend, sepse aty nuk ka grekë.

“(Kosova) *përfshin pjesën verilindore të Shqipërisë*” (f.129;V,f.3746) Tani duhet të bëjmë vlerësimin: O ka qenë në kllapi Sami Frashëri, o kanë shkruar kllapira profesorët tanë të gjeografisë, kur krahinën e Matit, Kukësin dhe Peshkopinë, e jo Kosovën, i konsiderojnë pjesë “*verilindore*” të Shqipërisë.

“(Në Kosovë) *ortodoksët janë të paktë, një pjesë e vogël e të cilëve janë sllavë, si bullgarë e serbë, ose janë sllavizuar me anën e shkollës e të kishës*” (f.131;V,f.3746)

“(Kraja) *në skajin veriperendimor të Shqipërisë*” (f.134;V,f.3609)

“(Kurshumlia) *në kufi të Shqipërisë. Popullsia (e saj) është krejtësisht shqiptare*” “*Iu la Sërbisë nga Kongresi i Berlinit, prandaj banorët emigruan*” (f.138;V,f.3723) Nëse është për të bërë bisedime midis Shqipërisë dhe Sërbisë, siç ka propozuar

B.Tadiqi, **pika e parë** duhet të jetë: *T'i kthehet Kurshumlia Shqipërisë, në mënyrë që të emigruarit e saj të mund të rivendosen në pronat e veta.*” Kurshumlia është 40 km në veri të Mitrovicës, kështu që Mitrovicës as që i bie radha të përmendet.

“*Liqeni i Ohrit gjendet në mes të Shqipërisë*” (f.19;I,f.149)

“(Manastiri) *qytet...në lindje të Shqipërisë*” (f.151;VI,f.4437-4440)

“(Kazaja e Margëlliçit). *E gjithë popullsia është shqiptare, shumica myslimanë*” (f.161;VI,f.4095)

“(Kazaja e Mitrovicës). *Popullsia është e përbërë nga boshnjakë dhe shqiptarë*” (f.165;VI,f.4149) Shteti serb s’ka asnjë punë aty. Imigrantët serbë (apo kolonët), që kanë ardhur aty në dekadat pas Samiut, le të rrinë aty. Ne s’u mohojmë asnjë të drejtë, si të tillë.

“(Narta) *qytezë që gjendet në skajin jugor të Shqipërisë*” “*iu dha kohë më pare Greqisë*” “*nga pikëpamja e ndarjes gjeografike, konsiderohet Shqipëri*” (f.169;VI,f.4544) Mund të ndodhin gjithfarë parcelimesh administrativo-shtetërorë. Përcaktimi gjeografik mbetet po ai. Sa shekuj ka që nuk ekziston më shteti i Maqedonisë Antike? Megjithatë nocioni gjeografik i saji nuk ka humbur. Narta, pra (jo kjo e Vlorës, por ajo e Gjirit të Ambrakisë), **nga pikëpamja gjeografike**, ndodhet në Shqipëri. Është skaji më jugor i Notio-Epirit.

“(Novipazari), *krahinë midis Bosnjës dhe Kosovës*” “*Gjysma...janë myslimanë, pjesa tjetër të krishterë. Myslimanët janë boshnjakë e shqiptarë që flasin 2 gjuhë*” (f.177;VI,f.4803)

“(Ohri) *qytet...në Shqipëri*” “*në qytet flitet shqip, turqisht, bullgarisht*” (f.172;II,f.1066)

“*Paramithia (Ajdonati)...ndodhet në pjesën jugperendimore të Shqipërisë*” “*Popullsia...rreth 16000 frymë... shumica... shqiptarë... gjysma e tyre myslimanë*” (f.32;I,f.280)

“(Parga) *qytet...në jug të Shqipërisë*” “*Popullsia është myslimane e shqiptare, edhe një pjesë e të krishterëvet janë shqiptarë, kurse të tjerët janë grekë*” (f.174;M,f.1463)

“(Peja) *qytet në pjesën veriore të Shqipërisë*” (f.179;II,f.1116)

“(Plava) *qytet në veri të Shqipërisë*” (f.193;II,f.1530)

“(Podgorica) *Traktati i Berlinit ia la Malit të zi, shumë banorë ikën në Shkodër*” (f.194;II,f.1542)

“(Nahija e Prespës) *Bujqit janë bullgarë dhe myslimanë shqiptarë*” (f.197;II,f.1497)

“(Preveza) *qytet në skajin jugor të Shqipërisë*” “(Sanxhaku i Prevezës) *shumica myslimanë, kurse pjesa tjetër e krishterë dhe pak hebrej*” “*shumica e të krishterëvet është shqiptare*” (f.199;II,f.1508) Si shkruhet në gjeografitë shkollore dhe universitare të shtetit grek?! Është koha që shteti grek, o të pushojë së shkeluri të drejtat e njeriut, o të mos përgjigjet para Evropës vetëm për shpenzimet e paravet, por të përgjigjet edhe për shkeljen e të drejtavet nacionale, ku e ku më brutalisht se në kohën e Bizantit.

“(Prijeplje). *Të gjithë flasin nashkëçe* (Dmth sllavisht. GjD)” (f.203;II,f.1511) Dëshmi që Samiu nuk është nga ata që e cenon sadopak të vërtetën.

“(Prilepi). *Shumica e popullsisë është myslimane, flet gjuhën turke, por pjesa më e madhe e tyre dinë edhe shqip*” (f.204;II,f.1500)

“(Prishtina) *qytet në anën verilindore të Shqipërisë*” (f.206;II,f.1498) Dalim tani te NEW BORNSI, zëmë pritë aty dhe i pyesim me radhë të gjithë banorët e Prishtinës: ***Ku ndodhet Prishtina?!***

“(Prizreni). *Një nga qytetet më të mëdhenj të Shqipërisë*” (f.210;II,f.1496)

“(Resnja) *vllahë dhe shqiptarë të krishterë*” (f.215;III,f.2278)

“(Struga) *qytezë...në Shqipëri*” (f.227;II,f.890)

“(Suli) *në krahinën e Çamërisë së Shqipërisë*” (f.228;IV,f.269)

“(Sharri). *Mal i lartë në Shqipëri*” (f.229;IV,f.2807)

“(Shkupi). *Qytet, qendër e Vilajetit të Kosovës*” (f.246;II,f.933-977) Askush nuk mund të thotë që Shkupi, **gjeografikisht**, gjendet në Maqedoni. Ai është kryeqyteti, kryeqendra administrative, e shtetit që sot quhet **Republika e Maqedonisë**, por nuk ndodhet në Maqedoni, as në kuptimin antik të saj, as në kuptimin kontemporan.

“(Tetova) *qytet... në Shqipëri*” (f.260;V,f.3556)

“(Tivari), *qytet në anën veriperendimore të Shqipërisë*” “*i është lënë Malit të Zi*” (f.264;II,f.1187) Pashko Vasa ka thënë: “*Qysh prej Tivarit deri në prevezë, është tokë e jona, të parët na e kanë lënë*”. Samiu po thotë që Tivari gjendet në anën veriperendimore të Shqipërisë. Unë, që po shkruaj këtë libër, jam prej Tivarit. Niko Stillo, që është nga Preveza, po thotë që Preveza është tokë çame. Bajroni, kur ka zbritur në Prevezë, ka thënë: “*Shqipëri, o nënë trimash të rreptë!*” A duhen të tjerë dëshmitarë?!

“(Ulqini). *Qytet në veriperendim të Shqipërisë*” (f.277;VI,f.4719) Një shkodran i pamençur, produkt i pamençurisë sonë katastrofike gjithkombëtare në fushë të terminologjisë, çon në tregun e Katërkollës (trevë e Ulqinit) 20 kavanoza me mjaltë. Në mbrëmje e pyet kojshia: **Ku qe saf?** Ai përgjigjet: **Qesh n'Mal t'Zi. Shita da mjaltë...** Ta hangërt dreqi mjaltin! Ashtu siç ke fjalët të pasakta, ke edhe mjaltin të pasaktë!

“(Kazaja e Vuçiternit) *5000 janë të krishterë dhe të tjerët* (20000) (janë) *myslimanë. Të gjithë flasin gjuhën shqipe.*” (f.286;VI,f.4691)

Një ndër shkaqet e një vargu së këqiash të Kombit tonë, është se në sh XIX **nuk u rilindën** të gjithë shqiptarët. Rilindja ndodhi. Ajo e shpëtoi Kombin tonë nga shuarja, por midis

nesh mbetën me shumicë *“halldupë”* e *“anadollakë”*. Të tillë shqiptarë **të parilindur**, për fatin tonë të keq, ka edhe sot, në sh XXI, me shumicë në Kombin Shqiptar.

Naimi pat thënë, me gjithë seriozitetin e mundshëm të një të sëmuri me tuberkuloz, i cili po vdiste duke punuar:

*“Punë, punë, natë e ditë,
Që të shohim pakëz dritë!”*

Por një numër i madh shqiptarësh nuk i kuptuan seriozisht këto fjalë të Naimit. Një numër i madh shqiptarësh nuk iu përveshën punëvet, as asaj prodhuese, as asaj kulturore e arsimore. Injoranca mbeti mbizotëruese edhe në ata breza që i bënë nga 8 apo 12 vjet shkollë. Mbeti mbizotëruese injoranca, sepse nuk është shkolla, nuk është dëftesa, ajo që ta jep diturinë. Është puna jote vetjake ajo që të bën edhe të pasur, edhe të ditur.

Pamençuria arriti deri atje, sa midis popullit u perhap fibula sarkastiko-ironizuese: *Ka thënë ai Naimi “Punë, punë, natë e ditë” por ai për vete s’e pat provuar turning e tretë*. Një shumicë tuberkulozisht shqetësuese të tillësh *“filozofë”*, jo seriozë e jo të mençur, sot i kemi nëpër burgjet e Botës, në ballet e të cilëvet, Kombi i tyre lexon me trishtim e me dhimbje prej prindi:

“Burg, burg, natë e ditë” ...

SHQIPËRIA, SI DUHET TË JETË

NA DUHEN SHKALLË, PËR T'U NGJITUR

Mendimi bazë i këtij libri që ne po publikojmë në prag të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, është ky: Pa njohur **ashpërsisht** të vërtetat e veta negative, asnjë komb, madje as vetë njerëzimi, nuk mund të përparojë.

Parë shkurtimisht dhe përmbledhtas të vërtetat tona **negative**, thënë ndryshe, të vërtetat **turpëruese**, që e kanë ulur dinjitetin tonë nga shekulli në shekull gjithnjë e më shumë, janë këto:

1.Mbretërit tanë të Antikitetit nuk kultivuan **shkrimin në gjuhën e vet**. Si pasojë, psh Aleksandri i Maqedonisë i pushtoi krejt Lindjen e Afërme dhe Lindjen e Mesme me ushtarët e vet, por nuk çoi atje kulturën e etnisë së vet. Çoi në Lindje kulturën e helenëve!

2.Iliro-arbro-shqiptarët, filluar prej sh VII e këndeje, nuk arritën dot të krijojnë **një shtet të vetin** të fuqishëm dhe të vinin në shërbim të atij shteti **kishën e vet** autoqefale. Sllavo-bullgarët dhe sllavo-sërbët, në të njëjtat hapësira gjeografike, i krijuan shtetet e vet dhe kishat e veta, ne, në Atdheun tonë shumëshekullor, nuk i krijuam dot. Despotati i Artës duket se ishste një përpjekje për një shtet më vete dhe, me sa duket, aty-këtu, pati përpjekje edhe për **një kishë në gjuhën arbërishte**, por nuk u arrit asgjë e qëndrueshme dhe kjo ka ndodhur pikërisht sepse **strategjia** e atij despotati nuk ka qenë aspak e qartë, madje ndoshta as që ka ekzistuar një **strategji** më vete e për vete. Kështu, në vend që të krijohej Kisha Ortodokse Autoqefale e Arbërvet e pakta në sh XIII, ajo u krijua, çalamane dhe e gjymtë, vetëm në sh XX. U bënë përpjekje, në veprimtarinë

sidomos të Arqipeshkvisë Katolike të Tivarit, për të mbajtur më këmbë Kishën proromake të Ilirikut Lindor, themeluar prej Justinianit të Madh, por ajo u gjend e bllokuar, e asfiksuar dhe e martirizuar, si nga pravosllavizmi, ashtu edhe nga islamizmi, në më se 9 shekujt e ekzistencës saj.

3.Nga sh XV e këndej, të parët tanë, në vend që t'i rezistonin, përveçse me armë, **edhe me mjetet e fesë së vet**, pushtimit osman, ata rezultativisht iu nënshtruan jo vetëm pushtimit ushtarak të Sulltanatit Osman, por **pranuan** (përqaftuan) edhe **pushtimin** e tij **fetar**. Në këtë mënyrë, në sh XIX Kombi ynë nuk konsiderohej më prej evropianëve si një komb që duhej çliruar, por thjeshtë si një pjesë territori që i duhej shkëputur Perandorisë Osmane. Greqia ish e krishterë dhe prandaj **“duhej çliruar”**. Sërbia **“duhej çliruar”**, Mali i Zi **“duhej çliruar”**, Bullgaria **“duhej çliruar”**. Të gjithë këta **“duheshin ndihmuar”**. Tokat shqiptare, myslimane, si Egjipti, si Libani, Palestina, Siria, mjaftonte të **shkëputeshin**, pa, se ç'bëhej me to, pak rëndësi kishte. Në krejt këtë tablo, me pasoja nga më tragjiket, deri në shkallën e pamundësisë për t'i përfytyruar, Evropa ka kusuret e vet dhe i ka për vete, ne, përveç tragjedisë, kemi edhe turpin e madh të katandisjes në atë gjendje. Turp përpara vetes!

4.Humbja (jo gjeografikisht por shtetërisht) e pjesëve veriore e lindore të Kosovës, humbja e Tivarit, e Ulqinit dhe e pjesëve të tjera në sh XIX, është **turp i madh** për ne. Humbja e Çamërisë aq të bukur, humbja e krejt Kosovës dhe e trevave të Vardarit, në sh XX, është prapë një **turp** i yni **i pakapërdishëm**. Turp, sepse **dëm i pallogaritshëm**. Dhe krejt kjo, s'është tjetër, veçse pasojë e **strategjivet të gabuara**, ultërisht egoiste, ekstremisht të verbëta, të Ballabanëve tanë, të Qyprylinjvet, të Begollvet, të Çaushollvet, të Bushatasvet e të shumë të tjerëve, të cilët nuk deshën të mendojnë sadopak më seriozisht dhe sadopak më mençurisht, për vendin dhe për Kombin, të cilit i përkisnin.

5. **Turp i madh** për ne është dorëzimi në atë mënyrë në duart e Italisë, më 1939-n, i shtetit tonë të 1912-s, gjësë më të shtrenjtë që ne kishim mundur të realizonim pas Epokës Heroike të sh XV. Lufta II Botërore ne shqiptarëvet na ka marrë shumë më tepër se 100000 jetë njerëzish. Pse nuk ia dhamë Atdheut, më 7 prill, 5000 prej këtyre, një të 20-ën a të 25-tën pjesë të jetëvet, që gjithsesi do t'i humbnim?!

6. **Turp i madh** për ne janë vitet kur dita e punës e një kooperativisti arriti të paguhej 30 qindarka (çmimi i atëhershëm i një shkrepëseje), kur paga reale e një punëtori a specialisti në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë arriti të jetë qindra herë më e ulët se paga reale e një punëtori a specialisti në Evropën Perendimore, dhe politikanët e pushtetarët tanë (pashallarë, tashmë jo jeshilë por të kuq), nuk ishin në gjendje të hartonin një **strategji tokësore**. Nuk ishin në gjendje atëherë dhe nuk qenë në gjendje as për 20 vjet të tjerë, mbas rrëzimit të Diktaturës.

7. **Turp i madh** është (pasojë e mungesës skandaloze të një **strategjie** të mençur kombëtare, kacavjerrja e mijëra të rinjve tanë nëpër kangjellat e ambasadavet. **Turp**, ravgimet vargje pas vargjesh, si fragmente tufash të bagëtivet, mbetur pa barinj e pa këmborë, humbur rruginash të malesh, i qindra mijë shqiptarëve, që shkuan në shtetin grek, në kërkim të një punëze të çfarëdoshme. **Turp**, të duruarit, pa asnjë të bërtitur, i thundravet e qytavet të një ushtrie zgjebemadhe. **Turp**, që një tufë brekëpalarësh guxojnë t'u çjerrërojnë (gjojakëdojnë) këngë, zorrëvet të shqiptarëvet. **Turp**, që monstra zorrëshpuara të gjakut tonë, që nga Himara në Tiranë, guxojnë t'u mbajnë iso, me mjaullima, të tillave të çjerrura!

Dhe mjaft !!

100-vjetorin e **Ditës së Flamurit** nuk duhet ta presim pa **një strategji** më të mençur. **Jo strategji hakmarrësish** e urrejtësish trushkalur, ashtu si **jo strategji dorëlëpirësish** e gjunjëlëpirësish, por **strategji njerëzish të mençur**. E njerëz të mençur ka Shqipëria më shumë se shumë popuj të tjerë. Mjafton që shqiptarët të mos shiten të gjithë si të mençur, por t'i dëgjojnë fjalët e atyre që janë mirëfilli të tillë. Shqiptarët duhet të dëgjojnë, jo ata që japin mend prej stolit të pushtetarit, por ata që i japin mend Kombit të vet, pa kërkuar që me çdo mënyrë të ulen e të ngulen në frona sundimtarësh.

Në daçim të zëmë një vend më dinjitoz midis kombevet, në këtë 100-vjetor na duhen shkallë më të sigurta për t'u ngjitur atje. Thënë më troç: Na duhen shkallë më të sigurta për të dalë nga humnera e të qenit i fundit në Evropë dhe për të mos rënë kurrë më në këtë humnerë.

RRËNJËT NGJALLËSE TË KOMBIT SHQIPTAR

1.E para rrënjë ngjallëse dhe gjallëmbajtëse e jona është vetë **lashtësia e Kombit tonë**. Një komb shumë i lashtë është njëkohësisht një komb i madh. Asnjë komb nuk e vështron veten në sinkroni. Të gjithë kombet i masin vlerat e veta, përveç së tashmes, edhe me lashtësinë e vet. Puna shkon deri atje, sa, kombet që nuk kanë rrënjë të thella, përpiqen t'ua marrin ato të tjerëvet. Psh sllavomaqedonët e sotëm, duke mos qenë një komb i lashtë, po mundohen me mënyra fantazmagorike, ta quajnë veten pasardhës etnikë të maqedonëve të dikurshëm. Nëse lexon tekstin 4-5 vëllimësh të historisë së Malit të Zi, do të shohësh që 60% e atij teksti, në mos më shumë, bën fjalë për tokat shqiptare, për shqiptarët dhe për paraardhësit e shqiptarëve. Në këtë vështrim, **ne shqiptarët jemi një komb i madh**, madje mund të themi, kombi më i madh në Evropë, sado që sot, numerikisht bëjmë pjesë ndër kombet mesatarë. Ky është i pari dhe më jetëdhënësi burim krenarie për ne.

2.Rrënja e dytë ngjallëse është **gjuha shqipe**, si me lashtësinë e vet, ashtu edhe me aftësitë shprehëse që i ka ruajtur e i ka edhe sot. Kur përfytyron sa e moçme është kjo gjuhë, sa dhjetëra breza e kanë folur këtë gjuhë (diku rreth 120 breza), të duket sikur edhe shkëmbinjtë e këtushëm dinë të flasin shqip. Gjen një eshtër njeriu, tek hap një kanal apo një themel pallati dhe thua: **Ky ka folur gjuhën që flas unë. Unë flas gjuhën që ka folur ky**. Nuk e kanë këtë fat të gjithë kombet. Amerikanët e sotëm nuk thonë dot kështu. Kockat që ata gjejnë, nuk janë kocka të gjyshërve të tyre.

Por gjuha shqipe ka vlera të mëdha edhe në të shprehurit të mendimevet e të ndjenjave. Larminë habitëse të mënyrave dhe të kohëve foljore, përemrat, ndajfoljet, ndajemrat, përdorimin e figurshëm të fjalëve (heq dorë, lë pas dore, fërkoj duart), nuk mund t'i shijojë, vetëm ai që nuk i njeh. Mundësi për të krijuar fjalë të reja pa mbarim, mundësia për të krijuar fjali me konstrukte nga më të larmishmit, janë aq tërheqëse, sa, ai që e flet këtë gjuhë, ndien kënaqësi të jashtzakonshme. Shqiptari, qoftë ai me shkollë, qoftë ai pa shkollë, ka prirjen për të folur sa më gjatë. Pse ndodh kështu? Sepse gjuha që ai përdor, i jep kënaqësi të veçantë. Shumë kombe të tjerë nuk e ndiejnë këtë lloj kënaqësie. Gjuhët e tyre nuk janë kaq narrative. Prandaj dhe nuk është thënë kot që gjuha shqipe është një gjuhë poezie. **Gjuha shqipe është poezia vetë!** Është i lumtur ai që e ka mësuar këtë gjuhë që në foshnjëri.

3. Qytetërimi ynë aq i hershëm është një tjetër rrënjë ngjallëse për shqiptarët e sotëm. Nëse do t'i prezantohesh dikujt, mëso përmendësh emrat e qyteteve të Ilirisë dhe thuaja! ***Unë jam pasardhës i këtij populli. Ti kush je?*** Numëroja qytetet, numëroja kështjellat, numëroji llojet e monedhave, numëroji llojet e anijeve, mëndafshin, dyllin, mjaltin, lëkurët, leshin, djathin, që është çuar përtej detrave me ato anije...

4. Mbretërit tanë të Antikitetit, pavarësisht të metave që ne ua kritikojmë, janë një prej rrënjëve tona nga më ngjallëset e më frymëzueset. Mbretërit, perandorët, sulltanët (rreshta Sulejmanërish, Mehmetërish, rreshta Luigjërish, Arturërish, Karlërish, rreshta Stefanash e Nikollajash), me të cilët mburren kombet që i kanë, asnjë prej tyre nuk i ka duart të palyera me gjak njerëzor. Megjithatë, pasardhësit e tyre nuk ngurrojnë për t'u krenuar me ta. Të gjithë thonë: ***I kemi pasur! Kanë luftuar për atdheun e për kombin tonë.*** Asnjë nuk thotë: ***Më mirë të mos i kishim pasur.*** Edhe shqiptarët, në mos më

shumë, të paktën sa popujtë e tjerë, kanë arsye për t'u mburrur me mbretërit e vet. Mësojini emrat e tyre përmendësh dhe thojnani të tjerëvet. Improvizoni buste për secilin prej tyre!

5.Në gjithë këtë kohë kaq të gjatë, etnia jonë iliro-arbro-shqiptare, madje, siç edhe kemi thënë më parë, ndoshta pellazgo-iliro-arbro-shqiptare, i ka dhënë vetes, po edhe më shumë Botës, **personalitete**, që nga më pak të përmendur, deri te më të përmendurit në historinë e njerëzimit. Janë aq shumë, sa do të duhej një sektor i veçantë, një aneks i posaçëm, vëllim më vete, në enciklopedinë tonë kombëtare, për t'i paraqitur biografitë dhe kontributet e atyre personaliteteve. Godina të posaçme muzeore dhe qindra përmendore anembanë Shqipërisë do të duheshin për t'i kujtuar e për t'i nderuar të gjithë ata njerëz, që kanë dalë prej genit tonë dhe që nuk kanë jetuar kot. Një e tillë galeri personalitetesh s'ka si të mos jetë një prej rrënjësh tona frymëzuese. Secilit shqiptar që ka lindur me një ambicie në shpirt, i duhet një e tillë galeri frymëzuese.

6.**Heronjtë** që i kanë mbrojtur këtë tokë e këtë popull me punën, luftën dhe jetën e vet, **dëshmorët, viktimat** e masakravet, janë rrënjë që lisin tonë të jetës nuk e lënë kurrë të thahet, sado që vrasësit s'kanë dashur tjetër veçse ta thajnë këtë lis. A është e mundur të përfytyrohen përkujtimoret, qoftë edhe vetëm të femijëvet, të therur, të prerë në fyt, të shpuar me bajoneta, të djegur në zjarre, prej njerëzish vërtet të egër?! Sa monumente do të duhej t'u gdhendeshin në mermer gravet të përdhunuara në këtë vend femrash të shenjta?! Sa monumente të tjerë prej granite, trimavet të këtij vendi, të cilët kanë ditur të vdesin, por s'kanë "**ditur**", vendin e të parëvet, as ta falin, as ta shesin?!

7.Monumente të një lloji tjetër janë edhe **baladat**, koleksion klasik i përjetimit dhe i përjetësimit të tragjedit, **kreshnikët**, skulptura të ngurta ndërtuar me fjalë, **këngët pa mbarim të dashurisë**. (Kush s'i di këto këngë, nuk di ç'është dashuria dhe nuk di të bëjë dashuri).

Vijnë pastaj ato që ne i quajmë **thënie të urta**, ato që i quajmë **dispozita kanunore**, kushtetuta të lashta të vetërregullimit dhe të vetëruajtjes etno-kombëtare në mungesë të shtetit të vet, ato që i quajmë **gojëdhëna** e deri te **rrëfimet e gjatë** (përrallat) dhe **gjëzat**, mjete didaktikë për edukimin e fëmijëvevet. Të gjitha këto krijesa të gjenisë sonë natyrore janë përjetësisht moderne. Janë moderne, sepse i ka krijuar, punuar e ripunuar, gdhendur e rigdhendur, një komb shumë i lashtë e shumë i madh. Ai që jeton në këtë lloj thesari, e ka shpirtin përherë të njomë. (Nuk po duam tani të flasim për tharje të shpirtit). Shpirti i njomë është gjithsesi i pranishëm midis nesh.

8.Vallet, këngët dhe meloditë, aq të larmishme të kombit tonë, e gjallërojnë njeriun edhe kur është i shtrirë për të vdekur. Në doni të vdesë i qetë një shqiptar, zini një valle dhe këndonin shqip rrotull tij!

9.Veshjet e krahinavet tona, të cilat, në ansamblin gjithpërfshirës, krijojnë një larmi të rrallëkundgjendur të veshjes sonë kombëtare, janë pa dyshim monumente të një etnokulture nga më të admirueshmet. Deri në dhjetëvjetëshat e vonë, secila vajzë që bëhej nuse, nuk e quante se është bërë nuse, po të mos i kish në pajën e vet 2 apo më shumë kostume të tillë. Edhe më vonë e njëjta traditë u trashëguua, pavarësisht nga varfëria që e ligu shqiptarin. Tani, sidomos në diasporë, ka filluar të ringjallet e njëjta dëshirë. Shikon një nuse dhe një burrë me veshje kombëtare shqiptare dhe, me pak përjashtime, (aty ku ka lënë ndikimin e vet kultura e importuar orientale), ke përshtypjen sikur ke zbritur në shekujt e Homerëvevet. Një mrekulli e papërsëritshme.

10.Shenjat e jetës së të parëvevet tanë, groposur herë më thellë e herë më cekët, ose nxjerrë prej plugjevet a prej ujit në sipërfaqe, prapë, nëse duam të ringjallemi, janë një pjesë e rrënjëvevet tona, pas të cilavet duhet të kapemi edhe ne si të gjithë kombet e tjerë. Nëse duam ta vlerësojmë vetëveten. Copëra stërralli në

formë thikëzash, copëra qermike, fragmente skulpturash, mure gjithfaresh (pa llaç, nga ata të tejhershmit, me llaç, të kohëvet të mëvona, mure të trashë, mure të lartë, mure të rrëzuar, themele muresh, këmbë urash. Merr një cope tjegull dhe të duket sikur po lexon një libër. Është arkeologjia ajo që, nëse do të tregonim kujdesin e duhur për të, do të përbënte një arsye më shumë për t'u ringjallur mendja dhe shpirti ynë.

11.Bimët, fushat, livadhet, pyjet, shkëmbinjtë, luginat, kanionet, përrenjtë, lumenjtë, liqenet, 2 detrat (ajo pjesë që na ka mbetur, qoftë edhe me një ishull të vetëm), kafshët e egra, shpendët, peshqit, kafshët e buta... Është e vërtetë që të këtilla gjëra ka në të gjithë vendet, por kush rritet në Shqipëri, madje edhe një i huaj që kalon vetëm njëherë këndeje, nëse është i pajisur me kulturën e duhur, kënaqësitë që përjeton këtu, rrallëkund mund t'i përjetojë. Ky vend kaq i bukur nuk kërkon tjetër, veç të ketë një administratë shteti disi më të rregullt.

12.Rrënjët ngjallëse që e bëjnë shqiptarin të jetë krenar për Atdheun e vet dhe për Kombin e vet, janë të panumërta në të gjitha periudhat e historisë së tij. Midis tyre, **Epoka e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut** është ndër më të ndriturat. Të tilla epoka kulmore në historitë e shumë popujve nuk ekzistojnë. Shumë popuj do të dëshironin të kishin pika të tilla të lavdishme në historinë e vet, por nuk i kanë. Disa, madje, duke mos pasur kulme të tillë realë, kapen pas ngjarjeve fare të vogla dhe mundohen t'i glorifikojnë, t'i mitizojnë. Ne nuk kemi nevojë ta shndërrojmë **Epokën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut** në mit. Ajo ka qenë aq e madhërishtme, sa s'ka pasë nevojë për kurrfarë suporti artificial. Përkundrazi, shumëkush, ndoshta duke u friguar prej një të tillë madhështie reale, duke e parë veten tepër të vogël përballë saj, është munduar ta zvogëlojë. Të tjerë janë munduar ta paraqesin, nëmos krejt Epokën, të paktën **Kryeherin** e saj, sikur është i tyre dhe jo i arbërvet.

Pikëpamja jonë është që atë **Epokë** nuk e ka realizuar vetëm 1 person. Atë e ka krijuar, e ka realizuar krejt etniteti ynë i asaj kohe, duke qenë i ndriçuar tashmë prej idevet të **Humanizmit Evropian** dhe njëkohësisht i ndodhur përballë forcës së errët, antihumaniste, e cila kish ardhur e papërmbajtshme nga Lindja. Si popull, i cili sapo ishte çliruar prej fuqisë shtypëse shumë të egër serbe, populli i Arbërit ia dinte më shumë se cilido etnitet tjetër vlerën frymës demokratike humaniste, e cila kish kohë që pulsonte në të 2 krahët e Adriatikut. Në anë tjetër kish më shumë se gjysmë shekulli që arbërit e kishin provuar konkretisht edhe frymën johumaniste aspak demokratike që e sillte Sulltanati i Azisë së Vogël, i fuqizuar aq frikshëm, sa e kish bërë të lëmekej krejt Evropën. Koha dhe vendi e kërkuan që arbërit të bëheshin mur dhe ata u bënë mur. Ne kemi arsye të plotë për t'u krenuar me atë brez të gjyshërve tanë.

13.E gjithë koha, prej rënies së murit kastriotas deri në një rilindje tjetër tonën, ka qenë plot me rrënjë të njoma, që e kanë mbajtur gjallë shpirtin e Arbërit. Këtu historiografia duhet të dallojë mirë që tharmi i të mbeturit gjallë i kësaj etnie, egërsisht të rrëzikuar, ka qenë pjesa jonë e krishterë. Në veriperendim është Arqipeshkvia e Tivarit, në veri e verilindje është Arqipeshkvia e Shkup-Prizrenit, në qendër është Durrësi me 2 kryepeshkopata, 1 katolike e 1 ortodokse. Mirdita, Puka, Lezha, Kurbini, Mati, Lura, mbetën bastione të rezistencës antiosmane. Këlmendi ishte një eshtër që i kish mbetur Dovletit në fyt. Në juglindje kemi Voskopojën, Korçën, Vithkuqin. Akoma më në jug, Sulin dhe në Brigjet e Jonit, Çamërinë ortodokse dhe Himarën. Pushteti islamik i osmanëve është munduar me të gjithë mjetet t'i shuajë këto vatra të gjallimit tonë të stërmundimshëm dhe në sh XVIII gati ia ka arritur qëllimit. Në këtë kohë dhe në gjysmën e parë të sh XIX ne kemi qenë gati t'i humbim të gjithë elementët madhor të subjektivitetit tonë evropian. Mirëpo, për fatin tonë

të mirë, fillimisht erdhën përpjekjet separatiste të Bushatasvet dhe të Alipashë Tepelenës, të cilat krijuan një lloj distancimi prej Portës edhe të pjesës sonë myslimane. Fill pas rënies së pashallëqevet, për fatin tonë të mirë, ndodhi edhe **zgjimi ynë rilindës**, i cili i hyri punës për bashkimin në një **KOMB**, në një **NYJË** të vetme, të të 3 konfesioneve: “*Mos shikoni kasha dhe xhamia!*”

14. Rilindja Kombëtare Shqiptare është një tjetër epokë e madhërishtme në historinë tonë: Është pikërisht **Epoka e krijimit të Kombit**. Ajo e merr oksigjenin ngjallës te antiosmani e proevropiani arbër, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Atë oksigjen jetëprurës e çojnë në popull **intelektualët tanë iluministë**, të cilët vijnë prej 3 burimesh të ndryshëm dhe, e themi prapë, për fatin tonë të madh, arrijnë të bashkohen në një lumë të vetëm. Pikërisht mbi atë lumë, tashmë të përbashkët për të gjithë shqiptarët, është ndërtuar edhe “*hidrocentrali*” udhëndriçues i Kombit tonë: Gjuhë e përbashkët, e pastruar prej orientalizmave, shkrim i përbashkët, evropian dhe jo turko-arab, si dhe projekti samian i krijimit të një shteti shqiptar sipas modelevet më të përparuar që i kish Evropa.

3 burimet janë:

1. Arbëreshët e Italisë dhe arvanitët e Greqisë, një fenomen i çuditshëm i ruajtjes fanatike të identitetit tonë në diasporë;

2. të krishterët e Shqipërisë, me qendrat kryesisht në Shkodër e në Korçë;

3. intelektualët myslimanë të **iluminizuar** kryesisht në shkollën “Zosimea” të Janinës, por edhe në Stamboll e në qendra të tjera, ku tashmë ishin krijuar kushtet për ndriçimin e mendjes.

Rol vendimtar në punët e ringjalljes sonë dhe të mbijetesës sonë si komb, patën gazetatat dhe librat shqip, që botoheshin jashtë Atdheut. Të mos ishin ato, nuk do të kish Rilindje dhe kjo është një arsye e fortë për të shprehur që ne shqiptarët, tani

që gazetat, mediat elektronike dhe librat i kemi jo jashtë por brenda Atdheut, së shpejti do të mund të kemi një **Neorilindje** mjaftësisht të fuqishme për t'u ngjitur në nivelet që i meritojmë. Rrënjët ngjallëse i gjelbërojnë dhe i rritin degët e Kombit. Natyrisht, nëse tregohet kujdesi i duhur.

15.Lidhja Shqiptare e Prizrenit është ai organizëm i cili, me një magji të habitshme, arriti t'i përçojë idetë intelektuale të Rilindësvet, te masa analfabete e shqiptarëvet. Jo më shumë se 1 apo 2 vjet jetë të asaj Lidhjeje, i kanë vlejtur Kombit tonë sa 1 shekull arsim universitar. Dikush thotë 250000, dikush thotë 500000 forca të armatosura qenë ngritur për të realizuar të paktën një autonomi. Ata ishin heronj të mirëfilltë. Ajo masë heronjsh nuk ka si të mos adhurohet. Mirëpo, pa *Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip të Stambollit* dhe pa *Shoqinë "Agimi" të Shkodrës*, asgjë nuk do të mund të realizohej.

16.Viti **1912** është viti i cili na mban gjallë të gjithë ne që vazhdojmë edhe sot të jemi shqiptarë. Ai erdhi ashtu si erdhi, duke i kapërcyer të gjitha greminat, duke u përballur me varre të panumërt foshnjash edhe grash, dhe duke mos ua hequr dot brezavet të mëpastajmë të tjera gremina e të tjerë varre. As bota ish e përgatitur për të na vënë në dyshek me pupla, as ne e kishim merituar parajsën në shtetin e sapothemeluar. Shteti që mundëm të sajojmë pas vitit 1912, ish më shumë një **bërthamë** e shtetit se sa një shtet i mirëfilltë. Askush nuk mund të pretendojë që e ka krijuar shtetin e mirëfilltë shqiptar. Mburria jonë ndalet vetëm te fakti madhor që, duke ecur në një terren gati të pashpresë, arritëm megjithatë ta krijojmë një **bërthamë** të shtetit tonë. Një pikëmbështetje, një shpresë. Dhe kjo është e mjaftueshme. Shqiptarët duhet ta festojnë në jetë të jetëve këtë ditë të lumnueshme.

17.Arsyeja pse nuk u krijua një shtet i mirëfilltë i shqiptarëvet, një shtet i plotë i yni, i cili madje duhej krijuar jo kaq vonë, në

sh XX, por edhe më parë, atëherë kur u krijuan shtetet e tjerë të Ballkanit, do kërkuar në faktin që, **vërtet në Kombin tonë ndodhi procesi i të rilindurit, por kjo, siç e thamë edhe pak parë, nuk do të thotë që u rilindën, u iluminizuan të gjithë shqiptarët.** Shqiptarë me mendje të mjegulluar dhe me shpirt të mykur pati me shumicë në vitet e Rilindjes, psh në Kuvendin e Dibrës të vitit 1880, dhe ka me shumicë edhe sot në vitin 2010 e do të ketë shumë të tillë edhe në të ardhshmen. Ka pasur dhe do të ketë midis nesh shqiptarë të pakthjellët, të parilindur kombëtarisht. Këtë duhet t'ia përsërisim vetes herëpas'here. Por kryesorja është që ne, me gjithë këto, arritëm deri këtu. Të gjitha këto rrënjë ngjallëse që i numëruam e që prapë nuk janë të gjitha, duhet të bëhen faktor jetëpërtëritës, për ta mbajtur edhe në të ardhshmen të gjelbërt pemën tonë nacionale. Dmth jetën tonë si qenie e gjallë.

DEGËT NJGJALLËSE TË KOMBIT SHQIPTAR

I. Degët dhe fletët ngjallëse të Kombit tonë, sot janë të shumta. Ndoshta jo më të shumta se kurrë më parë, por, sidoqoftë, të shumta. Janë të shumta, sepse, **veç çerekshtetit të Shqipërisë**, tashmë 100-vjeçar, kemi edhe **çerekshtetin shqiptar të Kosovës**, kemi **shqiptarët në shtetin Maqedoni**, faktor i rëndësishëm kombëtar, kemi **Anamoravën** që zien, kemi **lëvizjen çame** këtu në Republikën e Shqipërisë dhe në diasporë, kemi **Malësinë e Madhe** (pjesën e mbetur jashtë), **Kranjën, Ulqinin, Anën e Malit, Tivarin, Plavën**, gjithkund ka vatra patriotizmi. Vatra patriotizmi dhe individë patriotë ka edhe **midis ortodoksëve në Çamëri**, sado që ata nuk janë ende gjithaq të dukshëm. Mbetet vetëm për t'u organizuar dhe për të vepruar me më shumë efikasitet.

Diaspora shqiptare është sot shumë e interesuar për mbarëvajtjen e Atdheut. Atje ka bërë përshtypje shumë të madhe shpallja e Kosovës shtet i pavarur. Pas kësaj ngjarjeje madhore, diaspora pret, aspiron, përkrah dhe ndihmon ngjarje të tjera me përmbajtje patriotike. Ajo është gjithmonë e gatshme për t'u përfshirë në lëvizje, sepse asnjë i mërguar nuk ka burim tjetër frymëzimi e krenarie, përveç Atdheut.

II. Shqiptarët e mençur, kudo që ata ndodhen, janë **dega e parë gjelbëruese e Kombit tonë**. Ata, doemos, më qartë se kushdo e kuptojnë dhe e shohin sa të rëndësishëm janë përparimi dhe mbarëvajtja e Kombit. Rreth tyre, rreth njerëzvet të mençur, mbliidhen të gjithë dhe presin prej tyre, ç' do të thonë e ç' do të

bëjnë. Ata që vuajnë prej egoizmit, sado të mençur të duken, vetëkuptohet që nuk janë të mençur. Pra, nuk hyjnë në këtë kategori shqiptarësh.

Shqiptarët e zgjuar dhe të shkathët janë forca vepruese, forca e aksionit kombëtar në çdo kohë, pra edhe në kohën e sotme. Mjafton që ata të kenë motivim të mjaftueshëm atdhedhekombdashës. Mjafton që ata të mos kenë motive të gabuar, që energjia e tyre të derdhet në të kundërtën e interesave të Kombit tonë. Themi “*tonë*” sepse ka shumë që i derdhin energjitë në interesa të kombeve të tjerë.

Pas të mençurve dhe të shkathtëvet, vetëvetiu janë të prirur edhe **më pak të mençurit, edhe ata që nuk janë fort të zgjuar** e fort të shkathët. Mjafton që prijësit e tyre të jenë të sinqertë me ta.

Puna më e vështirë është me shqiptarët **dinakë e dredharakë**. Ata nuk kapen kollaj dhe nuk vihen dot në rrugë të mbarë pa përdorur metoda e taktika të veçanta, shpeshherë individuale. Por, nëse krijohet atmosfera e përgjithshme progresiste në mbarë Kombin tonë, edhe ata, pra dinakët dhe dredharakët, mund të shndërrohen në “*fletë të gjelbërta*”. Madje të tillët, kur ta kuptojnë që interesi i tyre është brenda Kombit të vet e jo jashtë tij, ndodh që bëhen edhe më aktivë se kushdo tjetër, dhe kjo nuk i sjell asgjë të keqe Lëvizjes Kombëtare. Mjafton që pjesa që udhëheq Lëvizjen, t’i mbajë gati gërshërët.

III.Në këndvështrimin social, **flamurin** e kombdheatdhepërtëritjes duhet ta mbajë dhe mund ta mbajë vetëm **klasa e të pasurve**. Ata që kanë qenë të zotë, në këtë kohë paskomuniste, të vënë pasuri të madhe, të nxjerrin veten dhe familjen e vet nga shkalla e mospasjes asgjë, në shkallën e një klase tashmë të pasuruar, ata janë dhe duhet të jenë në gjendje ta çojnë edhe Kombin tonë në shkallën që i takon midis

kombevet të tjerë. Nëse nuk do ta bëjnë këtë punë të pasurit shqiptarë, nëse ata nuk do ta kuptojnë që vetëm një komb i fortë shqiptar mund t'u sigurojë edhe atyre jetë të gjatë brez pas brezi dhe pasuri të qëndrueshme, Shqipëria nuk do të mund të rimëkëmbet kurrë. Kjo është logjika e punëvet. **Në një komb kapitalist janë kapitalistët ata që rrinë në krye.**

Luftërat që bëjnë të pasurit njëri me tjetrin, janë luftëra për të dalë secili në krye të Kombit tonë. Nëse do të kemi fatin që në krye të Kombit tonë të vihen **pasanikë patriotë**, shpëtimi ynë është i garantuar, nëse jo, Kombi ynë ka për t'u rrokullisur tatëpjetë dhe tatëpjeta e tij, jo mund, por me siguri do të na çonte në copëtimin edhe të shtetit që u miratua ndërkombëtarisht më 1913-n. Rrëziku më i madh në këtë mes është, që **zhbërësit** e Shqipërisë palën jopatriote e paguajnë mirë, ndërsa **mbrojësit** e Shqipërisë e të shqiptarëve nuk po e përkrahin as sa duhet, as si duhet palën patriote. Do cekur këtu që emërtimet: **patriot, më pak patriot** ose **jopatriot**, nuk nënkuptojnë asnjë parti, por vetëm individë të veçantë, të cilët gjenden në të gjithë organizmat, qoftë politikë, qoftë "**jopolitikë**".

E dyta forcë kombeatdhepërtëritëse janë qytetarët e mesëm, **shtetasit e mesëm**. Kushtet që shtetasit e mesëm, qytetarët e mesëm, ta japin të plotë kontributin e vet në veprën madhore të prosperitetit të Kombit tonë, janë 2: Ata t'i shkollojnë fëmijët e vet në gjuhën amëtare dhe: E vetmja parti për të cilën ata të votojnë, të jetë Kombi shqiptar.

Qoftë të pasurit, qoftë të mesmit, mund t'i çojnë fëmijët e vet edhe në shkolla të huaja, por baza e shkollimit të tyre duhet të jetë doemos **shkolla kombëtare**, që do të thotë: **Shkolla në gjuhën shqipe**, përfshirë aty historinë kombëtare, gjeografinë e Shqipërisë (Jo gjeografinë e ndonjë cope të Shqipërisë, por gjeografinë e krejt Atdheut tonë), dhe çdo gjë që i lidh ata me rrënjët e veta.

Njerëzit e shtresës së mesme vërtet nuk kanë fuqi vetjake, personale, për të kontribuar vendimtarisht në çështjet e Kombit të vet, por ata kanë në dorë potencialin e madh të të bashkuarit rreth Flamurit Kuq e Zi të Kombit. Shtresa e mesme, duke kultivuar patriotizmin në familjet e veta dhe në radhët e veta, mund të ndikojë vendimtarisht në krijimin e opinioneveve në masë, si dhe në orientimin kombëtar të politikës. Në kushtet e një demokracie reale, shtresa e mesme ka në dorë të sjellë në pushtet me anë të votave pikërisht ata njerëz që punojnë për Kombin. Prandaj edhe thamë që njëra prej 2 detyrave kryesore është që shtresa e mesme të mos ketë tjetër parti përveç interesave të Kombit. Shtresa e mesme nuk duhet të lidhet në asnjë rast me një parti të caktuar. Ajo duhet të jetë në gjendje në çdo 4 vjet, e ndonjëherë edhe më parë, ta rrëzojë çdo parti që nuk punon për shqiptarët e për Shqipërinë, qoftë edhe partinë, për të cilën ka votuar herën e kaluar. Dhe kjo nuk është pak, sidomos në qoftë se kjo shtresë ka në krye njerëz të mençur.

Ndërkaq, detyrat themelore të **shtresës së varfër** janë prapë 2: Të përpiqet për të dalë nga varfëria dhe të mos i kultivojë të fëmijët e vet përtacinë edhe vjedhjen. Të varfërit nuk guxojnë, nuk duhet, të pinë duhan. Të varfërit nuk guxojnë, nuk duhet, as për ditë feste të pinë alkol, se i vret mallkimi i fëmijëveve. Të varfërit nuk duhet as të shkulin në dyert e kafeneveve e të restoranteveve për të pirë e për të ngrënë. Nëse dëshiron të dalë nga varfëria, secili i varfër është i detyruar ta privojë veten nga çdo lloj luksi. Po vepruan kështu të varfërit shqiptarë, ata i kanë shërbyer Atdheut në masë të mjaftueshme.

IV. Në këndvështrimin e profileveve të profesionëveve është vështirë të thuhet se kush emban flamurin e kombeveveve të përparimit. Është e vështirë, por edhe **nuk duhet** të bëhet një klasifikim i tillë. Marrë në përgjithësi, janë **intelektualët iluministë** ata që i prijnë dhe që e mbajnë gjallë procesin e përparimit të Kombit.

Janë **gazetarët dhe punonjësit tjerë të mediave** ata më të shpejtët, më operativët dhe, për pasojë, më efikasët, janë **këngëtarët** dhe përgjithësisht krijuesit dhe **realizuesit e spektakleve**, edhe këta janë po aq e nganjëherë edhe më të efektshëm, janë **sportistët**, në shumë raste famërritësit më të bujshëm të Kombit të vet, janë **piktorët dhe skulptorët**, janë **shkrimtarët**, janë **shkencëtarët e fushave të albanologjisë**, janë **sociologët, politologët, filozofët, analistët, pedagogët, mësuesit**. Një force shumë e madhe e ripërtëritjes së Kombit është **inteligjenca teknike. Inxhinierët** e të gjithë profilevet, projektuesit dhe zbatuesit. Janë **juristët**, janë **mjekët**, janë **ekonomistët**. Çfarëdo pune që të bëjë, njeriu mund të bëjë dhe është i thirrur të bëjë edhe punë patriotike. Të shumtën e herëve kjo punë bëhet edhe pa folur. Kështu, askënd nuk mund ta vësh në krye, por askënd nuk mund ta lësh as në vend të dytë.

V. Duhet shtuar këtu edhe **klerikët** e të 3 konfesioneve në Shqipëri, të cilët kanë jo pak në dorë për të kontribuar në dobi të Kombit dhe Atdheut. Por, kur është fjala për kontributin e klerikëve në të mirë të Kombit e të Atdheut, ne duhet ta kuptojmë që ata e kanë shumë të vështirë ta kryejnë një të tillë detyrë. Të gjithë intelektualët e tjerë e kanë më të lehtë të veprojnë pozitivisht, sepse, në fund të fundit, kanë luftë vetëm me ndërgjegjen e vet. Ndërsa klerikët kanë edhe "**prangat**" e qendravet nga u vijnë urdhërat. Sa i përket Vatikanit, atje nuk duket se ka tendenca të denacionalizimit të besimtarëve katolikë. Në këtë vështrim, klerikët katolikë nuk e kanë aq shumë vështirë për të qenë njëkohësisht edhe fetarë, edhe atdhedashës e kombdashës. Ndërsa me klerikët myslimanë dhe me klerikët ofrtodoksë situata është krejt ndryshe.

Qendrat islamike kanë tendencën e depërtimit drejt vendeve të Evropës. Strategjia e tyre është të realizojnë në Evropë e Botë atë që nuk e kanë realizuar dot në Mesjetë. Shqipërinë ata e gjejnë

si një terren të gatshëm për ta realizuar këtë strategji. Prandaj dhe vepronë në të gjitha format, që nga ajo e “*modernizimit*” të Kur’anit, e shkollimit sa më cilësor të klerit të ri, deri te financimi me para në dorë i bartësve dhe i ruajtësve të islamizmit. Në këtë mënyrë, Shqipëria bëhet jo vetëm plasdarm i strategjisë islamike, por edhe vendi më i rrezikuar prej antiislamikëve sllavë edhe grekë.

Qendrat ortodokse kanë strategjinë, jo të përdorimit të shqiptarëve për ndonjë qëllim më të gjërë, por thjeshtë të zhdukjes sonë si komb. Nëse jemi katolikë, ata duan të na minimizojnë ose të na përzënë që këndeje me marifet. Arqipeshkinë e Tivarit ata e përshkruajnë si arqipeshkvi të tyren, pa qenë kurrë vetë katolikë. Se si mund të jetë një arqipeshkvi katolike e dikujt që s’është vetë katolik, këtë vetëm ata e dinë. Nëse jemi myslimanë, ata duan të na shfarosin ose të na dëbojnë me dhunë. Nëse jemi ortodoksë, ata duan të na greqizojnë dhe ta quajnë Greqi krejt vendin tonë, mundësisht deri në Tiranë e në Durrës.

Veprimtaria antishqiptare e qendrave ortodokse është qartësisht e dukshme.

Greqia po ndërton kisha në vendin tonë, duke shpenzuar beton më shumë se ç’ka shpenzuar Enver Hoxha për bunkerët dhe po u jep pensione falas të gjithë atyre shqiptarëve që pranojnë të quhen “*vorioepirotë*”, që sipas tyre do të thotë “*greqë*”.

Sllavomaqedonët po ndërtojnë manastire në vendin tonë, në të gjithë territorin ku banojnë e ku nuk banojnë shqiptarë. Nisuni nga Ohri në drejtim të Resnjës e Manastirit: Gjithkund do të gjeni manastire të vetmuar, pa njerëz rrethrotull, në të cilët ditë e natë nuk pushon muzika kishtarë sllave, e inçizuar në disqe CD. Ne, ndërkaq, po mundohemi t’i mundim sllavomaqedonët me xhami. Por me xhami nuk i mundim dot as sllavët, as dikënd tjetër.

Sërbët po duan dhe po ia arrijnë t’i kthejnë në prona të tyre

manastiret që na i kanë rrëmbyer në sh XIII. Qëllimi i tyre nuk është të ruajnë fenë në Kosovë, as kulturën e tyre mesjetare, por të ruajnë “**të drejtën**” për ta rimarrë Kosovën. Të njëjtën metodë për ta rimarrë “**një ditë të bukur**” edhe Shkodrën, po e përdorin sërëbët, duke ndërtuar aty kisha pravosllave dhe duke kërkuar “**të drejta**” për “**minoritetin sërb**”, për të cilin e dinë edhe ata që nuk ekziston.

Parë në këtë prizëm, klerikët tanë myslimanë dhe ortodoksë e kanë tepër vështirë të veprojnë si patriotë të mirëfilltë shqiptarë. Ata madje e kanë të vështirë të veprojnë edhe si fetarë të mirëfilltë, sepse qendrat e tyre i duan më shumë militantë se sa fetarë. **Nëse kërkohet të bëhesh militant i dikujt, bëhu militant i Atdheut tend.** Në kohë të shkuara ne kemi pasur shumë raste klerikësh mirëfilli patriotë, edhe midis ortodoksëve, edhe midis myslimanëve, edhe midis katolikëve.

VI. Kërkesë për të gjithë intelektualët të Kombit tonë është: Të mos largohen prej Kombit të vet. Të mos bëjnë asgjë kundër interesave të Kombit të vet, qoftë edhe kur paguhen. Këtu domosdoshmërisht duhet të përfshihen edhe tendencat ekstreme të antimoralit perendimor. Shqiptarëve u ka rënë për hise, o të bëhen pre e të gjitha të këqiavet, o të kenë kujdes e të ruhen. Intelektuali, nëse nuk dëshiron ta shikojë të tharë pemën e Kombit të vet, duhet të jetë në radhë të parë për vete “**fletë e gjelbër e kësaj peme**”.

Nuk besojmë të pengojë figuracioni për ta kuptuar idenë.

INSTITUCIONI I PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE Shqetësimi alarmues

Krejt çka kemi parashtruar deri tani, na çon në disa konkluzione tepër të rëndësishëm. Tepër të rëndësishëm, por edhe tepër shqetësues njëkohësisht.

1.Kombi shqiptar, në të kaluarën, ka qenë disa herë i rrëzuar për t'u zhdukur. Filluar që nga kohët para se të merrte këtë emër e deri më sot, ky komb, kjo etni, ka ardhur në ngushtim të vazhdueshëm, në një ngushtim vërtet alarmues, shoqëruar jo me muzikë dasmash, por me funerale copërash toke dhe turmash njerëzish. Mbështetur në krejt ato që na kanë ndodhur dhe duke i analizuar shkaqet pse na kanë ndodhur, ne arrijmë në konkluzionin se edhe në të ardhshmen, nëse nuk merren **masa shumë serioze**, ne prapë do të shkojmë drejt ngushtimit, drejt pakësimit, drejt asimilimit dhe përfundimisht në një fshirje krejt të palavdishme.

2.Faktorët që na kanë çuar në një të këtillë përfundim alarmues, janë disa: a.Shtetet dhe kombet fqinjë me ne, janë jomiqësorë dhe jodashmirës ndaj nesh (Shprehje këto shumë të buta, por që ne nuk po duam t'i themi ndryshe) b.Të gjithë shtetet e mëdhenj, të cilët kanë mundësi të na përkrahin dhe do të duhej të na përkrahnin më fuqishëm, duket se kanë më shumë interesa të lidhen me fqinjët tanë se sa me ne. Ose të paktën ashtu u duket atyre. c.Vetë ne nuk po tregohemi as të vëmendshëm, as energjikë, as të rregullt dhe as të denjë për të merituar përkrahjen e të tjerëvet. Madje strukturat tona të të gjithë niveleve, nuk po janë në gjendje të sigurojnë simpati reale as prej popullit të vet.

3. Atdheu i shqiptarëvet vazhdon të jetë i ndarë në 6 shtete dhe asnjëri prej këtyre shteteve nuk është në gjendje, nuk i ka potencialet as politike, as ekonomike, as kulturore e as ushtarake, për t'u përkujdesur efektivisht për 5 pjesët e tjera. As të 2 së bashku, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, nuk i kanë ata kapacitete.

4. Kombi ynë është i ndarë në 3 fe të ndryshme dhe asnjëra prej këtyre feve nuk i ka prerogativat për të marrë përsipër përkujdesjen shpirtërore ndaj krejt Kombit tonë. Bashkësia Islame nuk mund të përkujdeset për ortodoksët e për katolikët, Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare nuk mund të përkujdeset për myslimanët e për katolikët, madje ajo aktualisht po punon edhe kundër besimtarëvet të vet. Kisha Katolike Shqiptare gjithashtu nuk i ka ato mundësi. Në këtë mënyrë, roli i fevet në Kombin tonë mbetet vetëm ai i shkuarjes mirë njëra me tjetrën. Por kjo nuk është e mjaftueshme dhe, për më keq, shkuarja mirë midis tyre mund të mos jetë e përjetshme.

5. Kombi Shqiptar, **edhe mbasi të jetë inkuadruar në Bashkimin Evropian**, duke mos qenë i njësuar as shtetërisht as fetarisht (dhe duke manifestuar gjithë këto të meta të të gjithë llojevet), **do të mbetet përsëri i rrëzuar.**

Si dëshmi për këtë le të marrim vetëm gjendjen e ortodoksëvet shqiptarë dhe të arvanitëvet në shtetin grek. Megjithëse shteti grek ka vite që është anëtar i Bashkimit Evropian, as ortodoksët shqiptarë të atij shteti, çamët etj, as arvanitët, që gjithashtu janë ortodoksë, nuk i kanë as 3 elementët më të domosdoshëm që duhet t'i gëzojë çdo etnitet në një bashkësi demokratike: Regjistrimin si shqiptarë ose si arvanitë, shkollimin në gjuhën amëtare dhe liturgjinë në gjuhën amëtare. Të mos flasim pastaj për parti nacionale, për pëfaqësimin komunitar në parlament, për shtypin në gjuhën amëtare apo për median elektronike në gjuhën amëtare. Ata s'kanë asgjë. U rruat që janë në BE!

6.Rrjedhimisht, brezi i sotëm i shqiptarëvet është i detyruar të bëjë diçka. Ai është detyruar të gjejë rrugë shpëtimi e konsolidimi, në mënyrë që në të ardhshmen të mos na ndodhin tragjedira siç na kanë ndodhur në të kaluarën.

I shqetësuar në këtë mënyrë, autori i këtij parashtrimi është i mendimit që ne **duhet sa më parë të krijojmë një institucion tonin gjithshqiptar**, i cili të veprojë sipas një **strategjie**, jo më të lidhur me 1 shtet të vetëm, as me 2 shtete, jo më të lidhur me 1 a 2 territore, jo më të lidhur me 1 apo 2 parti dhe jo më të lidhur me njërën prej fevet, por të lidhur me krejt Kombin tonë kudo që ai jeton.

Ky institucion duhet të jetë **institucioni i përkujdesjes së gjithanshme** shpirtërore, edukative, arsimore, ekonomike, juridike, artistike, sportive, të mbrojtjes etj.etj, mbi të gjitha: propagandistike, politike e diplomatike, për secilin shqiptar a grup shqiptarësh, të cilëvet mund t'u paraqitet nevoja për një të tillë përkujdesje dhe për secilën pjesë të vendit të tyre.

Synimet strategjike

1.Të përmirësojmë individin shqiptar. Kombi përbëhet prej individësh. Pa individ të përparuar nuk ka Komb të përparuar. Një Komb i mirë përbëhet prej individësh të mirë.

2.Të përmirësojmë, zbukurojmë e ruajmë mjedisin ku jetojmë. Atdheu përbëhet prej pjesësh. Sa më shumë pjesë të tija të jenë të bukura, ekonomike dhe të këndshme për të jetuar aty, aq më i bukur, ekonomikisht i levërdishëm dhe i kënsëm për të jetuar aty, është Atdheu.

3.Të përkujdesemi njëkohësisht, si për pjesët, ashtu edhe për tërësinë tonë. Kur një pjesë e Kombit dhe e Atdheut nuk është mirë, krejt Kombi e Atdheu nuk janë mirë. Me fjalë tjera, kjo thuhet kështu: Të mbrojmë të drejtat dhe dinjitetin e secilit shqiptar dhe të secilës pjesë të Shqipërisë. Nëse sot guxon dikush të shkelë të drejtat dhe dinjitetin qoftë edhe të një shqiptari të

vetëm apo të një pjese të Shqipërisë, e pjesët e tjera nuk ndjehen, nesër vjen radha e individëve të tjerë dhe e pjesëve të tjera.

4. Të shkojmë mirë njëri me tjetrin. Të punojmë për të zgjidhur me drejtësi çdo mosmarrëveshje para se të ndodhin tragjeditë. Të krijojmë osmozën e mirëkuptimit e të harmonisë gjithshqiptare.

5. Të shkojmë mirë me kombet që na rrethojnë dhe me të gjithë kombet e tjerë të Botës. (Natyrisht, nëse edhe ata duan). Të punojmë për të zgjidhur me drejtësi çdo mosmarrëveshje me kombet që na rrethojnë dhe me të gjithë të tjerët.

6. Të ngrejme autoritetin dhe dinjitetin e Kombit e të Atdheut tonë në shkallën më të mundshme të barabartësisë me të tjerët. Nuk duhet të ketë arsye që të jemi poshtë kombeve të tjerë në asnjë aspekt.

7. Të mos lejojmë që Kombi ynë të zvogëlohet edhe më tej dhe të mos lejojmë që Atdheu ynë të ngushtohet edhe më shumë. Të bëjmë kujdes që edhe në rethana *“paqësore”* e *“superdemokratike”*, të mos **përvidhen** në Atdheun tonë etnitete të huaj. Se mjaft toka në janë marrë deri tash, dhunisht, por edhe *“paqësisht”*.

Kjo do të thotë: Jo vetëm **të parandalojmë luftërat**, të cilat në vendin tonë, në të gjitha kohët janë shoqëruar me masakra rrënqethëse, por edhe t’u bëjmë ballë përditshmërisht mijëra veprimeve të përditshëm dhe fjalëve të pëditshme, që në të katër anët kryhen e thuhën kundër nesh. Kryhen e thuhën, mjerisht, edhe prej vetë nesh.

E gjithë kjo punë, që nga pika 1 deri në pikën 7, është aq e vështirë, sa shqiptarëve të sotëm do t’u duhen e pakta **10000 heronj** vetëprivues e ndonjëherë edhe vetëmohues, për ta vënë në vijë këtë punë.

Probleme të organizimit.

Problemi nr. 1: Si dhe për çdo organizim tjetër, edhe për organizimin e Institucionit të Përkujdesjes Gjithëshqiptare, **duhen para.** (Shkurt do t'i themi *Përkujdesje*, zyrtarisht ndoshta, nga halli: *organizatë* apo *shoqatë*) **Pa para nuk ka kurrfarë organizimi.** S'ka nevojë të zgjatemi në këtë pikë. Do të shohim në kapitujt e mëtutjeshëm sa shumë para do të duhen. E vumë si pikë të parë këtë **problemin e madh të paravet**, nxitur edhe prej 2 të vërtetavet tona shumë të rënda: 1.Ka shqiptarë që flasin për patriotizëm, por mendjen e kanë te **përfitimet** që nxjerrin prej "*patriotizmit*". 2.Ka shqiptarë të tjerë që i japin 5 lekë dhe pastaj mburren sikur i kanë bërë shërbime të jashtzakonshëm Atdheut.

Organizuesit e *Përkujdesjes*, si dhe të gjithë të tjerët që do t'u shkojnë pas, as kanë ndërmend të pasurohen me këso mënyrash, as kanë ndërmend të mburren se kanë bërë sakrifica të mëdha. Paratë i duhen *Përkujdesjes* vetëm për të bërë punët dhe për asgjë tjetër. (**Përfitim ekonomik** natyrisht që kërkohet të ketë, por ai do të jetë **i tërthortë dhe gjithkombëtar**, jo drejtpërdrejtë i një grupi organizuesish: as i krerëvet, as i anëtarëvet.) Për këtë arsye, të gjitha paratë që do të mblidhen, do të dihet kush i ka dhënë, kur i ka dhënë dhe sa ka dhënë. Edhe 100 lekë të vjetër në i pastë dhënë dikush, atij do t'i jepet dokumenti përkatës dhe pastaj, emri i tij bashkë me shumën, do të nxiret në gazetë, përjashtuar rastet kur dhënësi nuk dëshiron të publikohet. E njëjtë do të jetë edhe transparenca e shpenzimevet. Të gjithë shpenzimet duhet domosdoshmërisht të publikohen ose, për raste të veçantë, të arsyetohen me komunikata të brendshme.

I themi këto gjëra, sepse në lëvizjen tonë kombëtare të dekadavet të fundit, janë vënë re shumë raste të pakëndshëm, deri edhe revoltues, kur njerëzit kanë dhënë paratë dhe s'është marrë vesh ku kanë shkuar ato para. Në disa ambiente, midis mërgimtarëvet tanë (sepse brenda Atdheut as që janë organizuar

donacione të kësaj natyre), ka shkuar puna deri atje, sa është thënë me zë të lartë: ***Boll, se nuk japim më asnjë cent ! Kushdo që vjen për të na takuar, nuk vjen se na do shumë, por sepse i duhen para.*** Kësaj gjendjeje natyrisht i duhet dhënë fund. ***Përkujdesja Gjithkombëtare***, o duhet të vendosë drejtësi edhe në këtë aspekt, ose ajo as që do të mund të themelohet.

Të gjithë e dimë sa shumë para janë duke shpenzuar në dëm të Kombit tonë dhe në emër të kuazinacionalizmit të tyre, fqinjët tanë, ata që i kanë hartuar prej kohësh **strategjitë e tyre**. Madje edhe në emër të gjoja përkatësisë së tyre **fetare!** I ndëshkoftë Zoti, ata që e përdorin fenë për të dëmtuar popujt e tjerë! Ne, ndërkaq, nuk do t'i përdorim paratë tona për të dëmtuar popujt e tjerë. Ne do t'i përdorim ato për të shpëtuar shqiptarët nga zhbërja, nga dekompozimi.

Problemi nr. 2: Fillimi i punës. Nuk është lehtë të fillohet puna, megjithatë, gjykuar nga fakti që një shumicë shqiptarësh e kanë kuptuar tashmë që **duhet bërë diçka**, se nuk na mbetet shumë kohë për të pritur, kjo nismë, sidoqoftë, duhet të realizohet.

Opcion: Takohen diku 4-5 miq, atdheekombdashës të sigurtë, e diskutojnë çështjen, caktojnë një kryetar nismëtar, hapin një numër llogarie në një bankë dhe e publikojnë njoftimin apo thirrjen përkatëse. Në njoftim apo thirrje do të thuhej edhe kjo: ***Të gjithë ata shqiptarë që dëshirojnë të bëhen pjesë e Përkujdesjes Gjithshqiptare, të derdhin në numrin e sapohapur të llogarisë kuotën e vet vjetore të anëtarësisë: 2400 lekë të rinj, 24 euro, 24 franga, 24 paund, 24 dollarë, 24 jenë, gjithëmonë përafërsisht sa vleftha reale e 2400 lekëvet të rinj.*** Nëse kjo kuotë konsiderohet e pakët, atëherë grupi nismëtar anoncon një kuotë tjetër.

Sapo të mblidhet një shumë e caktuar dhe sapo të bëhen aq nismëtarë sa duhen për legalizimin e institucionit ("*joqeveritar dhe jofitimprurës*"), duhet të fillojë puna e **legalizimit**, në secilin

shtet sipas ligjeve të atij shteti. Që këtu fillojnë pengesat.

Fillojnë pengesat, sepse në shtetin grek ne kërkojmë që arvanitët të regjistrohen në dokumentet e identitetit si arvanitë, shqiptarët ortodoksë në Çamëri e gjetkë të regjistrohen si shqiptarë, për të gjithë këta kërkojmë që të ketë shkolla shqipe dhe liturgji në shqip. A do ta lejojnë qeveritë greke një organizatë me një program të këtillë?

Në shtetin turk ne do të kërkojmë që të gjithë shqiptarët e atjeshëm të regjistrohen në dokumentet e vet si shqiptarë e jo si turq. Për të gjithë ata shqiptarë, ne kërkojmë që të hapen shkolla shqipe të të gjithë niveleve. A do ta lejonë qeveritë turke të cilitdo spektër një organizatë me një program të këtillë, ndonëse kjo do t'i bënte mirë, jo në radhë të parë, por fill pas nesh, vetë Turqisë?

Në shtetin serb ne do të kërkojmë që, bazuar në numrin e zgjedhësve, sa deputetë serbë të ketë në parlamentin e Prishtinës, aq deputetë shqiptarë të ketë në parlamentin e Beogradit. Ne do të kërkojmë që, në Sëri, të gjithë monumentet e kohës ilire, që nga varrezat tumulare deri te kështjellat apo bazilikat paleokristiane, të shpallen monumente të kulturës iliro-shqiptare dhe të vihen nën mbrojtjen e shtetit. Nëse serbët kërkojnë universitet serb në Prishtinë dhe në Mitrovicë, ne do të kërkojmë universitet shqiptar në Preshevë dhe në Beograd. A do ta lejojnë qeveritë serbe një organizatë me një program të këtillë?

Në shtetin e Maqedonisë, nëse sllavomaqedonët kërkojnë që fëmijët e atjeshëm shqiptarë të fillojnë për ta mësuar gjuhën sllavomaqedone qysh në klasë të parë, ne do të kërkojmë që edhe fëmijët sllavomaqedonë të fillojnë për ta mësuar shqipen që në klasë të parë. Nëse ata kërkojnë që fëmijët tanë atje të fillojnë për ta mësuar sllavomaqedonishten që në klasë të katërt, ne do të kërkojmë që edhe fëmijët e tyre të fillojnë për ta mësuar shqipen që në klasë të katërt. Vëç kësaj, ne do të kërkojmë që në sheshin kryesor të Shkupit të ngrihet monumenti i Justinianit të Madh,

monumenti i Belizarit, monumenti i Nënë Terezës, monumenti i 20000 shqiptarëve që e çliruan Shkupin prej osmanëve më 18 gusht 1912, në Manastir do të kërkojmë të ngrihet monumenti i Qiriazëve dhe i Bajo Topullit. Në Ohër na duhet një përmendore e madhe e Gropajvet. A do ta pranojnë sllavomaqedonët një organizatë të këtillë, e cila realisht nuk do të ketë asgjë kundër tyre?

Në Mal të Zi ne do të kërkojmë shkolla shqipe për të gjithë shqiptarët që jetojnë në Tivar e në Podgoricë dhe do të kërkohet që rrënojat e Dioklesë e të Meteonit, mozaikët e Rizonit etj. të shpallen trashëgimi kulturore e shqiptarëve. A do ta lejojnë qeveritë malazeze një organizatë me një program të këtillë?

Por, nëse nuk duam që sllavët jodemokratikë të vazhdojnë ta quajnë Kalanë e Rozafës kështjellë sërbe, nëse nuk duam që grekët jodemokratikë të vazhdojnë ta quajnë Shqipërinë Jugore (Vorio Epirin) tokë greke, dhe në fund, edhe njëherë edhe tjerët t'i bëjnë realisht të tyret këta vende, ne jemi të detyruar të kërkojmë legalizimin e organizatës sonë ***Përkujdesja Gjithshqiptare***, si i vetmi opcion i mundshëm për t'u pranuar prej të gjitha forcave demokratike të mirëfillta.

Problemi nr.3: Anëtarësia, armatë gjithndryshuese apo psherëtimë dhe rënkim i një pakice shqiptarësh frymëfikur?! Doemos, armatë gjithndryshuese! Opcioni ynë është opcion i optimal i mundshëm, për ta vënë Kombin tonë në rrugën më të garantuar të prosperitetit. Ky opcion nuk mund të ketë qortime përsa i përket bazës themelore dhe parimevet kryesorë. Mund të ketë vetëm përmirësime në elementë të veçantë.

Nisur nga kjo domosdoshmëri jetike, ne kërkojmë që **asnjë shqiptar të mos mbetet pa u bërë anëtar i Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Të parët në kohë do të jenë, sigurisht, ata shqiptarë që prej kohësh digjen për të pasur një formë organizimi sa më efikase. Këta janë nismëtarët dhe themelvënësit.

Shikuar në aspektin e rëndësisë, anëtarët që këtij organizimi

të madh do t'i jepnin pamjen e seriozitetit e të përkushtimit, të qëndrueshmërisë dhe të forcës, do t'ishin: Presidentët dhe ish-presidentët e Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, kryeministrat, ministrant, kryeparlamentarët dhe parlamentarët, kryeushtarakët, diplomatët, kryepartiakët, kryeklerikët, akademikët, profesorët që mbajnë tituj të lartë shkencorë, shkrimtarët e spikatur, kryegjiqtarët, avokatët, prokurorët, kryegazetarët, kryeaktorët, kryekëngëtarët, kryemuzikantët, kryesportistët, artistë të merituar, personalitete që mbajnë titullin “**Nderi i Kombit**”, presidentët e kompanivet tona të ndërtimit, të industrisë, të tregtisë, kryepronarët që tashmë nuk i mungojnë Kombit tonë, producentë të ndryshëm, kryebankierë. Të gjithë këta do t'ishin **anëtarë të rregullt, por edhe anëtarë nderi të Përkujdesjes sonë Gjithshqiptare**. Ashtu siç është një president i Greqisë edhe besimtar i Kishës Ortodokse Greke, ashtu siç është një president i Sërbisë edhe besimtar i Kishës Pravosllave Sërbe, ashtu një president i yni, një kryeministër, një kryetar partie, pa u penguar që të jetë besimtar i njëjës prej fevet tona ose edhe jopjesëtar i ndonjë feje tradicionale, do ta ketë për **detyrë patriotike** të jetë edhe anëtar i **Institucionit të Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Do ta ketë për nder e, njëkohësisht, edhe Përkujdesja Gjithshqiptare do të jetë e nderuar prej tij.

Nëse këta personalitete nuk do të bëhen pjesë e këtij organizimi, kjo do të jetë shenja më bindëse që Kombit tonë i mungon tragjikisht elita kombeatdhedashëse. Kjo do të jetë njëkohësisht një shenjë e dhimbshme që Kombi ynë nuk ka për t'u rimëkëmbur, sado që fitues të ndryshëm të zgjedhjevet mund ta reklamojnë veten si promotorë të suksesevet tanë, të paparë ndonjëherë.

Në anë tjetër, nëse **Përkujdesja jonë Gjithshqiptare** do të mbushet me **anëtarë të rregullt** e njëkohësisht **anëtarë nderi**

të **këtij niveli**, kjo do të jetë shenja më shpresëdhënëse që shqiptarëvet po u çelet një rrugë e ndritur drejt së ardhshmes. Le të shpresojmë që do të jetë kështu!

Anëtarë të tjerë të ***Përkujdesjes Gjithshqiptare*** duhet të bëhen të gjithë ata shqiptarë që i kanë mundësitë për t'ia dhënë kësaj ***Përkujdesjeje*** 24 euro në vit, qoftë edhe me shtërngime në shpenzimet e tjerë. Le t'i lënë disa kafe a disa birra pa i pirë, le t'i zvogëlojnë sadopak qokat e dhuratat dhe le t'ia paguajnë ***Përkujdesjes*** anëtarësinë e vet, sepse është pikërisht kjo ***Përkujdesje***, e cila do t'u sjellë shqiptarëvet ditë më të mira e më të sigurta në të ardhshmen.

Në rrethanat në të cilat jetojmë ne, është e pritshme që të ketë edhe të atillë shqiptarë që do të duan të bëhen anëtarë të këtij **Institucioni**, por që nuk do të dëshirojnë apo nuk do të mundin ta shpallin botërisht anëtarësimin e vet. Këta do të jenë **anëtarët ilegalë**, pranimin e të cilëve do të mund ta kryejë vetëm **Kryepaqësia e Përkujdesjes ose Komiteti**.

Po kjo **Kryepaqësi ose Komitet** do të mund të pranojë, me një procedurë fare të thjeshtë, edhe të atillë anëtarë, të cilët të kaluarën e vet nuk e kanë pasur të mirë. Dera e kontributit në dobi të Kombit nuk mund dhe nuk duhet t'i mbyllet askujt. Të punosh për Kombin e për Atdheun, nuk është asnjëherë vonë. Shërbimi ndaj Atdheut dhe Kombit është mënyra më e mirë për të shlyer çdo njollë që dikush mund t'i ketë vënë vetes.

Kryepaqësia e Përkujdesjes Gjithshqiptare ose Komiteti do ta quajë të suksesshëm misionin e vet, vetëm atëherë kur anëtarësia e këtij organizimi madhor gjithshqiptar do të ketë arritur numrin **500000 (pesë milionë)**, shifër kjo e përafërt me 30% të krejt numrit të shqiptarëvet që sot jetojnë në Atdheun e vet dhe nëpër Botë.

Problemi nr.4: Puna në terren duhet të bëhet me **grupe**

qindësh. Sigurisht, jo strikt, por me më pak, efekti do t'ishte mjaft i mangët, kurse me më shumë, prapë efekti vjen duke rënë. Megjithkëtë, atje ku s'janë mundësitë, grupet mund të pranohen edhe më të vegjël, kurse atje ku terreni e kërkon një gjë të tillë, grupet mund të jenë edhe pak më të mëdhenj.

Në krye të çdo grupi, organizuar sigurisht mbi bazën e vendbanimit, qëndron zakonisht **një njeri i ditur**. Mund të jetë me shkollë të lartë, mund edhe të mos jetë. Me **qindëshen** e vet ai ka për detyrë të organizojë 60 veprimtari në vit: 1 në çdo javë dhe disa të tjera në ditë të shënuara: **Dita e Flamurit**, absolutisht e domosdoshme dhe sa më madhështore; **Dita e Kosovës**, me të njëjtat përmasa; **Dita e Shkollës Shqipe**; **Dita e Themelimit të Përkujdesjes**; **Dita e të Rënëvet dhe e të Masakruarvet**.

Në të gjitha kryejavët dhe në të gjitha këto ditë, kryesuesi i **Qindëshes Përkujdesëse**, fillimisht duhet të bëjë takim me grupin e vet këshillues. *Kemi këto gjëra që na kanë ndodhur në vendbanimin tonë: Këta e këta banorë tanë (ose bashkëkombas tanë) janë pa punë, kemi këta fëmijë që nuk shkojnë në shkollë, kemi këta raste që drogohen, filani ka një problem në familje, midis 2 familjeve filan e filan ka filluar sherri. Ç'të bëjmë, që të mos shkojë puna deri te ngjarje edhe më të pakëndshme e, prite Zot, edhe deri te ndonjë vrasje?! Një varg tjetër problemesh: Papastërtia në vendbanim, ujësjellësi, taksat, fusha e sportit, reklamat në gjuhë të huaja. Nga Qendra e Përkujdesjes kemi marrë këta udhëzime apo qortime. Cilët nga këta shqetësime do t'i publikojmë sot dhe me cilët do të meremi veç e veç pa i publikuar? Cilin nga anëtarët tanë do të porositim për të folur me filanin që rri gjithë kohën i dehur?* Bëhen edhe letra apo kërkesa zyrtare dhe me kaq mbaron takimi me grupin këshillues.

Pjesa tjetër e aktivitetit është në ambientin ku mblidhen njerëzit, zakonisht kafe-pijetore ose restorant. Një anëtar i **Përkujdesjes** mund ta ketë lëshuar atë me pagesë ose duke

llogaritur xhiron ditore përkatëse. Në fillim kreu i grupit mban një bisedë në lidhje me Kombin e me Atdheun tonë. Ai duhet të ketë informacion të bollshëm nga historia e iliro-arbroshqiptarëvet, duhet të njohë gjeografinë e Shqipërisë, të ketë dijeni mbi ngjarjet aktuale që lidhen me Kombin tonë, të njohë veprat e çdo shkrimtari apo shkencëtari shqiptar, të njohë artistët, të njohë sportistët, gazetarët. Për këtë arsye secilin krye të grupit zakonisht e thërresin: **Profesor**.

Mbas fjalës së **Profesorit**, duhet të ketë një koncert ose spektakël tjetër me përmbajtje artistiko-patriotike. Mund të shoqërohet e gjithë kjo veprimtari modestisht edhe me të pirë e me të ngrënë. Vendimet e përbashkët i përcillen medias elektronike dhe asaj të shkruar.

Kreu i grupit të çdo qindësheje merr një shpërblim fare modest vjetor sa gjysma e kuotave që janë mbledhur nga anëtarësia e po asaj qindësheje. Por secila **Qindëshe Përkujdesëse**, sipas mundësive e rrethanave, duhet të sigurojë edhe donacione prej atyre anëtarëve apo simpatizuesve, të cilët janë në gjendje ta ndihmojnë organizatën tonë. Gjysmën e donacioneve çdo grup është i detyruar t'i arkëtojë në llogari të **Qendrës**. Në krye të çdo viti, i cili llogaritet nga muaji i themelimit, bëhen votimet për kreun e grupit, për **profesorin**, votime të cilët **doemos** duhet të jenë **të fshehtë**, dhe ku duhet të marrë pjesë 1 (vetëm 1) i deleguar i **Kryepëqësishë**.

Në secilin prej 6 shteteve ku banojnë shqiptarët, kuptohet, ka probleme specifike nga më të ndryshmit. Të gjitha qindëshet përkujdesëse veprojnë sipas situatave ku ata jetojnë dhe sipas problemeve që u dalin. Shqiptarët në diasporë kanë gjithashtu secili problemet dhe specifikat e veta.

Veç festave që i përmendëm, në shtete të ndryshëm mund të ketë edhe festa të tjera. Psh në Turqi, **Dita e Shqiptarëve të Turqisë**. Në Greqi, **Dita e Arvanitëve**, **Dita e Çamërisë së**

Vëllazëruar, në Itali, **Dita e Arbëreshëvet të Italisë**, në Kroaci, **Dita e Arbëneshëvet të Zarës**, në Ukrainë, **Dita e Shqiptarëvet të Ukrainës**, në Rumani, **Dita e Shqiptarëvet të Rumanisë**, në Bullgari, **Dita e Shqiptarëvet të Bullgarisë**. Në të gjithë mërgatën, po edhe në Atdhe, mund të përkujtohet përbashkësisht edhe **Dita e Mërgimtarëvet Shqiptarë**.

Të gjithë grupet e Përkujdesjes Gjithshqiptare mund dhe duhet të organizojnë **protesta të koordinuara** për ngjarje apo probleme shumë të rëndësishëm të Kombit tonë. Por këto bëhen me orientim nga **Kryepaqësia**, e cila normalisht duhet ta ketë selinë o në Tiranë, o në Prishtinë, ose në Prizren, në vendin ku edhe është sendërtuar i pari autoritet i yni madhor gjithkombëtar.

Problemi nr.5: Autoriteti Qendror i Përkujdesjes Gjithshqiptare (i cili mund të quhet edhe **Komiteti i Përkujdesjes Gjithshqiptare**), do të kishim dëshirë që t'i ngjante, simbolikisht, po edhe përmbajtësisht, **KOMITETIT TË STAMBOLLIT për mbrojtjen e të drejtave të Kombësisë Shqiptare**, krijuar në dhjetor të vitit 1877, i cili përbëhej prej 9 anëtarësh: **Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vretoja, Zija Prishtina, Ahmet Koronica, Mihal Haritoja, Mehmetali Vrioni, Iljazpashë Dibra**. (Krs. *Univers*, 2002, nr.2, f.151). Pikërisht për nder të atyre **BURRAVE, shpëtimtarë të Kombit tonë**, që menduan e punuan për Shqipërinë në ditët e saja më të bukura të rilindurit e njëkohësisht më të vështirat, ky **Komitet i Përkujdesjes Gjithshqiptare** duhet të ketë gjithashtu **9 anëtarë. 9 anëtarë**, të cilët për asnjë çast të mos harrojnë se duhet t'u ngjajnë atyre.

Organi më i lartë ndërkongresor i **Institucionit ose i Autoritetit të Përkujdesjes Gjithshqiptare** është **Këshilli i Përgjithshëm i Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të Përkujdesjes Gjithshqiptare janë të gjithë **lektorët** (për të cilët do të flitet pak më poshtë) dhe të gjithë

kryetarët e grupevet qindësh të Përkujdesjes. Anëtarë nderi janë, gjithkështu, të gjithë **personalitetet** e atashuar (për të cilët gjithashtu do të flasim pak më poshtë). **Këshilli i Përgjithshëm** bën **kongresin** e vet 1 herë në 5 vjet ose, në raste të ngutshëm, edhe më shpesh.

Pranë **Autoritetit Qendror**, pranë **Kryepleqësisë**, duhet të veprojë një **administratë** sa më e kompletuar, ndryshe strategjia e **Përkujdesjes Gjithshqiptare** nuk mund të zbatohet me efikasitetin e duhur. Aty janë: Sektori i **informacionit**, (Në sektorin e informacionit veprimtari më vete përbën të informuarit mbi çdo gjë që thuhet e shkruhet **rrotull nesh** e që lidhet me ne. Psh si janë hartuar tekstet shkollorë të historisë dhe gjeografisë në Sërbi, në Greqi, në Bullgari, në Turqi? Si janë hartuar Historitë e atyre vendeve, enciklopeditë etj dhe i gjithë ky informacion, natyrisht, do të jepet i përkthyer dhe, kur duhet, edhe i botuar në gjuhën tonë), sektori i **statistikavet** (**Përkujdesja** duhet të dijë në çdo kohë sa shqiptarë ka, ku i ka, si i ka, dhe jo vetëm kaq), sektori i **financës**, sektori i **propagandës** dhe i organizimit të ceremonive dhe manifestimeve, sektori i **avokatisë kombëtare** (mbrojtja juridike, si e personave të veçantë, ashtu edhe e çështjeve me karakter të përgjithshëm kombëtar) etj.etj.

Në sektorin e propagandës, krahas gazetarëve, grupevet artistikë (këngëtarë, muzikantë, valltarë, sportistë, grupe tifozësh etj etj), pjesë kryesore do të jetë sidomos grupi i madh i **lektorëve**. Ata **do të jenë dijetarë, njohës të themeltë të Kombit tonë, të cilët do të lëvizin prej grupit në grup për të ligjëruar mbi problemet që lidhen me Kombin tonë dhe mbi mënyrat se si mund të zgjidhen ata probleme**. Nuk është e thënë që një lektor i **Përkujdesjes Gjithshqiptare** të jetë ekskluzivisht i atij profesioni. Ai mund të jetë njëkohësisht edhe gazetar, këngëtar, jurist, tregtar, sportist, oficer, aktor, ekonomist, mësues, mjek, inxhinier, shofer, murator, kamerier, infermier,

aviator, shitës. Mjafton që atij t'i rrahë zemra fort për Kombin dhe Vendin e vet dhe të ketë **njohuri të themelta** mbi Kombin Shqiptar dhe mbi Shqipërinë. Si ndihmë për t'i plotësuar në vazhdimësi njohuritë e veta, për të paguar udhëtimet dhe për ligjëratat që mban, secili propagandues i këtillë i **kualifikuar** duhet të paguhet me një pagë, gjithsesi modeste. **Lektorët e Përkujdesjes Gjithshqiptare**, si edhe kryetarët e grupevet qindësh të Përkujdesjes, do të thirren **Profesorë**. Këta, në një farë mënyre, do të jenë **të ngjashëm me klerikët**. Pra, do të jenë **predikues**, veçse, në vend që t'u flasin besimtarëve të vet për fenë, do t'u flasin atyre për Kombin tonë. Pa një të këtillë **sistem edukimi permanent** ne, as nuk mund të dalim nga prapambetja, as nuk mund t'u dalim përpara rrëziqevet.

Lektorët dhe kryetarët e grupevet janë **misionarë të një shqiptarizmi bashkëkohor**. Pa **misionarë** të fesë (prift, hoxhë, sheh, rabin, pastor) nuk ka fe. Në kushtet e globalizmit kontemporan, **pa misionarë të kombit, nuk ka komb**. Njerëzimi ka nevojë për kombe. Kombi Shqiptar ka nevojë më shumë se shumë kombe të tjerë për të pasur **misionarët** e vet.

Pranë **Autoritetit** qendror të **Përkujdesjes Gjithshqiptare** do të funksionojë efektivisht edhe një **sektor i konkluzionevet dhe i orientimevet shkencorë mbi gjendjen dhe perspektivat e Kombit e të Atdheut**. Ky do të jetë një **sektor i atashuar** nëpërmjet lidhjevet të cilat sot nuk është vështirë të realizohen: Lidhje me gjuhëtarë, historianë, ekonomistë, inxhinierë, arkitektë, skulptorë, arkeologë, juristë, politologë, parlamentarë me kombësi shqiptare, funksionarë shtetesh me kombësi shqiptare, kryepasanikë të Kombit, kryepartiakë të partivet shqiptare etj.etj. Do të jetë, pra ky një kontigjent i madh i përbërë prej kryeudhëheqësve dhe kryedrejtuësve të Kombit Shqiptar, me të cilin Kryepleqësia do të koordinojë punët më të domosdoshme. **Autoriteti Qendror i Përkujdesjes,**

Kryepleqësia, nëpërmjet letërkëmbimit me këta njerëz, nëpërmjet lidhjeve të vazhdueshme me anë të internetit, me fakse etj, do të marrë mendime prej tyre, do të japë mendimet e vet dhe, ç'është edhe thelbi i kësaj pune, do të mundohet ta harmonizojë krejt veprimtarinë e **kokavet të Kombit** në të njëjtën hulli të interesave tanë të përbashkët. Për të zgjidhur problemet që dalin (e që nuk janë të pakët), **Autoriteti Qendror i Përkujdesjes Gjithshqiptare** do të bëhet, në këtë kuadër, nismëtar takimesh dypalësh apo disapalësh, me qëllim zgjidhjen sa më optimale të konflikteve. Prej të gjithë kësaj pune, do të nxiren prapë e prapë konkluzionet e nevojshëm shkencorë orientues dhe do t'i jepen Kombit me anë të mjeteve që ai i ka në dispozicion.

Problemi nr.6: Forma pune.

(Parimi kryesor: **Ne nuk do të përdorim kurrfarë dhune, as kurrfarë presioni, as makinacione. Ne thjeshtë do t'i propagandojmë idetë tona kombëtare dhe do të demonstrojmë në mënyrë shumë serioze në mbrojtje të ideve tona dhe të interesave të Kombit tonë. Punën më të madhe e kemi me vetëveten. Prej fqinjëve s'kërkojmë tjetër, veçse fqinjësi normale, krejt të barabartë.**)

Sqarim hyrës: Pjesa më e arrirë e Kombit tonë të ndihmojë që të përmirësohet edhe pjesa më pak e arrirë. Pjesa më e vetëdijshme të përpiqet për të vetëdijësuar pjesën që nuk është sa duhet e vetëdijshme. Pjesët më pak të rrëzikuara të shqiptarëve t'u vijnë në ndihmë atyre bashkëkombësve të cilëve u kanoset ndonjë rrëzik. Të ruhet Kombi shqiptar, si tërësi, nga çfarëdolloj të keqeje që i vjen, qoftë nga vetëvetja, qoftë nga të tjerët. Të punojmë me përkushtim që të jemi një Komb i pajisur me moralin më pozitiv njerëzor. Të punojmë që krenaria jonë kombëtare të arrijë në lartësinë e duhur, pa kaluar kurrë në ksenofobi dhe pa përçmuar kurrë kombet e tjerë. Të përpiqemi që në Kombin tonë të ketë sa më pak njerëz të varfër e sa më shumë familje të

mesme e të pasura, mundësisht të mos ketë varfëri ekstreme, por të jenë të gjithë ekonomikisht të siguar. Të mos pushojmë së përpjekuri që shqiptarët të marrin sa më shumë dituri, sidomos dituri kombëtare, të përvetësojnë sa më shumë profesione, të kemi sa më shumë dijetarë e specialistë të të gjitha fushave, sportistë e artistë, që ia lartësojnë Kombit emrin dhe famën. Të jemi një Komb i bukur dhe i pastër në të gjitha pikëpamjet. T'i heqim papastërtitë e të gjithë llojevet.

Siç e vumë në dukje edhe pak parë, ne mbrojmë pikëpamjen që, kur një komb bën një **strategji**, ai punën më të madhe duhet ta ketë me vetëveten, pra me pjesëtarët e kombit të vet. Ndaj kombevet të tjerë ne kemi vetëm qëllime të mirë dhe natyrisht kërkesa që të mos na dëmtojnë. Parimi ynë është: Ashtu si duhet të shkojë mirë njeriu me njeriun, ashtu si duhet të shkojë mirë familja me familjen, ashtu duhet të shkojë mirë edhe kombi me kombin. Parim tjetër i yni është: Brezat pasardhës nuk janë fajtorë për çfarëdo veprimi të brezave paraardhës, qoftë edhe kriminal. Por ata bëhen fajtorë, madje rreptësisht të qortueshëm, nëse nuk i dënojnë veprimet negativë të paraardhësve të vet.

a.Punë individuale, filluar prej atyre shqiptarëve që nuk dinë shqip dhe që nuk janë të regjistruar si shqiptarë, deri te ata që njihen si shqiptarë, por që bëjnë gabime, faje apo krime, dhe me këtë mënyrë krijojnë për shqiptarët opinion të keq.

Ne nuk duam t'u marrim kombevet të tjerë njerëzit e tyre, por ata njerëz që kombet e tjerë na i kanë marrë, ne dëshirojmë që t'i rikthejmë. Arsyetimi është ky: **Duke ndërruar kombësinë, njeriu i ul vlerat e veta**. Çdo ndërrim kombësie bëhet: a) për interesa egoistë, b) për servilizëm, c) nga frika, ç) për konformizëm, d) për shkak të dhunës. Asnjë prej këtyre motiveve apo shkaqeve nuk ka të bëjë me cilësi pozitive të moralit njerëzor. Si rrjedhojë, as kombi ku ka aderuar një i tillë banor i konvertuar, nuk ka kurrfarë përfitimi. Pëkundrazi, e mbush popullin e vet me

banorë të pavlerë. Ndërkaq, rikthimi në identitet është shprehje e virtytit më të lartë njerëzor. Po marrim si shembuj vetëm 2 emra: Xhozef Dioguardin dhe Xhim Belushin. Fundja, kjo është shprehja e modernitetit në kohën tonë: **Ruaji vlerat e kombit tend, ndero vlerat e kombevet të tjerë.**

Në anë tjetër, shqiptarët që bëjnë gabime, faje apo krime, përsëri i bëjnë dëm shumë të madh Kombit të vet u bëjnë dëm kombevet të huaj, dhe më së shumti i bëjnë dëm vetëvetes. Me këtë kategori njerëzish **Përkujdesja** jonë **Gjithshqiptare** duhet të punojë në mënyrë të pandërprerë. Kjo formë pune individuale me njerëzit që bëjnë gabime, faje apo krime, duhet të jetë aq e dendur dhe e përditshme, sa duhet të krijohet përshtypja sikur **Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare** është krijuar enkas për këtë punë.

Nuk mund t'i japësh urdhër tjetrit: Bëhu i virtytshëm! Bëhu i moralshëm! Bëhu i mirë! Aq më pak një pjese jo të vogël të Kombit. Por opinioni duhet krijuar dhe puna mbushamendëse nuk duhet ndërprerë asnjëherë.

Kategoritë e veprimevet negativë në mjedisin tonë, ashtu si edhe në kombet e tjerë, janë dhimbshëm të shumtë. Ne po numërojmë këtu vetëm disa prej atyre vetive që shqiptari duhet t'i luftojë te vetëvetja: Të mos jetë intrigant, të mos jetë gënjeshtar, të mos jetë i pasinqertë, të mos jetë mashtrues, të mos jetë tinzar, të mos jetë i pabesë, të mos jetë i korruptueshëm, të mos jetë korruptues, të mos jetë falsifikues, të mos vjedhë, të mos grabisë, të mos vrasë (përveç rastevet të jetëmbrojtjes), të mos jetë servil, të mos prostitutojë, të mos jetë homoseksual, të mos merret me tregti johumane (organesh, foshnjash, femrash, sakatësh), të mos vetëdrogohet, të mos u ofrojë drogë të tjerëvet (me asnjë lloj forme), të mos e ndotë mjedisin ku jeton (që nga bishti i cigares e shishja plastike deri te llojet e shumtë të industrivet ndotëse), të mos alkolizohet, të mos duhanëzohet, të

mos e praktikojë poligaminë, të mos keqtrajtojë burrin, të mos keqtrajtojë gruan, të mos keqtrajtojë prindët, të mos keqtrajtojë fëmijët e vet, të mos jetë dembel. O Zot! A do të mund t'i pastrojë krejt këto papastërti **Përkujdesja** jonë?!

Te puna individuale hyjnë edhe kontaktet me personalitete të ndryshëm shqiptarë, për të cilët dikush thotë apo faktet dëshmojnë se po veprojnë në dëm të shqiptarëve, qoftë të një komuniteti më të ngushtë, qoftë në shkallë Kombi. Kjo do të jetë puna më e vështirë e dinjitarëve të **Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Do të jetë punë e vështirë, sepse askush nuk dëshiron ta dëmtojë personalisht, qoftë edhe një personalitet të vetëm, por njëkohësisht askush nuk duhet dhe nuk mund të pajtohet, kur një punë e iks personaliteti dëmton komunitetin apo Kombin. Pikërisht për këto arsye, dinjitarët përkujdesës do t'u afrohen me shumë takt këtyre njerëzve, do të bisedojnë shumë miqësisht me ta dhe, vetëm pasi të jenë ezauruar të gjitha përpjekjet vetjake (individuale), do të pëdorin edhe publikimin, demonstrimin dhe, më në fund, autoritetin e vet tek votuesit, nëse do të jetë e mundur.

Nëse arrijmë ta pastrojmë kësaj vetëveten, të jemi të bindur që s'do të ketë shqiptar që të lakmojë për t'u tjetërsuar dhe s'do të ketë ish-shqiptar që të mos dëshirojë për t'u rikthyer në Kombin e vet.

Punë individuale duhet të bëhet psh me kryetarë të njësitve vendore, për të cilët dihet se janë shqiptarë, por nuk deklarohen as nuk punojnë si të tillë, me parlamentarë të kësaj kategorie, me personalitete të shkencës. Të tillë ka shumë sidomos në shtetin turk e në shtetin grek: Kryetarë të bashkivet në Çamëri e midis arvanitëve, në Janinë, në Konicë, në Izmir, në Stamboll, në Ankara e deri në Samsung. Atyre, përkujdesësit tanë duhet t'u afrohen me dashamirësi, nëpërmjet njohjeve personale, dhe t'ua kujtojnë që janë shqiptarë e t'u kërkojnë për të punuar në të mirë të shqiptarëve.

E njëjta gjë duhet të bëhet me një numër shumë të madh të

individëvet nëpër diasporë, të cilët nuk regjistrohen si shqiptarë, mbajnë emra e pranemra të huaj, nuk flasin shqip në familje dhe nuk i çojnë fëmijët në shkollë shqipe. Anëtarët e **Përkujdesjes Gjithshqiptare** do të kenë **100 (njëqind)** vjet punë me të këtillë individë dhe të njëjtën punë do t'ua lënë trashëgimi edhe pasardhësve.

Punë individuale duhet të jenë në shumë raste edhe kontaktet me personalitete joshqiptarë, për t'i angazhuar edhe ata në të mirë të Kombit tonë. Kontakte madje jo vetëm me ata që potencialisht janë të prirur për të na ndihmuar, por edhe me vetë **dëmtuesit** tanë. Nuk ka pse të mos kontaktohet personalisht apo të mos i shkruhen letra sqaruese një personi, i cili shkruan apo vepron në dëm të Kombit tonë.

b.Punë me grupe. Kjo është forma vazhduese e punës me persona të veçantë. **Ashtu siç i ka krijuar ritet e vet një fe, ashtu duhet të synojë të krijojë ritet e vet edhe një institucion kombëtar i shekujvet XXI e më tej.** Sidomos atëherë kur një komb nuk ka një fe të përbashkët.

Atje ku kombet konsiderojnë se kanë të gjithë pjesëtarët e tyre të njëjtën fe, si grekët, sërbët apo turqit, ritet fetarë janë njëkohësisht edhe rite të përbashkimit të tyre kombëtar. Por në kohët tona, kjo formë unifikimi të kombevet është mjaft konservatore dhe përmban në vetëvete mjaft rrëziqe, si për vetë kombet që e praktikojnë, ashtu edhe për etnitë e tjera, të cilat, ose kanë po atë fe ose janë të një feje tjetër, por jetojnë në të njëjtët shtete. Shembuj të përbashkët të shkombëtarizimit nën tingujt e nën hijen e kabanorevet të Kishës Pravosllave Sërbe, janë arumunët e sërbizuar në shtetin e Sërbisë, shembuj të përbindshëm të asgjësimit fizik nga ana e sërbëvet janë myslimanët e Bosnjës, që i përkasin të njëjtët etnitet sllav, shembuj të tillë të përbindshëm ka, në anë tjetër, historia e 2 shekujvet të fundit e shtetit grek, pikërisht sepse kombi grek e la

veten të udhëhiqej prej idevet konservatore të Patriarkanës.

Për këtë arsye, Sërbia psh, në intervalin prokomunist, e la veten të udhëhiqej nga Akademia Sërbe e Shkencave dhe Arteve. Por u udhëhoq ashtu si nuk duhej.

Ne nuk do të ndjekim ata shembuj. Ne do të jemi **faktor bashkëkohor i harmonisë ndërfetare** brenda Kombit tonë dhe, në të njëjtën kohë, faktor miqësie me kombet e tjerë. Por ritet do t'i krijojmë e praktikojmë, sepse e dimë që **asnjë institucion që ka për qëllim përbashkimin rreth të njëjtit ideal të një shumice njerëzish, nuk mund ta ketë jetën të gjatë, nëse nuk mbështetet në rite**. Pikërisht këtij synimi do t'i shërbejnë tubimet kryejavorë, rigorozisht kryejavorë, të **Qindëshevet të Përkujdesit Gjithshqiptar**, predikimet që do të bëhen në ata tubime, koncertet këngëtaromuzikorë, ndeshjet sportive, garat atletike dhe teatrot apo cirqet e herëpas'herëshëm. **Shekulli XXI duhet të jetë shekulli i turneve të qindra grupeve të vegjël nga një shtet në tjetrin, nga një qytet në tjetrin, nga një sallë në tjetrën**. Teatër, cirk, këngë, sport, recitime, atletikë, biseda, promovime, ekspozia pikturash...

Punë me grupe do të konsiderohen edhe thirrjet apo kërkesat thellësisht dashamirëse që do t'u drejtohen grupevet të ndryshëm të Kombit Shqiptar. Psh shqiptarëvet të Tivarit, për t'i rikthyer pranemrat dhe emrat në formën e tyre të natyrshme, për të hapur shkolla shqipe për fëmijët e vet, për t'i gdhendur epitafet e varreve në gjuhën e vet etj. Thirrje të ngjashme do t'u drejtohen shqiptarëvet të Kosturit, Konicës, Janinës etj, shqiptarëvet ortodoksë të Çamërisë, shqiptarëvet ortodoksë të Rekës e të Resnjës në shtetin e Maqedonisë. Paralel me këta do të punohet me grupe shqiptarësh, jashtë Atdheut tonë, psh në Turqi, në Kroaci, në Itali, në SHBA.

Formë më vete e punës me grupe, më mirë të themi: me kategori, mund të quhet edhe ajo me profesione apo me

kuaziprofesionë. Psh mund të punohet me mjekët e me farmacistët (individualisht dhe frontalisht), me juristët, me stafe të veçantë të njëres apo tjetres ministri, bashki, komunë, ose psh me ata subjekte që paguhen për pastërtinë e vendit e nuk pastrojnë as lagjen ku jetojnë fëmijët e tyre. Më në fund, me prostitutat dhe me tutorët e prostitutave, me falsifikuesit e dokumenteve, me kultivuesit e drogave, me falsifikuesit në prodhimin e ushqimeve, me spekulantë të ndryshëm, me tatimorët, të cilët, në vend që të mbledhin taksa prej tregtarëve, i rrjepin tregtarët dhe trashen për vete, me policët që, në vend të ruajnë rendin, ruajnë e mbrojnë shkelësit e rendit, prej të cilëve xhvatin para me tufa. Për të gjithë këta duhet të ketë **individualisht 2** alternativa: O të vazhdojnë të jenë objekt i pakënaqësisë sonë, o të heqin dorë prej “*profesioneve*” ndotës dhe t’i bashkohen **Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Në radhët e **Përkujdesjes**, si e thamë më lart, do të ketë vend në të gjitha kohët për të gjithë të rikthyerit. Edhe prostituta më shpresëfikur, nëse heq dorë nga pseudozanati i saj, do ta ketë vendin e vet midis atyre që duhet të përkujdesen për të mos e njollosur Kombin e vet. **E duam Shqiptarin të mirë! Duam ta kemi Kombin tonë objekt frymëzimi e krenarie, jo objekt turpërimi.**

Shumë nga **normat etike**, me kalimin e kohës, bëhen pjesë edhe e dispozitave juridike. Janë norma etiko-juridike ose etiko-etatike. Por kërkesa më racionale në jetën e njeriut është që njeriu **normat morale**, rregullat e sjelljes në mjedisin ku jeton, t’i vëre në jetë, t’i zbatojë e t’i respektojë, para se atë ta detyrojë ligji. Njeriu të mos **gënjejë**, jo nga frika e ndëshkimit, por sepse e tillë është norma e mirësjelljes. Njeriu të mos **vjedhë**, të mos **grabisë**, të mos **marrë ryshfet**, të mos **japë ryshfet** për të siguruar të pamerituarën. Të gjitha këto t’i ketë norma të jetës së vet, pa marrë parasysh ka apo s’ka ligje që të ndëshkojnë nëse ti ke vjedhur, ke grabitur, ke marrë ryshfet ose ke dhënë

ryshfet. Ta vësh **rripin** mbrojtës, jo nga frika e policit dhe jo atëherë kur e sheh se po i afroresh policit (se ashtu s'je kurrfarë burri), por në çdo kohë, sapo makina të jetë nisur. Ta vësh rripin, kur shikon se po i afroresh policit, është paburrëri, është ulje e personalitetit, asgjësim i vetëvetes në pikëpamje morale, sado që vënia e rripit është një punë fare e vockël. **Gruan të mos e rrahësh**, jo nga frika se ajo mund të të denoncojë (Në shumicën e rasteve denoncimi as që bëhet.), por për të mos e ulur dinjitetin tend si njeri dhe si bashkëshort. **Burrin të mos e fyesh**, të mos e nënvleftësosh, të mos e injorosh, të mos ia plasësh buzën, jo prej ligjit, por prej sedrës personale dhe për hir të dashurisë bashkëshortore. Dashurisë edhe obligimevet.

Kjo do t'ishte një pjesë e pamjes se **si duhet të sillet njeriu** në mjedisin që ia ka caktuar fati i jetës. Shqiptarët kanë një etikë të tyren, disa nga pjesët e së cilës vijnë qysh prej kohëveve tepër të hershme. Por shqiptarët kanë edhe të atillë elementë të etikës, të cilët sapo kanë filluar të praktikohen edhe në shkallë gjithnjëzore. Në të 2 rastet, edhe kur një normë morale është tepër e lashtë, edhe kur ajo tenton të imponohet që në zanafillë apo edhe "*shpikël*" spontanisht, njeriu është i thirrur të përdorë **arsyetimin**. Fakt është që midis etikës së vjetër dhe së resë bëhet përjetësisht një kacafytje e ashpër. Por ajo bëhet përherë e më e ashpër pikërisht atëherë kur shoqërohet me gjaknxehtësi dhe sidomos me shkurtpamësi. Shkurtpamësi, miopi, për shkak se vetë opinionin është shkurtpamës ose se vetë individi është i trashë, i cekët mendërisht, i pafuqishëm për t'i bërë ballë **opinionit regresiv** dhe, si pasojë, vjen prishja e harmonisë sjelljore midis njerëzvet.

Ne shqiptarët vuajmë shumë nga një e tillë prishje e rendit sjelljor. Njerëzit naivë, turmat naive, janë riprodhuese të vazhdueshme të dezekuilibravet në mënyrën e të jetuarit, pjesa më e madhe e së cilës përbëhet pikërisht prej **kodevet të**

etikës, qoftë të lashtë, qoftë të sapopiksur. Puna arrin deri aty sa **humbasin jetë njerëzish** pikërisht se i kuptojnë gabim rregullat e mirësjelljes. Puna arrin deri aty sa, jo vetëm humbasin jetë njerëzish, por ende edhe më keq: Prishet, shthuret, **shkatërrohet familja**. Shkatërrohen familjet që divorcohen, shkatërrohen edhe më shumë familje që i rrokullisin vitet me stërmundime, duke duruar njëri-tjetrin. S'të ka borxh **burri** që ta trajtosh si një qen rrugësh, s'të ka borxh **gruaja** që të sillesh me të si nuk sillesh dot as me një lavire. S'të ka borxh, madje edhe kur ajo mund të ketë qenë e tillë. S'të ka borxh **prindi** të sillesh ndaj tij si nuk sillesh dot as ndaj një bagëtie. S'të ka borxh **fëmija** që ta rrahësh, se as ariu i cirkut nuk mësohet me të rrahura. Të gjitha këto e kanë burimin te të moszbatuarit ose te të shtrembëruarit e kodevet të etikës.

Është së pari i paarrirë mendërisht ai prind që kërkon ta fejojë të bijën me **“një të parë”** të **“kandidatit”** në **“klub”**. Ta fejojë dhe, që ditën e fejesës, burri ta marrë te shtëpia e vet. Ç'kuptim ka dasma mbas kësaj?! Por është **fatkeqësi kombëtare** që mbi 70% e djemvet të qytetit dhe përgjithësisht e djemvet me shkollë, të **detyrohen** sot të martohen me **femra të përdorura**.

E gjithë kjo është kryekëput në dorën e **vajzavet**. Sa janë të kompletuara vajzat në fushën e etikës. Vajzat, qysh të vogla duhet të dinë ta fitojnë e ta ruajnë lirinë e vet. Nga njëra anë, të mos parapranojnë për t'u fejuar e për t'u martuar **“aty ku e shohin të udhës prindët”**. Këtë parim etik, që është ngushtë i lidhur me fatin e jetës së një femre, vajza duhet ta bëjë të vetin qysh së vogli. Nga ana tjetër, vajzat duhet gjithkështu qysh së vogli ta ngulin në mendje që, te burri, ku do të lindin fëmijë, ku duhet të kalojnë gjithë jetën dhe ku duhet të plaken, nuk është e rregullt të shkojnë si **gra të përdorura**. Vajzat shqiptare duhet ta kenë pjesë të idealit të vet që, kur ta gjejnë shokun e jetës, kur të vendosin për t'u martuar, të mos jenë **gra vejusha**, por të

jenë **vajza**.

Pikërisht për këtë duhet të shërbejë edhe e quajtura **lëndë e edukatës seksuale** në shkolla. T'u thuhet fëmijëve që edhe njeriu, ashtu si gjallesat e tjera, ka një veprimtari seksuale. Por, kur t'u thuhet kështu, t'u sqarohet se edhe kecat, qengjat, viçat, zogjtë e pulavet, deri sa të rriten, **nuk bëjnë seks**. T'u tregohen rrëzimet, domosdoja e të ruajturit nga seksi i parakohshëm. Jo veç rrëzik shëndetësor, por rrëzik psikologjik, rrëzik shoqëror nga më pasojërendët. Ashtu siç duhet të ruheni nga duhani, nga alkoli, nga droga, nga ngrënia e tepruar, nga vesi i të gënjerit, ashtu duhet të ruheni edhe nga **kurioziteti i të bërit seks**, sepse një pakujdesi e tillë ka këto e këto e këto pasoja. Jo t'u mësohet nxënësevet të shkollës 9-vjeçare si përdoren kontrceptivët. Ato punë janë për gratë e martuara dhe për burrat e martuar. Atyre t'u bëhen kurse për kontrceptivët.

Ndër shqiptarë ekziston së lashti një praktikë morale **për të ndihmuar njëri-tjetrin**. Ekziston një e tillë traditë, por zbatimi i saj bëhet për faqe të zezë. Dasmorët i derdhin paratë nëpër dysheme, i mbledhin pastaj me fshesë dhe ua falin muziktarëve. Çiftit të sapomartuar i mbetet vetëm "**entuziazmi**", i fiksuar në CD, e cila ruhet, por nuk shikohet thuajse asnjëherë. Kur ka sebepe, vrapojnë gratë, kush ta blejë tortën më të madhe dhe, në fund, gjysma e tortavet pishet e hidhet në kosh. Vrapojnë hallat e tezet për t'u blerë foshnjavet rrobëza sa më të bukura. Foshnjat sakaq rriten dhe nuk arrijnë t'i veshin as gysmat e tyre. Vrapojnë prapë e u blejnë nusevet fustanë, kostume e çorape, por nuset as 1/10 e tyre nuk i veshin, sepse ndryshon moda. Vdes njeriu, të afërmit, për të shprehur dhimbjen, shpenzojnë mijëra euro për kurora. Pasurohen, duke u gëzuar që vdiq dikush, kultivuesit dhe tregtarët e lulevet.

Ndoshta duket e çuditshme, por puna e parë që duhet të bëjnë shqiptarët **për të përmirësuar punën e të ndihmuarit**

njëri-tjetrin, është të rregullojnë e të garantojnë funksionimin e bankavet. Shteti duhet të përgjigjet para të gjithë depozituesvet për sigurinë e paravet të tyre. Si e realizon ai këtë siguri të domosdoshme, është punë e tija.

Puna e dytë është që çdo person duhet të ketë **kartvizita** dhe në ato kartvizita të jetë shënuar edhe **numri** i tij **i xhirollogarisë**. Të gjithë të afërmit dhe të njohurit e tij duhet ta zotërojnë atë kartvizitë.

Në këtë mënyrë, kur dikush nga të afërmit tanë **martohet**, ne shkojmë te banka, depozitojmë atje dhuratën tonë, marrim një faturë, e futim në zarf dhe ia çojmë atij që martohet.

Po kështu veprojmë në lindje, në raste vdekjesh, në ditëlindje, në përvjetorë të ndryshëm, kur të afërmit a shokët tanë diplomojnë ose kur fillojnë studimet...

Vihet në udhë të mbarë e gjithë tradita. Fëmijës nuk ka nevojë t'i çohen dhurata pa numër, të cilat ai i shkatërron brenda 3 minutash e gjysmë. Fëmijës, qoftë në ditëlindje, qoftë me raste të tjerë, t'i shtihen në bankë qoftë edhe nga 5 euro, në mënyrë që ai me ata 5 euro të mund të ushqehet, kur të shkojë në universitet. Kjo është dashamirësia më e madhe ndaj fëmijës. Dashamirësi largpamëse.

Tradita e ndihmës së ndërsjellë, gjithmonë në kornizat e **etikës**, do të duhej zgjeruar midis shqiptarëve edhe në veprimtaritë **ekonomike**, **shkencore** e **artistike**. Jo për të sponsorizuar bixhozin. Jo për të sponsorizuar makinacionet, dallaveret, pandershmërinë, por punët e mirëfillta të dobishme. Ke ndonjë djalë apo vajzë vëllai apo kushëri. E sheh që ka vullnet, është i sinqertë, ka një lloj talenti. Ndihoje, fillimisht me pak, duke e derdhur në bankë ndihmën tënde dhe duke ia treguar qëllimin tend. Pas kësaj, në e pafsh që i afërmi yt po ecën mirë, ndihoje edhe më shumë, tani me synime më konkretë dhe me kontrata të precizuara. Në këtë mënyrë, në

vend që të grindemi e të mbushemi me mëri e shtrembëshikime, forcohet farefisi. Forcohet ashtu krejt Kombi Shqiptar. Atje ku ndodhin zhgënjime, zhgënjimet të kapërcehen me mençuri, jo duke u betuar: **Unë nuk dua të kem punë me këta njerëz!** Jo duke u betuar ashtu, por duke kërkuar mënyra sa më efikase bashkëpërkrahjeje.

c. **Punët mbarëkombëtare.** Në rend të parë do të jenë **festat** që evokojnë ngjarje të mëdha të Kombit tonë. Ato nuk do të festohen më vetëm prej atyre që **rastësisht** mund të jenë kujtuar **për ndonjë ngjarje që na paska pasur të bëjë me fatet e Kombit.**

Festa e parë dhe më e madhja festë e të gjithë shqiptarëve do të jetë **28 Nëntori.** Ajo do të bëhet festë familjare e të gjitha familjevet shqiptare dhe, në një orë të caktuar, në të gjithë sheshet e qytetevet të shqipërisë, po edhe në çdo qytet të Botës ku ka më shumë se 100 shqiptarë, do të ketë nga 1 manifestim festiv. Vlora, Tirana, Prishtina, Shkupi, Presheva, Podgorica, Janina. Këta janë të parët qytete, ku nuk duhet asnjëherë të mungojë shkëlqimi i kësaj feste, fatlume për ne shqiptarët. Deri sa të mos ndodhë kështu në të 7-t këta qytete, ne nuk duhet të na zërë gjumi. Krahas këtyre, **përskuqja kuq e zi** duhet t'i hijeshojë në këtë ditë të gjithë qytetet e Atdheut tonë: Krujën, Lezhën, Prizrenin, Manastirin, Shkodrën, Korçën, Gjirokastrën, Tepelenën, Memaliajt, Ballshin, Durrësin, Elbasanin, Beratin, Sarandën, Konispolin, Delvinën, Fierin, Lushnjën, Kavajën, Shijakun, Vorën, Fushë-Krujën, Mamurrasin, Laçin, Milotin, Rrëshenin, Pukën, Fush-Arrësin, Bajram Currin, Kukësin, Krumën, Peshkopinë, Shupenzën, Bulqizën, Burrelin, Klosin, Ulzën, Peqinin, Cërrikun, Patosin, Kuçovën, Çorovodën, Gramshin, Poliçanin, Këlcyrën, Përmetin, Leskovikun, Ersekën, Maliqin, Pogradecin, Përrenjasin, Librazhdin, Pejën, Deçanin, Klinën, Istogun, Gjakovën, Rahovecin, Malishevën, Skënderajin,

Drenasin, Mitrovicën, Vushtrrinë, Podujevën, Kamenicën, Gjilanin, Vitinë, Ferizajn, Kaçanikun, Shtimjen, Lipjanin, Fushë-Kosovën, Therandën, Kumanovën, Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Dibrën, Strugën, Ohrin, Përlepin, Preshevën, Bujanovcin, Ulqinin, Tuzin, Gucinë, Plavën, Tivarin, Tutinin, Rozhajën, Filatin, Gumenicën, Paramithinë, Pargën, Artën, Prevezën, Dhodhonin, Meçovën, Konicën, Kosturin, Follorinë. Në kronikat televizive duhet të thuhet: **Ku u festua më me madhësi Dita e Flamurit dhe ku nuk u arrit të festohej.** Pas kësaj, duhet të jepen edhe kronikat e festimit të kësaj dite në Stamboll, në Athinë, në Bruksel, në Londër, në Njujork e kudo gjetkë, kudo ku gjenden momentalisht a ku jetojnë për gjithnjë mbi 100 shqiptarë. Atje ku ka më pak se 100 shqiptarë, **Dita e Flamurit** do të jetë vetëm festë familjare.

Dita e Kosovës, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës e 17 Shkurtit, duhet të festohet prapë në të gjithë qytetet që përmendëm (Por jo me flamuj të verdhë. Kurrë me flamuj të verdhë!)

Dita e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhet doemos të përkujtohet të paktën në ata qytete ku ka pasur degë të kësaj Lidhjeje, ndërsa manifestimi qendror, vetëkuptohet, në Prizren.

Në **Ditën e Lidhjes Arbërore të Lezhës** duhet të mblidhen përfaqësitë e të gjithë shqiptarëve në Lezhë. Në ditën e lejimit të shkollës shqipe, që quhet **Dita e Mësuesit** ose **Dita e Arsimit Shqip**, manifestimi qendror duhet bërë në Korçë. Në **Ditën e Alfabetit** duhet të mblidhen përfaqësi të të gjithë shqiptarëve në Manastir.

Anëmbanë Shqipërisë është detyrë e shqiptarëve (e shqiptarëve që kanë mbetur gjallë, pa u shfarosur nga masakrat), të organizojnë **ditë përkujtime** pranë memorialeve, që tashmë i përfytyrojmë të ngritur në çdo vend ku dikush ka dhënë jetën, vetëm e vetëm sepse ishte shqiptar. Për të gjithë këta, duhet të ketë një **ditë të përbashkët përkujtimi, Dita e të Rënëve**

dhe e të Masakruarvet, por ne nuk po mund tash të dallojmë, të veçojmë, për nga shkalla e dhimbjes, asnjërën prej tyre: A Ditën e Bihorit, a Ditën e Plavës e të Gicisë, a Ditën e Prekazit, a Ditën e Reçakut, a Ditën e Zajazit, a Ditën e Paramithisë, a Ditën e Tivarit, a Ditën e Borovës, apo ndonjë ditë tjetër të njëjtë si këto?! Janë shumë. Por asnjërën prej tyre nuk duhet ta harrojmë.

Në rastet kur Kombit tonë i bëhen padrejtësi, kur çenohet dinjiteti ynë, qoftë edhe gjoja nga pakujdesia apo gjoja incidentalisht, **Kryepaqësia e Përkujdesjes Gjithshiptare** duhet në radhë të parë të mendojë mirë çfarë duhet bërë, pastaj të veprojë. Mund të mjaftohet thjeshtë me publikimin e ngjarjes apo incidentit. Mund të dilet me deklaratë. Mund të kërkohet që qeveritë të reagojnë, por mund edhe të mos jetë oportune që të reagojnë qeveritë.

Format mund të jenë të llojllojshme, por asnjëherë nuk duhet të ndodhë që një protestë **kombëtare** të përfaqësohet *“prej 5 apo 7 çunavet të Toçit”*. Ata kishin të drejtë, por Kombi, për turpin e tij, nuk ishte i përgatitur për t’i përkrahur. Protestat, o do të bëhen siç janë për t’u bërë, o nuk do të bëhen fare. Nëse është për t’iu përgjigjur me demonstrata një ish-presidenti, kur ai deklaroi se *“gjysma e tokavet greke ndodhen në shtetin shqiptar”*, atëherë demonstratat do të bëhen në ata qytete ku e shohim ne të arsyeshme dhe ashtu siç mendojmë ne se duhen bërë. Nëse është për t’u tallur me një ministër të jashtëm, i cili kërkoi të drejta për pakicat serbe inekzistente në Republikën e Shqipërisë, e tallura duhet të jetë e atillë që atij të mos i shkojë më mendja për të bërë shaka. Nëse duhet reaguuar ndaj një pseudoenciklopedie, ai reagim, o duhet të bëjë efekt të atillë që kombi sllavomaqedon të dalë e të kërkohet të tjerë shkencëtarë për enciklopeditë e veta, o lëri në qejfin e tyre.

Duam të themi që reagime do të bëhen. Kur të shihet e nevojshme, do të bëhen edhe demonstrata masive, në të gjithë

ata qytete që jo më kot i përmendëm një për një pak më lart. Por ata demonstrime do të bëhen pa zhurma e pa të çjerrura, shumë serioze dhe të rënda, dinjitoze, sepse në të gjithë llojet e provokimevet, ne do të na kujtohen dhimbshëm të masakruarit tanë.

Në të tillë demonstrime, **në asnjë rast, shqiptarët nuk do të djegin as grisin flamujt e kombevet të tjerë.** Flamujtë e kombevet nuk janë pronë vetëm të pjesës së tyre të keqe. Ata janë pronë edhe e pjesëve të mira të atyre kombeve dhe ne na intereson që pjesët e mira të kombevet që na rrethojnë, të jenë me ne e jo kundër nesh.

ç.**Më e madhja punë e punës më të madhe.** Nëse e kemi konsideruar si punë tonën më të madhe punën me vetëveten, më e madhja e kësaj pune më të madhe duhet të jetë **shkollimi në gjuhën shqipe.** Institucioni i **Përkujdesjes Gjithshqiptare** ka detyrë të ngulë këmbë në organizimin e vënien në punë të arsimit shqip në të gjithë vendet ku jetojnë arvanitë, arbëreshë dhe shqiptarë. **Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare** nuk është ministri arsimit, por ai duhet t'u kërkojë me insistim ministrivët shqiptarë të arsimit që, o të jenë të përkushtuara ndaj kësaj çështjeje, o do të shpallen kombëtarisht si ministri antikombëtare, me demonstrimet më të përshtatshëm për to.

Ke vrarë një njeri? Gjykata të gjykon dhe mbi bazën e atij gjykimi, shpallësh kriminel. Por, nëse ke lënë një njeri pa arsim kombëtar, ti e ke vrarë atë njeri si personalitet (në kuptimin mendor dhe shpirtëror).

Një njeri që nuk shkollohet në gjuhën amtare e që nuk e mëson, qoftë në shkollë, qoftë jashtë shkollës, historinë e kombit të vet, sado të kompletohet me dituri të tjera, ai rrënjët e identitetit i ka të prera. Është si një degë limoni, e cila, edhe nëse lëshon rrënjë e bëhet pemë, ajo kurrë nuk do të jetë e shëndetshme si limonët e tjerë, të mbirë prej faravet dhe të shartuar në mënyrë

të rregullt. Një njeri pa arsim kombëtar është madje më keq se një degë limoni.

Ministritë tona të arsimit nuk kanë të drejtë të vrasin arsimisht asnjë fëmijë të Kombit të vet. Ne, në pikëpamje humane, ashtu siç bën Kisha Katolike, abortin e një foshnjeje e konsiderojmë krim. Të lënë të fëmijëvet të cilitdo komb pa shkollim në gjuhën e vet, s'është tjetër, veçse abort në përmasat e atij kombi. Kur një komb i lë fëmijët e vet në masë pa arsim kombëtar, ai s'bën tjetër, veçse aborton në masë.

Në të gjithë Botën duhet të hapen shkolla shqipe për **të gjithë** fëmijët shqiptarë: Në SHBA, në Kanada, në Australi, në Zelandë të Re, në Angli, në Francë, në Zvicër, në Itali, në Gjermani, në Austri, në Belgjikë, në Hollandë, në Skandinavi, ndoshta edhe në Japoni, në Kore, në Kinë. Por në mënyrën më preokupuese **Institucioni ynë i Përkujdesjes Gjithshqiptare** duhet të merret me arsimin shqip në shtetet fqinjë me Shqipërinë.

Me Turqinë është tepër e ngutshme të bisedohet, në shkallë shtetesh, që atje të hapen jo 1 apo 10, por qindra shkolla shqipe për diasporën tonë të atjeshme. Nga arsimi parashkollor deri në universitet. Shqiptarët, atje, janë diasporë. Por janë diasporë e madhe, e cila nuk mund të bëjë tjetër, veçse ta shëndoshë Turqinë, ashtu siç e ka shëndoshur në kohën e vet Ataturku.

E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe në shtetin grek. Për arvanitët, që janë diasporë, dhe për emigrantët e kohëvet të fundit, që gjithashtu janë diasporë, duhet ngutshëm të fillojnë punën diku rreth 6000 klasa shkollore në gjuhën shqipe. Ndërkohë, për çamët ortodoksë dhe ortodoksët e tjerë, të cilët janë vendës në ato pjesë të Shqipërisë Jugore, që i janë dhënë shtetit grek, duhet të kërkohet status si për të gjitha pakicat joimigruese. Kërkesa e parë e një të tillë statusi, është regjistrimi civil me kombësi shqiptare dhe me emra shqip, dhe kërkesa e dytë, paralel me të parën, është **shkollimi në gjuhën gjyshore**.

Në Bullgari, në Rumani, në Bosnjë e Hercegovinë, në

Kroaci, në Slloveni, në Itali, aje ku ka një numër shqiptarësh, arbëreshësh apo arbanasësh të mjaftueshëm për një klasë shkollë, atje të hapet dhe të funksionojë një rrjet shkollash në gjuhën tonë.

Për Sërbinë, Malin e Zi dhe për shtetin e sotëm që quhet Maqedoni, si edhe në shtetin grek për pjesët joimigruese, punët e arsimimit të shqiptarëve mund të trajtohen vetëm mbi argumentin se në ata shtete shqiptarët janë popullsi **konstitucionale**. Kjo do të thotë që **shqiptarët në ata shtete jetojnë në tokat e veta**, pra, bëjnë pjesë në ata shtete jo vetëm si shqiptarë, por edhe si **pjesë të Shqipërisë**. Të drejtat e tyre janë plotësisht të barabarta me të drejtat e sërbëve, sllavomaqedonëve, malazezëve dhe grekëve. Ata **nuk janë pakica**. Ata janë pjesë përbërëse, siç janë gjermanët, francezët dhe italianët në shtetin që quhet Zvicër. (**Pavarësisht prej numrit**.) Si rrjedhojë, legjislacioni në ata shtete, o duhet të rregullohet si në Zvicër, o shqiptarët duhet të kërkojnë rrugë të tjera.

Në këtë kontekst ne mund të themi vetëm kaq: ***Mjaft më me qëndrime anakronikë, ksenofobë e shovinistë! Shekulli XXI nuk duhet të jetë shekulli i shovinizmit.***

Për të hapur shkolla shqipe e për të funksionuar ato shkolla, duhet një **angazhim kolosal**. Për të hapur vetëm 1 shkollë shqipe në Paris, Toronto apo Damask, në Janinë apo në Tivar, duhet **angazhim kolosal**, le më të punosh për të hapur e për t'i mbajtur gjallë në vazhdimësi 20000 shkolla jashtë kufijvet të 2 shteteve të sotëm të Shqipërisë. Sa klasa, dmth sa ambiente shkollorë duhen? Sa libra duhen? Sa mësues duhen? Mbi të gjitha, sa propaganda duhet dhe sa përpjekje **diplomatike**?! Mirëpo ne shqiptarët nuk kemi ndërmend që pasuritë tona kombëtare t'i shpenzojmë as në programet bërthamore (për të prodhuar bomba atomike), as në pushtimin e Gjithësisë. Ne na duhet gjallërimi dhe përmirësimi i Kombit me anë të arsimimit. Ne nuk duam

të bëhemi fuqi botërore. Ne duam të bëhemi shembull i mirë në Botë.

Në 2 shtetet e sotëm të Shqipërisë, sistemi arsimor ka hasur në probleme të shumtë me natyrë të mirëfilltë gangrenore. Në shkollat tona dhe në universitetet tanë, **sistemi i antiedukimit** po funksionon pësosurisht, në një kohë kur **sistemi i edukimit** ka rënë në një inferioritet të mjerueshëm. Në shkollat dhe në universitetet tanë, **sistemi i antiedukimit** lulëzon, **sistemi i edukimit** vegjeton, pa nxjerrë as lule, as farë.

Ne nuk do të merremi këtu me të gjithë elementët e një të këtillë sëmundjeje (epidemi që s'është vetëm shqiptare), por do të prekim vetëm njërin element: Kopjimin e detyrave dhe provimevet nga ana e nxënësve dhe e studentëve. Siç ka virus për të gjitha sëmundjet ngjithëse, kështu ka virus edhe për korrupsionin dhe ky është pikërisht vesi i të kopjuarit. Mundohu sa të duash t'ia heqësh një të rrituri një ves që e ka marrë e pakta qysh prej klasave të larta të 9-vjeçares! Pedagogjia thotë: Riedukimi është shumëfish më i vështirë se sa edukimi. Një që e ka marrë virusin e të kopjuarit fshehurazi të provimevet, kur të rritet, as domino s'do të jetë në gjendje të luajë pa bërë hile.

Prandaj shkollat tona vetëvetiu, në procesin e përmirësimit të Kombit, do t'u bjerë një barrë e rëndë: Të gjejnë mënyra për të mos u infektuar nxënësit tanë me virusin e korrupsionit.

E morëm këtë si shembull, por sistemi ynë arsimor ka barrë të rëndë për të luftuar kundër të gjithë elementëve të **antiedukimit** dhe për t'i zëvendësuar ata me elementë të mirëfilltë të **edukimit**, human edhe kombëtar. **Istitucioni ynë i Përkujdesjes**, nuk do të kish për çfarë tjetër të kujdesej, nëse nuk do të kujdesej për arsimin shqip.

Rilevimi social

Brenda Shqipërisë do të ketë raste me shumicë që veprimet e njerit apo tjetrit të shkojnë kundër interesit të Kombit. **Përkujdesja Gjithshqiptare** natyrisht që do të mbajë qëndrimin e vet. Ajo do t'u thotë bashkëkombasvet:

Ne nuk jemi kundër pasurimit të cilitdo shqiptar. Shqiptarët le të pasurohen dhe asnjëri prej shqiptarëve që s'është i pasur, s'ka arsye që t'i ketë zili ata që pasurohen. Në vend të zilisë, smirës, ligësisë, shqiptari jo i pasur duhet të kultivojë te vetëvetja dëshirën **për të mësuar shumë e për të punuar shumë**, me qëllim që edhe ai të mund të pasurohet.

Ne nuk jemi kundër pasurimit të shqiptarëve. Përkundrazi, jemi që në Shqipëri të ketë një klasë kapitaliste sa më të fuqishme. Por **jemi kategorikisht kundër çdo metode të rrjepjes së shtetasvet shqiptarë**. Klasa e pasur duhet të kuptojë njëherë e përgjithmonë se **pa klasën e mesme** ajo nuk mund t'i sigurojë vetes as jetë të sigurtë, as jetë të pavarur prej të huajvet, as jetë të gjatë. Në të njëjtën kohë, të pasurit duhet ta kuptojnë që ekzistenca e shtresës së varfër në Kombin tonë nuk i sjell, as Kombit, as vetë klasës kapitaliste, kurrfarë të mire, as ekonomike, as morale, as politike. Prandaj, politikat sociale, të cilat realisht i orientojnë e i kontrollojnë të pasurit nëpërmjet parlamenteve, duhet të jenë të atilla që Kombi të mos jetë i pakënaqur prej atyre politikave.

Kombi duhet t'i dojë parlamentarët dhe politikanët, jo t'i shajë ata ditë e natë. T'i kritikojë ata në çdo veprim të tyre jo të drejtë, por jo t'i urrejë. Por kjo varet prej orientimit që do të marrë klasa kapitaliste: A do të marrë orientim në të mirë të Kombit të vet (largpamësisht edhe të vetëvetes), apo do të vazhdojë të jetë egoiste, e korruptuar, e shitshme te të huajtë (shkurtpamësisht edhe kundër vetëvetes).

Përfundimisht, pikësynimi i **Përkujdesjes Gjithshqiptare** do të jetë që relievi ynë social të jetë i atillë që ai të mos mund

të bëhet shkak për kurrfarë zgjatje duarsh të të huajvet drejt pasurivët tona dhe drejt tokavët tona. **Përgjegjësia** në kë aspekt **i bie tërësisht klasës sonë të pasanikëve**. Klasat e mesme dhe të varfëra nuk caktojnë dot deputetë apo ministra. Deputetët dhe ministrat i caktojnë të pasurit. Klasat e mesme dhe të varfëra zgjedhin, midis deputetëve që caktojnë të pasurit, ata që janë më të pranueshmit. Kriteri është: **Dëshmohuni atdhedashës, ndryshe, herën tjetër nuk do të votojmë për ju!**

Kaq mund të bëjnë zgjedhësit. Por **Autoriteti i Përkujdesjes Gjithshqiptare** duhet t'i gjejë mundësitë për të bërë shumë më tepër.

Zbukurimi i tokës së shqiptarëve.

Po shihet tashmë gjithandej që merakun ynë më i madh është: **Përmirësimi i individit shqiptar**. Vetëm nëse do të arrijmë që t'i kemi shumicën e shqiptarëve njerëz pozitivë, (që ai prifti i shitur të mos mund të thotë më: *Këtu prindi vret fëmijën, gruaja vret burrin e burri vret gruan!*), vetëm nëse arrijmë të kemi mësues të virtytshëm e dinjitozë, mjekë të virtytshëm e dinjitozë, juristë të virtytshëm e dinjitozë, parlamentarë të virtytshëm e dinjitozë, ministra të virtytshëm e dinjitozë dhe kryeministra e presidentë gjithanësisht të respektueshëm, vetëm atëherë ne do të mund të shpresojmë që Kombi ynë nuk do të pësojë më kasapime e shkrumbime, si në Bihor, Plavë e Guci, dhe vendi ynë nuk do të pësojë më copëzime e stërcopëzime, si në paloshtetin e Esatpashës të vitit 1914.

Por krahas asaj që ne ta rrisim përditë numrin e shqiptarëve edukativisht dhe moralisht të zbukuruar, duhet punuar më shumë se përditë për të zbukuruar **tokën e shqiptarëve**.

Janë përdorur shprejet “*atje i kam ment e mija*” “*lum kush t'rronjë, ta shohë zonjë*” “*ta bëjmë Shqipërinë kopësht me lule*”, por ne do të themi: **Ta bëjmë Shqipërinë të atillë, që ne vetë të mos vështrojmë për të ikur këndeje. T'i krijojmë**

vetes të gjitha mundësitë për të jetuar këtu! Po s'e bëjnë ne Shqipërinë, s'ka për të ardhur dikush tjetër e ta ndërtojë për ne. Ai i huaji, në ardhhtë (dhe s'janë të pakët ata që lakmojnë), kanë për ta bërë këtë vend për ata, jo për ne.

Përbashkësia ekonomike. Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet të ketë një sektor të informimit e të propagandës për bashkëpunimin ekonomik midis shqiptarëve. **Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare** nuk është as ministri e ekonomisë, as dhomë tregtie, por megjithkëtë ai është i thirrur që të kujdeset për këtë anë të jetës së Kombit, si për njërin prej aspekteve më të rëndësishëm të ekzistencës së tij. Kombi është bashkësi kulture, bashkësi tradite, bashkësi gjuhe, bashkësi prejardhjeje, por **kombi është edhe bashkësi ekonomike**. Nëse nuk do të kish nevojë për një bashkësi ekonomike, kombit s'do t'i duheshin gjë as shteti, as partitë politike, as sistemet e mbrojtjes, madje atij s'do t'i hynte shumë në punë as vetë atdheu. Interesat ekonomikë janë ata që, krahas kulturës, gjuhës, prejardhjes etj, e përforcojnë edhe më shumë përbashkësinë e një kombi.

Bashkëpunimi e bashkëveprimi ekonomik i shqiptarëve në sh XXI duhet të jetë themeli i suksesit e i përparimit të tyre. Askush deri më sot nuk e ka nxjerrë në shesh, nuk e ka bërë të dukshme, sa shumë energji në pikëpamje **ekonomike** kanë shqiptarët dhe sa po u shkapërderdhen ato energji, si ujërat që nuk kalojnë nëpër turbina.

Sektori informativ i ekonomisë pranë **Institucionit të Përkujdesjes Gjithshqiptare** duhet të ketë një skedar të gjërë të subjekteve ekonomikë shqiptarë, kudo që ata ndodhen, në Atdhe ose në Botë. Me anë të një të tillë skedari informues do të mund t'u shërbehet ministrivet përkatëse, dhomave të tregtisë, bankavet, organizatave të ndryshme të emigrantëve, shoqatave të ndryshme të punëkërkuësve.

Kapitali që grumbullon një biznesmen shqiptar i suksesshëm

në Amerikë, në Angli, në Gjermani, në Australi, duhet të gjejë rrugët për t'u shtuar edhe më shumë pikërisht këtu në Atdheun tonë. Kushti që një kapital i grumbulluar diku jashtë, të shumëfishohet këtu në Atdhe, është që zyrarët e këtushëm të jenë atdheekombdashës para se të jenë atdheekombrrjepës. Pikërisht këtu duhet të përqëndrohet **Përkujdesja**. Pasi të ketë hyrë kapitali lirshëm në Atdheun tonë, pa u ngërthyer e mbërthyer nga telat me gjemba të korrupsionit grykëkuçedër, edhe vetë aspiruesit e korrupsioneve do ta shohin që edhe për ata do të jetë më mirë.

Në një tjetër vështrim, bashkëlidhja ekonomike midis shqiptarëve që e zhvillojnë veprimtarinë e vet **brenda Atdheut**, dmth **brenda 6 shteteve ku jetojnë shqiptarët**, do të mund t'i sjellë Kombit tonë jo më thërrime të të mbijetuarit, por ringjallje të mirëfilltë dhe ngjitje deri në nivelin e cilitdo popull të Evropës.

Do të vijë ashtu një ditë, madje shumë shpejt, kur ekonomia jonë nacionale do t'i investojë kapitalet e vet edhe jashtë Shqipërisë, në Azerbajxhan, në Kanada, në Honduras, në Brazil, në Eritre, në Algjeri, në Egjipt, në Siri, në Iran, në Liban, në Rusi, në Ukrainë e në Spanjë. **Shqiptarët janë njerëz shumë të zotë**. Mjafton që të ruhen nga të harruarit që janë e që duhet të jenë më parë shqiptarë, pastaj qytetarë Botës. **Institucioni ynë i Përkujdesjes** duhet të luajë rolin e nënës ndaj të këtillë bijve të Kombit tonë.

Ka qindra mijë shqiptarë që kërkojnë punë dhe nuk u jepet kurrfarë mundësie **institucionale** për ta gjetur një punë. **Përkujdesja** duhet të mbajë lidhje me sa më shumë agjensi punësimi në mbarë Botën dhe t'ua rekomandojë të papunëvet të vet vendet e punës. Këtë punë duhet ta kryejnë, si **Kryepaqësia** në qendër, ashtu edhe grupet përkujdesës, që është paramenduar të ndodhen gjithandej. Këtu përsëri ky institucion duhet të luajë rolin e nënës. Ne nuk mund t'i lëshojmë të rinjtë tanë malevet e

detravet, sikur të jemi raca më inferiore.

Një ministri, qoftë edhe një tufë ministrishë, kështu si na ka lënë historia ne, të shpërndarë nëpër 6 shtete, po edhe të mbjellur nëpër Botë, sado që ato i kanë detyrat e veta, nuk do të mund ta kryenin kurrë punën gjithkombëtare, në formën që atë e kryen **Institucioni i Përkujdesjes**. As dhomat e tregtisë, sado punë të mirë të bëjnë ato, brenda kornizavet dhe mundësivet të veta, kurrë nuk do të mund t'i plotësonin kërkesat e ndëlidhjeve ekonomike midis të gjithë shqiptarëve apo këkesat e punësimit. Psh problemin e një arbëreshi apo të një shqiptari emigrant, mbetur pa punë diku në Sicili, asnjë ministri apo dhomë tregtie nuk besojmë të mund ta zgjidhë. Me të këtillë halle jetojnë nja 2 apo më shumë milionë shqiptarë, 1 këtu e 1 atje, 5 këtu e 7 atje. **Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare**, nëse punon vërtet si i tillë, shumicën e këtyre punëve do të mund t'i aranzhonte.

Me këso veprimtarishë kombeatdhedashëse vërtet do të mund të shihnin ditë më të mira të gjithë ata shqiptarë që **duan** të punojnë, por edhe vetë Atdheu ynë do të zbukurohej prej veprash të të gjitha degëve të ekonomisë.

Ne nuk jemi ksenofobë, prandaj në të gjitha ndërmarrjet ekonomike, qoftë të të kamurvet tanë, qoftë të punëkërkuesvet, **Përkujdesja Gjithshqiptare** nuk do të predikojë mbyllje në vetëvete. Ne do të bashkëpunojmë me të gjithë kombet.

Të vetmet kërkesa tonat do të jenë: Të mos na përdorin të huajtë si vegla e si shërbëtorë faqeleckë, të mos na ia thithin gjakun të huajtë ekonomisë sonë, përkundrazi, të jemi të paktën të barabartë në pëfitimet ekonomikë, të mos lejojmë depërtimin në vendin tonë të mallravet skarco "*bono per Albanesi*", se është turp e ulje skandaloze, të mos e pushtojnë të huajtë tokën tonë "*paqësisht*" nëpërmjet lidhjeve ekonomike me individë të ndryshëm ose me pushtetarë, të mos ua shesim të huajvet resurset... Rrotull nesh ka shumë të atillë që dinë ta përdorin

shkëlqyeshëm metodën e qyqes: I lëshojnë vezët në çerdhe të zogjvet të tjerë, zogjtë e tjerë naivë i ngrohin e i çelin ato vezë, më në fund, qyqet e vogla i nxjerrin me krahë dhe i hedhin poshtë në livadh të zotët e vërtetë të çerdhes. Me këtë lloj metode na janë marrë një pjesë e madhe e tokavet tona. Me po këtë metodë, nëse nuk do të rrimë syçelët, **në periudhën pas hyrjes sonë në BE**, ka rrezik të na e zaptojnë Shqipërinë zaptuesit e kahmotshëm. Këta 15 a 16 rreshta do të duhej t'i rilexonin çdo ditë të gjithë shqiptarët.

Natyra, toka e Shqipërisë. Bukuritë e vendeve ku jetojnë shqiptarët janë të atilla që, edhe kështu të papërkujdesura, i lënë pa mend njerëzit që i shohin. Ata që dinë t'i shohin! Relievi, bimësia, uji, ajri, deri edhe qielli i Shqipërisë është i magjishëm.

Merr cilin të duash kënd të vendit tonë. Lëre formën relievoe ashtu siç është, shto një ndërtim në harmoni me atë formë, plotëso me bimë, shumo zogjtë, peshqit, bagëtitë, si element dekorativ, zhduk mushkonjat, karkalecat, dhe çdo insekt të bezdisshëm, mos tolero të ketë njerëz të ligj rretherrotull, cinikë, hajdutë, grabitës, imoralë, arrogantë, pijanecë, zhurmamëdhenj, mburravecë, injorantë, përtacë, dhe e ke bërë Shqipërinë një **parajsë**, ku të gjithë të gjallët e Botës do të dëshirojnë të vijnë të paktën 1 herë në jetë.

Do punuar e do menduar përditë për zbukurimin e kësaj toke. Rrugët dytësore e tretësore, ambientet përpara shtëpivet e rrotull shtëpivet, prerje e pastrim shkurresh anash rrugëvet, ruajtje e drurëvet kudo ku ata mund të kenë mbirë vetë, mbjellje drurësh jo vetëm anash rrugëvet, por kudo ku shihet e nevojshme se mund dhe duhet të ketë një pyll, mbjellje, por edhe ruajtje e drurëvet, sepse, sado të mbjellësh, po nuk i ruajtje, ata nuk bëhen asnjëherë, ndëtim pritash, që toka të mos gërryhet, ndërtim çesdash dhe kronjsh (siç i përshkruan Lasgushi) në të gjithë ambientet, por sidomos pranë rrugëvet, moslejimi i asnjë

lloj ndotjeje (ndotje me mbeturina plastike, ndotje me ujëra të zez, ndotje me hedhurina metalike e me inerte, ndotje me anë të industrisë së pakontrolluar), moslejim i dëmtimit të peshqvet dhe kafshëvevet, nxitje për kultivim e bukurtrajtim të lulishtevet. Janë me mijëra punë që duhen bërë, me qëllim zbukurimin e këtij vendi, por janë me mijëra dëmtime nga ana e një pjese të bashkëkombasvet tanë (me të meta mendore e edukative), dëmtime të cilët duhen ndalur, duhen ndërprerë njëherë e mirë.

Shumë gjëra, për ta pasur Atdheun të bukur, mund të bëhen me vullnet, me dëshirë, me sedër kombëtare. Por sedra kombëtare ka nevojë të nxitet prej dikujt. Sedra kombëtare ka nevojë të kthehet në opinion zotërues. E dimë tashmë se cilën tokë quajmë **TOKË SHQIPTARE**, por kjo duhet përsëritur shumë herë. Quajmë **TOKË SHQIPTARE** të gjithë hapësirën gjeografike ku shqiptarët banojnë historisht. Pra, quajmë **TOKË SHQIPTARE** tokat që përfshihen në Republikën e Shqipërisë, tokat që përfshihen në Republikën e Kosovës, tokat që përfshihen në veri të shtetit grek, tokat që përfshihen në Republikën e Maqedonisë, ato që banohen edhe me shqiptarë, tokat që ndodhen në Republikën e Serbisë e që ne e quajmë Anamoravë dhe tokat që përfshihen në shtetin malazias, por që banohen edhe me shqiptarë. Pa marrë parasysh se në cilin shtet ndodhen tokat ku banojnë shqiptarë, ne duhet të punojmë në atë mënyrë që ato të dallohen **PËR MIRË**. Pra, të njihen se janë **TOKA SHQIPTARE**. Kur një i huaj hyn në këto toka, ai ta kuptojë se ka hyrë në Atdheun e një kombi të kulturuar. Të mos lidhen shëmtueshëm telat elektrikë, të mos ndehen rrobat nëpër ballkone, që t'i shohin sutjenat e brekët e gravet tona kalimtarët, të mos jenë të shëmtuar gjerdhet dhe portat e oborrevet nëpër fshatra, të mos digjen pyjet e kullotat, se e shëmtojnë Shqipërinë. Zjarrvënësit dhe dëmtuesit e pyjevet edhe në varr i ndjek e s'i lë të qetë mallkimi.

TOKA SHQIPTARE quhen edhe ato pjesë të Shqipërisë, të

cilat, filluar nga viti 1877 e këndeje, gradualisht janë zëvendësuar me popullsi të tjera, sllave ose greke. Për zbulimin edhe të atyre tokave, ne tashmë nuk kemi gjë në dorë. Por duhet thënë një e vërtetë, që është shumëfish e hidhur: **Ato toka, ATA TË TJERËT i mbajnë më mirë se ç'i mbajmë ne këto që s'na i kanë marrë.** Ka ardhur koha që sedra jonë të gërvishtet ndijshëm. Të na skuqet lëkura e faqes edhe prej kësaj së vërtete vërtet tepër gërryese!

Bujqësia, zbuluesja e Dheut. Ka ardhur koha që bujqësinë ta modernizojmë jo veç për ekonomi, por edhe në funksion të zbulimit të vendit tonë.

Sot për sot, bujqësia jonë, më mirë të themi **pabujqësia** jonë, i ka dhënë Dheut tonë një fytyrë të shëmtuar. I tronditur për dekada të tëra prej këtij lloji shëmtimi, autori i këtyre parashtrimeve ka menduar gjatë se çfarë bujqësie do t'u shkonte më për shtat shqiptarëve dhe tokavet të Shqipërisë. Çfarë bujqësie do t'u përshtatej shqiptarëve, që ata të mos e përbuzin dhe të mos e braktisin atë, siç e kanë braktisur. Sigurisht që mbi këtë problem ka shumë të tjerë që kanë menduar, por ne po japim mendimin tonë.

Vendit tonë nuk i shkon një prone bujqësore qindra e mijëra hektarësh. Ne nuk kemi hapësira të atilla, siç i kanë psh Rusia, Kanadaja, SHBA-ja, Australia. I kemi pasur **çifligjet e bejlerëve** dhe ata ishin aq anakronikë, sa e çuan krejt vendin në një kënetëzim mushkonjor, jo vetëm të pakëndshëm, por edhe të urrejtshëm e të frikshëm. I kemi pasur edhe **kooperativat e tipit të lartë**. Edhe ato e çuan vendin në një gërryerje e lakuriqësim, sa të pabukur, aq edhe përditë e më të paprodhimtë. Në pjesë të tjera të Shqipërisë, me pronat bujqësore kanë luajtur pushtuesit siç u ka dashur atyre qejfi.

Mirëpo ne nuk na shkon as një bujqësi që të jetë e grimcuar, e ndarë në prona të vogla 2-dynmëshe, 5-dynmëshe apo edhe

2-hektarëshe. Nuk na përshtatet një copëzim i këtillë, thjeshtë sepse nuk i del hesapi fshatarit të merret me atë punë në aq pak tokë. Prandaj ne mendojmë që **prona bujqësore në Shqipëri duhet të shkojë gradualisht drejt rrumbullakësimit rrotull 10-hektarëshit.**

Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare duhet të propagandojë, me argumentet përkatës të përimtuar, pikërisht pronat 10-hektarëshe. **Bankat duhet t'i stimulojnë me kredi të posaçme të këtilla prona.** Ato duhet të kreditojnë blerjen e sipërfaqeve deri në 10 hektarë (jo më shumë), pajisjen me mjetet e mekanizimit, rrethimin e tyre (si dikur në Angli, por me rrjetë teli, jo me gardh të kalbshëm) dhe vënien e tyre në punë. Kthimi i paravet do t'u garantohej bankavet nga vetë pronat e kredituara, siç bëhet zakonisht me kreditë e shtëpivet. Nëse kredimarrësi nuk i shlyen këstet, toka i mbetet bankës për t'ia shitur dikujt tjetër.

Pronat 10-hektarëshe i japin mundësi fshatarit për të zbatuar metoda bashkëkohore në të gjithë punën e tij. A) Të paguajë specialistët (agronom, veteriner, ekonomist, jurist) psh me nga 1/20-ën e pagës. (Secili prej këtyre specialistëve mund të mbajë me asistencë profesionale 20 ferma të tilla). B) Të përdorë në pronën e vet mjete të mekanizuar: traktor të vogël, prashitëse, korrëse, paketuese bari, pompa spërkatëse, pompa ujitjeje, rrjet tubacioni, serë etj. C) Të përdorë herbicide, pesticide dhe plehëra kimikë në mënyrë të rregullt. Ç) Të mbajë bagëti (4 lopë, 20 dhen, 7-8 dhi, 50 pula, rosa dhe pata) të cilat të mund t'i sigurojnë atij plehun e nevojshëm organik, me qëllim që prodhimet e tij bujqësorë të jenë "**të cilësisë bio**" në shkallën më optimale. D) Të organizojë në pronën e vet një qarkullim bujqësor sa më të përshtatshëm, por të ketë edhe pemë gjithfaresh (hardhi, fiq, agrume, mollë, ftonj, dardha). DH) Të mund të paguajë, në kohë piku, punëtorë me mëditje. E) Të sigurojë kontrata shitjeje në

kohë dhe me garancinë e nevojshme. E) Të mund t'i **shkollojë** fëmijët e vet normalisht, si të gjithë shtetasit e tjerë. F) Të mund t'i paguajë shtetit taksat në mënyrë të rregullt.

Përparësitë e pronave 10-hektarëshe janë qartësisht të dukshme në krahasim me çdo lloj prone tjetër bujqësore. Vetëm në këtë mënyrë fshatari ynë do të mund të quhet **fermer** në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Do të mund të krijohet kështu në Shqipëri një **klasë fshatare e mesme**, e cila do ta normalizonte shoqërinë tonë në shumë aspekte. **Institucioni i Përkujdesjes Gjithshqiptare** një të tillë klasë do ta kish mbështetur me të gjithë mjetet. Dmth me gjithë shpirt.

Meqë jemi te kreditimet bankarë, t'i themi edhe disa fjali nën okelion "**toka dhe uji**". Kreditimet e objekteve madhorë, të cilët në kohë thatësire i çojnë tokës ujin e në kohë reshjesh e mbrojnë tokën prej përmbytjesh, shembjesh e gërryerjesh, i organizojnë dhe i zgjidhin qeveritë. Bankat edhe këtu doemos e kanë rolin që u takon. Por në përpjesëtime më të vegjël, në përshtatje me kushtet e çdo grupimi fermash, (në vizionin tonë, jo më të mëdha se 10-hektarëshe), bankat do të mund të kreditonin **ngjitjen e ujit** nga baza (lumenj, liqene, kanale) në pikat dominuese të tokave. Kredimarrësi do ta kish pronë të vetën një të tillë **ujëngjitës** dhe ai do t'i nozullonte me sasi të nevojshme të ujit fermat rrethrotull, me të cilat, natyrisht, do të kishte kontratat përkatëse. Të tillë **ujëngjitës** do të mund të instaloheshin në vendin tonë disa mijëra. Një tjetër kreditim "**të vogël**" do të mund të bënin bankat për ndërtimin e **ujëmbledhësve familjarë**. Në Shqipëri ka qenë traditë ndërtimi i të tillë ujëmbledhësve ose **ujëgrumbulluesëve** dhe ata quheshin **hurdha**. Por tani bëhet fjalë që ata të jenë prej betoni, me kapacitet e kosto të studiuar mirë: 1000m³, 5000m³ ose edhe më pak, psh 200m³, 150m³ etj. Kërkesat për rezervuarë të tillë do t'ishin aq të shumta, sa vetë presidentët e bankave do të çuditeshin. **Shqiptari** duhet

të shikojë perspektivë, duhet të shikojë që ka të ardhshme, dhe ai është **jashtzakonisht aktiv**. Shqiptari është iniciator. Vetëm kur s'ka çka bën, shdërrohet në keqbërës (në radhë të pare në dëmtues të vetëvetes).

Kujtesa historike. Në token shqiptare ka nevojë të evidentohet vizualisht historia. Ç'duam të themi me "*të evidentohet vizualisht*"? Duam të themi që kalimtari të ketë mundësi t'i shikojë me sy ngjarjet që kanë ndodhur këtu në të gjitha kohët, dhe kjo arrihet duke ndërtuar **memoriale**. Shkëmbinj të mëdhenj me nga një tekst të gdhendur në ta, sajesa prej betoni, të formatuara në gjithfarë pamjesh e dimensionesh, në të cilat të mund të lexohet nga një tekst, pllaka mermeri, jo gjithmonë, madje pothuaj asnjëherë katërkëndëshe, sajesa metalike (bronx, gizë, inoks, llamarinë e zakonshme), sajesa të shumëllojshme qeramike, trungje të trashë e të mëdhenj, trajtuar në mënyrë që të mos kalben. Dhe shih ç'mund të gjejë kalimtari në të këtyllë objekte përkujtues! "*Këtu ka fjetur një natë Johannes Georg von Hahni në vitin 1858*". "*Këndeje ka kaluar me një ushtri të madhe sultan Mehmeti II në vitin...*" "*Ky është vendi ku ka bërë bisedime me përfaqësuesit ilirë pretori romak Anici, në vitin...*"

"*Në vitin 1702 ka bujtur këtu arqipeshkvi Vinçenc Zmajeviqi.*"

"*100 m më lart ndodhet një shpellë karstike.*"

"*Në v 1943, këtu partizanët shqiptarë u kanë bërë pritë italianëve*".

"*Në vitin 1944, në këtë vend, ka ndodhur një luftim midis ushtrisë partizane shqiptare dhe një kompanie gjermane.*"

"*Ky është vendi ku dikur është kultivuar mëndafshi*".

"*Në këtë krahinë ka një racë qensh që njihet me emrin (kështu)*"

"*Në këtë trevë kultivohet fiku me emrin (kështu)*".

“Ky vend kultivon rrushin që quhet (kështu).”

“Vizitoni ujërat termalë që njihen me emrin (kështu).”

“Këtu është vrarë Atë Shtjefën Gjeçovi.”

“Këtu ka jetuar Hasan Zyko Kamberi”

“Këtë pjesë të Shqipërisë e ka sunduar, në Epokën e Ilirëvet, mbreti (filan).”

“Këndej ka kaluar ushtria e mbretit Agron.”

“Këtu është rrëzuar një avion sërb”.

“Ky është vendi ku ka jetuar Ndre Mjeda”

“Në këtë vend janë ndeshur Mark Antoni dhe Jul Cezari.”(Vo!Jo te Shkëmbi i Kavajës, por në Karpen të Kavajës. GjD)

“Këtu është vrarë Xhevdet Mustafa.”

“Këtu është kapur Hamit Matjani.”

“Këndej ka kaluar Ahmet Zogu, kur ka rrëzuar qeverinë e Fan Nolit.”

“Këtu ka lindur Mehmet Shehu.”

“Kjo ka qenë shtëpia e Hivzi Sulejmanit.”

“Këtu ka punuar Esat Mekuli.”

”Këtu është zënë rob Moisi Golemi.”

“Këndej ka ardhur ushtria e Gjergj Kastriotit kur ka rrethuar Drishtin.”

“Këtu kanë pasë kuvendin françeskanët, nga v (kaq) deri në v (kaq).”

“Në këtë vend janë vrarë 5 komunistë, që më vonë u quajtën Herinjte e Vigut.”

“Këtu ka lindur atë Gjergj Fishta.”

“Ky është fshati i Selam Musait.”

“Këtu ka jetuar Marko Boçari.”

”Në kë krahinë rriteshin gjedhë të një race të veçantë me brirë të gjatë në Epokën e mbretit Pirro.”

”Kjo ullishtë është më se 2000-vjeçare.”

”Këtu është vrrarë Balsha II.”

“Në këtë vend kultivohet patatja”

“Këtu kanë bërë grevë minatorët e Trepçës”.

Kur të mbushet Shqipëria me të këtillë **përkujtues**, turistët nuk do të mund të ecin më me makina. Ata do të detyrohen të udhëtojnë më këmbë nëpër Shqipëri.

FEJA E SHQIPTARËVET

NË EPOKËN E GLOBALIZIMIT

Politika e jashtme e Etnitetit Arbëror (nga sh XVIII: Komb Shqiptar), që nga koha e Gjergj Kastriotit Skënderbeut e këndej, ka qenë, që ta bindë Evropën që ne nuk jemi një komb islamik. Madje, po të shikosh më tutje, njëra nga tendencat kryesore të arbërvet të hershëm ka qenë që ta bindin pjesën perendimore të Evropës se arbërit nuk janë as greko-bizantinë e as sllavë të jugut. [Shprehjet *me bindë*, *me i mbushë mendjen (dikujt)*, po i përdorim këtu me kuptim mjaft relativ.]

Tendenca kryesore e Rilindjes sonë të sh XIX ishte që t'i mbushin mendjen Evropës që shqiptarët nuk janë turq. Janë një varg i gjatë personalitetesh të Kombit tonë, të cilët e kanë shkrirë jetën pikërisht për këtë qëllim: Të krijojnë në botën e atëhershme bindjen që ne ishim dhe jemi një komb i lashtë, jo i Azisë, por i Evropës. De Rada, Kamarda, Skiroi, Serembe, Dara, Dora d' Istria, Veqilharxhi, Mitkoja, S.R.Dineja, J.Vretoja, P.Vasa, Marko Boçari, Z.Jubani, K.Kristoforidhi, P.Nini, K.Negovani, A.Z.Çajupi, N.Mjeda, F.Noli, Gj.Fishta, J.Rrota, D.Kurti, L.Gurakuqi, A.Xhuvani, K.Cipoja, A.Buda, A.Çeta, M.Krasniqi, Dom Lush Gjergji. Vargu i këtyre personalitetëve është shumë i gjatë. Ai nuk fillon te De Rada e te Skiroi, por shumë më thellë në histori, psh te arqipeshkvi Pjetër, themeluesi i Arqipeshkvisë së Tivarit në sh XI, te Pal Engjëlli, te Gjergj Pelini, te M.Barleti, te M.Beçikemi, te vëllezërit Gazulli, te Leonik Tomeu, te Gj.Buzuku, te P.Budi, te P.Bogdani, te F.Bardhi, te Gj.N.Kazazi. Madje edhe më tutje, shumë më përtej Arqipeshkvisë së Tivarit. Ngjizja, formimi, formulimi i Kombit tonë i ka rrënjët më thellë se cilido komb tjetër i Evropës. E themi pa mëdyshje: Më thellë

edhe se Greku, edhe se Latini. Për Rumunin nuk mund të themi, sepse nuk ia njohim rrënjët më të hershme.

Lëvizjes që e përshkruam pak më lart, pra, lëvizjes së një vargu të gjatë të arbro-shqiptarëve të krishterë, për ta bindur Botën që ne nuk jemi as grekë të Bizantit, as sllavë të Jugut, as turq myslimanë të Azisë, në sh XIX iu shtua edhe vargu i më të kthielltëve **shqiptarë myslimanë**. Na duhet të vëmë re këtu që, **po të mos e kish kuptuar pjesa myslimane e shqiptarëve që ne nuk jemi një komb islamik**, por jemi një komb me rrënjë të lashta të krishtera e madje para të krishtera, **Kombi Shqiptar nuk do t'ia arrinte të vetafirmohej as në sh XIX, as në sh XX**. Ishte pjesa myslimane ajo që iu bashkua frymës **rezistuese** të pjesës sonë të krishterë dhe i dha ashtu mundësi këtij Kombi që të bëhet shtet më vete dhe të hyjë përfundimisht dhe në mënyrë të pakthyeshme edhe zyrtarisht në listën e kombevet shtetformues të Evropës. Janë vëllezërit Frashëri (Samiu harton strategjinë e Kombit të vet, Abdyl i organizon lëvizjen politiko-shtetërore gjithkombëtare, Naimi bëhet poeti i Kombit të vet), është Hoxha Tahsini, janë Dinot e Çamërisë, është Ymer Prizreni, janë: Sylejman Vokshi, Ismail Qemali, Idriz Seferi, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Riza Cerova, Azem Bejta, Bajram Curri, janë: Zenel Gjoleka, Zylyftar Poda, Sali Butka, Selam Musai, janë: Sulejman Delvina, Avni Rustemi, Mehdi Frashëri, Sejfi Vllamasi, Selman Riza, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Selami Pulaha. Qindra të tjerë të njohur e qindra mijë të panjohur.

Të gjithë këta myslimanë shqiptarë, me punët e tyre konkrete, në shkencë, në art, në politikë, në arsim, i japin Kombit Tonë pamjen dhe tendencën e patjetërsueshme evropiane, joazatike dhe e lidhin ashtu ekzistencën e vet jo më me Orientin, por me Oksidentin. Dëshmia më madhore është pa dyshim vënia në ballë të këtij Kombi e një **flamuri**, ndoshta edhe të mëhershëm, por gjithsesi e përfundimisht **të krishterë**, sepse ishte flamuri i

Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Nuk është shkencërisht e vërtetë ajo që pohohet në njëren prej trupave tona humoristike që ne jemi “*portokalli*”. Ne nuk jemi dhe as duhet të jemi një komb *portokalli*. Ne jemi dritë **jeshile** për kulturën dhe për politikën progresiste evropiane dhe jemi dritë e **kuqe** për çdo gjë negative (jo për pozitiven), që ka ardhur dhe vjen qoftë nga Veriu, qoftë nga Lindja, qoftë edhe nga vetë Perendimi.

Përçarja kishtarë greke ka qenë një punë negative dhe ne nuk jemi pajtuar asnjëherë me të, pravosllavizmi i sërbevët dhe i bullgarëvet ka qenë një veprimtari negative në dëm të kulturës evropiane dhe ne i jemi kundërvënë, islamizmi ka qenë një mësymje regresive në drejtim të Evropës dhe ne e kemi kundërshtuar atë me mijëra jetë arbëresh.

Do thënë përsëri që etniteti ynë në të gjitha kohët u është ruajtur edhe tendencavet negative që janë shfaqur e na kanë ardhur nga Perendimi. Përndryshe ne do t’ishim romanizuar si rumunët, ose do t’ishim asgjësuar e zhdukur me kohë, si thrakasit.

Kjo është tendenca boshtore e krejt qenies sonë në të gjithë shekujt. Tani, në kohën kur Kombi ynë po hyn në një etapë të re të ekzistencës së vet, është më se e domosdoshme të kuptohen edhe të vihen praktikisht në jetë e pakta 4 pika shumë të rëndësishme, pa të cilat ne përsëri na rrëzikohet ekzistenca.

1. Ne duhet t’i mbushim mendjen vetes, por edhe Amerikës apo Evropës, madje edhe Turqisë, Iranit, Arabisë e të tjerëvet, që **shqiptarët nuk janë një komb mysliman**. Ne jemi pasardhës të pellazgo-ilirëvet paganë, jemi ndër përfaquesit e parë të krishtërit, që me shfaqjen e tij, dhe jemi të myslimanizuar në një pjesë të konsiderueshme tonën në rrethana tepër specifike.

Midis nesh ka edhe do të ketë myslimanë, por komb mysliman ne nuk jemi vetëkonsideruar kurrë dhe nuk mund as duhet të

konsiderohemi të tillë. Thënë më shkoqur e më pa doreza, ne shqiptarëvet, shumicës së Kombit tonë të sotëm (përfshirë këtu edhe pjesën tonë me traditë myslimane, por të pajisur me kulturë bashkëkohore kombëtare dhe evropiane), nuk na pëlqen që të shikojmë nëpër qytetet tanë gjithë atë mori minaresh të xhamivet, ashtu si nuk na pëlqen të shikojmë as kisha pravosllave, greke apo kriptogreke. Nuk na pëlqen të shikojmë vehabi me këmbëza pantallonash 3-çerekëshe dhe nuk na pëlqen të kemi midis nesh djem të rinj me mjekrra të gjata, të cilët as që duan të dëgjojnë për Gjon Buzukun e për Pjetër Budin.

Kjo duhet të jetë në sh XXI ndër pikat kryesore të politikës, të diplomacisë dhe të kulturës sonë kombëtare. Pa një të këtillë veprimtari të vetëdijshme dhe këmbëngulëse, Kombi ynë në të ardhshmen, mund të vihet para rrëziqesh tepër të mëdhenj, deri edhe te rrëziku i genocidit dhe tentativa për të na shfarosur. Popujt që janë rrotull nesh, për të cilët ne mendojmë se nuk do ta braktisin tërësisht politikën e vet shumëshkullore antishqiptare, edhe kur të mos reklamohemi si komb mysliman, do të punojnë për të na hequr kënde, le më nëse ne u japim një arsye më shumë, me anë të së cilës ata të mund të siguronin edhe miq të shumtë. Natyrisht, kjo nuk do të thotë që ne të kuturisim tani e t'i prishim prapë objektet e kultit. Kjo nuk do të përsëritet kurrë më. Çdo gjë që mund të mos na hyjë në punë, duhet të inventarizohet si një vlerë e pazëvendësueshme muzeale.

2.Ndaj ortodoksisë greke dhe pravosllavizmit sllav Kombi ynë është i detyruar të bëjë kujdes të përditshëm dhe të një shkalle sa më të angazhuar dhe të kualifikuar.

Greku po synon që me anë të ortodoksizmit të vet të futet sa më thellë në tokën e shqiptarëvet. Ne duhet të kuptojmë që **Greku nuk e ka hallin e fesë, por ka hallin e tokës së shqiptarëvet.** Kundërpërgjigjja jonë duhet të jetë kjo: Të gjithë ortodoksëvet shqiptarë e arvanitë që jetojnë në shtetin grek u duhet siguruar

Kisha Autoqefale. Midis arvanitëvet, midis çamëvet ortodoksë dhe midis të gjithë ortodoksëvet të tjerë që e dinë se janë shqiptarë me prejardhje, duhet të vendoset liturgjia në gjuhën shqipe. Këtu duhet të bëhet propagandë shumë e madhe dhe punë konkrete, duke shuguruar një numër të mjaftueshëm priftërinjsh të frymës **noliane**. Nëse grekët nuk duan të hapin rrugë në këtë drejtim, atëherë ne do të kërkojmë që, të gjitha kishat dhe të gjithë manastiret, ku ka besimtarë shqiptarë apo arvanitë, qoftë edhe një nga një, të kërkojnë **mbrojtje prej Vatikanit**, dmth të kërkojnë që të bëhen **uniatë**.

Nëse e humbim këtë përballje, njëkohësisht fetare, politike dhe diplomatike, duhet të dimë që edhe ekzistenca jonë si Komb Shqiptar është prapë e rrëzuar.

Sllavi, edhe ai sërb, edhe malazias, edhe maqedonobullgar, po synon që, me anë të monumentalizimit të kishavet e të manastirevet, të justifikojë prapë pretendimet tokësorë në Shqipëri. **Zhurma që bëhet për manastiret e Kosovës**, të cilët në themelin e tyre nuk janë sllavë, **nuk ka qëllim të ruajë të paprekur fenë e pravosllavëvet**. Feja e pravosllavëvet në vetë Sërbinë e në Malin e Zi është reduktuar në një përqindje krejt të papërfillshme. Ajo ka qëllim që të mbajë më këmbë pretendimin tashmë 1000-vjeçar për t'u bërë zot në të gjitha tokat tona. Të njëjtin synim kanë edhe ndërtimi e rindërtimi i manastirevet pravosllavë në Ohër, në trevën e Prespës, në Manastir, në Shkup e gjithandej në truallin e shtetit të sotëm të Maqedonisë. Sllavomaqedonobullgarët duan që të paktën në këtë pjesë të tokavet shqiptare në të ardhshmen të kenë **“të drejtë legjitime”** për t'i pasur të vetat. Mitropolia e Malit të Zi ruan edhe sot në emërtimin e vet të drejtën juridike fetare mbi ortodoksët e Shkodrës (Skenderijes), të cilët faktikisht as që ekzistojnë. Po ajo Mitropoli e Malit të Zi, në trevën e Tivarit, të Podgoricës, të Ulqinit e gjetkë, po sillet sikur ata vende kanë qenë përherë vende

të sllavëvet. Mitropoliti prosërb e antimalazias Amfillohije arriti të vijë në Shkodër gjysmëinkonjito dhe t' i “*vizitojë*” e “*bekojë*” varret e ushtarëvet sërbë e malazias, **pushtues** të vitevet 1912-1913, duke i quajtur ata hiç më pak se “*luftëtarë për çlirimin e Shqipërisë*”.

Të gjitha këto janë tepër serioze, prandaj, nëse duam të kemi një **Përkujdesje Gjithshqiptare**, ajo **Përkujdesje** është e thirrur që t' u përgjigjet këtyre situatave serioze në mënyrën sa më adekuate.

3.Feja katolike objektivisht nuk e rrëzikon Kombin tonë. Interesi ynë, e pakta qysh prej Justinianit të Madh e këndeje, pra këtu e 1500 vjet, edhe në pikëpamje të ruajtjes së identitetit, ka qenë që fetarisht të jemi të lidhur jo me Selanikun e me Konstantinopolin, të uzurpuar qysh atëherë prej klerikëvet grekë, por me Romën. Pikërisht për këtë arsye ai pat krijuar Kryepeshkvinë e Ilirikut Lindor me qendër në Justiniana Prima (Shkupi i mëvonshëm). Mirëpo, interesimi i Vatikanit për të ruajtur etninë tonë e njëkohësisht fenë së cilës i përkiste kjo etni, në të gjitha kohët nuk ka qenë as përafërsisht i mjaftueshëm. Vatikani, në shumë raste i ka përkrahur më shumë monarkët sërbë se sa princat e Arbërisë. Në ditët e sotme Vatikani po heziton për ta njohur Kosovën si shtet. Natyrisht, këta nuk janë shenja të mirë. Në të këtilla rrethana, megjithatë, ne na takon që të mundohemi ta ruajmë qenien tonë katolike, fe e cila ka ardhur në Iliri para se të shkonte në Itali. Por, më katolikë se spanjollët, se francezët, se gjermanët apo se italianët, kupohet që nuk do të kërkojmë të bëhemi. Ne jemi një komb në të cilin kanë të drejta të barabarta që të 3 religjionet, megjithatë, pa u përzier aspak në çështje të teologjisë, por historikisht, strategjikisht dhe politikisht **ne na takon të parapëlqejmë Krishtërimin Perendimor**. Duhet ta kemi të parapëlqyer Krishtërimin Perendimor, përfshirë aty edhe uniatizmin, midis tjersh edhe për faktin që **ai krishtërim**,

ndryshe nga ortodoksia dhe myslimanizmi, **nuk ka ardhur këtu si fe e pushtuesit**, por përkundrazi, është përhapur në Iliri si një prej mjeteve paqësore pikërisht për ta kundërshtuar atë pushtim. Ose, më mirë të themi, krishtërimi i shekujvet I dhe II të e.s. është përhapur ndër ne me idenë e madhe që të gjithë popujt duhet të jenë të barabartë para Zotit edhe para shtetit.

4. Duke i pasur parasysh të tria pikat që i trajtuam më sipër, Kombi ynë duhet të njohë edhe një tjetër fakt shumë të rëndësishëm: **Një pjesë e madhe e shqiptarëve**, ashtu si në të gjithë Botën, në Evropën Perendimore, në Amerikë, në Rusi, në Kinë e kudo gjetkë, **është tashmë laike**. Kjo, në pikëpamjen tonë do të thotë: Megjithse tradicionalisht i përket njërit apo tjetrit konfesion, ajo tashmë nuk zbaton rregullat as të njëres as të tjetres fe. Janë laikë, janë ateistë, janë shekullarë apo iluministë, quaji si të duash, por fakti është që ata ekzistojnë në një numër të madh dhe nuk ka asnjë arsye që të injorohen. Në politikën tonë kombëtare na duhet ta pranojmë që ata, laikët, janë shumë më të efektshëm se cilido prej konfesioneve tanë tradicionalë. Ata në një farë mënyre i trajtojnë që të gjitha fetë njësoj dhe e kanë shumë më të lehtë ta përqafojnë atë idenë e Kombit tonë, të shfaqur këtu qysh prej Rilindjes që ***Feja e Shqiptarit është Shqiptaria***.

Përmbyllje: Secili shqiptar është i lirë të zgjedhë e të praktikojë cilëndo bindje, por në të gjithë rastet është i lutur të ketë shumë kujdes. Kapitalizmi është sistemi i afirmimit të kombeve më shumë se cilido sistem tjetër i mëparshëm. Globalizmi, si epokë vazhduese globërisht e financiarizuar dhe e informatizuar e kapitalizmit, përmban shumë rrëzique jo për të gjithë kombet, por për ata kombe që nuk tregohen të kujdesshëm. **Ata kombe që nuk tregojnë kujdesin e duhur ndaj vetes, janë të destinuar të asgjësohen për llogari të kombeve të tjerë fqinjë ose jo fqinjë.**

Kaq për sa dimë deri këtu. Më tutje nuk dimë se çfarë do të

ndodhë, ndonëse duhet të përpiqemi për të parashikuar aq sa të jetë e mundur të parashikohet.

EKONOMIA E KOMBIT SHQIPTAR NË EPOKËN E GLOBALIZIMIT

Globalizmi është kapitalizëm në shkallë Globi, në përmasat e planetit Tokë. Kapitalizmi në shkallë shteti ka të bëjë me individë, me familje dhe me grupe individësh, me klasa e shtresa shoqërore. **Kapitalizmi në dimensionet e Globit, në shkallë Toke, ka të bëjë me shtete, me kombe, me grupe shtetesh a kombesh.** Nëse Globalizmi organizohet si kapitalizmi në Danimarkë, shtetet dhe kombet kanë hapësirë ligjore reale për të jetuar normalisht dhe për të prosperuar. Nëse Globalizmi organizohet siç u “*organizua*” kapitalizmi në Republikën e Shqipërisë (në vitet 1991-2010 etj), ku “*klasa politike*” s’i lodhi fare as shpirtin, as mendjen, për fatin e individëve, të familjevet e të grupevet të individëve, **kombet e Globit** do të kenë fatin e trafikantëve të llojlojshëm, të politikanëve birbo, të lypësve, të pensionistëve, të ish-të persekutuarve, të romëve, të emigrantëve klandestinë dhe të femrave naife, në Republikën e Shqipërisë të këtyre viteve. Kombi shqiptar, sigurisht, në një të tillë sistem globalizimi do të ketë fatin e qorrrave, të sakatëve dhe të prostitutave.

Por ne po shpresojmë që Globalizmi të mos organizohet si kapitalizmi i deritashëm në Republikën e Shqipërisë, por si kapitalizmi në shtetin e Danimarkës.

Përpjekje po bëhen (Kujto: takimet e G7-s a 8-s, të G-20-s, zërat e shkencëtarëve, lëvizjet e ekologjistëve etj), por, sidoqoftë, të gjithë kombet (apo shtetet) duhet ta kuptojnë që **edhe në Epokën e Globalizmit**, prapëseprapë, edhe në rastin më të mirë, **secili do të marrë atë** që i takon dhe atë që **meriton**.

Nëse është i paaftë për të punuar, nëse është i paaftë për t'u organizuar, nëse nuk harmonizohet dot në qenien e vet si shtet apo si komb, ai, prej sistemit globalist, e shumta do të mund të marrë një "*asistencë sociale*" dhe, ose do të rrojë gjithë jetën rromapërtoma, ose do të shuhet pa iu dhimbtë askujt.

Po marrim 2 shembuj. Në Republikën e Shqipërisë, grekët dhe romët, si pakicë kombëtare dhe në Republikën Franceze, rastin e romëvet imigrantë, krahasuar me atë të grekëvet imigrantë.

Në Republikën Franceze, romët (jvegjit, gabelët, arixinjtë, quaji si të duan ata), qeveria franceze i dëboi. Ka të drejtë a s'ka të drejtë, është tjetër punë. Por, a kemi dëgjuar ndonjëherë që francezët të kenë dëbuar nga Franca grekët?

Në Republikën e Shqipërisë, grekët kanë partinë e tyre. Romët nuk kanë parti, po edhe sikur ta kenë, ajo do të dallohej thelërisht prej partisë së grekëvet. Grekët, partinë e vet e kanë quajtur: *Partia "Bashkimi për të drejtat e njeriut"*. Me këtë ata duan të thonë: "*Të gjithë banorët e tjerë, që jetojnë në shtetin e shqiptarëvet, nuk janë njerëz. Vetëm ne jemi njerëz*"... Duan të thonë dhe e kanë thënë dhe askush prej shqiptarëvet nuk ka bëzajtë. Të gjithë ata grekë që ankohen se "*s'i kanë të drejtat e njeriut*" dhe kanë krijuar parti për të bashkuar zërat në kërkim të atyre të drejtave, i ke në parlament, i ke në të gjitha ministrinë dhe kudo ku ata e shohin të dobishme për të qenë. Shtiren sikur mbrojnë edhe të drejtat e romëvet dhe të pakicavet të tjera, por kjo është vetëm artificë e tyre. Realisht ata luftojnë vetëm për vete dhe për atë pjesë të shqiptarëvet apo vllahëvet, që arrijnë të bëhen "*njerëz*", duke u "*vorioepirotizuar*" alias "*greqizuar*". Romët, ndërkaq, mbeten anës lumenjvet, në periferi të qytetevet.

Ngjashëm me romët i ke edhe një pjesë të mirë të shqiptarëvet. Para pak kohësh zbarkuan në Shkup 2 autobusë me shqiptarë të dëbuar nga BE-ja, pa të drejtë për të shkuar

për 5 vjet në Zonën Shengen. Midis të dëbuarvet nuk kish asnjë sllavomaqedon, ashtu si midis romëvet të dëbuar nga Franca nuk kish asnjë grek apo rumun.

Ky është Globalizmi, në daç i rregulluar si kapitalizmi në Danimarkë e Francë, në daç i çrregulluar si kapitalizmi në Republikën e Shqipërisë dhe në shtetin që quhet Maqedoni.

Përballë një të këtillë së vërtete, pjesa e vetëdijshme e Kombit Shqiptar duhet t'ia vërë mirë gishtin kokës. **Po qemë të zotët të mirëkuptohemi e të bashkëveprojmë kombëtarisht, do të mund të prosperojmë, po s'qemë të zotë, nuk do të mund as të mbijetojmë.** Do të mbetemi “*anës lumenjvet*” të palarë, midis plehëravet, vetjakë dhe të importuar, gjithë jetën të margjinarizuar.

Përkujdesja Gjithshqiptare duhet të ketë si synim që, në një të ardhshme sa më të afërt, të mos i shkojë më mendja askujt për të dëbuar ndonjë shqiptar prej vendit ku ai ka shkuar. Kjo do të mund të arrihet, nga një anë duke u dalë zot bashkëkombasvet të vet, nga ana tjetër duke pëmirësuar individin tonë. Duke e “*trajnuar*” atë që të jetë i denjë për të qenë shqiptar. Nuk ka rrugë tjetër! Krijimi i ***qindëshevet përkujdesëse*** pikërisht këtë qëllim ka dhe institucioni i ***profesorit përkujdesës*** ka synimin pikërisht përmirësimin e pandërprerë të secilit individ dhe të secilit grup individësh. **Nuk ka fe pa prift, pa rabin, pa hoxhë, nuk ka përmirësim kombi pa predikues të kombit.** Predikues institucionalë dhe të përhershëm! Ndryshe, sidomos në gjendjen që jemi ne, nuk do të mund të arrihet asgjë, në këtë kohë, hem të mirë, hem të vështirë të Globalizmit.

(Meqë i përmendëm **romët**, po themi edhe këtë: Romët nuk do të mund të integrohen kurrë, dmth, nuk do të mund të barazohen kurrë me kombet e tjerë, po nuk krijuan shkollat, që nga fillorja deri në universitete, për fëmijët tyre, dhe po nuk e ndanë natë për natë gjysmën e pulës që hanë, për shkollimin e

racës së vet. Ne nuk do të kishim të drejtë të kërkonim prosperim për vete, në qoftë se nuk do të dëshironim që edhe ata dhe kushdo tjetër të prosoerojë.)

Pasi kombi, në këtë rast **Kombi ynë, Kombi Shqiptar**, të ketë qartësuar dhe vënë në rrugën e zgjidhjes praktikisht problemin e **arsimimit** më vete dhe për vete, atij, njëkohësisht e paralelisht i mbetet të qartësojë e të vërë në rrugën e zgjidhjes problemin e **ekonomisë** më vete e për vete.

Integrim nuk do të thotë as shkrirje as tretje. **Integrimi është bashkëveprim subjektsh qartësisht të dallueshëm**. Shkrirja apo tretja nënkupton përfitimin e një amalgame apo tretësire cilësisht të re. Në tretësirën cilësisht të re (ose amalgamën), lënda që është sasijisht më e pakët, i humb thuajse tërësisht vetitë e veta. Hidh 2 lugë kripë në 2 kuinalë sheqer. Ç'vlera do të ketë kripa?! Shkriji 2 milionë shqiptarë në 200 milionë sllavë apo anglofonë! Ç'përfaqësojnë aty shqiptarët?!

Ky është thelbi se si duhet ta kuptojnë shqiptarët **Epokën e Globalizimit**. Në të gjithë organizmat ekonomikë, ku marrin pjesë shqiptarët, është e domosdoshme të dallohet ç'është e tyre e ç'është e tjetërkujt. Vetëm në këtë mënyrë, shqiptarët do të mund ta përdorin për vete fitimin e vet. Ashtu si Amerikani, Anglezi, Gjermani, Italiani, Sërbi, Turku, Greku, e përdorin fitimin e vet **për vete**, ashtu edhe Shqiptari duhet ta përdorë pjesën e vet të fitimit **për vete**. Kur themi *për vete*, themi **për Kombin e vet**, jo për të shtuar dhjamin e barkut vetjak. Të ardhurat që shqiptarët realizojnë, qoftë brenda në Shqipëri (Tiranë, Tetovë, Trepçë, Tivar), qoftë jashtë Shqipërisë (Itali, Izrael, Izmir, Irlandë, Indonezi, Ilinois), nuk duhet të hyjnë në ekonominë shqiptare në formën e bamirësisë, si sadaka, por **në funksion të forcimit e të rritjes së kapitalit kombëtar shqiptar**.

Zotëruesit shqiptarë të kapitalevet, të udhëzuar e të nxitur nga propaganda e *Autoritetit Përkujdesës Gjithshqiptar*,

duhet t'ia dalin, duhet të arrijnë me përpjekje të gjithanshme që pjesa e tyre e investimevet në Shqipëri të japë po aq fitim sa edhe në një tjetër pjesë të Globit. S'ka pse pjesët e tjera të Globit të jenë **parajsë** për ekonominë e shqiptarëvet e Shqipëria të jetë **ferri** i ekonomizimit të tyre!

Puna e **predikuesvet përkujdesës** do të konsistojë në 2 fusha: 1.Në vetëdijësimin që, sado i suksesshëm të jetë një shqiptar, nëse shkëputet prej Atdheut të vet dhe prej Kombit të vet, suksesi i tij do të vijë duke u shuar. Nënosi i vetë atij, i pasardhësve të tij, doemos. 2.Ashtu siç lufton një shqiptar, me vetëdije individuale, për t'i bërë vend vetes në botën joshqiptare, ashtu duhet të luftojë e të përpiqet, me vetëdije patriotike, për t'i bërë vend vetes brenda botës shqiptare. Nuk është lehtë për një inxhinier apo ekonomist t'i bëjë vend vetes në Kanada apo në Gjermani. Duhet përpjekje, duhet disiplinë e zbatim ligjesh, duhen studim e specializim, duhen edhe njohje e miqësi me njerëz që i hapin rrugë individit. Atëherë, le t'i bëjë shqiptari të njëjtat përpjekje për të arritur suksesin edhe në Atdheun e vet!

Vijmë kështu prapë te domosdoshmëria e krijimit të **osmozës mirëkuptuese** në Kombin tonë. Në vështrimin e vetekzistencës si **etni**, pra edhe si **ekonomi**, të krijohet bindja se jemi shqiptarë dhe se, si të tillë, **duhet të shkojmë mirë njëri me tjetrin**, si dhe **të ndihmohemi reciprokisht**. Po nuk shkove mirë në familje, nuk ka si përparon familja dhe as vetë individi s'ka perspektivë. **Po nuk shkove mirë brenda kombit dhe po nuk bashkëpunove ekonomikisht, nuk ka si përparon kombi, dhe as individi**. Individi, sikur edhe majat e suksesit t'i ketë arritur, s'i ka vlerën dhe peshën që do t'i kishte kur është i lidhur me rrënjët e orgjinës së vet.

Një shqiptar, sapo t'i lejojë vetes të shndërrohet në **"amerikan"**, s'është tjetër veçse një lugë uji në oqean. Kurse një shqiptar, i cili qëndron në Amerikë si **"puro shqiptar"**, ai ka

atje vlerën e një relikeje qindramilionëshe. Ka vlerë në Amerikë, ka vlerë edhe në Shqipëri. Kur një shqiptar “*shndërrohet në grek*” në Greqi, ai humb midis grekëve si kokrra e arrës në thesin e arravet, lëndë e parë për bakllava. Por kur shqiptarët që jetojnë në Greqi, mbeten shqiptarë, ata, jo vetëm ia ruajnë vlerat vetes (njerëz të vërtetë, jo kokrra arrash), por e dobësojnë edhe shovinizmin grek. **Shqiptarët që greqizohen, e shtojnë shovinizmin grek dhe rrëzikun e një rigjakosjeje midis grekëve dhe shqiptarëve, ndërsa shqiptarët që nuk greqizohen, e neutralizojnë shovinizmin grek dhe i shtojnë shanset për të mos u gjakosur në të ardhshmen 2 kombet tanë.**

Shoqëri, miqësi, bashkëpunim, besim i ndërsjellët, zemërgjërësi, martesë djemsh shqiptarë me vajza shqiptare e vajzash shqiptare me djem shqiptarë, ekonomizim i përbashkët (ku natyrisht secili të ketë fitimin sipas kontributit, jo xhvatje), argëtim duke kultivuar artin tonë kombëtar, ruajtje e gjuhës shqipe, ruajtje e vlerave tona pozitive shumëshekullore, zbatim real dhe i kthjellët i besës shqiptare (themi: *real dhe i kthjellët, jo: besë prej budallai, as besë prej të pabesi*), kujdes për të mos ia prishur familjen tjetrit, këta duhet të jenë disa nga gurët themele në jetën e secilit komunitet shqiptar kudo që të ndodhet ai. Por kryesori është: **Të ndihmojmë njëri-tjetrin për t’u kapur e për t’u forcuar ekonomikisht.**

Çelësi më i thjeshtë, me anën e të cilit secili shqiptar ia hap rrugët afatgjata të jetës vetëvetes, është: **Të mos e fshehë, por ta reklamojë identitetin e vet.** Të **deklarohet** shqiptar dhe të **regjistrohet** shqiptar, edhe në Greqi, edhe në Turqi, edhe në Evropë, edhe në Amerikë, edhe në Indonezi, edhe pëtej Globit tonë, në Hënë, në Mars, në Jupiter, në Prahë edhe në Ferr.

Çelësi më i thjeshtë me anë të të cilit administrata shtetërore shqiptare dhe çdo lloj administrate tjetër e shqiptarëve, për t’ia bërë të dashur secilit shqiptar Atdheun dhe Kombin e tij, është:

Të mos pranojë ryshfete prej asnjë shqiptari në shkëmbim të kryerjes së çfarëdo lloj pune administrative. Hendikapi, i cili e ka emrin **Korrupcion** dhe që, në formën e prangavet të rënda mesjetare, bizantine, venedikase dhe turke, e pengon Kombin Shqiptar të ecë normalisht në rrugën e përparimit, mund të zgjidhet fare lehtë: **Kërkoji adresën apo kartvizitën çdo njeriu që vjen në zyrën tënde për çfarëdo lloj pune.** Në rastet kur individi, të cilit i ke bërë një shërbim **administrativ**, të ka lënë mbi tavolinë apo “**nën banak**” një të quajtur “**kafe**”, ti **shko në postë dhe ktheje “kafen” në adresën përkatëse.** A duam të jemi njerëz të rregullt e dinjitozë?! A duam të jemi komb i rregullt dhe dinjitoz?! Këto janë rrugët!

Autori i këtyre rreshtave ka **DISA** raste për të treguar se si e ka larguar ai këtë sëmundje prej vetëvetes. Po tregojmë vetëm 2 episode, edhe për t’iu larguar sadopak monotonisë teorike.

1. *Një nxënëse e mirë kish ardhur e papërgatitur dhe kish marrë notën 4. Në mbrëmje erdhi “për vizitë” nëna e asaj nxënëseje. Kish prurë një shportë me fiq të zez e me rrush tajgë. Mësuesi nuk mundi t’ia refuzonte “bakshishin”, por të nesërmen e ngriti prapë nxënësen në mësim dhe ajo mori prapë 4. Për 5 a 6 vjet shërbim në atë fshat nuk erdhi më askush për të prurë “dhurata” në familjen e atij mësuesi. Si rrjedhojë, të gjithë prindët ishin shumë të kënaqur prej punës së tij, sepse të paktën nuk do të pakësonin ushqimin e vet për të ushqyer mësuesin dhe familjebn e tij. Ndërsa fëmijët e tyre nuk do t’i mbështetnin më shpresat për nota të mira te rrushi, te mollët, te gjiza dhe te vezët.*

2. *Rasti i dytë i ka ndodhur autorit të këtyre radhëve shumë vite më vonë në një vend tjetër. Një nënë kish prurë një kovë të madhe me kos dhe po lutej për të mos ia humbur vitin djalit të saj. Askush s’kish ndërmend t’ia humbte vitin fëmijës, nëse ai do të përgjigjej të paktën për një 5. Por kovën me kos nuk mund ta pranonte, sepse një i tillë pranim do të përbënte jo vetëm një humbje të madhe*

morale, por do të dëmtonte në të ardhshmen dhjetëra nxënës të tjerë. Nëna e fëmijës ngulte këmbë për të mos e kthyer kosin nga e kish prurë, duke u justifikuar që nuk ia lejonte “feja”. Atëherë mësuesi i tha i zemëruar: “Ti ke fenë tënde, e cila nuk të lejon ta kthesh në shtëpi atë që e ke nxjerrë njëherë nga shtëpia, por edhe unë kam fenë time, e cila nuk më lejon që ta mbaj atë prodhim blegtoral në shtëpinë time. Merre dhe çoja dikujt tjetër! Çoja tezes apo hallës! Ose derdhe te mbeturinat!”...

Autori i këtyre radhëve nuk ka pasur rast që ta joshë dikush me miliona apo me miliarda, por është i bindur se edhe në të tillë raste do të kish vepruar po kështu. Kjo është rruga për të shëruar administratat shqiptare prej sëmundjes diabetike të korrupsionit. Xhelozia ndaj ekonomivet të stabilizuara të kombevet të tjerë, duhet të na shtyjë për ta shëruar vetëveten. Xhelozia, por edhe frika që, duke qenë të dobët ekonomikisht, jo **mund** të na përsëriten, por **me siguri** do të na përsëriten masakrat që i kemi përjetuar kaq herë. Dhuna ushtrohet ndaj të dobët.

Në kushtet e **Globalizimit** të ekonomisë, të cilën jo vetëm nuk mund ta ndalim, por as duhet ta ndalim, ne duhet të ruhem shumë nga të treturit, nga të shkrirët e ekonomisë sonë në detin apo në furrën e ekonomivet që na rrethojnë. Sado e vogël të jetë ekonomia jonë, ne duhet **të ruajmë subjektivitetin** e saj. Duhet **të ruajmë subjektivitetin e ekonomisë sonë**, e cila fillon me prodhimin dhe me shitjen e organizuar të fiqvet dhe të vajit të ullirit, të specavet të Pejë-Prizrenit, të patatevet të Vushtrrisë, të djathit të Shartrit, të peshkut të liqenevet, të megavatëvet të rrymës, të kromit e të naftës, dhe kornizohet, zinxhirëzohet, përafrohet drejt vetëvetes, me mirorganizimin e kapitalit tonë financiar. **Kapitali ynë financiar** mund të qarkullojë nëpër të gjithë meridianet, por turbinën e shndërrimit të energjisë së tij në produkte mirëqenieje, duhet ta ketë këtu në Shqipëri. Të ruajmë subjektivitetin e ekonomisë sonë, sepse, po nuk

e ruajtëm, ajo ekonomi do të mbytet prej ekonomisë italiane, greke, sërbe, kineze, ruse, amerikane, dhe: Ç'u muar vesh?! Lejuam që të na vrasë **Globalizmi**, në vend që ta shfrytëzojmë klimën e tij për ta trashur, midis trungjevet të tjerë, edhe trungun tonë. Vetëkuptohet që, për t'ua arritur këyre qëllimeve, duhet zgjuarësi, dinakëri, profesionalizëm dhe **kombeatdhedashuri**, që do të thotë: **Dashuri mençurore për vetëveten**. Të mosruajturit e subjektivitetit të ekonomisë shqiptare, do të çonte pashmangshëm në dobësimin dhe gradualisht në dekompozimin e vetë qenies sonë kombëtare. Do të mbeteshim përjetër një komb i *përtupastrueshëm* me lopata ose i *përturiciklueshëm*, siç pastrohet me lopata dhe siç riciklohet nëpër makineri çdo lloj tjetër mbeturine. (Me fjalën *pastrohet* kupto: *masakrohet* dhe *dëbohet*, me fjalën *riciklohet* kupto: *shkombëtarizohet*).

Nëse nuk krijohet dhe nëse nuk funksionon si duhet një **Institucion i Përkujdesjes Gjithshqiptare**, thelbërisht ashtu siç po e parashtrajmë ne, ne kemi bindjen që, që **të gjitha rrugët e tjera** do të na çonin në dhjetëvjetëshat që vijnë drejt rrëgjimit. Do të na çonin drejt rrëgjimit si komb dhe, ose do të na linin të fortët e Botës të mezigjallonim në marginat e të meziekzistuarit “*me asistencë të përjetshme ndërkombëtare*”, ose do të na riparcelizonin, duke mos ditur ç'të bëjnë tjetër me ne.

Na duhet të parasyshmojmë këtu me ngulafjalë të veçanta që, qoftë politikanët e Evropës, qoftë ata të Amerikës apo politikanët e tjerë të Botës, duhet ta kuptojnë që ekzistenca e shëndetshme (jo e sëmurë) e Kombit Shqiptar në këto hapësira, si pasojë, meliorizimi i truallit ku ai i ka thelluar rrënjët e veta, i ngjan ekzistencës së një toke që prodhon ullinj edhe agrume, në ansamblin e të tjeravet toka që, për nga përbërja pedologjike e tyre, prodhojnë mollë, kumbulla, banane. A do t'ish e dobishme që ta riorientonim këtë tokë (me neglizhencë, me makinacione ose dhunshëm), që të prodhojë jo ullinj e agrume, por mollë,

kumbulla dhe banane?! Thënë pa figurë: A është e arsyeshme që ekonomia shqiptare (e bashkë me të edhe Kombi Shqiptar) të bëhet një ekonomi sllave (e rrjedhimisht edhe komb sllav), ekonomi greke (e rrjedhimisht edhe komb grek), ekonomi turke (e rrejdhimishht edhe komb turk) apo ekonomi latino- ose jolatinoamerikane (rrjedhimisht, një komb lebrozoid në zhbërje e sipër)?!

NE DHE KOMBET QË NA RRETHOJNË

Ne shqiptarët nuk do të kërkojmë, sepse nuk mund të kërkojmë, që sllavomaqedonët të mos e kenë Shkupin kryeqytet. Por do të pranojmë, sepse jemi të detyruar të pranojmë, edhe për faj të të parëvet tanë, që atë qytet ta kemi kryeqytet të përbashkët. Ne nuk do të kërkojmë, sepse nuk mund të kërkojmë, që malazezët të mos e kenë Podgoricën kryeqytet. Ne nuk do të kërkojmë që të ikin nga Çamëria e nga Janina ata grekë të mirëfilltë që tashmë (ose prej kohësh) jetojnë atje. Ne nuk do të kërkojmë, më në fund, që sërbbët imigrantë të largohen nga Mitrovica.

Asgjë nga këto ne nuk do të kërkojmë, për 2 arsye kryesore: 1. Sepse jemi popull me kulturë disamijëvjeçare dhe se veprimtari të tilla nuk i shkojnë për shtat mentalitetit tonë tradicionalisht tolerant. 2. Sepse të atillë operacione largimesh apo zhvendosjesh të popullsisvet janë gjithmonë me pasoja të rënda humane dhe ne nuk duam të bëhemi shkaktarë të të tilla fatkeqësive. Nuk duam, edhe sikur t'i kishim mundësitë.

Mirëpo, në vend të çfarëdo kërkesë të palogjikshme, ne do të shtrojmë para vetes dhe para të tjerëve një varg kërkesash që janë të kuptueshme dhe të pranueshme për të gjithë. 1. Sllavomaqedonët e thejshtë, që nga nxënësit e shkollave e deri te akademikët dhe politikanët, duhet ta dinë që kryeqyteti i shtetit të tyre (dhe i shtetit tonë) ndodhet **në Shqipëri** dhe, qoftë edhe vetëm për këtë arsye, ata nuk duhet t'i urrejnë shqiptarët. As malazezët, qoftë edhe vetëm për arsyen se Podgorica, kryeqyteti i shtetit të tyre (edhe i shtetit tonë) ndodhet **në Shqipëri** (dhe

shqiptarët nuk po kërkojnë që t'i largojnë prej andej), ata nuk duhet t'i urrejnë shqiptarët. Grekët duhet të mësojnë qysh në bankat e shkollës që 2 popujt tanë kanë jetuar disa mija vjet në të njëjtat hapësira dhe se modusi më i mirë i bashkëjetesës është të shkuarit mirë njëri me tjetrin, respekti e jo urrejtja ndaj shqiptarëve. **2.** Ne do të kërkojmë, jo si shpërblim, por si një e drejtë e paposhtëdhëshme, që fëmijët tanë, kudo që të ndodhen, të bëjnë shkollë në gjuhën e vet dhe ta mësojnë historinë e kombit të vet, sepse vetëm ashtu ata do të mund të bëhen qytetarë dinjitozë, edhe të shteteve ku janë gjendur për shkak të rrethanave të kohëve të mëparshme. **3.** Do të kërkojmë që çamëvet t'u jepet e drejta për t'i pasur e për t'i gëzuar tokat e veta në Çamëri. Do të kërkojmë që shqiptarëve të Ulqinit t'u kthehen ullishtat, të cilat ua ka marrë dikur JNA-ja, e cila ka kohë që nuk ekziston. Do të kërkojmë që shqiptarët t'i gëzojnë pasuritë e veta kudo që i kanë. **4.** Do të kërkojmë që të mos pengohemi për të ngritur monumente e për të bërë homazhe në të gjithë vendet ku Kombit tonë i kanë ndodhur tragjedi. **5.** Kombet që na rrethojnë, të mos tremben prej nesh dhe, në vend që të synojnë për të na asgjësuar (siç kanë vepruar të parët e tyre), të synojnë jo vetëm shkuarjen mirë, si fqinjë që jemi, por edhe ta njohin historinë tonë (ta njohin ashtu siç është, jo të shtrembëruar), mentalitetin tonë, këngët tona, muzikën tonë dhe gjuhën tonë. Pse të mos e njohin grekët gjuhën tonë? Pse të mos e njohin sllavomaqedonët gjuhën tonë? Jo të gjithë, por të paktën ata që kanë kontakte të përditshëm me ne. Normalisht, jo **doemos**, por kur kërkojnë që ne ta mësojmë gjuhën e tyre **doemos**, atëherëherë përse edhe ata të mos e mësojnë tonën **doemos**? Dhe, mbi të gjitha, të mos e urrejnë gjuhën tonë! Të mos i nënçmojnë këngët tona! Të mos lejojnë që të shpifet kundër nesh! Të gjithë këta popuj **na duan fort**, kur ne shqiptarët mësojmë gjuhët e tyre, kur e “**ndërrojmë**” kombësinë, duke u regjistruar grekë, sërbë, sllavomaqedonë apo

malazezë. Kurse ne themi që ata **duhet të na duan më shumë** kur ne të mbetemi këta që jemi.

Në lidhje me të ardhshmen **shtetërore** të Kombit tonë, punë kjo që lidhet edhe me të ardhshmen **shtetërore** të kombevet që na rrethojnë, janë shtruar deri më tash disa variante. Organizata ku unë kam bërë pjesë qysh në vitin 1962, e ka elaboruar këtë temë qysh prej asaj kohe. Programi ynë **strategjik** ka qenë: **Bashkimi i krejt Kombit Shqiptar në një shtet të vetëm**. E njëjta strategji duhet të mbetet dhe do të mbetet edhe për të ardhshmen, jo se kemi dëshiruar e thënë ne, ose dikush tjetër para apo pas nesh, por sepse kjo është një kërkesë nga më legjitimet e cilitdo komb që ekziston në këtë Botë. Kjo është kërkesa, kjo është **strategjia**, ky është synimi, por mënyra e arritjes deri atje u është nënshtruar dhe do t'u nënshtrohet pashmangshëm në të gjitha kohët **rrethanavet**, të cilat **asnjëherë** nuk mbeten po ato.

OPCIONI *SCARDUS MONS*

Në gazetën "*Koha jonë*", datë 2 maj 2005, f.18-19, unë kam dhënë një intervistë, në të cilën kam shtruar mendimet e mi për këtë problem, mbështetur në **rrethanat** që po krijoheshin në fund të sh XX dhe që do të vazhdonin, të paktën deri sa politika botërore, ajo **racionalja**, të mund ta ruajë paqen në këto hapësira. (Intervista është botuar me disa gabime, sidomos me një skicë harte krejt të papërshtatshme.)

Kohë më vonë, duke iu përmbajtur së njëjtës ide, i kam dërguar një gazete malazeze një elaborat të zgjeruar. Ata nuk e kanë botuar dhe kjo s'është e habitshme, përkundrazi, është e pritshme, sepse, si malazezët ashtu edhe sllavomaqedonët janë ende aq keq të indoktrinuar kundër nesh, sa ngjajnë si të sëmurë. Shkrimi titullohet: "*A do t'u interesonte malazezëvet dhe sllavomaqedonëvet një konfederatë me shqiptarët?*"

Duke qenë se ata nuk e kanë botuar dhe duke qenë se ato ide

meritojnë të trajtohen jo vetëm në shkallë rajonale, por edhe në rrethet e politikës gjithbotërore, asaj **racionale**, unë po e përkthej atë dhe po e paraqes **të plotë** në faqet e këtij libri:

“Këtë ide timen mbi mundësinë e një konfederate midis shqiptarëve, sllavomaqedonëve dhe malazezëve e kam publikuar para ca kohësh në gazetën ‘Koha jonë’ në Tiranë dhe po dua që të njëjtën ide ta paraqes edhe para lexuesvet të Malit të Zi si dhe atyre maqedonë.

Me qenë se jam shqiptar, nuk do t’ish e sjellshme po qe se do të parashtroja këtu në radhë të parë interesat e malazezëve apo të sllavomaqedonëve, para se të shprehja mendimin mbi interesat e Kombit tim, dmth të shqiptarëve. Nuk do t’ish e sjellshme sepse do të dilte sikur shqetësohem më shumë për të tjerët se sa për popullin tim.

Rrethanat historike kanë qenë të atilla, që ne shqiptarët kemi qenë të detyruar ta presim sh XXI të ndarë e të bërë copa-copa në jo më pak se 6 shtete. Një pjesë e shqiptarëve, diç më pak se gjysma e tyre, e ka fituar shtetin e pavarur në v.1913. Kjo është Republika e sotme e Shqipërisë. Pjesa tjetër e Shqipërisë, dmth territori i Kosovës së sotme, ka rënë nën pushtetin e Sërbisë në të njëjtin vit, 1913, në mënyrë që vetëm në vitin 1999 më në fund t’i shkëputet Sërbisë dhe të vihet nën protektorat ndërkombëtar. Por edhe mbas v.1999, një pjesë e Shqipërisë, në trevat e Moravës së Epërme, prapë ka mbetur nën Sërbinë. Në krahun lindor një copë mjaft e madhe e Shqipërisë gjendet sot në përbërje të shtetit Maqedoni. Në Jug, qysh më 1913, territore të gjërë të Shqipërisë i janë dhënë shtetit grek, thjeshtë në formë dhurate. Këto janë trevat e gjëra të Çamërisë, pastaj trevat e Janinës dhe suliotët famozë, tash të shkapërderdhur nëpër Botë, si dhe Kosturi, Konica, Follorina. Në krahun veriperendimor ndërkaq, një pjesë e rëndësishme e Shqipërisë ka rënë, qysh prej gjysmës së dytë të sh XIX nën sundimin e shtetit të atëhershëm të Malit të Zi.

Cilido analist duhet ta ketë më se të qartë që, një i këtillë copëzim i Shqipërisë (dhe i shqiptarëve) në mes të shteteve, nuk mund kurrësi të jetë faktor paqeje dhe përparimi në këtë nënqiell. Kjo është absolutisht e pakundërshtueshme. Të duan a të mos duan individët, të duan a të mos duan politikanët dhe shtetarët, patriotët dhe jopatriotët, problemi i integritetit të shqiptarëve do të mbetet pashmangshëm në rend të ditës, gjersa të mos jetë gjetur sadokudo një zgjidhje e përshtatshme.

Duke pasur këtë parasysh në lidhje me opcionin tim mbi një konfederatë katërshtetëshe, është e domosdoshme të mbahen në vëmendje edhe së paku tre faktorë: Së pari, integrimi i përgjithshëm i Ballkanit në Bashkimin Evropian nuk e zgjidh as për afërsisht një të këtillë ndarje të panatyrte të Shqipërisë. Së dyti, as konfederata e thënë nuk e zgjidh plotërisht problemin nacional të shqiptarëve, sepse prapë do të mbeteshin jashtë saj Presheva, Bujanovci etj., Çamëria deri në Artë, Janina, Konica, Kosturi etj. Së treti, megjithëse ideja e konfederatës nuk i plotëson kënaqshëm kërkesat historike të ne shqiptarëve, ne do të detyroheshim ta pranoni këtë opcion pikërisht sepse me këtë mënyrë nuk do të rishikoheshin kufijtë e shteteve ekzistues. E dihet që një rindryshim i tillë i kufijve, sidomos në këto hapësira, pashmangshëm do të sillnin luftëra. Nuk është në interes të asnjërit prej popujve tanë që këtu të rikthehen përsëri trazirat dhe aventurat. Mu për këtë arsye, kam menduar dhe mendoj që do t'ish më me vlerë të diskutohej mbi një marrëveshje të këtillë, se sa t'i hyjmë tani rizhvendosjes së kufijve.

As krijimi i 2 shteteve shqiptarë, një të quajturit shtet të Kosovës, përkrah shtetit ekzistues të Shqipërisë, nuk përbën kurrfarë zgjidhjeje afatgjatë. Populli i shtetit në Republikën e Shqipërisë dhe populli i Kosovës është i njëjti popull, përveç disa pakicave krejt të pakta. Si është vepruar psh me flamurin e Kosovës, me stemën shtetërore, me himnin dhe me simbolet

e tjerë nacionalë? Të gjitha këto janë zgjidhur në dukje në mënyrën më të mirë, por në të vërtetë në mënyrën më të keqe të mundshme. Pra, me krijimin e shtetit të Kosovës problemi i shqiptarëve në këtë nënqiell prapë nuk është zgjidhur.

Pikërisht për shkak të të këtillë improvizimeve të pjesërishëm, nën diktatin e subjekteve ndërkombëtare, midis shqiptarëve kudo që ata ndodhen dhe jetojnë, ekziston sot një rrymë e fuqishme mbi krijimin e një **'Shqipërie të pastër etnike'**, me synim çlirimin e krejt trevave që i kemi përmendur më sipër. Kjo, siç thashë edhe pak parë, në rrethanat e sotme, është e pamundshme, por është në të njëjtën kohë dhe për të njëjtët shkaqe, edhe stabiliteti (në shkallë rajoni) absolutisht i pamundur. Jo vetëm sepse janë përjetësisht të pranishëm tensionet, por ata janë edhe të pashmangshëm në të këtillë kushte. Natyrisht, jo për faj të shqiptarëve, sepse nuk janë shqiptarët ata që kanë kërkuar për ta copëtuat Atdheun e vet.

Në anë tjetër, në rrethanat e sotme, më shumë se kurdoherë tjetër, është utopi e pakuptimtë të rropaturit rreth krijimit të shteteve etnikisht **'të pastër'**. Në kushtet e sotëm do të ishte një punë krejt e kundërrrymshme përpjekja për të sajuar shtete të pastër njënacionalë. Për ne shqiptarët krijimi i një shteti të tillë jo vetëm që është i pamundur, por do t'ish për vetë ne e papërshtatshme, sepse, përveç pengesave të tjera të pakapërcyeshme, do ta kishim të pamundshme për të sendërtuar marrëdhënie të mira me fqinjët. Të gjithë fqinjët tanë, përveç ndoshta Turqisë, do t'ishin kundër nesh, duke na emërtuar as më pak, as më shumë, por si **"një shtet të pastër mysliman"**. Shqiptarëve nuk u përshtatet kurrsesi emërtimi **'komb mysliman'**, si dhe çfarëdo lloj kujdestarie nga Lindja. Natyrisht, pa mohuar, gjegjësisht pa hedhur poshtë miqësitë politike dhe bashkëpunimet ekonomike, si me Lindjen ashtu dhe me Veriun.

Qe, pikërisht për këto që i parashtrova deri këtu, ne

shqiptarëvet, nga njëra anë, nuk na intereson të mbetemi kështu të copëzuar, siç na ka prurë historia deri në sh XXI, nga ana tjetër, nuk kemi kurrsesi interes që të angazhohemi tani për çfarëdo 'Shqipërie etnikisht të pastër', e cila është quajtur, pa kurrfarë logjike, 'Shqipëri e Madhe'.

*Ne shqiptarëvet, në kuadër edhe të interesit të trefishtë të bashkëpunimit me sllavomaqedonët dhe me malazezët, në të këtilla rrethana siç janë krijuar mbas shpërbërjes së pashmangshme të ish-Jugosllavisë, na shkon përshtat që të vëmë në lëvizje një nismë konstruktive mbi krijimin në këtë pjesë të Ballkanit të një konfederate shqiptaro-maqedono-malaziase. Ajo konfederatë do të përfshinte shtetin e sotëm të Maqedonisë, shtetin e sotëm të Shqipërisë, shtetin e sotëm të Malit të Zi dhe shtetin e sotëm të Kosovës. Asnjëri prej këtyre 4 shteteve nuk do të humbte, të thuash, asgjë prej suzerenitetit të vet. Ata do t'i ruanin absolutisht të paprekur organet e vet ligjvënës, do t'i ruanin organet e vet ekzekutivë, filluar prej qeverivët e deri te pushtetet lokalë, do t'i ruanin të paprekur organet e drejtësisë, kryeqytetet e vet, institucionet e vet të arsimit e kulturës, gjuhët e veta, flamujtë e vet shtetërorë dhe nacionalë, si dhe çdo simbol tjetër komb-apo-shtetpërcaktues. Të gjitha këto do të mbeteshin ashtu siç janë edhe sot, kurse do t'u shtoheshin vetëm ato gjëra që do të na vlenin të gjithvet: do të kishim një kryeqytet të përbashkët, pas mendimit tim, Prizrenin, një parlament konfederativ, një president të përbashkët, një qeveri konfederative, përfaqësi të kompaktësuar diplomatike etj. emri i asaj konfederate, me qëllim që të largohemi prej ngasjevet nacionaliste dhe që të anojmë sa më shumë drejt qytetarisë moderne racionale, pas mendimit tim do të duhej të ishte **SKARDUS MONS**. Ai emër antik i malit **Sharr** do të bëhej për secilin prej nesh i afrueshëm dhe i pranueshëm dhe do të përshtatej me thelbin e orientimit tonë për të kultivuar te popujt tanë ide ekologjike të volitshme, të*

natyrshme dhe për ne më se të domosdoshme. Është e sigurtë që aty do të kishte shumë probleme, por me një dëshirë të mirë, me një bindje racionale iluministe, se kjo do t'ishte rrugëdalja jonë më e pranueshme, çdo gjë do të rregullohej, dhe ajo konfederatë, kam bindjen, do të bëhej shumë shpejt, jo veç për Evropën, por për krejt Botën, një shembull edhe më i mirë se sa, ta zëmë, Zvicra e sotme.

*Megjithatë, le të ndalemi pak në këtë problematikë. Nga vetë natyra e tyre, idetë federative apo konfederative në Ballkan, na duhet të pranojmë që nuk kanë pasur fat të lumtur. Ka qenë në sh XVIII e quajtura '**Konfederata Ilire**', ide e cila kish dalë prej kokës së Karamahmutpashë Bushatasit. Nuk ka pasë sukses dhe as që do të mund të kish sukses, thjeshtë sepse një e tillë ide kish lindur jo në mentalitetin demokratik të një shqiptari, por në mentalitetin feudalo-turk të një pashai. I njohur është edhe programi i bashkëpunimit malazezo-shqiptar i Stjepan Zanoviqit. Kanë pasur ide të tilla edhe Petari I Petroviq Njegoshi dhe Petari II Petroviq Njegoshi. Ka pasur të tilla ide edhe Millosh Obrenoviqi. Është realizuar më në fund ideja e Karagjorgjeviqvet me krijimin e Mbretërisë Sërbo-kroato-slllovene. Ka vazhduar me të njëjtën ide edhe Josip Broz Titoja, duke korrigjuar disa nga mangësitë e mbretërisë së mëparshme '**federative**', por duke lënë të pakorrigjuar një varg mangësish të tjera. Titoja madje pat shkuar edhe më larg në projektimin e përfshirjes në atë federatë të krejt Ballkanit ose së paku të Bullgarisë dhe Shqipërisë.*

*Këto ide që i përmendëm më lart mbi "**të federuarit**" e popujvet të Ballkanit lidhen kryesisht me 3 shekujt e shkuar. Por etje për ta përfshirë krejt Ballkanin e edhe më gjërë, nën një kufi të vetëm, ka pasur këtu në të gjithë shekujt. Pushtimet e Romës kanë pasur pikërisht këtë synim: Të përfshirët brenda një kufiri të vetëm jo veç të Gadishullit Apenin dhe aitij Ilirik, por të krejt*

Evropës, të krejt Lindjes së Afërt dhe të krejt Afrikës Veriore. Edhe perandori ilir Justiniani i Madh ka zhvilluar pikërisht me këtë qëllim një varg luftërash. Pastaj carët bullgaro-maqedonë, Borisi, Simeoni, Samuilloja. Perandorët grekë e kanë pasë uzurpuar fronin e Bizantit dhe pastaj i kanë ndrydhur e shtypur popujt bashkëthemelues të asaj perandorie. Në një farë mënyre, secila perandori është një lloj “**federate**” ku nuk qeverisin popujt. Edhe dinastia serbe e Nemanjiqvet, deri në shpëbërjen e Perandorisë së Dushanit, ka dëshiruar dhe synuar të njëjtën gjë. Më në fund ka ardhur Perandoria Osmane dhe e ka rrasur në të njëjtën “**federatë**” pjesën më të madhe të Ballkanit, duke e hedhur këtë mundimadhin gadishullin tonë në 500 vjet prapambetje. Kjo pra është historia, thënë figurshëm, e idevet dhe e realizimevet “**federative**” dhe “**konfederative**” në këtë nënqiell tonin, dhe njeriu me të vërtetë ka të drejtë të frikësohet nga vetë të menduarit e një pune të tillë e le më t’i hyjë realizimit.

Por prapëseprapë sendet duhet të shikohen me gjakftohtësi dhe, një të këtillë gjakftohtësi, është e domosdoshme ta zbatojnë në debatet e tyre, jo vetëm dijetarët dhe intelektualët, por edhe vetë popujt tanë në kuptimin më të gjërë, sepse pikërisht me këta popuj kanë të bëjnë këta debate. Duhet të dallohen mirë politika e të **rrasurit** të popujvet dhe kombevet si në një thes dhe politika e të **mirëkuptuarit** mbi bazën e interesavet reciprokë lehtësisht të dukshëm. Duhet dalluar mirë politika e **pushtimevet**, politika e rrënimit të qytetevet, siç kanë vepruar romakët psh në Ilirikun e Jugut, politika e të rrafshuarit të qytetevet deri në themele, siç ka vepruar Stefan Nemanja me ‘**qytetin e famshëm Tivarin**’ dhe jo vetëm me Tivarin, politika e asgjësimit të plotë të qytetevet, siç ka vepruar car Samuilloja me Dioklenë e moçme, politika e djegies dhe shkretimit të krejt katundevet e nahivet deri te vetë Cetinja, siç kanë vepruar pashallarët shqiptarë të Shkodrës nëpër Mal të Zi e në Bërda, përfshirë aty edhe Malësinë shqiptare të

Mbishkodrës, dhe prapë politika e të rrafshuarit të qyteteve, siç ka vepruar knjaz Nikolla me Tivarin plot 700 vjet mbas Stefan Nemanjës. Duhet dalluar mirë politika e të përdorurit të popujvet për harem, siç kanë vepruar sulltanët e Perandorisë Osmane, politika e kolonizimit, siç ka vepruar Jugosllavia e Vjetër me Kosovën, politika e genocidit, e shpërnguljeve dhe e asgjësimit të popujvet, siç ka vepruar Slllobodan Millosheviqi dhe jo vetëm ai. Krejt këto duhen dalluar mirë prej marrëveshjeve demokratike midis popujvet mbi bazën e frymëzimeve të ndërsjellë jetësorë, ekonomikë, politikë e kulturorë.

*Kjo konfederatë e jona, nëse do t'i hyhet realizimit të saj, ose do të bëhet një **shembull botëror** i bashëpunimit midis popujvet, ose nuk do të krijohet fare, duke ua lënë rrugën të hapur shembujvet “**federativë**” dhe “**konfederativë**” të sipërpëmendur.*

Ndërkaq, shembuj përpjekjesh, por edhe realizimesh të këtyllë bashkëpunimesh midis arbërvet dhe malazezëve ka pasur gjatë historisë, ndonëse jo në atë masë dhe në të atilla përmasa sa ç'duhej të kishte. Bashkëpunimi ynë i parë, pikërisht në prag të krijimit të kombit malazias, ka qenë ai midis Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe Stefan Zezë-Cërrnojeviqit. Ai bashkëpunim është vazhduar edhe më vonë, midis Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe të nipit nga e motra, Ivan Zezë-Cërrnojeviqit. Është e vlefshme të theksohet këtu që Zezë-Cërrnojeviqtë kanë qenë vazhdim i drejtpërdrejtë i një familjeje fisnike arbërore dhe që, do të thosha unë, vetë formimi i kombit malazias është pikërisht rezultat i bashkëpunimit midis arbërvet dhe popullatës sllave, vendosur gjatë shekujvet midis nesh. Përpjekjet e përbashkëta të rezistencës së fiseve arbër dhe malazias, përpara mësymjeve turke, kanë qenë pa dyshim kurora e bashkëpunimit tonë të ndërsjellë. Mund të përmendim këtu sulmet e pandërprerë të Ivanbeg Zezë-Cërrnojeviqit mbi rrethuesit turq të Shkodrës në

vitet 1474-1479. Në mbrojtjen e Shkodrës, veçanërisht me sulme prapa shpine, pa dyshim kanë vepruar së bashku arbërit dhe malazeztë, ndonëse mbase ende jo tërësisht nën të këtillë emra.

Por kanë ardhur prapë kohë të vështira. Turqit i kanë pushtuar këto treva dhe, fatkeqësisht, i kanë përdorur njerëzit tanë, edhe arbërit, edhe hercegovasit, edhe boshnjakët, në mësymjet e tyre mbi fiset liridashës malazias e malësorë.

Si një shembull bashkëpunimi do të mund të përmendja një rast të vogël të prelatit dhe shkrimtarit tonë nga Kosova, Imz.Pjetër Bogdanit, i cili në një rast ka porositur në Itali 2 piktura për manastirin pravosllav të Sveti Nikollës në Vraninë. Kryepeshkopi Pajsije, i cili është martirizuar prej bashkëfisasvet tanë të islamizuar, njihej nën emrin **'kryepeshkop i sërbëvet (nënkupto: pravosllavëvet) dhe i arbërvet'**. Pra edhe kjo është njëra ndër format e bashkëpunimit, në përpjekjet për rezistencë përballë pushtuesit të përbashkët.

Të marrim prapë shembullin e Petarit II Petroviq Njegoshit. Ai, fill pasi është titulluar vlladikë, është përpjekur të realizojë një bashkëpunim me malësorët tanë dhe me arbër të tjerë, në luftë kundër turqvet, por i dërguari rus në Dubrovnik ia ka tërhequr menjëherë vërejtjen vlladikës së ri, që kurrë më të mos vepronte ashtu, sepse Ruisë nuk i konvenonte kurrfarë lidhjeje midis popujvet sllavojugorë dhe arbërvet. Aritmetika e Ruisë ka qenë: Ose shfarosja, ose sllavizimi i arbërvet. Vlladika Rade kurrë më nuk ka tentuar që të afrohet me arbërit. I përhumbur ndër iluzionet e pansllavizmit, ai madje, do të thosha unë, ka vepruar ndaj nesh si një jodashamirës, ndonëse e dinte mirë që **'Skënderbegu është me zemër Obiliqi'**. I thurte vargje Obiliqit, si një heroi sërb, pa i shkuar fare mendja që ai Obiliq do të mund të ketë qenë një arbër i Kosovës. Vlladika Rade nuk është afruar me arbërit, sipas porosisë së zëdhënësit rus, por sa herë që zbriste në Kotorr, ai vendosej në familjen e Lumbardiqëvet,

madje, sipas disa zëravet, dhimbshëm dhe tuberkulozshëm i dashuruar në bijën e asaj familjeje, pa ia marrë as mendja që edhe ajo vajzë ishte me prejardhje arbërore. **'Lumbardiq'** në shqip shpjegohet me **'lumë i bardhë'**.

Me sllavomaqdonët (Po përdorim këtë shprehje, sepse ata shqiptarë që rrojnë në territoret e Maqedonisë së dikurshme janë popullatë vendëse, dhe, nëse themi thjeshtë **'maqedonët'**, aty jemi të detyruar të nënkuptojmë edhe njëërë, edhe tjerët.), pra, me sllavomaqedonët, bashkëpunimi ynë, i iliro-arbërvet më vonë të emërtuar shqiptarë, ka filluar qysh para se bullgarosllavët e ardhur të kenë pranuar krishtërimin. Iliro-arbërit, gjegjësisht maqedono-arbërit, kanë qenë të krishterë e pakta 8 shekuj para se bullgaro-sllavët ta kenë pranuar krishtërimin. Krishtërimin e kanë predikuar midis popullatave jo të krishtera, jo vetëm klerikët grekë, por edhe ata iliro-arbër apo maqedono-arbër. Madje këta kanë qenë më të shumtë, sepse ishin vendës. Kryepeshkopata e Ohrit, më vonë patriarkanë, ka qenë me shekuj qendër e përbashkët fetare edhe e arbërvet, edhe e sllavëvet, edhe e vllahëvet. Bashkëpunimi midis iliro-arbërvet vendës edhe sllavëvet është i dokumentuar edhe në kryengritjet antibizantine. Më vonë po ai bashkëpunim ka qenë evident edhe kundër sundimit osman. Në ato kryengritje, të cilat nuk kanë qenë të pakëta gjatë gjithë shekujvet, është e dokumentuar që ka pasur pjesëmarrje, madje edhe udhëheqje, të përbashkëta, ndonëse, fatkeqësisht, nuk janë përjashtuar as rastet kur, herë njëri herë tjetri etnitet, u ka shërbyer pushtetmbajtësve për shuarjen e të tilla revoltave. Megjithatë, rrezet e mirëkuptimit reciprok dhe të organizimit të përbashkët midis shqiptaromaqedonasvet dhe sllavomaqedonasvet kanë arritur të pashuara deri te Kryengritja e Ilindenit e te Karposh Vojvoda, si edhe deri te Lufta e Dytë Botërore kundër pushtuesve nazifashistë. Mjerisht, të gjitha ato lidhje shumëshekullore kanë qenë **përjetësisht** rrëzëshëm

të infektuara dhe të rrënuara, qoftë së jashtmi, qoftë edhe së brendshmi.

Vetëm tash, mbasi i pamë të gjitha këto, mund të nismohet shqyrtimi: A do t'u interesonte sllavomagedonëvet dhe malazezëvet një konfederatë shqiptaro-maqedono-malaziase me emrin '**Scardus Mons**'? Nëse do të bënit intervistë me një malazias, ai natyrisht do të ju fliste së pari për interesat ose jo, të malazezëvet, pastaj do t'u kthehej edhe interesavet të 2 popujve të tjerë. Nisur pikërisht prej një të tillë pozite, unë, si shqiptar, ju kam folur fillimisht për interesat e shqiptarëvet. Por kjo nuk do të thotë që unë nuk i kam parasysh edhe interesat e 2 popujvet sllavë.

Maqedonia dhe Mali i Zi janë 2 shtete të cilët në Jugosllavinë e Vjetër nuk janë pranuar si të tillë. Mali i Zi ka qenë katandisur nga niveli i një shteti sovran në një BANOVINË të rëndomtë e të parëndësishme. Historia tashmë e ka dëshmuar që idetë jugosllavomëdha dhe idetë sërbbomëdha i kanë prurë Malin e Zi dhe malazezët në buzë të mosekzistencës. Dmth veçantitë e tyre nacionale i kanë prurë në marginat e shuarjes së plotë, duke i zëvendësuar ato me veçantitë gjegjëse të sërbbëvet. Vetëm e quajtura "**Jugosllavi e Titos**" u ka dhënë Malit të Zi dhe Maqedonisë statusin e republikavet. E kjo, për mendimin tim, përfaqëson edhe shpëtimin nacional, si për malazezët, ashtu edhe për ata sllavo-maqedonë, të cilët qenë gjendur në përbërjen e Jugosllavisë. Të ketë qenë si të ketë qenë, çfarëdo qëndrimi që ne të mbajmë ndaj atij regjimi komunist, Mali i Zi dhe Maqedonia janë të detyruar t'i jenë mirënjohës pikërisht atij regjimi për faktin se ata, mbas shpërbërjes së Jugosllavisë, ia arritën të shpallen e të pranohen si shtete.

Ia kanë arritur të shpallen si shtete, por në Mal të Zi ideja sërbbomadhe as për afërsisht nuk është shmangur. Ideja sërbbomadhe në Mal të Zi i ka rrënjët të thella, kurse datat e fillimit

i ka ndoshta qysh para Nemanjiqvet. Dihet që Stefan Nemanja e ka konsideruar Zentën si 'tokë babe'. Por dihet gjithashtu që, në 2 shekujt e sundimit të Nemanjiqvet, Zenta megjithatë nuk është bërë dot 'tokë babe' për asnjërin prej Nemanjiqvet. Zenta, në të 2 ata shekuj ka qenë mbretëri më vete dhe ka qëndruar vazhdueshëm dhe këmbëngulshëm kundër absolutizmit të Rrasës.

Të përmendim kalimthi edhe rastin e banorëve të Pranëlimit të Epërm. Atyre u thoshin me tallje "sërbljaci". Kjo vërteton vetëvetiu që ata nuk kanë qenë sërbë, por diçka e tjetërsuar, gjoja sërbë.

Në kurthin e sërbizmit ka rënë tragjikisht edhe kral Nikolla. Në dështimin e kral Nikollës, në injorimin e tij nga ana e sërbevët, në poshtërimin neveritës deri te dëbimi prej atdheut të tij, shikohet qartë rezultati i iluzionevet prosërbë te malazeztë. Në çfarëdo lloj rrethanash ideja e sërbizmit te malazeztë nuk mund të përkufizohet ndryshe veçse si një sëmundje kuazinacionale tepër e rrëzikshme vetasgjësuese.

(Prej atij lloj sëmundjeje kuazinacionale, madje antinacionale, lëngojmë edhe ne shqiptarët madje edhe më shumë se malazeztë. Ka prej nesh shqiptarëve, të cilëve u duket sikur janë turq apo të afërt me turqit. Ky është skandali më i turpshëm që mund të manifestojë pjesëtari i një kombi, i cili me shekuj ka derdhur një det me gjak pikërisht kundër pushtimit turk. Ka prej nesh shqiptarëve, të cilëve u duket sikur janë malazezë e deri edhe kroatë apo sërbë. Edhe ky është një skandal i të njëjtit lloj. Por ka prej nesh shqiptarëve, të cilëve u duket se janë grekë. E dinë ata dhe çfarë janë edhe kush janë, por nuk i lejon natyra prej këpucëlëpirësish që t'i gjejnë vetes vend midis njerëzish dinjitozë edhe korrektë. Çfarë do të mund të thoshim përballë të gjitha këtyre që thamë? Njerëz, shkunduni prej iluzionevet! Njerëz, kthehuni te vetëvetja! Të qenët në vete është thesari më me vlerë. Një shqiptar që nuk shtiret sikur është malazias,

mund të jetë njëmijë herë më mik i malazezëve se ai shqiptar që shtiret malazias. Një malazias që nuk shtiret sikur është sërb, mund të jetë njëmijë herë më mik i sërbëve se ai malazias që shtiret si sërb.)

Në vitet kur po punohej për mvehtësimin e Malit të Zi, si edhe mbas mvehtësimit, në popullin malazias u evidentua, do të thosha, një lloj riorientimi nacional. Po kërkohen rrënjët. Po analizohet e kaluara historike. Po sillen argumente mbi dallimet midis kombit malazias, si edhe gjuhës, dhe kombevet të tjerë sllavojugorë, veçanërisht midis malazezëve dhe sërbëve. Thënë shkurt, malazezët i kanë hyrë punës për të gjetur vetëveten në rrethanat e reja historike. Por duhet pranuar që aty ka edhe shumë probleme. Problemi më kryesor është mbijetesa ekonomike. Nëse një popull nuk ka ekonomi solide, qenia e tij është e kërcënuar në çdo hap. Është i kërcënuar zhvillimi kulturor, është e kërcënuar politika nacionale. Në të kaluarën, me qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e qenies së vet nacionale, malazezët kanë vepruar kryesisht në 3 drejtime: Ndihmë nga jashtë, ku rolin kryesor dhe vendimtar e ka luajtur Rusia, zgjerim terriore në dëm të Shqipërisë, Bregdetit dhe Hercegovinës dhe shkrirje me Sërbinë. Nuk do të ndalem në analizat e këtyre tre drejtimeve. Bëhet pyetja: Në cilët drejtime do të veprojë Mali i Zi i sotmi? Çfarë do t'i sillte Malit të Zi një rimbështetje te Rusia? Çfarë do t'i sillte Malit të Zi një rikthim eventual në prehërin e Sërbisë "vëllazërore"? Dhe e treta, gjë që mua, si shqiptar nga Shestani, më intereson më së shumti, çfarë do të na sillte, malazezëve edhe ne shqiptarëve, një veprimtari e malazezëve në dëm të shqiptarëve, psh në dëm të ulqinakëve, tivarasvet etj?

Animi nga Sërbia i një numri malazezësh, dmth animi në drejtim të heqjes dorë prej identitetit të vet të formësuar në shekuj, haset në çdo hap nëpër Mal të Zi. Kjo dukuri është e shprehur deri në atë masë, sa që do të mjaftonte fitorja në zgjedhje e një

partie tjetër, që ta kthejë sa çel e mbyll sytë busullën politike të Malit të Zi në drejtim të Beogradit. Në një rast të tillë do të mjaftonte vetëm të ndryshuarit e një neni të vetëm në kushtetutë, psh miratimi i një amendamenti, i cili, malazezëvet që jetojnë në Sërbi, t'u jepte të drejtë vote edhe në Mal të Zi. Çdo gjë do të niste nga e para dhe këtë hetë Mali i Zi do të humbte jo vetëm shtetësinë, por edhe statusin e dikurshëm të banovinës.

Në një të tillë situatë, ata shqiptarë të cilët sot i takojnë shtetit të Malit të Zi, jo do të kërkonin shkëputje, por do të detyroeshin që ta shpallin shkëputjen. Shqiptarët kanë votuar në mënyrë plebishitare për mvehtësimin e Malit të Zi. Një gjë e tillë ne shqiptarëvet na ka interesuar dhe prandaj kemi vepruar ashtu. Por në qoftë se dikush do të tentonte që Malin e Zi prapë t'ia nënshtrojë Beogradit, sado që ai Beograd të jetë **'demokratizuar'** tashmë, për shqiptarët nuk mund të ketë kthim prapa. Jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të tjerë grupime të këtushëm fetaro-nacionalë, rikthim prapa drejt Sërbisë nuk mund të ketë. Atëherë, çfarë do të mund të ndodhte në një të tillë kthesë, e cila realisht është e mundshme? Do të shkohej pashmangshëm në një luftë qytetaro-nacionale. Do të ringjallehin brenda natës metodat arkaniane të tigrimit dhe të shkabërimit.

Në anën tjetër, në qoftë se do të llogarisnim një shtresë vërtet të demokratizuar edhe të malazezëvet, edhe të shqiptarëvet, edhe të sllavomaqedonëvet, një diskutim mbi konfederatën e pastaj realizimi i saj, do të na sillte të gjithëvet, do të thosha, përfitime të gjithanshëm. Në radhë të parë, malazezëvet dhe sllavomaqedonëvet, me rastin e konfederimit me shqiptarët, në asnjë kuptim nuk do t'u rrëzikohej identiteti. Malazetë dhe sllavomaqedonët mund të rrojnë 1000 vjet në një konfederatë të përbashkët me shqiptarët dhe të mos çenohet qenia e tyre nacionale as në gjënë më të vogël.

Të bashkuarit ndërkaq të sllavomaqedonëvet me Bullgarinë

do të nënkuptonte as më pak e as më shumë, por humbjen totale të identitetit të tyre si një komb më vete. Maqedoninë Egjease grekët thjeshtë e kanë **'pastruar'**, Maqedonia Pirinase e ka humbur tashmë identitetin e dikurshëm. Megjithatë, mund të hamendim që sllavomaqedonët e shtetit të sotëm të Maqedonisë do të orientoheshin për t'u bashkuar me Bullgarinë. Do të ndodhte pashmangshëm ndarja e shtetit të sotëm të Maqedonisë. Kjo tashmë është përfolur në qarqet politike, por me një shikim tepër shkurtpamës të gjëravet. Duhet të kuptohet njëherë e mirë: Ne shqiptarëvet ndarja e shtetit të Maqedonisë nuk na intereson. Ne nuk e kemi kërkuar dhe nuk dëshirojmë ta kërkojmë ndarjen, përveç në qofshim të detyruar. Por nëse detyrohemi, atëherë të gjithë duhet ta dinë: As edhe 1 fshat shqiptar nuk do t'i bashkohet Bullgarisë! Në një tillë situatë, nuk mund dhe nuk do të funksionojë as parimi i **'shumicës'** dhe as cilido tjetër sistem votimesh. Qëndrimi i shqiptarëvet në atë rast do t'ishite i qartë dhe i vendosur: As edhe 1 familje të vetme e le më katund, nuk do t'ia lëshonim Bullgarisë. Megjithëse, në çfarëdo marrëdhëniesh të tjera ne nuk do t'i largoheshim asnjë aspekti të miqësisë me të njëjtën Bullgari. Pra, opcioni i inkorporimit të sllavomaqedonëve me Bullgarinë, si dhe opcioni i të ribashkuarit të Malit të Zi me Sërbinë, pashmangshëm do të shkaktonte gjakderdhje. Kurse unë nuk besoj që një gjakderdhje e re do t'i sillte ndonjë të mirë cilitdo prej popujvet të këtij nënqielli.

Ndërkaq, e dimë tashmë që malazetë në Beograd dhe në Novi Sad kanë humbur më shumë prej së qeni malazetë, se sa ata të Çikagos apo të Buenos Airesit. Në të njëjtin vështrim nacional do të ndjeheshin ku e ku më komodë edhe sërëbet në Kosovë. Sërëbet në Kosovë, sllavomaqedonët dhe malazetët, do të ndjeheshin dhe realisht do t'ishin shumë më të sigurtë në një të këtillë konfederatë, se sa të ndarë në shtete të veçantë siç janë sot.

Kurse sa na përket ne shqiptarëvet, përfitimi ynë politik

më domethënësi do t'ishte të shmangurit e përshtypjes, si të brendshmes, ashtu edhe të jashtmes, sikur ne qenkemi ndonjë komb myslimanësh. Heroi ynë nacional është i krishterë, flamuri ynë kombëtar është i krishterë, dhe prapë na konsiderojnë si myslimanë. Në këtë kuptim ne jemi të detyruar të bëjmë një kthesë. Se si do të ndodhë një e tillë kthesë, kjo është çështja jonë e brendshme. Por nëse do të konfederoheshim me sllavomaqedonët dhe me malazetët, përpara se të inkuadrohemi në mjaft të flashkëtin Bashkim Evropian, kjo për ne do të përbënte një hap të madh përpara drejt një evropianizimi të mirëfilltë dhe nuk do të shkonim atje për ta dobësuar Evropën, por për ta forcuar, pikërisht me shembullin tonë.

Në pikëpamje ekonomiko-financiare, themelimi, gjegjësisht konstituimi i një të këtillë konfederate, do të shënonte një lulëzim të mirëfilltë. Shteti i Maqedonisë automatikisht do të bëhej një shtet bregdetar, madje në kushte shumë më të volitshëm se kur ka qenë në përbërje të Jugosllavisë. Po ashtu edhe shteti i Kosovës. Kurse shtetit të Malit të Zi do t'i hapeshin rrugët drejt Jugut, jo me mënyrat siç kanë synuar paraardhësit e tyre, por me një mënyrë krejt paqësore dhe krejt racionale. Të kesh Shkodrën, Lezhën, Durrësin dhe Vlorën sa të zgjatësh dorën, kjo në kuptimin ekonomik vërtet nuk do t'ishte pak për një Malë të Zi të vogël, duke mbajtur parasysht edhe atë që lidhjet tregtraro-transportuese me Kroacinë, me Bosnjen, me Sërbinë, me Bullgarinë, do të zhvilloheshin me këtë konfederatë ku e ku më mirë se kështu si jemi, as të bashkuar, as të ndarë dhe gjithë jetën me probleme.

Duke prezumuar gjithë këto që i thamë e edhe shumë më tepër që mund të diskutohet lidhur me këtë ide, ajo konfederatë e jona do të bëhej vërtet një faktor tepër i rëndësishëm jo vetëm për të 3 popujt tanë, por për krejt rajonin. Në vend të 'shembujvet' të grindjevet njëri me tjetrin, hileve, prapaskenave, të shikuarit

shtrembër, mostolerimit, vrasjevet, deri edhe massive, do të mund të bëheshim, PAPRITUR, shembull bashkëpunimi e mirëkuptimi.

A është e mundur që të realizohet diçka e tillë, unë nuk e di. Por që të nismohet një disput me qëllim të mire, jam i bindur që është madje shumë e dobishme. Tani të shohim.”

Shkrimin ia pata dërguar, me anë një miku, njërës prej gazetave mjaft prestigjioze të Malit të Zi. Por ata **nuk e botuan**, ashtu siç edhe pritej.

Fqinjët tanë janë aq shumë të indoktrinuar kundër nesh, sa ke përshtypjen që, edhe kur flasim a shkruajmë në gjuhët e **tyre**, ata nuk na kuptojnë. Janë të antidemokratizuar në shkallën më flagrante, sado që termat demokraci dhe evropianizim i kanë si lugën në filxhanin e kafes. Ata nuk e kuptojnë të folurit tonë, në çfarëdo gjuhe që të artikulohet. Nuk na njohin, ndonëse na kanë përditë përpara syvet. Shikojnë e takojnë shqiptarë përditë, por nuk dinë kush janë shqiptarët.

Fajin qendror, fajin madhor, përbindëshin faj, e kanë në radhë të parë akademitë e tyre dhe kishat e tyre. Pas fajit të akademivet dhe të kishave, renditen të gjithë fajet e tjerë të shkallëve më të ulëta: Ai i sistemit shkollor, i tekstevet nëpër shkolla, i propagandës mediatike, i programevet stërvitorë të ushtarëve, deri te familjet, te përrallat me kacafytje, te këngët me duele dhe te secili individ i konkretshëm.

Martohen femrat serbe me shqiptarë, lindin fëmijë me shqiptarë, i rritin ata fëmijë, jo si pinjoj të përbashkët dykombësh, por duke ua mëkuar në shpirt ditë e natë helmin kundër shqiptarëve. Plaken këto femra serbe në familjet shqiptare dhe vdesin pa e mësuar kurrë realisht se kush janë shqiptarët. Është vërtet dukuri më shumë se e çuditshme. Unë njoh të tilla serbe. I njoh edhe fëmijët e tyre (me baba shqiptar, i cili ka pamjen e buallit). Atyre fëmijëve u lëbyren sytë, kur dëgjojnë të flitet shqip.

Megjithkëto, ne jemi të detyruar t'i vështrojmë punët me

mençuri. Me mençuri dhe me gjakftohtësinë që i karakterizon burrat e vërtetë. S'ë kemi të lehtë t'u themi malazezëvet: ***Hajdeni, të bashkohemi në një shtet***, kur na rrinë përpara syvet fëmijët e Bihorit, ca të therur, ca të ngrirë në borë. S'ë kemi të lehtë t'u themi sllavomaqedonëvet: ***Hajdeni, të krijojmë një konfederatë***, kur s'na hiqen nga sytë dhjetëra mijë bashkëkombas tanë, të çarë kafkash, të therur e të ritherur, që nga Manastiri në Kumanovë. S'ë kemi të lehtë, por duhet ta themi. Duhet ta themi dhe duhet ta pranojmë, nëse pranojnë ata.

Përndryshe, e kam thënë edhe në shkrimin që sapo lexuam: Nuk ka më as ribashkim të Malit të Zi me Sërbinë, as ristrehim nën sjetullën e Rusisë. Nëse ndodhin të atillë ekzibicione, Podgorica mbetet në Shqipëri. Nuk jemi ne ata që u kemi thënë malazezëvet: ***Ndërtojeni kryeqytetin tuaj në tokën tonë***. Nuk ka më as ribashkim të sllavomaqedonëvet me Bullgarinë. ***Traktati i Shën Stefanit*** ka kohë që është shfuqizuar. Nëse tenton dikush për ta ringjallur, ai dikushi duhet ta dijë që Shkupi ndodhet në Shqipëri. Nuk jemi ne ata që u kemi thënë sllavomaqedonëvet: ***Ndërtojeni kryeqytetin tuaj në tokën tonë***.

Fqinjët tanë e kanë mësuar veten të na shikojnë ne shqiptarëvet si **objekt**. Nuk janë mësuar të na shikojnë edhe si **subjekt**. Por tash ka ardhur koha të jemi edhe **subjekt**. Madje **subjekt** gjithanësisht i përfillshëm. Këtë duhet t'ua bëjmë të ditur edhe politikëbërësve dhe ekonomibërësve të Evropës. Këtë duhet t'ua bëjmë të ditur edhe analistëvet të SHBA-së. Të mos na dërgojë këtu SHBA-ja ca ambasadorë të mefshët, por të na dërgojë **Kisingerë**. Sepse rëndësia jonë për krejt Perendimin është pikërisht e atillë. Në shumë pika ne jemi si Izraeli. (Irani etj kërkojnë ta zhdukin atë Izrael nga faqja e Dheut.) Miqtë tanë duhet **praktikisht** ta dinë që edhe ky "***Izraeli***" i këtushëm, duhet të forcohet, si ai atje, sepse vetëm kështu, të gjithë këta që na rrethojnë, mund të bëhen aleatë me Evropën e

me Amerikën. Ndryshe ata, të gjithë fqinjët që janë këtu rotull nesh, nuk do të jenë kurrë aleatë të sigurtë të Perendimit. Po u hoqëm ne shqiptarët këndeje, ose po mbetëm kështu të dobët siç jemi sot, Ballkani s'është më pjesë e asaj Evrope, të cilën po përpiqen ta konstruktojnë evropianët.

Ndërkohë, detyra më e ngutshme e **Përkujdesjes Gjithshqiptare**, pasi ajo të jetë organizuar e konsoliduar, mbetet puna për një pastrim të përgjithshëm të **ballkanologjisë**. Po nuk u bë rishikimi nga themelet i **ballkanologjisë**, akademitë tradicionale do të vazhdojnë t'i dezinformojnë popujt. Dezinformimi s'është tjetër, veçse parapërgatitje për kasaposje. Ne kemi për detyrë që ta paaftësojmë dhe ta neutralizojmë, helmin që u injektohet ballkanasvet qysh në djep.

UNIVERSITETI “KONSTANTINI I MADH”

Është punë e ngutshme dhe nga më të rëndësishmet, krahas me ekonominë dhe madje krahas edhe me forcat e armatosura, marrja në dorë prej shqiptarëvevet e fatevet të shkencavet ballkanologjike. Njerëzit që kanë sadopak mendje të kultivuar, mendje të arsimuar, e kuptojnë menjëherë këtë që po themi. Ushtarët grekë kurrë nuk do të këndonin këngë zorrësh e opingash, nëse ballkanologjia do t’ ishte atje ku duhet.

Projektidenë time për **Universitetin e Ballkanologjisë “Konstantini i Madh”** ia pata dhënë një njeriut tim shumë të afërt. Ai e kish lexuar, e kish pëlqyer, por nuk u fut për të komentuar as edhe njërin prej problemevet më madhorë që shtroheshin këtu. Më tha vetëm kaq: “*Ai monumenti i Shën Konstantinit s’ka pse të jetë 50 metra i lartë.*” Kjo mjafton për të kuptuar që mendja e atij njeriut tim shumë të afërt s’ish as e kultivuar, as e arsimuar, në shkallën që i kërkohet sot cilitdo inelektual të Kombit tonë. Kisha përpara një njeri që nuk i kish bërë shprehi as të lexuarit e libravet, as të shkruarit, për ta rropatur mendjen, për ta shtrydhur, për ta munduar. Njeriu më i rendomtë i kohës sonë duhet të lexojë përditshmërisht literaturë, e pakta 6000 faqe në vit. Dhe po ky njeri duhet të shkruajë diçka, të paktën 1 faqe në natë, për t’ua lënë pasardhësvet. Përndryshe, ne s’mund të jemi tjetër, veçse peshk rifugjo, sardele për konserva.

Në vitin 2013, në shkallë botërore, krishtërimi do të përkujtojë 1700-vjetorin e **Ediktit të Milanos**. (E falenderoj për këtë informacion arqipeshkvin e Tivarit, Imz.Zef Gashin.) Në të gjithë botën e krishterë do të organizohen seminare, simpoziume

e mesha kushtuar Shën Konstantinit. Me atë rast ka mundësi që edhe sërëbët t'ia ngrejne Shën Konstantinit një përmendore në Nish. Një përmendore në Nish Shën Konstantinit, por pa e cilësuar që Ai ka qenë paraardhës i shqiptarëve të sotëm të Kosovës.

Ndërkaq, ne shqiptarëve, pasardhësve të njërit prej njërezve që i ka hapur rrugën **legale**, tashmë 1700-vjeçare, njërit prej qytetërimeve më rezultativë gjithnjëzore, ka të ngjarë të na dalë gjumi vetëm mbasi të ketë mbaruar Viti Jubilar i **Ediktit të Milanos**. Të na dalë gjumi mbasi të kenë mbaruar manifestimet edhe në Zelandë të Re, edhe në Alaskë, dhe atëherë t'u kujtohet skulptorëve tanë për të gatuar argjil, pikërisht ashtu siç kanë vepruar edhe për Nënë Terezën. A do ta bëjë efektin argjili ynë, qoftë edhe broxi, si kofini pas të vjelit?

Kjo është përsa i përket monumentit të **Shën Konstantinit**, 50 metra të lartë, mu në hyrje të **Universitetit të Ballkanologjisë**, ide kjo që është hedhur në letër qysh në mars të vitit 2004.

Vendi më i përshtatshëm, ku duhet të ngrihet ky **Universitet i Ballkanologjisë**, është **Durrësi**. Por jo qyteti. Jo edhe ndonjë fushë afër qytetit. **Universiteti i Ballkanologjisë** duhet të ngrihet imponant në njërën nga kodrat më të bukura, jo larg detit, dhe me sipërfaqe jo më të vogël se 10 hektarë.

Në kë universitet do të studiohen gjuhët, kulturat, historitë etj të kombeve: shqiptar, rumun, grek, bullgar, maqedon, kroat, boshnjak, hercegovas, sërb, malazias, slloven dhe turk. Do të studiohen edhe gjuhët, kulturat, historitë etj të pakicave rezidente në gadishullin tonë: arumunë, hebrenj, italianë, hungarezë, romë. Kjo do të thotë që ky universitet nuk do të ketë më pak se 12 fakultete dhe 5 katedra për pakicat.

Fushat e studimeve do të jenë: arkeologjia, gjuhësia, gjeografia, historia, etnografia, folklori, artet e kultivuar, arsimi, ekonomia etj. të secilit prej kombeve. Kjo do të thotë që secili

fakultet do të ketë e pakta nga 9 departamente. Studentët që do të grumbullohen këtu, do të jenë nga gjithë Bota: Diplomata me orientim Ballkanin, studiues me orientim Ballkanin, biznesmenë dhe menaxherë biznesesh me orientim Ballkanin, specializantë të fushavet nga më të ndryshmet: gjeologji, hidrologji, arkitekturë, komunikacion, bujqësi, blegtori, rrjete të elektroenergjetikës, turizëm, sporte, arkeologji, spellollogji, studiues monumentesh të kulturës dhe të natyrës, studiues të bimësisë rajonale, studiues të mjekësisë rajonale, gjuhëtarë, historianë, politologë. Të gjithë këtyre, që e kanë orientim pune rajonin tonë, u duhen gjuhët dhe kulturat e kombevet që jetojnë në këtë rajon. Pa njohur gjuhët dhe kulturat e këtyre kombeve, nuk mund të bëjë askush asnjë punë me vlerë të mirëfilltë në këtë gadishull kaq të trazuar. Edhe shoferëvet që qarkullojnë nëpër këta vende, u duhen gjuhët e kombevet të këtushëm.

Profasorati i këtij universiteti do të jetë, vetëkuptohet, i përzgjedhur prej të gjithë këtyre vendeve. Fakulteti i gjuhës, kulturës, historisë etj të kombit rumun, do t'i ketë profesorët nga Rumania. Fakulteti i gjuhës, kulturës, historisë etj të kombit grek, do t'i ketë profesorët nga Greqia. Vetëm rektorati si dhe administrata, vetëkuptohet, do të jenë krejt ose thuajse krejt shqiptare.

Një korpus më vete dijetarësh do të bërëbëhet prej studiuesvet ballkanologë. Këta do të vijnë këtu, dhe do të punojnë këtu ndoshta gjithë jetën për t'i dhënë ballkanologjisë fytyrën që i takon. Jo fytyrën që prodhon luftëra, por fytyrën që sjell harmoni, në një truall kaq të harmonishëm, e njëkohësisht kaq të paharmoni. Kombet e Ballkanit e meritojnë, më në fund, një trajtim serioz prej të gjitha forcave kulturëkërkuese të Botës. Puna e parë që do t'u kërkohet këtyre dijetarëve, do të jetë njohja solide e secilës prej gjuhëvevet të këtij gadishulli. Pa njohur gjuhët e Ballkanit, nuk mund të bëhesh ballkanolog. Specializimet, pas ose paralel

me nxënien e gjuhëvet, do të jenë nga më të ndryshmit. Disa do të jenë njohës të arkeologjisë, të tjerë do të specializohen në gjuhësi, dikush ndoshta edhe më ngushtë: në numizmatikë, në heraldikë, në bimët endemike, në studimin e poezisë popullore ballkanike, në histori, të ndarë në periudha ose gjithnjohëse, në mitologji, në sportet bashkëkohorë dhe atyre të lashtë, në vallet dhe meloditë popullore ballkanike.

Një i këtillë universitet nuk ka si të mos bëhet jo vetëm vatër dijesh, debatesh dhe përballjesh **demosteniane**, por edhe nga më atraktivet, nga më tërheqëset. Festivale folklorikë, konkurse të llojllojshëm, festivale filmash, festivale teatri, ndeshje sportive, ekspozita pikturash dhe skulpturash, ekspozita të teksteve shkollorë dhe debate në lidhje me atë si ua mësojmë në fëmijëvet tanë psh. historinë, gjeografinë, ekspozita të produkteve ushqimorë tipikë të Ballkanit, ekspozita të artizanatit, qëndisje, gdhendje në dru, ekspozita pijesh, llojet e rrushit, llojet e mollëvet, lundrimi në shekuj, një mrekulli e pandërprerë.

A mund të thotë dikush që nuk na duhet ky universitet? A mund të thotë dikush që nuk kemi pare për një të këtillë vepër? Po. Mund të thonë edhe do të thonë, ata që s'i ka krijuar Perendia për tjetër, veçse për peshk rifugjo. Të gjithë të tjerët s'do të bëjnë tjetër, veçse do t'i hyjnë punës për ta vënë jetë edhe këtë pjesë të **strategjisë** së Kombit tonë, pjesë për të cilën u tha pak parë që s'është më pak e rëndësishme se sa strategjia jonë e ekonomisë dhe ajo e mbrojtjes.

SHTETI SI INSTITUCION

As në shkallë botërore shteti nuk e ka arritur përsosmërinë që kërkohet. Vetë etatologjia, në rreshtin botëror të dijevet, nuk është në lartësinë e duhur. Por për ne mjafton të dimë e të themi vetëm kaq: **Ai shtet shqiptar që nuk u shërben shqiptarëvet, s'ka ç'u duhet shqiptarëvet.** Kjo është thënia te e cila duhet të mbështetemi e të mbahemi fort. Pas kësaj vijnë fare natyrshëm përpjekjet për ta bërë shtetin më të mirë, për ta përsosur shtetin, për t'i detyruar, me legjislacion, ushtruesit e pushtetit që t'i shërbejnë Kombit të vet.

Kur themi, nuk ka ç'na duhet një shtet shqiptar që nuk u shërben shqiptarëvet, kjo nuk do të thotë: ***Meqë nuk ka ç'na duhet, hajde ta prishim!*** Jo ta prishim shtetin, por ta **rregullojmë!** Jo të largohemi, sepse s'e paskemi të mirë shtetin. Por të rrimë këtu dhe të gjejmë mënyra për ta përsosur shtetin tonë. Madje edhe shtetin që është gjysmë i yni, psh shtetin që quhet Maqedoni, kemi për detyrë që ta përsosim, sepse ashtu ai do të na shërbejë më mirë edhe ne. Edhe shtetin ku ne shqiptarët jemi pakicë vendëse, psh në Mal të Zi dhe në Sëربي, duhet të përpiqemi për ta përmirësuar aq sa të mundemi. Për ta përmirësuar jo si t'i dojë qejfi dikujt prej shumicës, por si të na shërbejë edhe ne shqiptarëvet. Edhe shtetin ku nuk kemi as edhe një të drejtë nacionale, psh në Greqi, duhet të përpiqemi për ta prurë në binarët e demokracisë së mirëfilltë. Jo si u shkon përshtati kishës arkeobizantine dhe pushtetarëvet pseudodemokratë, thelbërisht antidemokratë të Greqisë, por ashtu si të na shërbejë, përveç grekëvet, edhe ne, dmth ne çamëvet ortodoksë, ne arvanitëvet,

të gjithë ne shqiptarëvet që jetojmë në atë shtet. Ky është parimi ynë. Shteti në të cilin jetojmë, duhet të na shërbejë. Shteti është krijuar që t'i shërbejë njeriut.

Mirëpo, duke gjykuar kështu, ne sërish duhet të kthehemi te 2 shtetet që tashmë janë në duart e shqiptarëvet: në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Po nuk i vumë për vijë ashtu si duhet këta 2 shtete, as që mund të shpresojmë që shqiptarët të shohin ditë **nacionalisht dinjitoze**, atje ku ata nuk e kanë shumicën ose atje ku ata janë imigrantë.

Këta 2 shtete, të cilët në të ardhshmen mund të bëhen 1 shtet, themelin e ekzistencës së vet duhet ta kenë të patriotizmi. Të mos kish motivin e patriotizmit, asnjë komb nuk do të kish pse ta kërkonte lirinë kombëtare. Liria kombëtare nënkupton pikërisht shtetin kombëtar. Nënkupton shtetin kombëtar, i cili doemos duhet të jetë për secilin më i mirë se ai jokombëtari. Shteti kombëtar duhet t'i sjellë kombit me doemos mirëqenie. Patriotizmi i shtetasvet të një shteti kombëtar, filluar prej individit pa asnjë detyrë shtetërore deri te kreu i shtetit, e jep efektin para së gjithash te mirëqenia. Jemi shtet kombëtar, e kemi lirinë kombëtare (të cilën të parët tanë nuk e kanë pasur), duhet pra të përpiqemi gjithë jetën që ta ndiejmë realisht se më në fund e kemi shtetin tonë. Ai që është në fund, dmth në bazën e piramidës shtetërore, të kujdeset për të qenë shqiptar i mirëfilltë dhe të punojë për ta rritur mirëqenien vetanake dhe atë të familjes. Ai që është në shkallët më të epërme të piramidës shtetërore, të kujdeset jo veç për mirëqenien e vet, por edhe për shkallët e mëposhtme.

Në shtjellim të mëtejshëm të kësaj që po themi, vjen edhe preokupimi për ta pasur shtetin sa më funksional që të jetë e mundur.

Themeli, siç dihet, është **kushtetuta**. Në të 2 shtetet që kemi, ne nuk kemi arritur ende të kemi një kushtetutë **të adhureshme**.

Prandaj është detyrë e secilit qytetar, veçanërisht e secilit intelektual, që t'i studiojë të 2-ja kushtetutat tona dhe të meditojë për secilin nen, me qëllim pëmirësimi. Është detyrë e partivet, është detyrë e parlamentarëve, për të debatuar, analizuar e bërë riformulime, deri në atë shkallë, sa të mund të mendohet që tashmë s'kemi ç'i heqim as ç'i shtojmë. Vetëm atëherë, mbasi të kemi krijuar bindjen që një e këtillë kushtetutë do të jetë e **adhurueshme**, teksti i saj (ose teksti i tyre) duhet të hidhet në **referendum**. E dihet që çdo gjë e **adhurueshme** është edhe e **frikshme**. Prandaj, **para një të tillë kushtetute duhet t'i dridhen këmbët çdonjërit që i shkon mendja për ta shkelur**, qoftë edhe shpërfillur.

Është thënë që **presidenti** përfaqëson Kombën. Është thënë që **presidenti** është kryekomandant i forcave të armatosura. Është thënë edhe se **presidenti** është kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Që një **president** të përfaqësojë Kombën, ai duhet të zgjidhet prej atyre që e përbëjnë Kombën.

Në rastin tonë, asnjëri nga **presidentët** e Shqipërisë, as ai i Republikës së Kosovës, as ky i Republikës së Shqipërisë, nuk mund ta përfaqësojnë Kombën tonë as për afërsisht. Pra, kjo mbetet vetëm dëshirë edhe përpjekje. Kështu, ndonëse juridikisht ata nuk mund të jenë përfaqësuesit autentikë të krejt Kombit tonë, krejt qenia e tyre duhet të pulsojë pikërisht në këtë kahje. Nëse nuk punojnë për krejt Kombën, ata nuk meritojnë të jenë as përfaqësues të një pjese.

Kur thuhet që presidenti është kryekomandant i forcave të armatosura, në një shtet ku ministrinë e mbrojtjes dhe ministrinë e policisë i ka në dorë ekzekutivi, pra kryeministri, është njësoj sikur t'i kesh thënë një qytetari të çfarëdoshëm: **Ti je komandanti i këtyre**.

Të thuash që **presidenti** është kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, madje duke mos i pasur as Gjykatën Kushtetuese, as Gjykatën e Lartë nën ingerencat e drejtpërdrejta, dhe kur për prokurorinë vetëm thuhet që është e pavarur, është njësoj sikur t'i thuash cilitdo qytetar: *Merru ti me këto punë*.

Prandaj, nëse themi që **presidenti** është përfaqësuesi i Kombit, nëse themi që është kryekomandant i forcave të armatosura dhe nëse themi që është kryetar i gjyqësorit, ai duhet të ketë nën varësinë vet të gjithë dikasteret që i vënë në jetë këta funksione. Po nuk t'u dha mundësia ta vësh në jetë, asnjë funksion nuk ka kurrfarë vlere. Po i renditim:

1. Dikasteri i diplomacisë, sepse Kombi (si pjesë) lidhet me botën e jashtme pikërisht me anë të këtij dikasteri. Me anë të këtij digasteri lidhen edhe pjesët e tjera të Kombit tonë, që nuk jetojnë brenda këtij shteti. Kështu **presidentit** i jepet mundësia që të kujdeset realisht për të gjitha pjesët e Kombit të vet.

2. Dikasteri i arsimit, i shkencës, i kulturës, sepse edhe ky ka të bëjë me thelbin e ekzistencës dhe të prosperitetit të Kombit tonë. Ky dikaster nuk ka për detyrë të merret vetëm me atë pjesë të Kombit që gjendet brenda shtetit ku ai është **president**, por ka detyrë të merret me plotësimin e kërkesave arsimore, shkencore, kulturore, të krejt Kombit.

Po prekim këtu, midis shumë tjerash, nevojën e madhe që ka sot Kombi ynë për të stimuluar materialisht **krijuesit e literaturës**. Nga njëra anë të gjithë e dinë që librashkruesit, marrë në kuptimin më të gjërë, janë **pasuri e Kombit**. Nga ana tjetër, gjendja e sotme e po këtyre librashkruesve është mirëfilli gjendje lypësash. Prandaj, për ta ndryshuar të paktën pjesërisht gjendjen e kësaj kategorie lypsarësh, **presidenti**, duke pasur nën kujdesin e vet dikasterin e arsimit, shkencës dhe kulturës, do të mund të realizonte për këta njerëz një lloj **rimbursimi**. Është i njohur tek ne i quajturi rimbursim i ilaçevet. Sigurisht, një punë e mirë.

Por ne po sjellim në mendje tani thënien e një studenti kinez, më vonë shkrimtar i njohur në Kinë, i cili pat shkuar në Japoni për të studiuar mjekësinë. Mirëpo, duke parë që bashkëkombasvet të tij, në rrethanat e asaj kohe, më shumë se çdo gjë, u mungonte **dinjteti kombëtar**, ai i tha vetes: “*Ky popull ka më shumë nevojë për mjekim të mendjes e të shpirtit, se sa të trupit.*” E la mjekësinë dhe iu kushtua letërsisë.

Ne nuk themi që ai rimbursimi sado i vogël i ilaçevet të mos bëhet, por, duke marrë shembull nga kinezi i mençur, po themi kështu: Shtetet shqiptarë, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, duhet të nxjerrin e të vënë në jetë **LIGJIN MBI RIMBURSIMIN E LITERATURËS** për të gjithë ata që shkruajnë. Kush boton 1 libër, kuptohet: libër, jo broshurë, ka të drejtë të blejë nga literatura që i nevojitet, me 2/3 e çmimit. Kush boton 3 libra, shteti i rimbursion 50% të literaturës që atij i nevojitet për të studiuar. Kush boton 5 libra, atij shteti ia siguron falas krejt bibliotekën që i duhet. Ky do t’ ishte rimbursimi më çudibërës në jetën kulturore të shqiptarëve, sepse do t’u jepte mundësi krijuesvet të mos vuajnë të paktën për literaturën e sferës që ata studiojnë. Sepse, të jesh psh leksikograf dhe të vuash për fjalorë, është një tmerr i vërtetë. Po edhe një kompjuter, se ia blen shteti një studiuesi, nuk bëhet kiameti. Po edhe se po ia paguan shpenzimet për botimin e ndonjë libri që dihet se nuk shitet, raprë s’ bëhet kiameti.

3. Dikasteri i mbrojtjes së Atdheut dhe i interesave të Atdheut. Kryeministri s’ është tjetër veçse kryeadministrator i një shteti. Fati i mbrojtjes së Atdheut dhe i interesave të Atdheut nuk i lihet në dorë atij. Ai nder dhe ajo barrë i takojnë **presidentit**, i cili, para se të zërë atë vend, duhet të jetë i dëshmuar si një njeri gjithanësisht i denjë, por mbi të gjitha i përkushtuar ndaj Atdheut.

4. Dikasteri i policisë, thënë ndryshe, dikasteri i asaj pjese

të forcavet të armatosura që e mbron shtetin **së brenshmi**. Duhet thënë këtu edhe se, për dallim nga policia, ushtria nuk përdoret kurrë kundër çfarëdo lloj force kundërshtare **të brendshme**. Kjo duhet të jetë e precizuar në kushtetutë.

Që dikasteri i policisë ka në dorë **fytyrën** e Kombit tonë, po sjell këtu vetëm njërin prej shembujvet drastikisht të dukshëm, atë të të quajturavet *radhë*, që janë shekullisht të pranishme, sidomos në këtë pjesë të vogël të Shqipërisë, që quhet: **Republika e Shqipërisë**. Është vetëm një aspekt, por është shumë domethënës dhe imponues për t'u ndalur, si prej një ferre që të tërheq për rrobash. E kam quajtur: **diare kronike**. Në shqip i thonë: **barku i keq**. I thonë edhe: **skurlë**. Sidoqoftë, është sëmundje e bezdisshme, e cila, psh në raste kolere, mund të bëjë kërdi në popull.

Këtu, fjalën **diare** (ndryshe: **bark i keq, heqje barku, bizgë, skitë**), në lidhje me dukuritë e quajtura *radhë*, që shqiptarët janë të vetëdetyruar t'i përjetojnë thuajse në çdo punë që kërkon njëfarë organizimi, sigurisht, nuk po e përdorim me domethënien e saj të drejtpërdrejtë, por me kuptim të figurshëm.

Për mirësjellje mund t'u themi *radhë*, por në të shumtën e rasteve ata janë **grumbuj amorfë** me karakteristikat e një **kopeje** të çfarëdoshme **pa bari**. Po numëroj disa prej tyre, ndonëse ato mund të shfaqen në variantet më të paparashikueshëm.

Në Kohën e Enverit, **diare** të tilla sociale kishte psh në stacionet e autobusëve. Duhet të çoheshe në orën 3 të mëngjesit, të zije të quajturën *radhë* për të marrë biletë, të shtyheshe deri sa të të mbulonin djersët nga koka deri në fund të këmbvet, të të griseshin xhaketa dhe këmisha dhe, në orën 6 ose 7, mund të ktheheshe në shtëpi pa marrë biletë. Ose do ta merrje biletën, duke u munduar të harroje adhapin e madh që kishe hequr. Në Kohën e Enverit të tilla **diare** përjetonte populli atje ku shitej qumështi, atje ku shitej gjiza, atje ku shiteshin bukë të sapodala

nga furra. Në ditët e fundit të dhjetorit, kur dilte ndonjë artikull: mish, verë, fruta, të cilët u duheshin njerëzvet për të festuar Vitin e Ri. Të dilnin përhundësh, edhe Viti i Vjetër, edhe Viti i Ri. Ndodhte që, mbas 4 orë qëndrimi në gjojarresht, të merrje për Vit të Ri vetëm 1 kg mish dhe. Ndodhte që të të thyhej shishja e verës duke dale nga *“rreshi”*.

Sot, mbasi Koha e Enverit ka perënduar në moskthim, e njëjta dukuri e **diarësë** të gjithkundshfaqshme, është po aq e bezdipakundfundtë, sa edhe në atë kohë. Në dyert e ambasadave, grumbuj të përditshëm që flënë atje, midis murevet prej blloqesh betoni, përfund sporteve të konsullatave (përveç fundjavave, kur **padronët** tanë pushojnë në një formë të ndryshme nga ç’kanë pushuar në 5 ditët e tjera të javës). Në zyrat e gjendjes civile, sidomos kur vijnë emigrantët për gjoapushime dhe lodhen këtu më shumë se ç’janë lodhur për 11 muaj, atje ku i ka degdisur Atdheu. Në ambientet para Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në ndonjë zyrë pritjeje në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në libraritë në çdo fillim viti shkollor. Në sekretaritë e universiteteve. Në pikëkalimet kufitarë, aq sa të huajtë na ironizojnë e sarkastikojnë: ***Tani po hyjmë në Shqipëri. Këtu duhet të kesh nerva të fortë.***

Gjithkund grumbuj. Grumbuj, ku gjendet një rubinet uji, grumbuj në zyrat e kadastrës, grumbuj ku paguhen dritat dhe uji, grumbuj ku merren pensionet. Grumbuj, jo radhë, por turma qeniesh pa dinjitet, përpara stadiumit *“Qemal Stafa”*. Atje policët dinë të të rrahin, por nuk dinë të vënë rregull.

Çfarë duhet të bëjnë shqiptarët për të shpëtuar nga kjo sëmundje zorrësh, kaq brekëpërlyerëse! Mos duhet për këtë punë një ministri e posaçme? Ku ta vëmë? Pranë ministrisë së kulturës? Pranë ministrisë së edukatës e mirësjelljes? Pranë ministrisë së antiburokratizmit? Apo përballë ndonjë spitali?!

I kanë edhe popujt e tjerë të këtyllë lëngime, që i sjell anarkia

në administratë, por ata, sidoqoftë, ia kanë arritur t'i zgjidhin këto punë secili në mënyrën e vet. Vetëm ne, ushkurkëputurit, zhagitemi nga shekulli në shekull, pa mundur ta mbledhim veten. E pra, s'është sëmundje që nuk mund të shërohet! Mjafton t'i thuhet një polici: **Shko e gjobite kryezyrtarin përkatës!** Jo të shkojë polici të mbajë radhën, por të shkojë atje dhe t'i vërë gjobë kryezyrtarit: Pse s'ka vënë punonjës të mjaftueshëm, pse s'i kryen më shpejt e më saktë kërkesat e popullit, pse nuk ka sportele aq sa duhet? Qytetarin, i cili nuk sillet mirë në të tilla pika shërbimi, nuk ka detyrë polici ta mësojë se si duhet të qëndrojë në radhë. Ai merret që andej, çohet në polici, procedohet për gjyq dhe dënohet jo më pak se 1 vit burg.

Përveç këtyre, punë kjo që lidhet me një tjetër pamje të fytyrës sonë, është ajo e **mbajtjes apo mosmbajtjes së armëvevet**. Duhet ditur dhe kuptuar seriozisht që Kombi Shqiptar e ka në traditën e vet mijëravjeçare edhe **mbrojtjen individuale e familjare**. Kjo traditë nuk u duhet shkelur shqiptarëvet as në kohën kur, më në fund, e kanë shtetin e vet. Përkundrazi, me rregulla të përcaktuara, që s'është vështirë të dihen, se i kanë kanunet, por i kanë edhe shtete të tjerë të Botës, psh në SHBA, çdo shqiptari i duhet lejuar pasja dhe mbajtja e armëvevet, të brezit edhe të krahut. **Presidenti shqiptar** duhet ta konsiderojë si nder të veçantë që gjendet në krye të një populli tërësisht të armatosur dhe në të njëjtën kohë nga më paqëndruesurajtesit.

5.Shërbimi inteligjent (dikasteri i zbulimit dhe i kundërzbulimit). Ky shërbim ka si veçori që doemos duhet të jetë **i dyzuar**: 1.Në shërbim inteligjent (informativ) **pozitar** dhe 2. Në shërbim inteligjent (informativ) **opozitar**.

Realisht, në çdo shtet ekzistojnë pa numër shërbime të fshehtë. Ata i kanë firmat e kompanitë në veprimtarinë ekonomike, në trafikim, në kontrabandë, në krimin e organizuar, i kanë partitë politike, i kanë shtetet rivalë, madje edhe shtetet

aleatë nën rrogazet e njeri-tjetrit. Kjo vjen nga që të gjitha punët e këqia bëhen fshehtas dhe secili subjekt është i detyruar t'i zbulojë ato po në mënyrë të fshehtë.

Por **presidenti** është i thirrur t'i ketë në vartësinë e vet, nëpërmjet kryetarëve, 2 hallkat kryesore të këtij lloj shërbimi: 1 shërbim sekret të opozitës dhe 1 të pozitës, të cilët gjithsesi mund të alternohen. Të 2 këta shërbime punojnë në mënyrë të pavarur dhe janë të përhershëm. Janë në kontradiktë njëri me tjetrin, por janë edhe në garë, përpara **presidentit**, se kush do t'i mbrojë më mirë interesat e Atdheut. Ato lëndë që i plotësojnë kushtet për hetime gjyqësore, të 2 shërbimet ia dorëzojnë prokurorisë.

Çfarë arrihet duke pasur një spiunazh të dyzuar? Po marrim vetëm një shembull midis dhjetëra të tjerëve, atë të korrupsionit. Korrupsionin ka për detyrë ta investigojë dhe ta zbulojë pikërisht shërbimi sekret. E kemi parë njëherë se sa lehtë e kanë për ta larguar prej vetes korrupsionin njerëzit me ideale. Por korrupsioni nuk është atribut i njerëzvet me ideale. Korrupsioni është atribut i peshkut rifugjo, i cili nuk pyet asnjëherë se kush është pronari i fabrikës së konservimit.

Me mënyrën që po e projektoj unë, shërbimi sekret i pozitës, i partisë që e ka shumicën në parlament, do të investigojë korrupsionin në diplomaci, në ushtri e polici, në arsim, në drejtësi dhe lëndët përkatëse që kërkojnë gjykim, do t'ia paraqesë prokurorisë. Nëse has në pengesa, në shikim subjektiv apo partiak të gjëravet, pozita ka edhe parlamentin, ku mund të formohen komisione të posaçëm hetimi, tashmë jo vetëm për subjektin pengesësjellës, por edhe për vetë prokurorin e përgjithshëm apo kryegjykatësin. Vetëm për **presidentin** nuk mund të organizohen afera hetimore apo gjyqësore, deri sa ai të mbarojë mandatin. Mbasi ta ketë përfunduar mandatin, mund edhe të ketë gjykime.

Në anë tjetër, shërbimi sekret i opozitës investigon korrupsionin në krejt aparatin qeverisës të quajtur ekzekutiv, që nga kryeministri e ministrat deri te nëpunësi më i ulët. Në industri, në tregti, në bujqësi, në komunikacion, në mjekësi, në investime, në gjendjen civile, në sistemin e dokumentimit, në institucionin e kadastrës, kudo ku ka një punë që lidhet me kompetencat e pozitës, dhe, lëndët që kërkojnë gjykim, i dorëzohen prokurorisë. Prokuroria, mbasi t'i ketë verifikuar akuzat, të cilat sot nuk është vështirë të dokumentohen falë mjeteveve elektronikë, ia përcjell lëndën gjykatës përkatëse. Populli mund t'i denoncojë keqbërësit drejt e në prokurori, por ai mund të sinjalizojë edhe në shërbimin sekret, pa iu trembur aspak epitetit të “*spionit*”. Keqbërja do luftuar me të gjitha format qëllimmira e mirëbërëse.

Të 2 shërbimet inteligjentë, që do të vareshin drejt e nga **presidenti**, do të vepronin kështu kundër cilësdo dukuri negative, që nga parandalimi i grabitjeve e i vrasjeve, deri te pastrami e ruajtja e ambientit, që nga komplotet e ndryshëm antishqiptarë, që nuk janë të pakët, deri te vjedhjet e kapakëvet të pusetave.

A vështirë është ta ndalosh vjedhjen e kapakëvet të pusetave? Shko te uzina e shkrirjes, gjej vetëm 1 kapak pusete dhe gjobite uzinën për të 1000 copët që kanë humbur. Nëse policia e qytetit ku janë vjedhë kapakët nuk e bën këtë punë, ministri shkarkon drejtorin e policisë të atij qyteti. Nëse ministri s'i ka ruajtur pusetat, dmth s'e ka shkarkuar drejtorin përkatës të policisë, kryeministri shkarkon ministrin. Por nëse as kryeministri s'i ka ruajtur dot pusetat, atëherë ngrihet padi jo kundër vjedhësve, që s'është vështirë t'i kaspësh, por kundër vetë kryeministrit. Ai popull që s'di t'i bëjë këto punë, le të rrijë pa puseta.

Këto do t'ishin të vetmet dhe më efikasat mënyra për ta çuar krejt vargun e gjatë të keqbërjeve, jo me fjalë boshe, por me anë të sistemit shtetëror, në tashmë shumë të trumbetuarën “*tolerancë zero*”. “*Toleranca zero*” vihet në jetë vetëm atëherë

kur të **detyrojnë** ligjet, jo kur mund t'i gatuash ligjet si ta ketë njëri apo tjetri oreksin. Ai komb që s'di të hartojë ligje për secilën nga dukuritë penguese, le të ecë duke u penguar, duke zënë në thua gjithë jetën.

6.**Dikasteri i drejtësisë** natyrisht që s'ka kujt t'i takojë tjetër përveç **presidentit**. Nuk mund të mendohet që ministrinë e drejtësisë ta administrojë ekzekutivi e **presidenti** të mbajë emrin e kreut të institucionit të drejtësisë. Gjyqësori nuk mund të jetë realisht i pavarur, kur ministria e drejtësisë t'i jetë lënë ekzekutivit. Thënë më saktë, kryeministrit, ministrit, shumicës në parlament. Ndërsa kur i jep llogari 1 personi të vetëm dhe pikërisht atij që i është atribuar ruajtja e vleravet të Kombit, punët e drejtësisë doemos që do të shkojnë më mirë.

Megjithkëtë, edhe këtu duhet të ketë një formë detyrimi. Jo formë detyrimi subjektive, por formë detyrimi strukturore-ligjore. Për të mos u shndërruar shkallët e gjykatavet në hallka formale, ligjet duhet të përcaktojnë imtësisht përgjegjësitë që ka secila gjykatë e brenda gjykatës secili anëtar, kur shqyrton një lëndë e kur merr një vendim. Definicioni më i shkurtër do t'ishte ky: ***Çdo gjykatë ka përgjegjësi penale në qoftë se nuk bën gjykim të drejtë.*** Secili gjykatës, që ka një diplomë juristi dhe që e ka në dispozicion literaturën përkatëse, është në gjendje të marrë vendimin siç e thonë ligjet. Atëherë, pse të mos përgjigjet penalisht, një gjykatës që nuk ka gjykuar sipas ligjit?

Pala e pakënaqur nga vendimi i gjykatës së një shkalle më të ulët, qoftë edhe prokuroria që është denoncues shtetëror, nëse bën padi (ankimim) në një shkallë më të lartë, ajo duhet organikisht të përfshijë në padi (ankimim) edhe gjykatën që e ka bërë atë gjykim. Shkalla më e lartë, nëse vërtet e gjen jo të rregullt gjykimin, shqipton denim edhe për gjykatën përkatëse të nënrenditur. Pa një legjislacion të këtillë, drejtësia nuk mund të vihet kurrë në pozicionin që i takon.

7. **Presidentit** do t'i takonte fare natyrshëm edhe **dikasteri i pakicavet dhe i demografisë**. Ashtu siç ka detyrë një **president** demokrat të mbrojë interesat e Kombit të vet, ashtu ka për detyrë të mbrojë edhe të drejtat e secilit grup tjetër etnik që jeton në shtetin e tij. Këtë detyrë, që është në shumë raste delikate, as **presidenti** as dikush tjetër nuk do të mund ta kryente pa pasur një dikaster të specializuar.

Në Shqipëri, pra kudo në Shqipëri, jo vetëm në Republikën e Shqipërisë, duhet të ketë ligje që, kush nuk është shqiptar, të mos ketë të drejtë të regjistrohet si shqiptar. **Përjashtim** bëjnë ata banorë e grupe banorësh për të cilët mund të vërtetohet shkencërisht se të parët e tyre kanë qenë ilirë, arbër apo shqiptarë. Të tillë janë vllehtë, nëse vërtetohet që paraardhësit e tyre të moçëm kanë qenë ilirë, kuçasit në shtetin e sotëm të Malit të Zi, palabardhasit, piperasit, plavjanët, rozhajasit, sjenicasit, jenipazarasit, ortodoksët e Rekës, ortodoksët e Resnjës, ortodoksët e Çamërisë, një pjesë e janinjotëve, konicasit, follorinasit, kosturiotët, disa nga dropullitët, pogonitët etj. Këta, pasi të jetë shqyrtuar shkencërisht prejardhja e tyre, qoftë nga vetë ata, qoftë prej institucioneve, do të mund të deklarohen dhe të regjistrohen si shqiptarë. Po kështu edhe për ata që vijnë nga çifte kombëtarisht të përzier, duhet të ketë ligje të përpiktë. Të tjerët, që nuk i përkasin etnitetit tonë, nuk duhet të kenë këtë të drejtë për t'u regjistruar si shqiptarë. S'është për ksenofobi, por, kur një prind a një familje ka të drejtë t'i bëjë një foshnjeje analizat e AND-së, kombi e ka atë të drejtë shumëfish më të arsyetuar.

Në median politike rutinore, në vend të fjalës *tejudukshmëri* është përdorur fjala *transparencë*. Një shtet demokratik pa ligje të qartë mbi tejudukshmërinë nuk mund të funksionojë. Thënë me fjalë të tjera, pa e ditur të gjithë shtetasit ç'po bëhet brenda atij shteti dhe pa i pasur shteti gjithanshmërisht të dhënat lidhur

me shtetasit, nuk mund të ketë demokraci. Kjo nënkupton: Nëse duam që shteti të jetë vërtet instrument në dorën e demosit, së pari, ai shtet duhet të ketë evidenca rigorozisht të rregullta mbi gjendjen e shtetasvet të vet dhe së dyti, ato evidenca shteti duhet detyrimisht t'i publikojë.

Po renditim këtu disa nga të dhënat kryesore mbi gjendjen e shtetasvet, të cilat shteti duhet t'i ketë në evidencë të përhershme dhe të jetë në gjendje t'ua bëjë ato të njohura shtetasvet të vet në çdo kohë: **1.**Datëlindja. rrjedhimisht mundësia për të llogaritur moshën në çdo çast.

2.Seksi. A është mashkull apo femër. Përmasat trupore, grupi i gjakut.

3.Gjendja qytetare. Dmth: A është i martuar apo jo dhe nëse është martuar më se 1 herë? Emrat e bashkëshortëvet apo bashkësorëvet, emrat e pjesëtarëvet të familjes, fëmijët, prindët etj.

4.Vendbanimi. Adresa, por edhe lëvizjet e mundshme, sa shtëpi banimi ka, ku i ka, si dhe mënyrat e kontaktit të detyrueshëm: celular, internet, telefon fiks.

5.Arsimi. dëftesat shkollore, diplomat, gradat shkencore, dëshmitë e trajnimevet, dëshmitë e kursevet apo specializimevet. Shkollimet që ka kryer dhe çfarë shkolle është duke vazhduar. Si rregull, njeriu duhet gjithë jetën të arsimohet. Njeriu që vazhdon të arsimohet, është bimë që i çel fletët, që i zgjat degët dhe që rritet vit për vit. Njeriu që e ndërpret arsimimin, ka vlerën e një dërrase, një trangu të stazhionuar, ose thjeshtë vlerën e djathit, gjalpiti apo turshisë. Shtetasit, nëpërmjet shtetit të vet, duhet të dinë: Sa përqind e bashkështetasvet e kanë ndërprerë rritjen?

6. Punët që ka bërë, puna a punët që bën aktualisht, pagat, të ardhurat e tjera. Aksionet. Inventari i objektevet personalë dhe familjarë. Inventari i pasurivet të patundshme. Taksat që i paguan shtetit.

7.Raca, kombësia, duke shënuar linjën e prejardhjes, e pakta në 4 breza: 2 prindët, 4 gjyshërit e pare, 8 gjyshërit e dutë, 16 gjyshërit e tretë. Në këtë mënyrë krijohet tradita e ruajtjes dhe njohjes së pemës gjenealogjike të secilit shtetas.

8. Përkatësia fetare. Prejardhja fetare, mundësisht që nga thellësitë e kohës. Ndryshimet që mund të ketë pësuar shtetasi vetë në lidhje me përkatësinë fetare.

9.Përkatësia partiake. Ndryshimet eventualë që mund të ndodhin në përkatësitë partiake.

10. Anëtarësia në shoqata, në grupime të ndryshëm shoqërorë, kulturorë, sportivë, hobit, pasionet.

11.Ndëshkimet, gjobat, dënimet, gjyqet, burgimet.

12. Gjendja shëndetësore, sëmundjet, ndërhyrjet kirurgjikale, invaliditetet, bursat, pensionimet.

13. Kartat e identitetit, pasaportat që ka zotëruar e zotëron, shtetësitë që mund të ketë pasur apo ka.

Të gjitha këto evidenca **demografike**, mund dhe duhet t'i kryejë ajo zyrë që në Republikën e Shqipërisë quhet **zyrë e gjendjes civile**. Kjo zyrë e gjendjes civile nuk duhet të ketë vetëm nëpunës të stacionuar, por duhet të ketë edhe **nëpunës të lëvizshëm**. Thënë më saktë, **zyra të lëvizshme**: Ata nëpunës, me makina të pajisura me kancelaritë e nevojshme, të jenë të detyruar 1 herë në vit të vizitojnë e të verifikojnë dokumentet në secilën familje atje ku ato banojnë.

Ka mendime që disa prej këtyre të dhënave janë çështje private a personale. Në të vërtetë, të gjitha këto janë gjendje ose veprimtari private. Por asnjëra prej këtyre nuk ka përse të konsiderohet punë apo gjendje sekrete.

Po në këtë dikaster, si drejtori e posaçme, hyjnë edhe trajtimi dhe kujdesi ndaj bashkësisvet të ndryshme fetare. Bashkësitë fetare nuk kanë pse trajtohen as financiarisht prej ekzekutivit. Ato kanë mbrojtje të veçantë dhe fonde të veçantë direct prej **presidentit**.

Pas të gjitha këtyre, kristalizohen 3 çështje kryesore:

1. **Kandidati për president** duhet të jetë një person i dëshmuar për cilësitë më të mira.

2. Zgjedhja e tij duhet të bëhet nga populli, jo nga parlamenti.

3. Shteti në krye të cilit qëndron një **president** me këta attribute, quhet **republikë presidenciale**.

Në të vërtetë, **presidenti** i një republike të këtillë ka atributin e një mbreti të mirë. Themi **mbreti të mirë**, sepse është, siç thamë, i sprovuar qysh më parë në fusha të tjera të jetës. Ndryshimi qëndron vetëm në faktet: (1) që ai mund të qëndrojë në atë post të lartë e shumta 8 vjet, (2) që nuk mund të trashëgohet në linjë familjare dhe (3) që nuk mund të përfitojë nga ai post kurrfarë pasurish të tjera përveç rrogës.

Rrogën, për sa kohë qëndron në atë post, presidenti duhet ta ketë sa **dyfishi i kryeministrit**. Mbasi e mbaron atë detyrë, rroga e tij, tashmë e përgjysmuar, është e përjetshme. Ish-presidenti nuk ka pension, por ka rrogë të përjetshme. Ish-presidenti, edhe pasi ta ketë lënë detyrën, nuk ka të drejtë për t'u anëtarësuar në asnjë parti, sepse vetë autoriteti i tij, nëse ka ditur ta ruajë, ka vlerën e një partie. Vendi i tij më i natyrshëm i të qenit i organizuar, është të mbetet anëtar, tashmë jo i thjeshtë, por anëtar nderi, i **Përkujdesjes Gjithshqiptare**. Themi "**të mbetet**", sepse në përfytyrimin tonë, asnjë shqiptar nuk do të mund të bëhej president i shqiptarëve, pa qenë më parë anëtar i **Përkujdesjes**.

Kryeministri dhe **ministritë**, si dhe **qeveritë lokale**, që së bashku është bërë traditë të quhen **pushtet ekzekutiv**, kanë gjithkështu rol të pazëvendësueshëm. Kanë industrinë, bujqësinë, tregtinë, financat, bankat, sistemin e taksave, buxhetin (me kushtetutë paracaktohet sa përqind e buxhetit i takon presidencës), politikën e punësimit, mjekësinë, lidhjet ekonomike me vendet e tjerë, ndërtimtarinë, planifikimet në fushën e ekonomisë, urbanistikën, transportet, telekomunikacionin, shërbimet ndaj

popullatës në zyra e kudo gjetkë (përveç dikasterevet që i udhëheq presidenti).

Njerëzimi, si fenomen i veçantë i botës së gjallë në planetin Tokë, ka krijuar 2 **forma pronësie**, kurse në të vërtetë ekzistojnë 3 e jo 2: “**Prona**”, më saktë, pasuria gjithnjëzore (ku përfshihen edhe 2 pronat e tjera), prona (pasuria) shtetërore dhe prona (pasuria) private e më tej: personale.

Duam të spikatisim me këtë rast diçka tepër të rëndësishme: Thënia e njohur e sistemit shoqëror kapitalist “**Prona private është e shenjtë**”, në konceptin tonë zgjerohet: “**Janë të shenjtë të 3 llojet e pronës: Edhe “prona” gjithnjëzore (pasuria që në të vërtetë s’u takon vetëm njerëzvet) , edhe prona shtetërore apo kombëtare, edhe prona private apo personale**”. Midis këtyre 3 formave të pronës, **prona gjithnjëzore është kryeshenjtëresha. Prona shtetërore (kombëtare) dhe prona private (personale), janë të shenjta secila në qerthullin e vet, por është e detyrueshme për t’u konsideruar si të tilla prej gjithkujt.** Së këndejmi formulohet edhe thënia ndoshta **më serioze** që është formuluar ndonjëherë në historinë e njerëzimit: **Askujt të mos i lejohet që pronën (çdo lloj prone) ta përdorë si prostitutë!** Nëse shpallet diçka e shenjtë, ajo të trajtohet **vërtetësisht si e shenjtë.** Ligjet e shtetit duhet të jenë në këtë pikë thellësisht skrupulozë, të devotshëm dhe të përpiktë, duke e ditur që **beteja kryesore e moralit njerëzor** zhvillohet pikërisht midis të ruajturit, të pasurit kujdes dhe të shkelurit, të përdhosurit, të keqpërdorurit të **pasurisë.** Madje edhe asaj së vetës.

Qeveria ekzekutive, vendore dhe qendrore, i ka të tre këta lloje pasurish nën përgjegjësinë e vet rigorozë. Nëse qeveria nuk është rigorozë në qeverisjen e pronës, siç e pamë edhe pak parë, pala tjetër, opozita, me shërbimin e vet informativ, të plotfuqizuar prej presidentit, nuk bën tjetër veçse denoncon në prokurori shkeljet e ekzekutivit, që nga zyrtari më i thjeshtë

e deri te kryeministri. Dihet ndërkaq që opozita ka vullnet të madh për të zbuluar shkeljet e qeveritarëve (Ajo përpiqet të reklamohet si ruajtësja më përkushtuar e çdo gjëje pozitive.) mjafton që presidenti, prokuroria, policia dhe drejtësia të kryejnë detyrën e vet kushtetuese dhe krejt veprimtaria e ekzekutivit s'ka nga shkon ndryshe veçse në rrugën e korrektësisë, në rrugën e zbatimit të kushtetutës. Praktikës boshe për të akuzuar e për të mos ndryshuar asgjë, në këtë mënyrë do t'i shkohej drejt fundit.

Është e arsyeshme t'i cekim edhe 2-3 gjëra në lidhje me **qeverinë**, si një prej pushteteve bazë të një shteti modern. Vihen re tendenca të animimit herë nga njëra formë e pronësisë, herë nga tjetra. Ka periudha kur i jepet përparësi pronës private deri në absurditet, ashtu siç kemi përjetuar periudha kur pronën private e anatemonim si shkaktare e të gjitha të këqia. Në të vërtetë, si e thamë edhe shparës, kujdesi duhet bërë ndaj secilit lloj të pronës. Prona (pasuria) gjithnjëzore, psh atmosfera, ajri, ujërat, ekosistemi, bimët, kafshët, shpendët, vetë njeriu, po edhe çfarë grumbullon njeriu për vete, të gjitha këto askush nuk ka të drejtë t'i trajtojë sipas dëshirës, tekavet apo levërdisë vetjake. Forma e dytë e pronës, ajo që quhet pasuri shtetërore, gjithsesi është e domosdoshme të përcaktohet mirë dhe të ruhet mirë, sepse në thelbin e vet ajo i shërben secilit individ, secilit pjesëtar të shtetit. Ka sektorë që nuk mund të konsiderohen pronë e privatëve, por ka edhe segmente të ekonomisë që, ndonëse mund edhe t'i lihen privatit, del e nevojshme t'i administrojë shteti si pjesëmarrës. Thesari i shtetit, psh nuk mund t'u lihet privatëve, as doganat, as taksat, as banka qendrore, e cila rregullon, kontrollon e koordinon punën e të gjitha bankave të tjera, ndërtesat qeveritare, një pjesë ndërtesave shkollore, një pjesë ambienteve dhe të veprimtarive spitalore, një pjesë e pasurive nëntokësore (pjesa më e madhe), objektet arkeologjike, trashëgimitë kulturore, monumentet e natyrës, një pjesë e mediave, frekuencat elektronike, gjithkund

shteti ka pjesën e vet, gjë që në fund të fundit është pasuri e përbashkët e të gjithë shtetasvet. Sa më i pasur të jetë shteti, kur atë pasuri nuk e përvetëson dot kush të jetë më afër, aq më mirë është për të gjithë shtetasit. Gjithë puna është që njëri apo tjetri të mos marrë dot ç' nuk i takon prej asaj pasurie.

Po marrim si shembull **pyjet**, njërën prej pasurivet që i takon krejt Kombit e që ka për detyrë ta ruajë pikërisht **qeveria**. Ta ruajë ekzekutivi e ta mbikqyrin organet që udhëhiqen prej **presidentit**, siç veprohet edhe për të tjerat.

Nëse Shqipëria nuk vendos ligje **të përpiktë** dhe shumë **të rreptë** për **pyjet**, ajo kurrë nuk do të bëhet një vend jetëgjatësisht i bukur. Kur themi: **të përpiktë**, puna duhet të arrijë deri te matrikullimi i miliona drurëvet që **duhen ruajtur**. Kur themi: **shumë të rreptë**, puna duhet të arrijë deri atje, sa prerja e një druri, të caktuar për t'u ruajtur, të quhet krim i rëndë dhe ndëshkimi të jetë shumë i ashpër, si për atë që e ka prerë drurin, ashtu edhe për ruajtësin, nëse nuk e ka denoncuar krimin në kohë.

Në të gjithë Shqipërinë, jo veç në Republikën e Shqipërisë e në Republikën e Kosovës, por edhe në shtetet e tjerë, qeveritë lokale duhet të hartojnë ligje vendorë, autonomë, ku të caktohen masive të veçantë, në të cilët **të ndalohet prerja për 100 vjet**. Të ndalohet prerja, duke lejuar vetëm pastrimet dhe krasitjet. Vetëm mbasi të jenë krijuar në Atdheun tonë pyje të tillë 100-vjeçarë, bukuria e këtij vendi do të bëhet për t'u pasur zili. Dhe jo vetëm bukuria, por edhe pasuria.

Kushtet i kemi. Duhet vetëm pasion e atdhedashuri. Ta duash Atdheun, do të thotë të duash edhe **ahun** e tij, edhe **pishën**, edhe **bredhin**, edhe **lisin**, edhe **ketrin**, edhe **drerin**, edhe **shkëmbinjtë**, edhe **kanionet**, edhe **ujëvarat**.

Për formën e tretë të pasurisë, për pronën private, na duhet të vëmë në dukje se, sado që individi synon të vetësugjestionohet: **Kjo është prona ime!**, prapëseprapë shumica e asaj pasurie në

realitet nuk është as nuk mund të jetë kurrë pronë e një individi të vetëm. Ajo gjithmonë ose pothuajse gjithmonë u takon **grupimevet** të ndryshëm individësh, filluar prej pjesëtarëve të familjes deri te kompanitë e korporatat. Megjithatë, ambicja e njeriut për të pasur, për të realizuar e për të ruajtur një pasuri të vetën, është një ndër promotorët kryesorë të zhvillimit gjithnjëor.

Mbështetur në këtë të vëretetë, në Shqipëri është e domosdoshme, për shkak të një tradite shumëshekullore, të njihet si pronë e grupit, pronë private e grupit, edhe **prona** e përbashkët **tradicionale e fshatravet**. Nuk duhet të ketë të drejtë shteti të përvetësojë territoret që tradicionalisht u takojnë fshatravet, pa u marrë vesh me ta, pa i bërë edhe ata aksionerë ose pa ua paguar atë pronë.

Shteti, në radhë të parë ekzekutivi, ka detyrë themelore të harmonizojë kërkesat dhe interesat e përgjithshëm me kërkesat dhe interesat e individëve. Kur i jepet një kompanie e drejta e të shfrytëzuarit privat të një resursi, minerali, naftë etj, asaj kompanie duhet t'i **imponohet** mirëruajtja dhe mirëmbajtja e vendbanimevet rrethrotull. S'u realizua ky kusht, me anë të mekanizmevet brendaqeveritarë (kontrolle, gjobitje, gjykata administrative), prokuroria, e cila udhëhiqet nga presidenti, çon në gjyq qeverinë, jo kompaninë.

Qeveria qendrore duhet të ketë në përbërje të vet një **ministri**, jo formale por efikase, **për punësimin e të papunëvevet** dhe, brenda saj, **drejtorinë e asistencës sociale**, jo burokratike, por praktike dhe tepër rigorozë. Që të mund t'u gjendet punë të papunëvevet, ajo ministri duhet të ketë në dispozicion të vetin një numër ekonomish shtetërore ose gjysmështetërore (ndërmarrje, sipërmarrje, kompani, korpuse prodhimi), të cilat në situata jorentabiliteti edhe të subvencionohen ose të paktën të mos taksohen siç veprohet me të tjera ekonomi. Pa një mbështetje të

këtuillë **ekonomiko-oranizative**, papunësia në vendin tonë nuk do të mund të minimizohet asnjëherë. Por këtu duhet të ketë ligje shumë të përpiktë. I papuni ka të drejtë të kërkojë punë sipas profesionit, por shteti nuk është i detyruar t’ia gjejë atij një të atillë punë. Shteti është i detyruar t’i gjejë të papunit një punë të çfarëdoshme, në bujqësi, në zdrukhtari, në magazinë, në ngarkim-shkarkim, në pastrim qyteti, dhe, gjë që është shumë e rëndësishme, afër punës t’ia sigurojë edhe banesën, jo luksoze, por të pranueshme. Ose t’i sigurojë transportin. Këto i detyrohet shteti të papunit dhe duhet t’ia garantojë. Nëse i papuni nuk i pranon punën dhe banesën që zyra përkatëse ia ka ofruar, atëherë shteti (nëpunësi përkatës) është i detyruar me ligj që ta fshijë atë të papunë nga lista e të papunëvevet. Natyrisht, shoqëruar me arsyetimin përkatës, të shkruar. Ka qarqe e grupime të ndryshëm që rrojnë jo me punë, por me spekulime, të cilët e krijojnë artificialisht papunësinë. Këta i sjellin mjerim vendit të vet.

Me qëllim për të luftuar parazitizmin, shteti duhet të arrijë deri atje sa të fshijë nga lista e të papunëvevet, e rrjedhimisht edhe nga ndihmat sociale, deri edhe ata që pinë duhanin apo alkolin. Një që tymos duhan e pi raki, nuk e meriton ndihmën sociale. Në anë tjetër, po kjo ministri është e detyruar t’u sigurojë jetesë normale të gjithë të paaftëvet për punë, të sëmurë kronikë, invalidë, të sëmurë mendorë, pleq të braktisur, fëmijë të braktisur. Kjo duhet të arrihet jo vetëm me anë të pensionimevet, por edhe me asistencë të rregullt ushqimi dhe banimi. Populli nuk është i detyruar të ushqejë lypësat anash trotuarevet, madje as t’i shikojë ata oreçast si një shëmti të pagëlltitshme të “*arkitekturës*” sociale. Populli i jep shtetit **taksat**, ndërsa shteti (në këtë rast, ministria për të cilën po flasim) është i detyruar të ndajë prej atyre taksave pjesën që i takon kësaj kategorie njerëzish. Kombi shqiptar duhet ta bojkotojë përfundimisht lypësinë, kudo që ajo të jetë shfaqur dhe nga kushdo që të ushtrohet. Kush dëshiron

dhe mund të ndihmojë të varfërit dhe invalidët, le t'ia japë kësaj ministrie sadakanë.

Një ndër aspektet që janë për t'u vënë dukje këtu, është edhe ajo përralla që thotë se partia që vjen në pushtet, dmth partia që fiton shumicën në parlament dhe që, rrjedhimisht, fiton të drejtën për të krijuar qeverinë, nuk ka të drejtë të ndryshojë administratën. Kjo s'është veçse përrallë nga më patërheqëset. Partitë që i alternojnë pushtetet, kanë secila armatën e vet të zyrtarëvet e të specialistëvevet, prandaj ato duhet të kenë të drejtë legale për të punësuar në krejt aparatin administrativ në radhë të parë anëtarët e vet, pastaj “të paanshmit” (që zakonisht janë njerëz të qullët) dhe në fund, në teproftë vend, anëtarët e partisë apo partivet të opozitës . S'ka përse një parti, e cila për faj të vetin ka dalë tashmë në opozitë, të kërkojë që partia kundërshtarë, fituese e zgjedhjevet, t'ia mbajë në punë anëtarët. Fundja, cili është qëllimi që një parti lufton për të marrë pushtetin? Lufton që, **1.** me programet e vet, ta përmirësojë ekonominë e shtetit dhe **2.** që të ketë mundësi për t'i sistemuar më mirë nëpër punëra anëtarët e vet. Vetë anëtarët e një partie nuk do të kishin motiv për të votuar për atë parti, nëse nuk do të llogaritnin që, krahas së mirës së përgjithshme, të përfitonin diçka edhe në planin personal e familjar. Për partitë që kanë humbur në zgjedhje, për pothuajse krejt anëtarët e saj, nuk mbetet rrugë tjetër përveç veprimtarisë private. **“Të kisha punuar mirë, që të mos i humbje zgjedhjet!”** Ky është motivimi i të pushuarit nga puna. **“Jo, por unë kam punuar mirë!”** **“Ke punuar mirë ti, por s'kanë punuar shokët e tu, përndryshe populli do të kish votuar prapë për ju.”** Mbyllet këtu dialogu.

Përrjashtim bën vetëm **ministra për punësimin e të papunëvevet**, e cila ka detyrë t'u gjejë punë të gjithë të papunëvevet, pa dallim partie. Por punë të atillë siç e përshkruam më parë. Jo punë të zgjedhura.

Sa i përket të të quajturit “**pushtet i katërt**”, ne shqiptarët mjafton të kujtojmë vetëm kaq: Promovuesi dhe promotori i Rilindjes sonë Kombëtare në sh XIX ka qenë pikërisht ky i quajtur “**pushtet i katërt**”. Nuk kemi pasë në dorë as edhe 1 nga 3 pushtetet e tjerë. Kemi krijuar, me një abetare 8-faqëshe, me sakrificat të papërfytyrueshme, me nostalgjinë e rizgjuar të atyre që e kishin lënë këtë vend 4 shekuj më parë, me nostalgjinë e atyre që mund të rronin gjithkund rrethrotull, por jo në Atdheun e vet, **të parin** “**pushtet**” të shqiptarëve, atë “**të katërtin**”. Dhe falë pikërisht mrekullibërjes së atij lloj “**pushteti të katërt**”, erdhi edhe **Dita e Pavarësisë** dhe iu dha mundësia më në fund Kombit tonë për të promovuar, herë disi e herë asses, edhe 3 pushtetet e tjerë. Unë kam bindjen që dhe në të ardhshmen ky “**pushtet i katërt**” do të ketë rolin kryesues për një **neoshqiptarizëm të sh XXI**, nga më demokratikët nacionalizma që ka parë ndonjëherë ky gadishulli ynë.

të tjera në lidhje me shtetin

Në lidhje me shtetin si institucion ka shumë për të folur. U tha diku më parë që as në shkallë botërore **etatologjia** nuk është në lartësinë e duhur. Në përgjithësi shkencat sociale në Botë në kohën tonë janë në nivelin e të quajturave shkencë ekzakte. Por, për ne shqiptarët është më se e ngutshme ta kuptojmë që, **100 vjet mbas Shpalljes së Pavarësisë** ne ende nuk e kemi një model të shtetit **funksional**. Në popull, këtu në Republikën e Shqipërisë, por tash së voni edhe në Republikën e Kosovës, po thuhet: “**Ne nuk kemi shtet.**” Thuhet kështu me domethënie që ne shqiptarët nuk kemi një shtet **funksional**. Dhe kjo, fatkeqësisht, është shumë e vërtetë. Në një vend ku një polic, rrugor apo finciar, mund të të dënojë pa të drejtë dhe të mos pushohet nga puna, jo më pa e denoncuar, por as kur e denoncon i dëmtuari, kuptohet që shteti s’është as për afërsisht **funksional**. Në një vend ku nëpunësi të merr ryshfet dhe nuk pushohet, ku

gjykatësi merr ryshfet dhe nuk burgoset, ku doganieri nuk e bën zhdoganimin si duhet ta bëjë dhe nuk dënohet, është krejt e kuptueshme që aty shteti s'është **funksional** as përafërsisht dhe mund të thuhet me indinjatë që aty shteti s'është për tjetër veçse për të rjepur e xhvatur kush të mund e kë të mund.

Janë sajuar gjithfarë justifikimesh, është thënë që e kemi fituar vonë pavarësinë, është thënë që populli ynë ishte mbi 90% analfabet. Të gjitha këto janë të pranueshme deri diku, por e vërteta është se as shtetet që kemi rrotull nuk janë çliruar prej Turkut kushedi sa kohë para nesh. Nuk janë çliruar kushedi sa kohë para nesh, por ia kanë arritur të ndërtojnë **për vetë** shtete mjaft funksionalë. Madje, ata arritën që brenda 2 a 3 dhjetëvjeçarësh jo vetëm të ndërtojnë **për vetë** shtete funksionalë, por edhe të armatosen e të sulmojnë tokat tona për t'u zgjëruar. Ne nuk arritëm as t'i mbrojmë as t'i çlirojmë pjesët e paçliruara të Atdheut tonë. Përkundrazi, na pushtuan përsëri më 1939-n dhe i thirrëm në ndihmë ushtritë e huaja disa herë në vitet 1990. Thirrëm ushtritë dhe po i thërrasim, për turpin tonë, sa herë që po bëjmë zgjedhje, qindra të huaj për të na **mbikqyrur**. Kroacia s'pat aspak nevojë as për UNMIK, as për EULEKS. Ne na u "*deshën*" edhe UNMIK-u, edhe EULEKS-i.

Është thënë dhe thuhet që "*shqiptarët nuk kanë aftësi shtetformuese*". Pa marrë parasysh që këtë e thotë propaganda antishqiptare, ne nuk na lejohet të jemi indiferentë ndaj të tilla thënieve. Në këtë **100-vjetor të Pavarësisë** gjëja më e ngutshme për ne është t'i bëjmë realisht funksionalë të paktën 2 shtetet shqiptarë, në mënyrë që Kombi ynë ta përjetojë më në fund realisht lirinë e vet. **Të përjetosh më në fund lirinë e vet kombëtare, mbi të gjitha duhet të kesh arritur të ndërtosh një shtet më të mirë se shteti i ish-robëruesit tend.** Ndoshta s'mund të bëhet brenda ditës më i pasur, por të paktën të jetë shtet i mirë, shtet dashamirës, shtet i përzemërt, shtet me

disiplinë dhe mbi të gjitha shtet që nuk u lë hapësirë veprimi individëve negativë.

Por **shtetin**, qoftë funksional, qoftë jofunksional, formal, absolutist, vasalist, mjerimndjellës, e **ndërtojnë** ata që kanë në dorë pushtetin, që do të thotë **të pasurit e një vendi**. Që të kemi shtet të mirë, **është e nevojshme që të pasurit shqiptarë**, siç është thënë edhe herë tjetër, **të jenë të edukuar në frymën e patriotizmit**. Vetëm ashtu do të mund të ketë shtet të mirë Kombi ynë.

Populli, pjesa e tij e mesme dhe e varfër, s'ka tjetër në dorë, përveç presionit të fjalës dhe presionit të votës. Por kjo s'është pak. Një popull patriot, me anë të fjalës së vet të përditshme dhe me anë të votës së vet, e detyron të quajturën klasë politike të mos i largohet **patriotizmit**.

Mirëpo, jo shumë kohë më parë dëgjuam në television që 2 të tretat e nxënësve në Republikën e Shqipërisë (për Republikën e Kosovës s'u tha gjë) e praktikojnë të quajturin kopjim nëpër provime. Si mund të pritet ta dojë Atdheun, të jetë patriot, një tillë ri, i cili nuk di të dojë as veten?! E pra, pikërisht këtu fillon fatkeqësia jonë: Te bankat e shkollës.

Pyes një ish-nxënës që sapo ka mbaruar shkollën e mesme: *“Çfarë mësove në këto 12 vjet?”* *“Mësova me kopju detyrat.”* *“Cila ish lënda më e dashur për ty?”* *“Me i kopju zushës mu në bankë të parë e ajo mos me më kapë.”* *“A nuk gjete dot ndonjë lëndë më të bukur?”* *“Qysh!?”* Heshtim një hop. Unë s'kam gjë tjetër për t'i thënë. Ai, me sa duket, e kupton që duhet të më sikterisë dhe më thotë: *“Ti, plako, qenke trap fare! Ti s'marrke vesh nga dynjaja!”* Ky është sistemi ynë arsimor!

Njeriu duhet ta dojë veten në mënyrë **racionale**, dmth në mënyrë të mençur, jo si një shkurtpamës. Një i ri që e paguan patentën e shoferit, shpeshherë më shumë se tarifa, pa e mësuar siç e kërkojnë rregullat zanatin e shoferit, nuk e do veten në

mënyrë **racionale**. Ndaj dhe shumë prej tyre gjejnë vdekjen nëpër autostrada, duke i lënë në mjerim nënat e veta. Një student që e detyron familjen të paguajë shuma jo të vogla, jo për të studiuar, por thjeshtë për të marrë një diplomë, nuk i do në mënyrë **racionale** as veten, as familjen. A mund të shpresojmë që të këtuillë njerëz të keqvetedukuar të mund ta duan në mënyrë të mençur Atdheun e vet dhe Kombin?

Një i tillë popull vetëkuptohet që s'ia ka haberin mënyrës se si mund të detyrohet një parlament për të nxjerrë ligje të mirë. Një i tillë popull s'ia ka haberin as mënyrës korrekte të të votuarit.

I vetmi organizëm që do të mund ta mësonte Kombin tonë si ndërtohet praktikisht një shtet funksional, madje edhe ai pas shumë mundimesh të përditshëm, është organizimi që unë e kam quajtur **Përkujdesja Gjithshqiptare**. Prandaj, vetëm atëherë kur kjo **Përkujdesje** të ketë në radhët e veta **5 milionë anëtarë**, vetëm atëherë do të mund të thuhet që Kombi Shqiptar do të mund t'i shpëtojë rrezikut të vetëshuarjes.



Po e mbyll më në fund këtë libër të vështirë. Shkrova më se 1300 faqe dhe po publikoj vetëm 250 prej tyre. Shpeshherë më janë lagur shpinat e duarvet dhe gishtat duke fshirë fytyrën. Prej gishtavet të lagur lotët kullonin mbi tastiera dhe së andejmi përlotej edhe bota elektronike e kompjuterit. Por, të gjitha këto s'janë tjetër veçse qurravitje krejt të kota e pa pikë vlere, nëse nuk do të lëvizin në kahun e duhur shpirtërat dhe mendjet e miliona bashkëkombasvet të mi.

Tash s'më mbetet tjetër veç t'u them atyre shqiptarëve që janë më të rinj se unë dhe atyre që ende s'kanë lindur: ***Bëhuni zbatues të kësaj strategjie dhe do ta keni jetën të mbushur plot***

me arsye për të jetuar sa më gjatë! Secili prej jush i ka aty edhe këndelljen e përditshme të shpirtit, edhe lavdinë personale të përjetësisë.

Pjezë, 16 mars 2011.
G.J.D.

NAMIK SELMANI

NJË SHKRIMTAR MIDIS TIVARIT DHE MATTIT

Bashkë me mikun tim, piktorin çam, Njazi Hyseni, kaluam këto ditë pragun pragun e shtëpisë së Dabajvet. Mustakthinjuri Gjokë Dabaj, e zonja e shtëpisë, Fotinia, bijë Përmeti, mbesë e një patrioti shumë të shquar, na pritën në një shtëpi ku vinte aromë lulesh, aromë mollësh, musht rrushi dhe shumë, shumë skeda që rrinin në tavolinën e tij të punës afër kompjuterit.

Gjoka ishte një rrëfyes i jashtzakonshëm. I ëmbël në ligjërim. I rrallë në mirësjellje e në atë të folur plot dritëzim të shpirtit shestanas.

Brijedh nga një familje e njohur shestanasë e rrethit të Tivarit, e përmendur, për mirë, qysh në fillimet e shekullit XVII. Ka lindur më 25 shkurt 1938 në Kadi Qoi, një prej lagjevet më në zë të Stambollit. Rritur: Verës në fshatin Gurrzë të Shestanit, dimrit në fshatin Krythë të Ulqinit. Shkollimi fillor: Në vjeshtë e në pranverë në Dedanj të Shestanit, në dimër në fshatin Salç të Ulqinit. Klasën V e VI në qytetin e Ulqinit, klasën VII e VIII të 8-vjeçares në

qytetin e Tivarit. Të 8 klasët sllavisht. Ndërprerë shkollimin për shkaqe ekonomike nga viti 1954 deri më 1957. në vitin 1957 shkon me bursë në Shkollën e Mësuesisë në Nikshiq të Malit të Zi. Përsëri sllavisht.

Në vitin 1960 largohet prej Nikshiqit, me qëllim që shkollimin ta vazhdojë në gjuhën shqipe. Regjistrohet në Normalen e Prishtinës, ku orën e parë të mësimit në gjuhën shqipe e zhvillon me Prof. Demush Shalën, pikërisht me “Vajin e Bylbylit” të Ndre Mjedës. Nuk mbeten pa u përlotur, as nxënësi, as profesori. Në Prishtinë s’qëndron veçse 3 muaj, pasi nxënësit shqiptarë që vinin prej Republikës së Malit të Zi, transferohen me urdhër prej Prishtinës në Gjakovë.

Në pranverë të vitit 1961 Gjokë Dabaj realizon në konviktin e Normales së Gjakovës një nga revoltat e para të një tipi të ri organizimi me metodën 1+3, tip i cili më vonë do të praktikohet masivisht me shumë sukses në krejt Kosovën. Revolta merr shkas gjoja për shkaqe ekonomike, por në të vërtetë me qëllim për të nxitur dhe forcuar midis rinisë gjakovare dhe asaj jogjakovare ndjenjën e përbashkimit për kauzën e Kombit. Revolta rezulton shumë e suksesshme. Midis gjimnazistëve qytetarë dhe normalistëve që vinin nga krahina të ndryshme, pas grevë-demonstratës, ndihmuar edhe prej pjesës më të madhe të pedagogëve, krijohet një

osmozë e jashtzakonshme përkrahjeje reciproke, gjë që UDB-s dhe pushtetmbajtësvet slave nuk u interesonte kurrsesi. Me atë rast, Gjokë Dabaj, falë qëndresës deri në përmasa të heroizmit nga ana e shokëvet, shpëton pa u zbuluar prej UDB-s dhe pa iu dorëzuar gjyqit.

Në vitin e ri shkollor 1961-1962, detyrohet të kalojë në Prizren, për të mos e ndalur as atje veprimtarinë politico-patriotike, së cilës tashmë i kishte hyrë me gjithë forcën e vet intelektuale dhe shpirtërore. Boton poezi dhe lëndë folklorike në revistën *“Jeta e Re”*. Përkrahet fort nga kryeredaktori i asaj reviste Esat Mekuli. Në almanakun e Normales së Prizrenit arrin të botojë, në gjuhën sllave, një poemth-manifest, në të cilin shprehej alegorikisht përcaktimi i gjeneratës, së cilës i përkiste, për t’u shkëputur prej Jugosllavisë dhe për t’iu bashkuar Republikës së Shqipërisë. Ndërsa poezitë e tjera të tijat, sidomos ato me titull *“Pse”* dhe *“Nesër”*, botuar në *“Jetën e Re”*, njohën një përhapje gati të çuditshme ndër lexuesit e asaj kohe, poemthi-manifest *“Ia refuzoj dashurinë hanxheshës”* nuk arriti të njihet, veçse në një rreth të kufizuar lexuesish në shkollat e mesme të Prizrenit.

Në pranverë të vitit 1962 krijohet në Prizren një nga grupet ilegale politico-patriotikë nga më gjurmëlënësit të krijuar në Kosovë para vitit 1968, me emrin *“Liria”*. Një prej themeluesvet të atij grupi ishte edhe Gjokë Dabaj. Programi që pat formuluar ai grup, në bashkëpunim sidomos midis

drejtuesit të grupit, Bedrush Çollaku dhe Gjokë Dabajt, Haxhi Zybës e Fadil Cukajt, ka qenë ndër më realët dhe më larpamësit e kohës. Brenda 2-3 muajsh grupi, ndonëse në rrethana tejet të rënda e të rrëzikshme ilegaliteti, ka arritur të lidhet edhe me Adem Demaçin, i cili në ata vite qëndronte në krye të një organizate të madhe gjithkosoare e më gjërë. Në krye të asaj organizate vepronte organi i saj drejtues me emërtimin kuptimplotë: Komiteti Organizativ për Bashkim. Bedrush Çollaku i transmeton atij Komiteti një mendim që kish lindur në grupin “*Liria*” për të deleguar një anëtar të vetin në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të vihej në dijeni shteti shqiptar mbi ekzistencën e kësaj organizate, programin e saj, shtrirjen, numrin, përbërjen arsimore të anëtarëve dhe nevojat për ndihmë e instruksione. Do thënë këtu që Republikën e Shqipërisë anëtarët e kësaj organizate e quanin thjeshtë “*zonë e çliruar e Shqipërisë*” e cila e kish për detyrë të punonte e luftonte për çlirimin e zonave të tjera të paçliruara.

Në qershor të vitit 1962, Bedrush Çollaku, kryesuesi i grupit “*Liria*”, i jep Gjokë Dabajt, në emër të Komitetit Organizativ për Bashkim, detyrën për të kaluar kufirin, për të çuar memorandum (promemorjen, gojarisht e jo të shkruar) dhe për t’u kthyer në Kosovë brenda 6-7 ditësh, natyrisht, nëse një gjë të tillë do ta shihnin të arsyeshme organet e shtetit shqiptar. Për të bërë të mundur që çuarja gojarisht e memorandumit, e promemories,

Bedrush Çollaku, i kontaktuar me Adem Demaçin e ndoshta edhe me dikënd tjetër (kjo është marrë vesh vetëm mbas vitit 1990), ka bërë me Gjokë Dabajn konsultime për gati 2 javë rresht.

Më 7 korrik 1962, Gjokë Dabaj kalon kufirin në pikën kufitare të Taraboshit, i përcjellë deri në kufi nga shoku i grupit Fadil Cukaj. Mbahet nën hetime 4 muaj, plotësisht i izoluar. Mbas 4 muaj hetimesh, çohet në Tepelenë. Atje punon 5 vjet si punëtor i thjeshtë në një ndërmarrje bujqësore lokale. Mbas 4 vjetësh e gjysmë, për shkak se segmente të caktuar të pushtetit, pas gjasës të dirigjuar prej agjunkturës projugosllave, e cilësojnë Gjokë Dabajn si “armik” të Shqipërisë dhe e shpallin si të tillë në një mbledhje punëtorësh, shokë me të cilët kish punuar gjithë ata vite. Për të vërtetuar që nuk ishte armik, madje duke kundërakuzuar si armiq sekretarin e organizatës-bazë të Partisë (PPSH) dhe kryetarin e organizatës profesionale të atyshme, Gjokë Dabaj bën një grevë urie 5-ditore. Mbas kësaj, i njoftuar ndoshta prej Degës së Punëve të Brendshme të Tepelenës, po edhe prej Namik Lucit, një studenti nga Peja që vinte në Tepelenë, se ishte i martuar aty, njëri prej drejtuesvet të Ministrisë së Brendshme, Skënder Backa, vendos që Gjokë Dabajt t’i jepet bursa dhe ndërhyrje që t’i jepet shtetësia shqiptare.

Nuk ish vetëm Gjokë Dabaj, të cilit në ata vite i jepej e drejta e studimevet. Në atë kohë paten ardhur në fakultete të ndryshëm në Tiranë mbi 100 studentë

nga të gjithë viset shqiptarë të përtejkuqurit. Në vitin 1970 martohet me një vajzë nga Përmeti, njohur në Tepelenë, dhe vendoset për të banuar përkohësisht në familjen e Rifat Kuçit, një patrioti të merituar nga Suhareka dhe ish-profesorit të vet nga Normalja e Prizrenit. Rifat Kuç i lëshon çiftit të sapomartuar një dhomë në banesën e vet. Bashkëshortja, Fotini Barko-Dabaj, punon 1 vit si mësuese gjuhe në një fshat të Korçës.

Në vitin 1971 Gjokë Dabaj diplomon në gjuhë shqipe dhe letërsi dhe emërohet mësues në rreth të Matit. Punon, së bashku me bashkëshorten, në fshatin Fullqet deri në vitin 1976, kur mbas një dënimi 6-mujor pune korrektuese në kooperativë, transferohet në shkollën e mesme të Klosit. Në vitin 1979 kalon me banim në fshatin fshat. Në vitin 1982 i jepet përfundimisht banesë në qytezën e Klosit.

Për më se 20 vjet qëndrimi në trevën e Kryematës, Gjokë Dabaj ka zhvilluar një punë gjurmëlënëse në fushën e mësimeve, kërkues dhe praktikues i metodave shumë efektive, botuar edhe në shtypin e kohës, gjurmues e grumbullues i pasurisë folklorike e etnokulturore të zones, hartues i një vargu temash shkencore, si nga fusha e pedagogjisë, ashtu edhe në folklore e gjuhësi, veçanërisht në leksikografi. Në mënyrë të veçantë ai bën përpjekje për të pasuruar e vënë realisht në përdorim të bibliotekave shkollore në fshatin Fullqet dhe në shkollën e mesme të Klosit. Në shkollën e Klosit,

nga 400-500 copë libra që gjen, arrin të krijojë një bibliotekë me rreth 12000 ekzemplarë. Jo bibliotekë që, siç ndodhte në shumë raste, të mbahej e kyçur nën dry, por bibliotekë, e cila shfrytëzohej me punë të përditshme, tërësisht të papaguar.

Gjatë këtyre viteve çiftit Dabaj i lindin 5 fëmijë. Fëmijët rriten në kushtet e një jete jashtzakonisht intensive, të shtërngimevet ekonomikë, po edhe të përmbysjevet të mëdha. Bëhen që të gjithë inxhinierë dhe arkitektë.

Në vitin 1991 Gjokë Dabaj tenton të aktivizohet në politikë. I tërhequr nga emri “Kombëtar” i një partie, bëhet anëtar dhe madje nënkryetar i sajë. Por shumë shpejt zhgënjehet rëndë.

Në vitin 1993, duke shitur në Tivar një tokë të trashëguar, blen një tokë dhe muranën e një shtëpie në fshatin Pjezë në afërsi të Shijakut. Me shumë mundime, me punën e djemvet në megrim, familja e tij arrin ta bëjë të banueshme muranën e blerë. Gjokë Dabaj ndërkohë vendos të merret me krijimtari. Del në pension para kohe. Sistemon krijimtarinë e deriatëhershme. Shkruan, lexon, skedon pa ndërprerje. Njëkohësisht, për të kontribuar sadopak në të ardhurat e familjes, ruan e ushqen për më se 10 vjet nga një lope e nga një viç, që i kullot në tokën e vet, po edhe anash kanalevet e rrugëvet.

Në vitin 1995 fillon të shkruajë një libër për

krahinë e Shestanit. Merr nxitjen dhe një ndihmë të vogël në të holla nga një biznesmen shestanas, që quhet Mitër Pekaj nga Brisku e me punë e banim në Çikago. Lexon një literature shumë të gjërë, skedon me mijëra skeda, grumbullon rreth 800 fotografi, pjesën më të fotografivet e bën vetë, duke shkelur me këmbë krejt krahinën. Mbledh mbi 2000 toponime, sistemon dhe komenton përmbi 150 këngë që kish mbledhur qysh në moshën 20 vjeç prej njerëzish që tashmë nuk jetonin, harton një monografi mbi të folurit e Shestanit, bën një përshkrim etnokulturor të krejt krahinës, shkruan një panorama historike 3000-vjeçarere nëpër të cilën ka kaluar Shestani, dhe në fund, në vitin 2004 del në dritë libri voluminoz i formatit A4, me lidhje të forte, në 2 vëllime, me gjithsej rreth 1400 faqe, i titulluar: “*Shestani, studim filologjik gjithpërfshirës*”. Promovimi i bëhet në Ulqin. Pjesëmarrja në promovim është e jashtzakonshme. Aty marrin pjesë përmbi 500 vetë, shestanas, ulqinakë, anamalas dhe kranjanë. Në shtypin ditor botohen disa shkrime ku i bëhen atij libri vlerësime me superlative, duke e quajtur enciklopedi (e një krahinë), krestomaci etj.

Patí edhe 2 reagime negative: njëri në një gazette malaziasë prej një shqiptari promalazias, i cili nuk dëshiron që Shestani të quhet krahinë shqiptare dhe tjetri në internet prej një shqiptari proislamik, i cili mendon se patriotizmi shqiptar buron te islamizmi dhe se kombi shqiptar duhet t'i jetë mirënjohës për ekzistencën e vet pjesës së myslimanizuar.

3 librat që u botuan mbas vitit 2004, ishin me vargje poetikë, të quajtura përsiatje. “Ta kisha një forcë të madhe”, botuar në Ulqin në 2 gjuhë, shqip edhe sllavisht. “Prush plagësh të pambyllura”, elegji kushtuar të masakruarvet të Tivarit, botuar në Prishtinë 39 vjet mbasi ishte shkruar. “Prush mbi ujë”, përsiatje me përmbajtje social-patriotike të kohës sonë, botuar në Tiranë. Libri V, botuar në vitin 2011 nga Qendra e Studimevet Albanologjike në Tiranë, është “Fjalori i Selman Rizës”, i cili përmban rreth 4000 fjalë karakteristike të vjelura prej veprave të gjuhëtarit tone të shquar, të cilat nuk gjenden në fjalorët tanë ekzistues.

Simbas fjalëve të vetë autorit, asnjëri prej këtyre librave nuk është kërkuar në tregun e shitjes. Përsiatja “Ta kisha një forcë të madhe”, shkruar edhe në gjuhën sllave, nuk ka arritur as të shpërndahet midis shqiptarëve të Tivarit, që nuk dinë të lexojnë shqip, ndërsa shqiptarët që dinë të lexojnë shqip, as që e kanë kërkuar, ndonëse, kur aktori Simon Shkreli e ka recituar në tubimin promovues të librit “Shestani”, shumë prej të pranishmëve janë përlotur. Elegjinë “Prush plagësh të pambyllura” e pat përgatitur në formë recitali aktori ynë i njohur Çun Lajçi, por recitali nuk u realizua, siç duket nga droja se mos na zemërohen bijtë dhe nipërit e masakruesvet. Për vëllimin “Prush mbi ujë” kanë marrë në telefon disa nga ata që e kanë lexuar, duke shprehur fjalë lavdëruese, por në treg nuk ka pasur shitje, sepse shoqëria jonë e sotme nuk është e disponuar as

ta durojë kritikën artistike, le më ta pëlqejë e ta kërkojë. Askush nuk dëshiron t'i shohë zorrët e veta mbi tavolinë. Për veprën leksikografike “Fjalori i Selman Rizës”, autori, në respekt të gjuhëtarit Selman Riza, po edhe për të ndihmuar gjuhëpërdoruesit e sotëm të shqipes, ka shpenzuar rreth 2 vjet punë. Ai thotë se ndien kënaqësi të veçantë, kur e kujton të realizuar atë vepër, por as ajo jo vetëm që nuk është shitur, por me ngjasë, as që është shpërndarë nëpër librari.

Ky autor është tani afër të 75-ave. I ka në arkivin e vet edhe nja 20 vepra, përfshirë aty rreth 15 vëllime mbi 200-faqesh me përsiatje poetike, të cilat dëshiron t'i botojë, por që, siç duket, nuk kanë për t'u botuar asnjëherë, sepse mungojnë sponsorët. Mungojnë në Shqipëri Dukët e Vajmarit, siç i pëlqen atij të shprehet nganjëherë, trishtueshëm dhe madje dëshprueshëm.

Ani, ai është aty si Gardian i palodhur i fjalës së mençur shestanase, matjane, por edhe shijakase e durrësake. E lamë në studion e tij me sa e sa skeda, ku ky shestanas, kaq i bukur në shpirt, ka ende shumë punë.

*Marrë nga gazeta “Republika”, 26 gusht 2011, f.16-17, me pak shkurtime.

RRESHTA QË NA JAPIN SHPRESË

Gjithmonë kam pasë mendimin që, të mos kish qenë duka i Vajmatit, i cili i ndihmoi financiarisht Gëten dhe Shilerin, Gjermania nuk do të kish sot as Gëte, as Shiler. Në anë tjetër, të mos ishin Gëteja dhe Shileri, për dukën e Vajmarit as që do të dihej në ka ekzistuar gjëkundi. Të gjithë së bashku, ata që kishin penën dhe ata që kishin paren, e bënë Gjermaninë kaq të përjetshme dhe kaq madhështore sa ç'është sot.

BEDRI HOXHA është një ish-nxënësi im, unë jam një ish-mësues i tiji. Me Selman Hoxhën, të jatin e Bedriut, më ka lidhur një simpati e hershme, për faktin se ai ishte një nga mësuesit më skrupulozë që kam njohur. Gani Hoxhën, vëllanë e Bedriut, e kam njohur fillimisht si një nxënës të qetë dhe të zellshëm, më vonë si një inxhinier nga më të zotët, por edhe ekonomist, dhe më në fund biznesmen po astu i qetë, i kujdesshëm dhe largshikues. Që të 2, edhe Ganiu, edhe Bedriun, arrita t'i shoh më vonë deputetë. Duke i njohur qysh më parë cilësitë e tyre, nuk mund të mos isha krenar, se janë që të 2 ish-nxënës të mi. Për familjen Hoxha në rreth të Matit vlerësimi i përhershëm ka qenë ky: *“Është nga më të mirat familje të Gurit të Bardhë. Është familje tradicionalisht arsindashëse. Bën vetëm punë të mira. Punë të këqia nuk ka bërë kurrë.”*

Kur ia paraqita Bedriut librin tim të radhës, nuk qe nevoja t'i them 2 herë: *“A po më ndihmon?”* Ai më tha vetëm kaq:

“Ta lexoj dhe të kthej përgjigje.” Kjo është tepër mbresëlënëse për një krijues. Por mbresëlënësia më e fuqishme ndodhi më vonë, kur unë e pashë që Bedriu, lekët që do të jepte për librin tim, po i hiqte nga rroga e vet. Madje duheshin pritur 2 rroga, që të hiqeshin pak prej njëres e pak prej tjetres. Bedriu ka një familje, ka 2 fëmijë të vegjël, ka një angazhim shumë të ngjeshur si deputet, ka doemos edhe shpenzime të shumtë. Por ai e gjeti mundësinë për të ndarë diçka edhe për librin tim. Kur u paraqitëm në një shtypshkronjë, na ndodhi prapë një ngjarje tjetër që s’mund të lihet pa u përmendur. Zonjës që na priti, iu prezantova: ***“Unë jam filani, ky është filani, deputet i rrethit të Matit.”*** Bedriut nuk i erdhi mirë. E pashë që u ngushtua. Pak më vonë më tha: ***“Unë nuk i prezantohem askujt si deputet. Madje as policëvet, kur duan të më gjobisin.”***

Të themi në mbyllje edhe që, në këtë përpjekje tonën të përbashkët, për t’i parë Shqipërinë dhe shqiptarët në ditë më të mira, u bë pjesëtar edhe z.ILIR LLESHI, pronar i shtypshkronjës ILAR. Ai, kur mori vesh titullin e librit, nuk tha: ***“Ka q kushton”***, por pyeti: ***“Sa lekë keni?”*** Unë i thashë: ***“Ka q.”*** Dhe aq mbeti shpenzimi i të shtypurit. ***“Të tjerat”*** tha ai, ***“i sponsorizojmë ne.”***

Në këtë mënyrë, sodisfaksioni im është i shumëfishtë. Shpresa ime është shumë e madhe. Shqiptarët vetëm kështu, duke dhënë gjithkush pjesën e vet të kontributit, do të mund ta bëjnë Shqipërinë siç e kanë bërë Gëtet, Shilerët dhe dukët e Vajmarit, Gjermaninë.

Gj.D.

PËRMBAJTJA

NË KËRKIM TË SYVET...-----	Faqe 5.
...NË KËRKIM TË GJENERALËVET-----	5.
MAJA LAPSASH... JETË ROZAFASH -----	8.
CILI ËSHTË ATDHEU I SHQIPTARËVET ?-----	10.
KOMBI SHQIPTAR-----	16.
TANI PO HUAZOJMË PREJ SAMIUT... -----	21.
“SHQIPËRIA Ç’KA QENË?”-----	22.
SHQIPTARËT DUHET TË DIJNË KUSH KANË QENË...-----	23.
Koha parailire -----	24.
Koha ilire -----	34.
Qytetet në Iliri -----	36.
Mbretërit tanë -----	39.
Koha e Pushtimit Romak -----	43.
Mjaftojnë 2 apo 3 rrënjë kalbëse -----	43.
Koha e barabartësisë në në Perandorinë e Romës -----	46.
Zanafillat e të copëtuarit tone -----	49.
Uzarpimi = rirobërimi -----	52.
Sllavët në Gadishullin e Ilirikut -----	53.
Iliro-albanizmat në gjuhët slave -----	60.
SHQIPTARËT DUHET TË DINË: PSE NUK JANË ATA QË	
DUHET TË JENË-----	82.
Tragjeditë -----	83.
TURQIA -----	87.
Prapë barbarët! Ne prapë të paparambrojtur!-----	95.
Një nga dëshmitë e Çamëri së-----	95.
Viti 1912 -----	98.
Viti 1913 -----	100.

Viti 1914 -----	103.
Vitet 1916-1918 -----	104.
Viti 1919-----	104.
Viti 1920 -----	106.
Viti 1921 -----	106.
Vitet 1922 – 1924 -----	108.
Vitet 1941 - 1947 -----	109.
Janar 1943. MASAKRA E BIHORIT. -----	109.
Viti 1944 -----	109.
 SHQIPËRIA Ç’ËSHTË? -----	 116.
ANTIKOZMETIKË-----	118.
REVVY VETINDINJUESE-----	121.
DY PARALELE -----	121.
ARKITEKTURA E SHKATËRRUAR E ATDHEUT -----	121.
ARKITEKTURA E SHKATËRRUAR E SHPIRTIT-----	124.
Në intervistë para vetes -----	127.
Ekonomi e dobët. Përse? -----	128.
FORMULË VETËQORTIMI: NA PLAÇIN SYTË! -----	134.
KËTU KA DIÇKA -----	144.
NJË DIARE KRONIKE -----	165.
A MUND TË SHPRESOJMË ?! -----	167.
Duke pritur 100-vjetorin: KU PO SHKON SHQIPËRIA IME?--	171.
KATASTROFA JONË NË TERMINOLOGJI (SFIDË PYETJESH NË PRAG TË HYRJES NË BE)-----	176.
Sami Frashëri... në <i>Kamus Al-Alam</i> -----	185.
 SHQIPËRIA, SI DUHET TË JETË? -----	 192.
NA DUHEN SHKALLË PËR T’U NGJITUR -----	194.
RRËNJËT NGJALLËSE TË KOMBIT SHQIPTAR -----	198.
DEGËT NGJALLËSE TË KOMBIT SHQIPTAR -----	207.
INSTITUCIONI I PËRKUJDESJES GJITHSHQIPTARE-----	214.
Shqetësimi alarmues -----	214.

